Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje
Kosovo Judicial Institute

JUSTICIA

Revistë shkencore juridike e kandidatëve të Programit të Trajnimit Fillestar 2013/2015 në Institutin Gjyqësor të Kosovës

Prishtinë, 2015

Viti V, Nr 5/2015

JUSTICIA

Revistë shkencore juridike e kandidatëve të Programit të Trajnimit Fillestar 2013/2015 në Institutin Gjyqësor të Kosovës

Viti V, Nr 5/2015

Prishtinë, 2015

Botues

Instituti Gjyqësor i Kosovës

Dizajni dhe radhitja kompjuterike:

Instituti Gjyqësor i Kosovës

Publikuar nga Instituti Gjyqësor i Kosës

Publikimi i kësaj reviste u mundësua nga Deutsche Gesellschaft für Internationale

Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Reformës Juridike në Kosovë, i angazhuar nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Të nderuar lexues,

Me kënaqësi po u drejtohem përmes kësaj reviste juridike, publikimi i të cilës tashmë është bërë traditë e çdo gjenerate për gjyqtarë dhe prokurorë, duke zënë vend të çmueshëm në literaturën juridike si dhe në publikimet e IGJK-së.

Kjo revistë përmban punimet e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të cilët vijojnë Programin e Trajnimit Fillestar të IGJK-së. Revista përmban tema të ndryshme që trajtojnë institute të ndryshme të së drejtës, aspekte të ndryshme nga legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar si dhe nga praktika gjyqësore.

Qëllimi i kësaj reviste juridike përveç formimit dhe ngritjes së shkathtësive të kandidatëve në sferën e hulumtimit dhe shkrimit ligjor është edhe ofrimi i mbështetjes profesionale për juristët e rinj, gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët tjerë ligjor në Kosovë e më gjerë.

Revista Justicia botohet nga secila gjeneratë e kandidatëve të Programit të Trajnimit Fillestar dhe ky është numri i pestë (5) i saj. Temat e kësaj reviste përzgjidhen dhe redaktohen nga vet kandidatët.

Nga leximi i gjashtëmbëdhjetë punimeve në këtë revistë vërehet se kandidatët kanë studiuar dhe analizuar posaçërisht çështjet juridike të cilat ishin temë e ndryshimeve në legjislacion si dhe instituteve ligjore të cilat shkenca juridike në Kosovë ka nevojë që ende t'u kushtojë vëmendje.

Shpresojmë se temat e trajtuara në këtë numër të revistës "Justicia" do të ofrojnë informacione të duhura dhe do t'u shërbejnë gjithë profesionistëve ligjor dhe lexuesve të tjerë që të kenë para vetës një mundësi për të njohur perspektiva të ndryshme.

Mr.Sc. Lavdim Krasniqi

Drejtor i Institutit Gjyqësor të Kosovës

Murat Hulaj* **Sabahate Beqiri***

POZITA JURIDIKE E GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE NË RELACION ME SUBJEKTET TJERA GJATË HETIMEVE PARAPRAKE

ABSTRAKT

Në kohë të fundit jemi dëshmitarë të ndryshimeve të shpejta në legjislacionin e procedurës penale pothuajse në të gjitha shtetet e Evropës Perëndimore. Këto ndryshime janë në drejtim të avancimit të mbrojtjes së të drejtave individuale dhe përshpejtimit të procedurës penale, ndryshime këto që nuk kursyen as Evropën Juglindore dhe as shtetin e Kosovës. Karakteristikë e këtyre ndryshimeve është nxjerrja e Kodit të Përkohshëm Penal dhe atij të Procedurës Penale të Kosovës, për herë të parë në vitin 2004 nga Parlamenti i Kosovës, me qellim që sistemi gjyqësor të jetë më funksional në krahasim me atë që ishte sipas LPP të sistemit të kaluar.

Me fillimin e zbatimit të KPPK-së, filloj një qasje krejt ndryshe e rolit të organeve të Drejtësisë, Policisë, Prokurorive dhe Gjykatave, meqë u bë një kalim prej sistemit inkuizitor në atë akuzator pasi që i pari u konsiderua i pa dobishëm dhe jo funksional. Në sistemin akuzator, tani në aplikim, kompetencat e hetimeve që më parë i kishte gjyqtari hetues kaluan tek prokurori i shtetit e që një veprim të tillë më herët e kishin ndërmarrë pothuajse gati të gjitha shtetet e Ballkanit.
Në mesin e shumë risive të pasqyruara në KPPK, është përcaktimi i pozitës dhe rolit të veçantë të gjyqtarit të procedurës paraprake. Me KPPK, i cili ka hyrë në zbatim nga 1 janari 2013 është avancuar më tutje pozita e gjyqtarit të procedurës paraprake.

Fjalët kyçe: **Gjyqtari paraprak, roli, autorizimet, kompetencat, subjektet tjera etj.**

* Mr. sc. Murat Hulaj, Bashkëpunëtor Profesional në Prokurorinë Themelore – Pejë, Kandidat për Gjyqtar në Gjeneratën e V-të të PTF.

* Sabahate Beqiri, Bashkëpunëtore Profesionale në Prokurorinë Themelore, Kandidate për Prokuror në Gjeneratën e V-të të PTF.

Hyrje

Karakteristikë themelore në procedurën paraprake është se gjyqtari i procedurës paraprake, nuk merr asnjë veprim sipas detyrës zyrtare me një përjashtim të vogël por gjithnjë sipas propozimeve të arsyeshme ligjore të palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë në situatat dhe kushtet e parapara sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës në zbatim nga 1 janari i vitit 2013, atëherë kur duhet të vendoset lidhur me kufizimin e lirisë dhe të drejtave të personit. Mbase në këtë drejtim Kodi i Procedurës Penale do të mbajë parimin e barazisë së palëve në këtë aspekt edhe në procedurën paraprake ku roli i prokurorit të shtetit është dominant. Edhe pse veprimet, vendimet dhe urdhëresat merren në propozim të palëve e asnjëherë sipas detyrës zyrtare këto veprime të gjykatësit të procedurës paraprake kanë rol të rëndësishëm meqenëse vendoset për liritë dhe të drejtat e personit përkatësisht kufizimit të tyre, ndërkaq veprimet hetimore të prokurorit dhe të policisë fitojnë legjitimitetin në këtë aspekt. Ndërkaq në rast se do të ndërmerreshin veprime të tilla pa vënien në dijeni përkatësisht lëshimin e urdhëresave nga gjykatësi i procedurës paraprake veprimet e tilla do të përbënin prova të papranueshme në procedurë penale që zhvillohej në gjykatë, më saktësisht që përcaktohet sipas përmbajtjes së nenit 257 paragrafi 2 të KPPK[1].

Roli dhe aktiviteti i gjyqtarit të procedurës paraprake vihet në lëvizje duke marrë vendime përkatëse, urdhëresa të caktuara vetëm e vetëm sipas propozimit të palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurën paraprake. Më saktësisht në vijim të kësaj teme, do mundohemi të pasqyrojmë rolin dhe kompetencat e gjyqtarit të procedurës paraprake sipas kësaj radhe:

1. Vendimet, urdhëresat sipas propozimit të prokurorit të shtetit-policisë,
2. Sipas propozimit të të pandehurit e mbrojtësit të tij dhe
3. Vendimet, urdhëresat sipas propozimit të te dëmtuarit, përfaqësuesit të tij ligjor dhe të autorizuar.

1. Vendimet, urdhëresat sipas propozimit të prokurorit të shtetit-policisë

1.1. Fillimi, vazhdimi, zgjerimi dhe pushimi i hetimeve.

Prokurori i shtetit me të vendosur që të fillon hetimet[2] për rastin që e ka para vetës në shqyrtim dhe pas analizimit të kallëzimit penal, më të gjetur se në përmbajtje ekziston dyshimi i bazuar se ndaj të paraqiturit ekzistojnë elementet se ka kryer vepër penale të caktuar, për të ardhur në ndriçim të rastit penal, prokurori kryen veprime joformale, kryen edhe ato formale duke marrë aktvendim me shkrim mbi fillimin e fazës se hetimeve ku menjëherë një kopje ia dërgon gjyqtarit të procedurës paraprake në mbështetje të nenit 104 paragrafi 1 të KPPK-së[3]. Ky

[1] Sipas paragrafit 2 theksohet se provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.

[2].Neni 102 paragrafi 1 të KPPK-së, faqe 45.

[3] Neni 104 par.1 percakton se Hetimi fillohet me aktvendim te prokurorit te shtetit. Aktvendimi percakton personin kundër të cilit do të kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e vepres penale dhe elementet e sajë, Neni [3] Neni 104 par.1 përcakton se Hetimi fillohet me aktvendim te prokurorit te shtetit. Aktvendimi përcakton personin kundër të cilit do të kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e veprës penale dhe elementet e saj, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale, nëse masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit apo hetimit janë autorizuar dhe provat me të dhënat e mbledhura deri në atë moment.

veprim i prokurorit ka edhe rëndësinë praktike të këtij akti meqenëse prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi do të llogaritet kohëzgjatja se një person ka qenë nën hetime në një periudhë të caktuar por jo më gjatë se 6 (gjashtë) muaj nga fillimi i hetimeve, meqenëse për kohëzgjatjen më të madhe nevojitet autorizimi i veçantë nga gjykatësi i procedurës paraprake.

1.2. Detyrimet e Prokurorit të Shtetit ndaj Gjykatësit të Procedurës Paraprake

Prokurori i shtetit gjithashtu obligohet që të njoftojë gjykatësin e procedurës paraprake për zgjerimin e hetimeve dhe atë përshtatshmërish sipas nenit 157 paragrafi 3 të KPPK, si dhe me faktin e pezullimit të hetimeve në mbështetje të nenit 157 paragrafi 4 të KPPK.

Në rastet kur hetimet nuk përfundojnë brenda periudhës dy vjeçare, prej ditës së fillimit të hetimeve prokurori duhet të paraqesë kërkesë me shkrim gjyqtarit të procedurës paraprake, së bashku me arsyet për zgjatjen e hetimit (neni 159 paragrafi 2 i KPPK).

1.3. Kërkesat e Prokurorit të Shtetit - detyrim përgjigjeje për Gjykatësin e Procedurës Paraprake?

Gjykatësi i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim të hetimit edhe për 6 muaj të tjerë, kur kjo sipas kërkesës së prokurorit arsyetohet me ndërlikueshmërinë e çështjes. Për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me të paktën 5 vjet burgim gjykatësi i procedurës paraprake sipas kërkesës së re mund të autorizojë edhe një vazhdim deri në 6 muaj. Nëse edhe në këtë periudhë nuk janë kryer hetimet duke u arsyetuar me ndërlikueshmërinë e çështjes vetëm Gjykata Supreme e Kosovës përjashtimisht mund të autorizojë edhe një vazhdim prej 6 muajsh.

Pas marrjes së kërkesës për vazhdim të hetimeve gjykatësi i procedurës paraprake do të njoftojë të pandehurin dhe të dëmtuarin për hetimin dhe kërkesën e prokurorit të shtetit për vazhdimin e tij. I pandehuri dhe i dëmtuari kanë të drejtë të paraqesin deklaratat e tyre lidhur me vazhdimin e hetimit brenda 3 ditëve nga njoftimi. Vendimi i gjykatësit të procedurës paraprake lidhur me vazhdimin e hetimit i nënshtrohet ankesës nga palët dhe i dëmtuari.

Prokurori i shtetit i cili ka parashtruar kërkesë për zgjatje të hetimit dhe gjatë periudhës pritëse të vendimit për zgjatje hetimesh, prokurori në situata kur zhvillon hetime edhe pse pa marrë vendimin formal për shkak të situatave të ngutshme për të siguruar prova, është i obliguar që ta njoftojë gjyqtarin e procedurës paraprake.

1.4. Mbledhja e provave dhe ekspertizat

Marrë parasysh faktin se provat janë produkt i procedurës penale, në të kaluarën provat kryesisht janë pranuar si të ligjshme sepse ato siguroheshin përmes urdhrit të gjyqtarit apo prokurorit dhe si të tilla përfshiheshin në aktakuzë dhe pastaj pranoheshin nga gjyqtari për konfirmim. Ky proces normal ishte formal dhe mund të mos garantojë mbrojtjen e të drejtave

të palëve dhe as t'i shërbente interesave të drejtësisë, pasi që provat jo të plota mund të pranohen apo provat e rëndësishme, marrja e të cilave nuk është urdhëruar mund të humben.

Sipas kodit aktual në zbatim nga 1 Janari 2013, roli dhe rëndësia e provave është më e sofistikuar, posaçërisht gjatë fazave më të hershme e që ndërlidhet me veprimet fillestare. Sa për ilustrim, sipas nenit 70 policia mund të sigurojë prova gjatë hapave fillestarë pa mbikëqyrjen e prokurorit por personi i cili mbledh provat nga ana e policisë duhet të jetë mirë i trajnuar dhe duhet të jetë i aftë dhe në gjendje për ti shpjeguar veprimet e ndërmara prokurorit, e më vonë edhe gjykatësit dhe kjo mënyrë lehtë i bën provat e transportueshme (të pranueshme) – neni 150 paragrafi 7 dhe 8 që janë marrë pa urdhër hetimi nga prokurori apo gjyqtari. Kjo bënë për të kuptuar se rolet e pjesëmarrësve në procedurë në dekadën e fundit kanë ndryshuar dukshëm në krahasim me të kaluarën.

Përderisa me dispozitat të KPPK-së, të mëparshëm sipas dispozitës së nenit 176 theksohet se ekspertimin e urdhëron gjykata në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, mbrojtësit të të pandehurit apo të dëmtuarit, pa dashur të bëjë përjashtimin ndonjëherë sipas detyrës zyrtare. Ndërkaq sipas nenit 139 par.1 gjykata çdo herë urdhëron që të bëhet inspektimi i kufomës dhe autopsisë, kurse neni 187 ekspertimin e drejton gjykatësi i procedurës paraprake. Për dallim, KPPK-ja që është në fuqi, sipas nenit 137 përcakton se prokurori i shtetit mund të nxjerrë vendime për caktimin e ekspertit duke marrë parasysh edhe propozimet e palëve në procedurë, që këta të fundit mund t'i shfaqin mospajtime duke dhënë secili propozimet individuale. Kjo përzgjedhje mund të sfidohet nga i pandehuri apo pala e dëmtuar[4], ashtu që gjyqtari i procedurës paraprake duhet të merr vendim përkitazi me sfidimin brenda dhjetë ditëve. Sipas nenit 141 i pandehuri mund të kërkojë që prokurori i shtetit ta caktojë ekspertin, ose mund ta paguajë vetë ekspertin. Nëse paraqiten mendime të kundërta të të dy ekspertëve atëherë gjyqtari apo prokurori i shtetit mund të kërkojnë mendimin e një eksperti tjetër.

Gjithashtu gjykata urdhëron që për materiet e dyshimta të gjetura në kufomë, të kryhen analizat toksikologjike[5]. Ndërkaq sipas nenit 144 paragrafi 4 ekzaminimi fizik që ndërlidhet me ndërhyrje trupore siç është marrja e mostrave të gjakut gjatë kontrollit fizik mund të bëhet vetëm me urdhrin e gjykatësit ose me pranimin e vullnetshëm të personit në fjalë. Derisa në nenin 144 par. 9 të KPPK-së, theksohet "se shtrëngimi për ekzaminimet fizike dhe kontrolle të tilla mund të përdoret vetëm me urdhër të posaçëm të gjykatës". Është interesant se në nenin 76 të KPPK-së, paragrafi 5 kur policia kryen alkotestin dhe duhet ti merr mostrat e urinës ose të frymëmarrjes theksohet se mostrat nuk duhet të merret me detyrim pa urdhrin e gjykatës.

Me dispozitat e nenit 148 paragrafi 2 të KPPK autopsinë, kontrollin fizik, përveç rasteve nga neni 145 paragrafi 2 deri 4 dhe 76 të këtij Kodi, kontrolli psikiatrik, kontrolli molekular e gjenetik dhe analizat e ADN-së mund të urdhërohen vetëm nga gjyqtari i procedurës paraprake përveç në rastet kur dëshmitari ose i dëmtuari pajtohet që këto veprime të ndërmerren nga policia ose prokurori. Sipas kësaj dispozite shihet qartë se edhe këto veprime dhe urdhëresa

[4] Neni 137 par. 2.1 KPPK-ës, faqe 61, përcakton se i pandehuri, mbrojtësi, viktima ose mbrojtësi i viktimave mund të kundërshtojë përzgjedhjen e ekspertit bazuar në kualifikimet e tij apo konfliktin potencial të interesit duke paraqitur kundërshtim tek gjyqtari i procedurës paraprake. Gjyqtari i procedurës paraprake merr aktvendim mbi përzgjedhjen e ekspertit brenda (10) ditëve prej momentit të caktimit të ekspertit nga ana e prokurorit.
[5] neni 143 paragrafi 2 i KPPK

janë në kompetencën e gjykatësit të procedurës paraprake por përjashtimisht me pajtimin e të dëmtuarit dhe dëshmitarit këto veprime do të ndërmerren nga policia ose prokurori publik dhe do të jenë veprime të ligjshme.

Gjykatësi i procedurës paraprake në rastet kur një dëshmitar apo ekspert nuk paraqitet ose nuk pranon të paraqitet pa arsye ligjore para prokurorit të shtetit, sipas propozimit të prokurorit të shtetit GJPP do të shqiptojë gjobitjen në shumë prej 250 euro për mos paraqitje[6], për sa herë që thirrja i është bërë në mënyrën e rregullt të paraparë me ligj. Po ashtu vlen të theksohet se në situatën kur dëshmitari paraqitet kur është thirrur, dhe pasi i bëhet me dije për pasojat e mos deklarimit dhe refuzon të dëshmojë pa arsye ligjore përkundër dënimit të shqiptuar, prapë refuzon të dëshmojë mund të burgoset dhe atë për aqë kohë sa ai refuzon të dëshmoj por jo më shumë se një muaj ditë apo përderisa dëshmia e tij bëhet e panevojshme. Po ashtu edhe masat e tjera që ndërlidhen me caktimin e ekspertëve rreth kryerjes së ekspertizave, e që mund të jenë për fusha të ndryshme, këto masa urdhërohen vetëm nga gjykatësi i procedurës paraprake në varësi të natyrës së veprës penale për të cilën janë duke u kryer hetimet.

1.5. Urdhëresa gjyqësore mbi kontrollin e lokaleve dhe personave duhet të gëzoj mbështetje ligjore

Sipas kërkesës së prokurorit të shtetit, gjykatësi i procedurës paraprake mund të urdhëroj kontrollin e një shtëpie, të lokaleve të tjera të mëdha, të pronës së një personi të caktuar kur ekziston dyshimi i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe kur ka gjasa që kontrolli të rezultoi me arrestimin e këtij personi ose me zbulimin dhe konfiskimin e provave të rëndësishme për procedurën penale. Në të njëjtat kushte mund të urdhëroj kontrollin personal të një personi konkret kur ka gjasa reale se kjo kontrollë do të rezultoi në zbulimin e gjurmëve ose me konfiskimin e personave të një vepër penale. Urdhëresën do ta zbatoj policia gjyqësore. Kjo çështje është rregulluar me nenin 105 par. 1,2,3 dhe 5 të KPPK-së. Ky kontroll nuk është i njëjtë me kontrollin e përkohshëm për siguri që e kryen policia pa urdhër të gjykatës përshtatshmërisht me dispozitën ligjore të kodit të ri në zbatim.

Vetëm përjashtimet sipas nenit 110 të KPPK, në rrethanat e ngutshme kur urdhri me shkrim për kontrolle nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rrezik real për vonesë që mund të rezultojë me humbjen e provave ose në rrezik ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve, policia gjyqësore mund të filloj kontrollin në bazë të lejes gojore të gjyqtarit të procedurës paraprake. Kur policia ndërmerr kontrolle pa urdhër të shkruar gjyqësor në rrethanat që i përcakton dispozita e nenit 110 paragrafi 1 dhe 5 të KPPK obligohet që në afat prej 12 orësh ti dërgoj raport prokurorit të shtetit dhe gjykatësit të procedurës paraprake[7].

---

[6] Shih nenin135 par.1 dhe 2 të KPPK-së

[7].Neni 110 par.6 i KPPK-së, përcakton se kur policia ndërmerr kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësor brenda afatit prej 12 orësh pas kontrollit i dërgon raport lidhur me këtë prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit kompetent nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtar në mënyrë që të merr aprovimin retroaktiv gjyqësor të kontrollit në pajtim me dispozit at kushtetuese.

Parimisht dhe ligjërisht asnjë urdhër kontrolli nuk do duhej lëshuar nga GJPP, pavarësisht që para vetës ka një kërkesë nga prokurori apo policia për një gjë të tillë, nëse ndaj personit për të cilin kërkohet urdhër kontrolli ekziston vetëm një dyshim se ka kryer vepër penale, përderisa ndaj tij nuk është marrë një aktvendim mbi fillimin e hetimeve për një dyshim të bazuar se ka kryer vepër penale. Kjo lë të kuptohet se nuk do duhej të ndodh në praktikën e përditshme një gjë e tillë, pa dashur që të hyjmë në saktësim të rasteve që janë evidente sigurisht në secilin regjion ku më shumë e ku më pak, dhe jo për shkak që mungon profesionaliteti, por për shkak të angazhimeve të shumta ditore të prokurorëve dhe gjyqtarëve si rezultat i numrit të madh të lëndëve që vazhdimisht kanë para vetes në mungesë të kuadrit të mjaftueshëm. Për më tepër shpesh janë të detyruar që kërkesat e tilla t'i bartin për në punë tek stafi mbështetës për t'i punuar, e që këta të fundit si në prokurori dhe gjykata i punojnë në emër të bartësve të lëndës, ashtu që në pamundësi të një kontrollimi të duhur, prokurorët dhe gjyqtarët i nënshkruajnë nganjëherë pa pasur kohë për t'ju bërë një vështrim përmbajtjesor si kërkesës apo urdhrit të punuar, e që si pasojë për shkak të shkeljeve të tilla, në një stad të mëvonshëm, gjykata i shpall si të pa pranueshme qoftë sipas detyrës zyrtare apo kundërshtimit të të pandehurit apo mbrojtësit të tij[8], sepse nuk janë marr në përshtatshmëri me dispozitat ligjore dhe kështu vihet tek rrezikimi i humbjes së rastit për të cilin është ngritur akti akuzues dhe përkundër realitetit që vepra penale ka ndodhur. Thënë ndryshe, asnjë urdhër kontroll nuk do duhej të ndodhë pa një bazë ligjore të përshkruar si me lartë më përjashtim të rasteve të cekura dhe të përcaktuara në nenet 110 dhe 111 të KPPK-së, nëse nuk kemi një Aktvendim të fillimit të hetimeve ndaj një apo më shumë të pandehurve për të cilin ekziston një dyshim i bazuar.

1.6. Masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit

Gjithashtu, gjykatësi i procedurës paraprake lëshon një seri urdhëresash me propozim të prokurorit dhe palëve sipas kapitullit XXIX masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

Kështu sipas nenit 91 paragrafi 1dhe 2 të KPPK-së, gjyqtari i procedurës paraprake me kërkesë të prokurorit të shtetit mund të urdhërojë secilën masë të paraparë me Kod. Kuptohet se për lëshimin e urdhëresës së masave të fshehta teknike do të vlerësohen kushtet dhe rrethanat konkrete për secilin rast veç e veç.

Në raste të ngutshme kur pritja e urdhrit të gjykatësit të procedurës paraprake nga paragrafi 2 i nenit 91 do të rrezikonte sigurinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e të dëmtuarit, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre prokurori i shtetit mund të jep urdhër të përkohshëm për njërën nga 10 masat e përmendura. Urdhri i tillë i përkohshëm e humb fuqinë nëse nuk konfirmohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda 24 orëve nga momenti i lëshimit.

Sipas nenit 96 paragrafi 6 dhe 9 të KPPK-së, prokurori i shtetit informon me shkrim me anë të postës rekomande çdo person të përfshirë në urdhër për faktin se i është nënshtruar regjimit të masave të fshehta dhe se ka të drejtë ankese në Panelin e vëzhgimit dhe rishqyrtimit të

[8]. Neni 249 par.1 pika 1.1, 1.2,1.3 të KPPK-ës, faqe 113-114

hetimeve, përmes kryesuesit të organit kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore, brenda 6 muajve dhe se atij i lejohet qasje në materialet e mbledhura nëse më nuk ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprën penale ose prokurori i shtetit nuk ka ngritë aktakuzë brenda një viti pas përfundimit të urdhrit (neni 96 paragrafi 1).

Në raste të veçanta sipas kërkesës së prokurorit, gjykatësi i procedurës paraprake mund të urdhërojë që personi i cili i është nënshtruar urdhrit të mos i lejohet qasje në sende dhe materiale të mbledhura gjatë hetimeve të fshehta nëse qasja e personit i cili i është nënshtruar urdhrit në materiale të tilla do të rrezikonte sigurinë e hetimeve apo jetën apo sigurinë e të dëmtuarit, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre ose që një njoftim i tillë të vonohet por jo më shumë se një vit nëse zbatimi i detyrimit të tillë para skadimit të periudhës së skaduar do të rrezikonte sigurinë e hetimeve, sigurinë a jetën e të dëmtuarit, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre.

Ndërkaq, në mbështetje të paragrafit 3 të nenit 96 gjykatësi i procedurës paraprake me kërkesën e prokurorit të shtetit mund të urdhërojë me shkrim që lidhur me informatorin, ose zyrtarin e autorizuar të policisë gjyqësore, që ka zbatuar masat sipas këtij kapitulli, që emrat, adresat, vendi i punës, profesioni a informacioni tjetër në materiale të tilla që do të mund t'i identifikonte ata të fshihen apo të shmangen si dhe të dhënat në materiale të mbledhura që identifikojnë personat e tillë. Urdhri i tillë mund të lëshohet para se të informohet personi ndaj të cilit është marrë urdhri.

Subjektet që marrin pjesë në procedurën paraprake, duhet të respektojë decidivisht procedurën e marrjes së masave nga ky kapitull, meqenëse urdhëri për masën dhe zbatimin e saj nëse është i paligjshëm do të trajtohet si provë e papranueshme në rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor në kuptim të nenit 97 par.1.

1.7. Masa e sigurimit të prezencës së të pandehurit, pengimin e ri kryerjes së veprës penale dhe siguri për zhvillim të procedurës penale.

Roli dhe aktiviteti i gjykatësit të procedurës paraprake gjithashtu vihet në dukje te kapitulli X, për lëshimin e ndonjërës nga masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë, në kuptim të nenit 173 paragrafit 4 lidhur me nenin 175 paragrafi 4 të KPPK-ës, gjykatësi i procedurës paraprake lëshon urdhëresat ne saje te propozimeve dhe varësisht nga kushtet arsyetuese ne propozim qe kërkohet specifikishtë mund te lëshoj njërën nga masat ne vijim:

- urdhër arresti (neni 175)
- premtimi i të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin (neni 176),
- ndalimi për t'i ofruar vendit ose personit të caktuar (neni 177),
- paraqitja në stacionin policor (neni 178),
- dorëzania (neni 179),
- arrestim shtëpiak neni 183 i KPPK-ës
- diversioni (neni 184) dhe
- caktimin e paraburgimit (neni 187)

Çdo njëra nga masat e përmendura lëshohet në momente dhe situata të caktuara, siç është atëherë kur kemi të bëjmë me kryerës veprash penale të cilët nuk ndihmojnë organet në ndriçimin e rasteve penale, duke filluar nga injorimi i marrjes dhe mos lajmërimi te organi procedues. Se çfarë urdhëresa lëshon gjyqtari i procedurës paraprake varet prej rastit në rast dhe nga vetë arsyeshmëria e kërkesës së prokurorit të shtetit, neni 188 paragrafi 1 të KPPK-së. Kjo do të thotë se pavarësisht nga arsyeshmëria dhe nevoja e sigurimit të pranisë së të pandehurit në procedurë varet aplikimi i masës të cilën e lëshon GJPP. Çdonjëra nga masat lëshohet sipas kërkesës se prokurorit kur çështja ndodhet në hetim e sipër tek prokurori, e nëse janë shtjerrë mundësitë paraprake ligjore të shfrytëzuar nga prokurori dhe janë plotësuar kushtet ligjore që përcaktohen për çdonjërën nga masat e cekura, atëherë GJPP, përshtatshmërish me rrethanat arsyetuara të kërkesës lëshon ndonjërën nga masat e nevojshme për tu siguruar prania e të pandehurit.

Kërkesa për masë nuk është obligative të respektohet për lëshuarje, nëse alternativat e masave tjera janë mjaftuese për kërkesat që i nevojiten organit procedues (prokurorit).

1.7.1. Paraburgimi, caktimi, vazhdimi, ndërprerja dhe zbatimi i paraburgimit

Meqenëse është një njëra ndër masat më të ashpra të kufizimit të lirisë dhe të drejtave të personit atëherë do të përpunohet paksa më gjerësisht.

Në mbështetje të nenit 188 paraburgimin e cakton gjyqtari i procedurës paraprake në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit pas seancës së dëgjimit.

Në seancën e dëgjimit mbi paraburgimin prezent domosdoshmërisht do të jetë prokurori i shtetit dhe mbrojtësi i të pandehurit. Edhe në rastin kur i pandehuri nuk angazhon mbrojtës, mbrojtja do t'i caktohet sipas detyrës zyrtare meqenëse është fjala për mbrojtjen e obligueshme sipas nenit 188 paragrafi 4 të KPPK. Në seancë prokurori i shtetit paraqet arsyet edhe gojarisht për paraburgimin, ndërkaq i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të përgjigjen duke prezantuar argumente të tyre në kuptim të nenit 188 par.5 të KPPK[9].

Ndaj aktvendimit për përcaktimin e paraburgimit, palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 24 orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit. Për ankesë vendoset në Kolegjin Shqyrtues të Gjykatës së Apelit, brenda 48 orëve nga paraqitja e saj.

Kur gjyqtari i procedurës paraprake e refuzon kërkesën e prokurorit të shtetit për caktimin e paraburgimit, ai mund të urdhëroj cilën do masë tjetër nga kapitulli X – masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit.

Sipas dispozitave të nenit 190 paraburgimi mund të zgjatë më së shumti një muaj nga dita e arrestimit në bazë të aktvendimit të parë të gjykatësit të procedurës paraprake. Pas kësaj kohe

[9].Neni 188 përcakton procedurën për urdhrin për paraburgim, më saktësisht par.5 citon se: në seancë dëgjimore për paraburgim prokurori i shtetit paraqet arsyet mbi kërkesën e paraburgimit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të përgjigjen duke prezantuar argumentet e tyre. Ne lidhje me këtë sipas par.6 të nenit 188 gjyqtari i procedurës paraprake vendos, shih KPPK faqe 86.

ai mund të mbahet në paraburgim vetëm me aktvendim të gjykatës mbi vazhdimin e paraburgimit[10].

Para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi mund të zgjasë më së shumti një vit, përkatësisht nëse janë në pyetje veprat penale të dënueshme më me pak se 5 vjet, paraburgimi zgjatë 4 muaj, ndërkaq për veprat penale të dënueshme me burgim mbi 5 vjet, paraburgimi zgjatë 8 muaj. Në raste të caktuara mund të vazhdohet deri më 4 muaj për vepra penale të dënueshme me më pak se 5 vjet burgim, ose 12 muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme në të paktën 5 vjet burgim, në rrethana të jashtëzakonshme kur mosparaqitja e aktakuzës brenda afatit nga paragrafi 2 neni 190 ndërlidhet me ndërlikueshmërinë e rastit ose me faktorë të tjerë që nuk mund t'i atribuohen prokurorit të shtetit. Nëse aktakuza nuk ngritët para kalimit të afateve të përmendura i paraburgosuri lirohet.

Referuar nenit 191 të KPPK-së, që rregullon zgjatjen e paraburgimit, kuptohet se para ngritjes së aktakuzës çdo herë duhet të bëhet sipas propozimit të prokurorit të shtetit i cili do të vë në dukje arsyet e caktimit dhe vëzhgimit të paraburgimitt dhe se sa janë ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyetueshme për të përjashtuar zbatimin e hetimit.

Sipas nenin 191 par. 3 paraburgimi i caktuar nga gjyqtari i procedurës paraprake mund të zgjatet nga gjyqtari paraprak, gjyqtari individual si dhe kryetari i trupit gjykues, e gjitha kjo në varësi se në cilën fazë të procedimit ndodhet çështja penale. Për dallim nga kodi aktual në zbatim, sipas kodit të mëparshëm të vitit 2004 e që ishte në zbatim gjerë me 31 dhjetor 2012, zgjatjen e paraburgimit në kuptim të nenit 284 dhe 185 par.3 fillimisht e bënte për një muaj gjyqtari i procedurës paraprake ndërsa zgjatjen e bënte kolegji prej tre gjyqtarësh, jo më shumë se dy muaj, brenda afateve të parapara me nenin 284 të këtij kolegji, pas dorëzimit të parashtresave nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, ndërkaq paraburgimi i caktuar nga kolegji prej 3 gjyqtarësh mund të zgjatet nga gjyqtari i procedurës paraprake jo më shumë se një muaj, brenda afateve të parapara me nenin 284 të këtij Kodi pas seancës së dëgjimit. Prej kësaj kuptohet se paraburgimi një herë i caktuar nga gjyqtari i procedurës paraprake, mund të zgjatet nga kolegji penal dhe të vazhdohet përsëri nga gjykatësi i procedurës paraprake, për një muaj pas seancës dëgjimore dhe në këtë mënyrë alternativisht, do të bëhet vazhdimi i paraburgimit deri në maksimumin nga neni 284 i këtij Kodi. I dëmtuari dhe mbrojtësi i viktimave mund të kërkojnë formalisht apo jo formalisht nga prokurori i shtetit që ky i fundit të intervenoj me kërkesë për vazhdim të paraburgimit. I pandehuri dhe mbrojtësi informohen me propozimin jo më vonë se tri (3) ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit[11].

1.7.2. Ndërprerja e paraburgimitt sipas mbikëqyrjes se Gjykatës

Në bazë të nenit 197 të KPPK-së, paraburgimi mund të ndërpritet me pëlqimin e prokurorit të shtetit nga gjykatësi i procedurës paraprake. Në raste mospajtimi vendos Kolegji Penal brenda 48 orëve nga pranimi i kërkesës së Gjykatësit.

[10].Neni 191 par.1 i KPPK-ës,
[11] . Neni 191 par.2 të KPPK

Theksimi i lartcekur që ndërlidhet me fillimin e punimit, i potencuar se gjyqtari paraprak vepron vetëm sipas kërkesave të palëve procedurale, me përjashtime të vogla, na solli deri tek fjala e ripërsëritur se mu në këtë dispozitë të nenit 192 par.1 se vendosja për ligjshmërinë e paraburgimit sipas detyrës zyrtare dhe se para se të marrë vendim për ndërprerje të paraburgimit, GjPP tri ditë përpara e lajmëron prokurorin e shtetit, e që ky i fundit ka të drejtë ankimi të kolegji shqyrtues prej tre gjyqtarëve, kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për ndërprerje paraburgimi. Kolegji shqyrtues nxjerrë aktvendim brenda 48 orëve.

Me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe pikërisht nenit 192 paragrafi 2 deri 4, është paraparë një procedurë e re për heqjen e paraburgimit dhe atë vlerësimi i ligjshmërisë së caktimit dhe vazhdimit të paraburgimit ose habis korpus*(habeas corpus)* procedura. Sipas kërkesës së të paraburgosurit ose mbrojtësit të tij në çdo kohë mund t'i ankohen gjyqtarit të procedurës paraprake që të vendosë mbi ligjshmërinë e paraburgimit.

Gjyqtari i procedurës paraprake mund të zbatojë seancën e dëgjimit në pajtim me nenin 188 paragrafi 3,4,5 dhe 6 nëse në shikim të parë me ankesë vërtetohet se:

Arsyet për paraburgim nga neni 187 i këtij Kodi që nga vendimi gjyqësor për paraburgim kanë pushuar së ekzistuari, ndryshimit të rrethanave ose zbulimit të fakteve të reja ose ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i paligjshëm.

Gjyqtari i procedurës paraprake në seancë dëgjimi urdhëron lirimin e menjëhershëm të të paraburgosurit kur konstaton se:

- Kanë pushuar së ekzistuari arsyet e paraburgimit nga neni 187 të këtij Kodi,
- Ka kaluar afati i paraburgut i urdhëruar nga gjykata (prokurori nuk ka ushtruar kërkesë për vazhdimin e paraburgimit),
- Afati i paraburgimit i caktuar nga gjykata kalon afatin e paraparë në nenin 190 (8,12 muaj) ose
- Ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i paligjshëm[12].

1.7.3. Zbatimi i paraburgimit në Institucionin Korrektues

Gjykatësi i procedurës paraprake vendos në marrëveshje me drejtorin e institucionit që i paraburgosuri të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive të tij fizike dhe mendore në institucionin e burgut (neni 199 par. 2 të KPPK).

Me leje të gjykatësit të procedurës paraprake e nën mbikëqyrjen e tij ose personit të caktuar nga ai i paraburgosuri mund të vizitohet nga farefisi i afërm, nga mjeku apo persona të tjerë (neni 200 par.2 i KPPK-së).

Me dijeninë e gjykatësit të procedurës paraprake përfaqësuesit e zyrës së ndërlidhjes ose Misionit Diplomatik pa mbikëqyrjen e gjykatësit kanë të drejtë të vizitojnë shtetasin e tyre,

[12]. Shih nenin 189 par.1,2,3 dhe 4 të KPPK-së

sikurse edhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare të vizitojnë të paraburgosurit që kanë statusin e refugjatit (neni 200 par. 2).

Të paraburgosurit mund të korrespondojnë ose të kenë kontakte me persona jashtë institucionit në dijeni dhe nën mbikëqyrjen e gjykatësit të procedurës paraprake. Pas konsultimit me prokurorin e shtetit mund të ndalojë një komunikim të tillë me arsyet ligjore (neni 200 paragrafi 4).

Sipas nenit 201 gjykatësi i procedurës paraprake mund të shqiptojë dënim disiplinor të ndalimit ose kufizimit të vizitave a korrespodencës së paraburgosurit që ka bërë shkelje disiplinore (neni 201 paragrafi 1 dhe 2 të KPPK-ës).

1.8. Mbrojtja e të dëmtuarit, dëshmitarit dhe dëshmitarit bashkëpunues

Prokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i të pandehurit, dëshmitari bashkëpunues apo dëshmitari, në cilën do fazë mund ti paraqesin Gjyqtarit kompetent kërkesën me shkrim për urdhër - mbrojtje ose anonimitet.

Me dispozitat e nenit 220 dhe 222 të KPPK-së mund të shpallet dëshmitar bashkëpunues personi i cili ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale e sipas propozimit të prokurorit shtetit.

Po ashtu me nenin 220 par.1 dhe 226 të KPPK-së, gjykatësi i procedurës paraprake në propozim të prokurorit të shtetit, të dëmtuarit ose dëshmitarit, gjithashtu mund të shpallen si dëshmitarë të mbrojtur.

Për të dy këto raste urdhëresën pas seancave të mbyllura do ta lëshoj gjykatësi i procedurës paraprake.

2. Sipas propozimit të të pandehurit e mbrojtësit të tij

Sipas dispozitës së nenit 125 të KPPK-së i pandehuri mund të paraqesë ankesë te gjyqtari i procedurës paraprake për të vendosur mbi ligjshmërinë e detyrimit të tij për t'ju paraqitur prokurorit të shtetit. Kjo dispozitë ka hasur në reagime qysh prej kur Kodi ka qenë projekt i publikuar. Është e vërtetë se dispozita e nenit 125 nuk ka rregulluar deri në fund këtë kompetencë të gjykatësit të procedurës paraprake.

Megjithatë dispozitat e procedurës penale duhet të interpretohet në favor të të pandehurit dhe të merret parasysh se i pandehuri për herë të parë po njoftohet se ndaj tij po zhvillohen hetimet kur e merr ftesën për tu paraqitur te prokurori shtetit. Meqenëse edhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale bazohen në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut andaj edhe në vendimet e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut sipas përcaktimit të kësaj gjykate "akuzë penale quhet edhe çdo njoftim nga organi shtetëror se po ngarkohet për një vepër personi i caktuar". Kjo çështje edhe tani e tutje ka mbetur e diskutueshme meqenëse edhe dispozita ka lënë zbrazëti sidomos në vendimet e mundshme të gjykatësit të procedurës paraprake. Për më tepër deri më tani nuk është shënuar ndonjë ankesë e tillë.

Sipas dispozitës së nenit 213 par. 3 të KPPK-së, mbrojtësi i të pandehurit duhet t'i lejohet nga prokurori shtetit që të shikojë, të kopjoj ose fotografojë shkresa, libra, dokumente, fotografi dhe objekte tjera materiale në zotërim të prokurorit të shtetit, materialet të cilat shërbejnë për përgatitjen e mbrojtjes si prova që janë marrë nga i pandehuri apo kanë qenë pronë e tij varësisht nga rasti. Prokurori i shtetit mund të refuzojë, por në raste të tilla mbrojtësi mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake të lejoj shikimin e kopjimin ose fotokopjimin. Po ashtu sipas nenit 214 par.1 edhe nëse një gjë e tillë refuzohet nga gjykata dhe prokurori që është normuar në par.2 të nenit 214 atëherë të dëmtuarit dhe mbrojtësit i lind e drejta ligjore të paraqet ankesë të GJPP e që vendosja e këtij të fundit është vendim përfundimtar.

2.1. Vendimet e gjyqtarit të procedurës paraprake janë përfundimtare

Personi i arrestuar nga policia gjyqësore jo më vonë se 6 orë nga momenti i arrestimit, prokurori i shtetit duhet që për të dyshuarin të lëshoj vendimin mbi ndalimin gjë që më Kodin e Përkohshëm të vitit 2004 e kishte edhe oficeri i policisë gjyqësore. Ndaj vendimit mbi ndalim sipas KPP, aktual, e drejta në ankesë i lind të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij të angazhuar në afat prej 24 orësh, tek gjykatësi i procedurës paraprake.

Gjykatësi i procedurës paraprake vendos për ankesë brenda 48 orëve nga momenti i arrestimit. Gjithashtu i pandehuri ka të drejtë të kërkojë nga prokurori i shtetit marrjen e ndonjë prove konkrete[13]. Nëse prokurori shtetit refuzon kërkesën për marrjen e provës, i pandehuri mund t'i ankohet gjyqtarit të procedurës paraprake ndaj vendimit të tillë. Edhe në këtë rast Kodi i Procedurës Penale nuk ka zgjedh definitivisht këtë çështje dhe nuk ka përcaktuar vendimin e mundshëm dhe karakterin e tij në këtë procedurë.

3. Vendimet, urdhëresat sipas propozimit të të dëmtuarit, përfaqësuesit të tij ligjor dhe të autorizuar

I dëmtuari në procedurën e tanishme penale ka një zgjerim të të drejtave në procedurën penale dhe trajtim më adekuat, madje në disa vepra penale si kundër integritetit trupor, dhunës seksuale ka trajtimin e palës së barabartë me palët e rregullta procedurale (neni 219 paragrafi 1, pika 7 lidhur me nenin 374 par. 2 të KPPK-së.

Po ashtu, i dëmtuari gjatë procedurës penale paraprake (hetimeve), me qëllim të marrjes dhe ruajtjes se provës mund të kërkoj nga prokurori i shtetit marrjen e ndonjë prove konkrete brenda dhe jashtë vendit[14], ashtu që ky i fundit varësisht nga kënd-vlerësimi vendos për rëndësinë e provës dhe dobishmërinë e saj për procedurë të mëvonshme dhe në bazë të këtij aprovimi bënë aprovimin apo refuzimin e saj duke u thirrur në nenin 217 par. 1,2,3,4.

Sipas propozimit të te dëmtuarit në mbështetje të nenit 218 par. 2 të KPPK-ës, gjykatësi i procedurës paraprake merr aktvendim për sigurimin e kërkesës pasurore juridike.

[13] .Shih nenin 216 par.1 të KPPK-së
[14] Neni 219 par.1,2,3,4,5,6,7 të KPPK-së

I dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij ligjor ose përfaqësuesi i autorizuar kanë të drejtë të shikojnë, kopjojnë ose fotografojnë shkresat dhe provat materiale që i disponon prokurori i shtetit nëse legjitimohet interesi i tij. Në rast që prokurori refuzon këtë kërkesë të të dëmtuarit, i dëmtuari paraqet ankesë tek gjyqtari i procedurës paraprake.

Vendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake është përfundimtar, por në rast se refuzon shikimin e shkresave për këtë vendos kolegji penal.

Gjithashtu sikurse për të pandehurin edhe për të dëmtuarin në dispozitat e nenit 216 të KPPK-së është paraparë e drejta që të kërkojë nga prokurori i shtetit marrjen e ndonjë prove konkrete. Në rast se refuzon prokurori, i dëmtuari mund t'i ankohet gjyqtarit të procedurës paraprake ndaj vendimit të tillë.

4. Mundësia hetuese e jashtëzakonshme

Me dispozitat e nenit 149 të Kodit të Procedurës Penale është paraparë mundësia hetuese e jashtëzakonshme, kur prokurori i shtetit ose i pandehuri mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake të merrë dëshmi nga dëshmitari ose të kërkojë mendimin e ekspertit, me qëllim të ruajtjes së provës kur ekziston vetëm një mundësi për marrjen e provës së rëndësishme ose kur ka rrezik potencial se kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Në situatat kur GJPP refuzon propozimin e paraqitur nga palët e autorizuara sipas KPPK-së, automatikisht derivon e drejta ligjore e parashtrimit të ankesës tek kolegji prej tre gjyqtarëve. Në rast se gjykatësi ndërmerr këto veprime hetimore do të mbajë seancën dëgjimore për marrjen e dëshmisë, nga dëshmitari dhe eksperti në prezencën e të pandehurit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit të shtetit, ndërkaq i dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij do të informohen për seancën e dëgjimit dhe ata kanë të drejtë të jenë të pranishëm.

5. Përfundim

Përshkruar si me lartë rezulton se Gjyqtari i Procedurës Paraprake është një subjekt me një rol dhe rëndësi të veçantë në radhën e subjekteve tjera procedurale. Roli dhe pozita e GJPP, kompetencat dhe autorizimet ligjore të përcaktuara janë dëshmi që paraqesin rolin e tij në një stad avancimi, për kontroll ligjshmërie të veprimeve që i ndërmerr policia dhe prokuroria gjatë hetimeve paraprake. Mënyra aktuale e shfrytëzimit dhe aplikimit të masave është bërë dukuri e zakonshme e sidomos në situatat kur kallëzimet penale nëpër prokuroritë e Kosovës paraqiten ndaj NN personave, e që vepra penale vërtet është kryer. Konsideroj se në situata të tilla ekziston arsyeshmëria.

Jemi dëshmitar të praktikave të përditshme se momenti i fillimit të aplikimit të masave të fshehta për herë të parë në Kosovë ka filluar në vitin 2004, gjë që më herët Kosovës, i mungonte një teknikë e tillë. Po ashtu nuk duhet anashkaluar edhe faktin se në këtë periudhë kohore na u paraqit edhe instituti emërtues i Gjyqtarit të Procedurës Paraprake, që vetë fjala e fundit ngërthen në vete pozitën, rolin, autorizimet dhe kompetencat shtrirëse për këtë stad procedural si subjekt që balancon ligjshmërinë e kërkesave të palëve që tani Kodi Procedural Penal në

zbatim ua njeh. Kosovës më herët i mungonte një infrastrukturë ligjore dhe vet ana teknike, gjë që një pamundësi e shfrytëzimit të masave të tilla pamundësoj ndriçimin e shumë e shumë veprave penale të kryera në Kosovë që ende sot e kësaj dite nuk janë ndriçuar. Kodi i Procedurës Penale aktualisht kërkon më shumë përgjegjësi nga palët dhe nga vetë Gjyqtari si pjesëmarrës garantues në Procedurë rreth garantimit të të drejtave të përcaktuara me ligj për palët. Thënë ndryshe nëse i referohemi rolit të gjyqtarit roli i këtij të fundit ka ndryshuar dukshëm, ngase është shndërruar nga një rol shumë pro aktiv në hetimin dhe gjykimin e veprave në një rol shumë më pak aktiv gjatë procedurës, ndërsa janë rritur përgjegjësitë e palëve tjera në procedurë. Roli i GJPP në aktivitetin që ja garantojnë dispozitat e KPPK-së, në stadin paraprak, veprimet që i ndërmerrë në saje të kërkesave të subjekteve procedurale duhet të jenë kërkesa të pranueshme për lëshim masash me vetë faktin se të gjithë gjyqtarët në procedura penale pavarësisht se në cilin stad shtrihen autorizimet e tyre ligjore duhet ti përfillin dhe ti zbatojnë më përpikëri ashtu siç ua njeh ligji, sepse në këtë mënyrë mundë ta dëshmojmë profesionalitetin, pavarësinë, paanshmërinë dhe intergritetin si zbatues të ligjit dhe respektuesit e të drejtave dhe lirive të njeriut konform Konventave që jemi obligues ti respektojmë krahas akteve tjera të brendshme që domosdoshmërisht i aplikojmë për çdo ditë për rastet që na vijnë para vetes për trajtim.

6. Rekomandimet:

- Rekomandohet që parashtruesit e kërkesave që të kursehen sa më shumë nga kërkesat e pa nevojshme kur ka mundësi që një hetim penal të kryhet pa pas nevojë se aplikuari masat e fshehta teknike të përgjimit dhe telekomunikimit.
- Rekomandohet që, po ashtu edhe GJPP, me vëmendje dhe syçeltësi të veprojnë kur marrin kërkesa të tilla duke analizuar me profesionalitet kushtet për secilën kërkesë që ka para vetës se a i plotëson kushtet ligjore për tu lëshuar ashtu siç ka kërkuar propozuesi (policia apo prokurori), e më pas të vendosin se a ka arsyeshmëri lëshuarje, me faktin se në praktikë nuk do duhej lejuar që pa marrë aktvendim mbi fillimin e hetimeve ndaj x apo y personit të aplikohet parashtrimi i kërkesës nga subjektet e caktuara me ligj dhe me pas gjykatat –gjyqtarët e procedurës paraprake ti aprovojnë, gjë që një veprim i tillë është bërë praktikë e përditshme në disa gjykata.
- Të identifikohen situatat kur kemi të dyshuar dhe kur kemi të pandehur, me faktin se për të dyshuarin ende jemi para një situate kur kemi ndoshta vetëm një kallëzim penal dhe të pa mbështetshëm në dyshim të bazuar, atëherë për të ardhur gjerë të dyshimi i arsyeshëm (bazuar), në pamundësi të grumbullimit të fakteve tjera mund të aplikojmë edhe masat tjera të fshehta si alternativë e fundit edhe pse nuk kemi aktvendim të hetimeve sepse kemi vetëm personin për të cilin ka vetëm dyshim se ka kryer v.penale.
- Si për prokurorin ashtu edhe për Gjyqtarin e Procedures Paraprake vlenë: Për Prokurorin e shtetit mos të parashtroj kërkesë për urdhër kontroll të lokaleve apo banesave etj, ndaj x apo y personit tek GJPP, nëse nuk ka një dyshim të bazuar se është kryer apo do të kryhet vepra penale, përderisa personi i cili kërkohet të jetë subjekt kontrollimi i shtëpisë, banesës apo lokaleve të mos ketë një status të pandehuri dhe

ndaj të cilit është marrë aktvendim mbi fillimin e hetimeve, e që dy fjalitë e fundit të jenë detyrim ligjor për GJPP që mos ta aprovojnë një propozim të tillë.

- Gjyqtarët është mirë që kërkesat e pranuara fillimisht t'i analizojnë personalisht e më pas t'i dërgojnë në përpunim tek stafi mbështetës, gjë që në praktikë për shkak të angazhimeve të shumta që i kanë, një gjë e tillë po duket që po mungon.
- Rekomandohet që, prokurorët, e po ashtu edhe gjyqtarët si autoritete që kërkesat e njeri- tjetrit për vendime, urdhëresa të jenë në nivel profesionalistësh dhe vërtetësie ligjore, e jo në një nivel formaliteti aprovimi duke respektuar çdo herë.

Në pamundësi numërimi të të gjitha rekomandimeve ne shpresojmë se këto gjashtë rekomandime si më kryesore, do t'i rekomandoja për të autorizuarit e shtetit, prokurorët dhe gjyqtarët që si të tilla të jenë në vëmendje të përhershme zbatuese në situata kur janë të nevojshme, krahas të tjerave që nuk kemi pasur mundësi secilën veç veç ta elaborojmë.

Bibliografia

- Kodi i Procedurës Penale të Kosovës nr.04/L-123
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.04/L-082
- Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës UNMIK/RREG/2003/26
- Rregullorja nr.2002/6 mbi masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit
- Dr.Ejup Sahiti dhe Dr.Rexhep Murati, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013
- Prof.Dr. Enver Hasani / Prof.Dr.Ivan Cukalovic, Komentar Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Botimi 1.
- Udhëzues i shkurtër i Konventës për të drejtat e njeriut, Donna Gomien, edicioni i 3-të
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Leonora Shemsiu-Kadriu*

REHABILITIMI DHE ZBULIMI I TË DHËNAVE NGA DOSJA PENALE

ABSTRAKT

Me anë të këtij punimi pretendoj të theksoj rolin e institutit të rehabilitimit, vendin e tij në kodin penal, përfituesit dhe mënyrën e rikthimit të të drejtave në një vështrim krahasues me kodet penale të rajonit. Se çka në të vërtetë është rehabilitimi, mundësitë, amnistinë që njëfarë mënyre u fal shteti me anë të dispozitave ligjore për personat që e arsyetojnë këtë me sjelljen e tyre pas mbajtjes së dënimit dhe kalimit të periudhës së paparë ligjore, mënyra e rikthimit të të drejtave që u janë mohuar për shkak të rënies ndesh me ligjin do të jetë temë kyçe e këtij punimi. Me anë të këtij punimi kam pretenduar që në njëfarë mënyrë ti bëj apel shtetit që të përcaktojë organin publik kompetent për çështje gjyqësore që do të merrej me rehabilitimin ligjor sipas detyrës zyrtare që në një mënyrë do të shkarkonte edhe gjykatat nga një punë e panevojshme si dhe në një masë të madhe do të arrinte të rikthente besimin e qytetarëve tek organet e drejtësisë.

Fjalët kyçe: Rehabilitimi, organi publik kompetent për çështje gjyqësore, gjykata, rehabilitimi ligjor, rehabilitimi gjyqësor, shlyreja nga evidenca e të dënuarve, kërkesa.

Hyrje

Instituti i rehabilitimit të personave të dënuar bie në radhën e instituteve që shkenca juridike penale nuk i ka kushtuar vëmendje të merituar, pavarësisht se me aprovimin apo refuzimin e kërkesës së personit të dënuar preken të drejtat e gjithë atyre që në ndonjë periudhë kanë qenë të përfshirë si të pandehur në ndonjë çështje gjyqësore që ka përfunduar me sanksion penal. Gjithashtu, nga mosnjohja e kësaj të drejte sipas detyrës zyrtare u kufizon të drejta të caktuara në themelimin e marrëdhënies së punës apo ushtrimin e ndonjë veprimtarie të caktuar. Nuk ka dyshim se ky institut ka të bëjë me dimensione të rëndësishme penale juridike, për çka ndonjëherë edhe keqkuptohet nga faktorët relevant të drejtësisë. Prandaj, mund të thuhet që ky institut margjinalizohet në pikëpamje shkencore dhe funksionale dhe rëndësia e vetme e tij

* Master në shkencat juridiko penale, Bashkëpunëtore profesionale në Gjykatën Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, kandidate për prokurore

trajtohet vetëm në pikëpamje praktike. Ky institut trajtohet vetëm në pikëpamje deskriptive pa ndonjë pretendim për kuptimin e tij juridik dhe funksional.

Qëllimi i këtij punimi është të shihet efekti i këtij instituti përkundër vështirësive që e përcjellin, si dhe zhvillimit të tij në drejtim të preventivës që ka arritur sepse me kërkesën e personit të dënuar ka mundësi edhe të krahasohet e kaluara dhe ndikimi pozitiv apo negativ i dënimit dhe në përgjithësi realizimi i qëllimit të ligjvënësit me dënimin e shqiptuar, si masë e mjaftueshme për parandalimin e kriminalitetit dhe risocializimit të dënuarve.

Qëllimi i punimit

Në ketë punim do të analizohet instituti i rehabilitimit gjyqësor dhe ligjor sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dispozitave ligjore të parapara lidhur me këtë institut e po ashtu edhe zbulimi i të dhënave nga dosja penale që në njëfarë mënyre prek edhe në privatësinë e personave- e drejtë kjo e përcaktuar me Konventën Ndërkombëtarë për të drejtat dhe liritë e njeriut e zbatuar drejtpërdrejtë në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Gjithashtu për mënyrën e përfitimit të kësaj të drejte, arsyeshmëria me ç rast vëmendja do të përqendrohet në shqyrtimin e kërkesës së personit të dënuar. Analiza ka të bëjë me natyrën juridike të rehabilitimit gjyqësor si institut penal e cila duhet të trajtohet si e drejtë e personit të dënuar apo vetëm si mundësi që paraqet legjislacionit pozitiv në Kosovë. Në pikëpamje të organit që vendos për rehabilitim në shkallë të parë e deri tek përsëritja e kërkesës për realizimin e kësaj të drejte.

Pastaj përparësitë e sistemeve juridike të rajonit mënyra e rregullimit të këtij instituti, dhe trajtimit si të drejtë të personit të dënuar nga gjykata.

Pavarësisht se legjislacioni ynë nuk e shuan të drejtën për aplikim pas refuzimit të kërkesës, mënyra e aplikimit për realizimin e kësaj të drejte dhe humbja e kësaj të drejte nga paraqitja e hershme apo para afatit të paraparë ligjor për një periudhë dy vjeçare tek personat e dënuar krijon përshtypje për vendosje arbitrare, mosbesim të kësaj pjese të popullatës që ka vuajtur një dënim dhe “shpërblimin” ligjor për mos shmangie nga ekzekutimi i dënimit.

1. Nocioni dhe llojet e rehabilitimit

Çdo shtet pavarësisht se çfarë rregullimi shtetëror ka apo në cilin sistem është përcaktuar në rendin e vet ligjor doemos ka paraparë përpos mbrojtjes së sovranitetit të tij edhe mbrojtjen e qytetarëve si detyrë gjenerale. Në këmbim të mbrojtjes dhe sigurisë që shteti ofron, nga qytetarët kërkohet sjellje konform rregullave të parapara ligjore, në kuadër të të cilave hyn edhe përmbajtja nga kryerja e veprave penale, nga sjelljet dhe veprimet që do të përbënin vepër penale, njëkohësisht duke paraparë dhe sanksionin penal.

Republika e Kosovës në Kushtetutën e saj parasheh respektimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve brenda territorit të saj, të të gjithë shtetasve që përkohësisht janë jashtë territorit të saj për arsye pune apo me vendqëndrim të përkohshëm, si dhe të gjithë atyre që për arsye të

ndryshme janë brenda territorit të saj[15]. Ky autoritet bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut..[16], por siç e theksuam edhe më lartë mos respektimi i këtyre të drejtave dhe lirive të parapara me kushtetutë dhe ligje relevante përbën përjashtim nga rregullat që duhet sanksionuar.

Sanksionet penale janë shprehimisht të parapara me ligj dhe askush nuk mund të shpallet fajtorë për një vepër penale e cila në kohën e kryerjes së saj nuk ka qenë e paraparë si vepër penale njëkohësisht duke ndaluar edhe veprimin retroaktiv të ligjit përveç nëse i njëjti është në favor të të pandehurit-akuzuarit.

Po thuajse i gjithë qëllimi i sanksioneve penale është preventiva gjenerale – parandalimi i veprave penale dhe kryerësve potencial nga veprimet e kundërligjshme. Ndërsa, qëllimi kryesor risocializimi dhe riedukimi i tyre në mënyrë që ti kthehen shoqërisë si kontribues me sjellje të mira dhe në harmoni me të drejtën pozitive. Etiketimi i pafund i këtij numri të njerëzve dhe privimi i tyre i përhershëm nga të drejtat kushtetuese nuk i shërben qëllimit të sanksionit penal.

Siç e theksuam qëllimi i ligjvënësit nuk është vetëm përgjegjësia e kryerësve të veprave penale për një të keqe të shkaktuar dhe dënimi i tyre, por preventiva gjenerale është arritja e qëllimit të paraparë ligjor – riedukimi dhe risocializimin në kuadër të të cilit mund të sistemohet edhe instituti i rehabilitimit ligjor. Kjo pasi një individ i cili në një periudhë të caktuar të jetës me dashje apo nga pakujdesia ka shkelur ligjin nuk do të ishte e drejtë dhe njerëzore që tërë jetën të vuajë pasojat e një vepre penale, (duke përjashtuar veprat e rënda penale dhe ato të ndëshkuara ndërkombëtarisht), prandaj instituti i rehabilitimit ligjor është një lloj satisfaksioni të themi që ligjvënësi ka paraparë për ish të dënuarin i cili me sjelljet e tij pas ekzekutimit arsyeton të njëjtën.

Me rehabilitim në kuptim të gjerë nënkuptohet rivendosja e të drejtave të mëparshme të personit të dënuar, pasi të jenë plotësuar kushtet e përcaktuara me ligj, përveç atyre të drejtave që mund të jenë të kufizuara me ligje të posaçme[17]. Sipas këtij përkufizimi, personit të dënuar i kthehen disa të drejta që ligjërisht i janë kufizuar për shkak të kryerjes së veprës penale të caktuar, pra *"instituti i rehabilitimit është në fakt një lloj fiksioni mbi jo ndëshkueshmërinë"*[18].

1.1. Llojet e rehabilitimit sipas KPRK-së

Rehabilitimi si institut ligjor dhe zbulimi i të dhënave nga dosja penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, janë paraparë në nenin 102 deri në nenin 105 , ku në mënyrë të detajuar është pretenduar të rregullohet ky institut.

---

[15] ''....ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin etë drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe gjithë individëve brenda kufijve të saj".
Kushtetuta e Republikës së Kosovës , neni 2.
[16] Kushtetuta e Republikës së Kosovës.,neni 3, par.2
[17] Elezi,I.,Kaqupi,S.,Haxhia,M.,Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë,Tiranë,2009,fq.293-294
[18] Salihu,I., E drejta penale , pjesa e përgjithshme.Prishtinë 2005, fq.552

Sipas KPRK-së pozita juridike e personave të dënuar pas mbajtjes së dënimit, lirimit ose parashkrimit duhet të ndryshohet dhe atyre t'u kthehen ato të drejta që u janë kufizuar për shkak të dënimit për vepër penale përkatësisht pas " mbajtjes së dënimit me burgim, faljes ose parashkrimit të dënimit, personit që ka bërë dëmshpërblimin..." [19], duke paraparë edhe kohëzgjatjen e kufizimeve sipas llojit të dënimit të shqiptuar. Kjo dispozite ligjore[20] lë të kuptojmë se të drejtat që i janë kufizuar personit të dënuar i kthehen vetëm pasi i njëjti të ketë mbajtur dënimin e shqiptuar, qoftë vërejtje gjyqësore, gjobë, dënim me kusht ,apo dënim me burg, të jetë liruar nga dënimi apo vepra penale për të cilën i njëjti është ndjekur për shkak të rrethanave të ndryshme është parashkruar, amnistuar apo falur, e që ndaj të njëjtit për atë vepër nuk ka mundësi më të ndërmerret një ndjekje penale apo ekzekutim i dënimit."*Rehabilitimi shpreh qëndrimin e shoqërisë e cila niset nga koncepti se njerëzit e dënuar mund të korrigjohen e nuk mund të mbeten gjithmonë në statusin e të dënuarit, prandaj atat mund të gëzojnë të drejta të njëjta me shtetasit tjerë*"[21]

Sipas KPRK-së janë paraparë dy lloje të rehabilitimit të personave të dënuar:

Rehabilitimi ligjor[22]
Rehabilitimi gjyqësor[23]

1.1.1. Rehabilitimi ligjor

"*Me rehabilitim ligjor dënimi shlyhet nga evidenca e personit të dënuar për herë të parë...*"[24] pas skadimit të periudhave kohore të parapara konform ligjit nëse personi i dënuar brenda asaj periudhe kohore të përcaktuar me ligj nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Sipas kësaj disozite ligjore personi i dënuar përfiton nga kjo e drejtë në atë mënyrë që dënimi shlyhet nga evidenca penale dhe ai person më nuk konsiderohet i dënuar[25] e me këtë i kthehen edhe ato të drejta që i janë kufizuar, nëse janë përmbushur afatet e përcaktuara ligjore të parapara sipas lartësisë së dënimit të shqiptuar, që do të thotë se organi publik kompetent për çështje gjyqësore sipas detyrës zyrtare merr aktvendim për shlyerjen e dënimit nga evidenca penale[26].

Nga instituti i rehabilitimit nuk mund të përfitojnë të gjithë personat e dënuar, prandaj Kodi Penal parasheh kufizime përfitimi nga kjo e drejtë. Kufizimi i parë u referohet të dënuarve me

[19] Kodi Penal i Republikës së Kosovës(në vazhdim të këtij punimi do të shënohet KPRK), neni 102, par.1.
[20] "pas mbajtjes së dënimit me burgim, faljes, ose parashkrimit të dënimit,personi i dënuar i cili ka bërë dëmshpërblimin i gëzon të drejtat e përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, përveç nëse parashihet ndryshe në këtë kod , e që gjithashtu ky nen zbatohet edhe për personin që është liruar me kusht., neni 102 par.1 e 2 i KPRK-së
[21] Elezi,I.,Kaqupi,S.,Haxhia,M.,Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë,Tiranë,2009,fq.294
[22] Neni 103 i KPRK-së
[23] neni 104 i KPRK-së
[24] Neni 103 i KPRK-së
[25] Salihu.,I. E drejta penale pjesa e përgjithshme. Prishtinë, 2005, fq.554
[26] Neni 520 par.1 i Kodit të procedurës penale(në vazhdim KPPRK)

mbi pesëmbëdhjetë vjet burgim[27], personave të dënuar me burgim të përjetshëm, gjatë kohëzgjatjes së dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm[28].

Nisur nga kjo organi publik kompetent për çështje gjyqësore për dënimet e shqiptuara jashtë kësaj sfere sipas detyrës zyrtare merr aktvendim[29] që dënimi të shlyhet nga evidenca e personave të dënuar, një vit nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit në rastin e vërejtjes gjyqësore[30] që do të thotë se personit që i është shqiptuar me aktgjykim të formës së prerë vërejtje gjyqësore, i njëjti do të shlyhet nga evidenca dhe nuk do të konsiderohet i dënuar nëse ka kaluar afati kohor një vjeçar nëse gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka kryer ndonjë vepër tjetër penale.

I dënuari që është shpallur fajtorë dhe i është shqiptuar dënim me kusht, do të shlyhet nga evidenca e personave të dënuar një vit pas periudhës së verifikimit. Periudha e shlyrejes së dënimit është një vit nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit edhe në rast të dënimit me gjysmëliri.

Në rastet kur kryerësit të veprës penale i është shqiptuar dënim me burgim deri në një vit, dënim me gjobë ose dënim plotësues, dënimi do të shlyhet nga evidenca e të dënuarve nëse kanë kaluar tre vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, ka shlyer obligimin lidhur me pagesën e gjobës[31] apo ka përfunduar periudha e kufizimit të ndonjë të drejte të shqiptuar me dënim plotësues. Në mënyrë të njëjtë do të veprohet edhe kur të dënuarit i është shqiptuar dënim me gjobë dhe për arsye të ndryshme nuk ka arritur atë dënim ta pagujë prandaj i është shëndrruar në dënim me burg. Në këto raste dënimi mund të shlyhet nga evidenca kur të ketë kaluar periudha e paraparë ligjore për shlyerje nga dita kur i njëjti e ka vuajtur dënimin me burg. Kur të dënuarit i është shqiptuar dënim me burgim nga një deri në tri vite, periudha e rehabilitimit ligjor dhe heqja e kufizimit të të drejtave si pasojë e dënimit arrihet pesë vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, tetë vite nga dita e mbajtjes së dënimit në rastin e shqiptimit të dënimit prej tre deri në pesë vite burgim, dhjetë vite kur i është shqiptuar dënim me burgim prej pesë deri në dhjetë vite dhe pesëmbëdhjetë vite nga dita e mbajtjes së dënimit prej dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vite burgim[32]. Pra, nga dispozita ligjore vërejmë se periudha kohore e mundësisë së shlyerjes nga evidenca varet nga kohëzgjatja e dënimit që përkon edhe me rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer penale.

Rehabilitimi ligjor nuk e eliminon ekzekutimin e dënimit plotësues. Përkatësisht nëse të dënuarit krahas dënimit kryesor i është shqiptuar edhe dënimi plotësues me kufizime për kohë të caktuar, në këso raste me anë të rehabilitimit nuk ndalet ekzekutimi i dënimit plotësues. Ky dënim do të shlyhet pasi të ketë kaluar periudha e verifikimit sipas kohëzgjatjes së dënimit plotësues. Në rastet kur të njëjtit person i janë shqiptuar shumë dënime, mund të shlyhen dënimet vetëm në të njëjtën kohë, dhe atë nëse janë plotësuar

[27] Salihu,I.,.E drejta Penale, pjesa e posaqme,Prishtinë 2005, fq.554
[28] Neni 103, par.3 dhe 4
[29] Neni 520 i KPPRK-së
[30] Neni 103 par.2 pika 2.1 i KPRK-së
[31] Kur të dënuarit i është shqiptuar dënim me gjobë dhe me qëllim të mos dëmtimit të madh të ekonomisë familjare i njëjti ka kërkuar që ti mundësohet pagesa në këste , i dënimi do të shlyhet nga evidenca e personave të dënuar tre vite pasi i dënuari ka paguar kështin e fundit të dënimit me gjobë.
[32] Neni 103 par.2 pika 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, dhe 2.7 të KPRK-së

kushtet për shlyerjen e secilit prej tyre. Me njohjen e rehabilitimit nuk mohohen apo nuk kufizohen të drejtat e personave të tretë që mbështeten në dënim.[33]

Vlen të theksohet se ligji ka paraparë edhe përgjegjësinë penale të personave juridik, fillimin dhe pushimin e pasojave juridike për të njëjtit duke paraparë edhe afatin ligjor lidhur me rifitimin e këtyre të drejtave të kufizuara si pasojë e veprës penale të cilat "*nuk mund të jenë më të gjata se periudha pesë vjeçare nga dita kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë*"[34].

Për rikthimin e të drejtave të kufizuara si pasojë e veprës penale për personat juridikë sipas afatit të paraparë ligjorë, procedura vihet në lëvizje me kërkesë të personit juridik, dhe për këtë vendosë gjykata duke marrë parasysh sjelljen e personit juridik, kompensimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale, pagimin e gjobës dhe kthimin e përfitimit pasuror të fituar si pasojë e veprës penale duke vlerësuar edhe rrethana të tjera që arsyetojnë rikthimin e këtyre të drejtave dhe pushimin e pasojave juridike të dënimit[35]

1.1.2. Organi publik kompetent për rehabilitimin ligjor në Kosovë

Kjo në radhë të parë varet prej asaj se kush mban evidencën e dënimeve. Është pyetje e shpeshtë në Kosovë, por së cilës nuk i është dhënë përgjigje në asnjë shkrim të deritanishëm. Kjo do të thotë se askush nuk është marrë seriozisht me ketë rrethanë deri tani. Vështirësitë krijohen nga vetë shprehja e përdorur në nenin 520 par.1 të KPPRK-së, ku thuhet *"…organi publik kompetent për çështje gjyqësore…"*bënë shlyerjen e dënimit sipas detyrës zyrtare pas kalimit të afatit të përcaktuar me ligj nën kushte të caktuara. Se nuk është në pyetje organi gjyqësor por organi administrativ që do të bëjë shlyerjen e dënimit sipas detyrës zyrtare konfirmohet nga emërtimi i nenit 421 i KPPRK-së pasi sipas kësaj dispozite *"Procedura për shlyerjen e dënimit në rastet kur organi administrativ nuk vepron*". Për më tepër teksti në gjuhën serbe te neni 520 par.1 flet për organin publik në çështje të judikaturës, sikurse edhe teksti në gjuhën angleze. Sidoqoftë të gjithë qytetarët e Kosovës e dinë se Certifikatë të jo dënueshmërisë nxjerrin nga policia e cila edhe pse mban evidencën e dënimeve në Kosovë, deri më tani asnjëherë nuk ka nxjerrë vendime sipas detyrës zyrtare, prandaj qytetaret çdo herë janë të detyruar për një dokument të tillë t'i drejtohen Gjykatës.

Bindja se nuk është në pyetje organi gjyqësor që vepron sipas detyrës zyrtare, forcohet edhe nga praktika dhe legjislacioni i vendeve tjera. Bie fjala Ligji i Procedures Penale të Republikës Federale të Gjermanisë, përcakton Regjistrin e Përbashkët mbi Veprimet e Prokurorive, të cilin e udhëheq Drejtoria Federative për judikaturë.[36] Më qartë në ketë drejtim është legjislacioni kroat i cili edhe është harmonizuar me legjislacionin e Unionit Evropian që përveç Ligjit të Procedures Penale ka marrë edhe një ligj specifik Ligjin për Pasojat Juridike të Gjykimeve, evidencës së dënimeve dhe rehabilitimit. Në nenin 3 të këtij ligji përcakton se evidencën e dënimeve do të mbaj dhe udhëheq Ministria kompetente për Judikaturë, ndërkaq me nenin 7

[33] Komentar i Kodit te Perkohshem Penal te Kosoves,Prishtine, 2012.,fq.190
[34] Neni 16 par.2 i Ligjit për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë
[35] Neni 16 par.2 dhe 4 iLligjit për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë
[36] Ligji i procedurës penale i Republikës Federale Gjermane, neni 492/1, botim në gjuhën boshnjake, në Sarajevë 2011, fq.196.

theksohet se aktgjykimet e plotfuqishme do t'u dërgohen nga Gjykatat, shënimet për mbajtjen e burgimit nga burgjet, nga shërbimet e veqanta për ekzekutimin e punës në dobi të përgjithshme dhe gjithashtu nga Gjykatat për datën e pagesës së gjobës[37].

Nuk ka dyshim se ligjdhënësi (KPPRK) ka menduar për organin administrativ që merret me çështje të judikatures e cila si shprehje përfshin Ministrinë e Drejtësisë në Kosovë. Megjithëse, nuk ka përfunduar, kompletuar legjislacionin duke obliguar Gjykatat që aktgjykimet e plotfuqishme t'i dërgohen kësaj ministrie, ndërsa burgjet të informojnë për dënimet e ekzekutuara, lirimet me kusht, Shërbimin Sprovues të Kosovës për përfundimin e dënimeve me kusht dhe punës në dobi të përgjithshme, në mënyrë që të mbajë regjistër të përgjithshëm për dënimet dhe të jetë në gjendje që sipas detyrës zyrtare të bëjë shlyerjen e dënimeve. Në këtë mënyrë qytetaret nuk do të ishin përballë me procedura të panevojshme para Gjykatës.

Duhet theksuar se kjo çështje është e rregulluar në mënyrë strikte edhe në vendet e regjionit, Mali i Zi, Serbi, Bosnje e Hercegovinë etj. Prandaj, mbetet detyrë e legjislativit të Kosovës që të qartësojë ketë çështje me normë ligjore në mënyrë që qytetaret të kenë qasje më të lehtë në liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë, pasi sigurimi me vështirësi i këtyre të dhënave është pengesë e punësimit të tyre, apo edhe arritjes së të drejtave tjera.

1.2. Rehabilitimi gjyqësorë

Rehabilitimi gjyqësor është plotësim i atij ligjor[38] dhe vihet në lëvizje me kërkesën e personit të dënuar për të cilën vendoset po ashtu me aktvendim sikurse tek rehabilitimi ligjor me dallimin se sipas kësaj kërkese vendos gjykata e jo organi publik kompetent.

Për rehabilitim gjyqësor mjafton që të ketë kaluar gjysma e afatit të paraparë ligjor për shlyerje nga evidenca e të dënuarëve sipas nenit 103 par.2 dhe personi i dënuar gjatë kësaj periudhe kohore të mos ketë kryer vepër të re penale[39],. Karakteristikë e rehabilitimit gjyqësor është se gjykata nuk është e obliguar që të vendosë sipas detyrës zyrtare për shlyerje nga evidenca e të dënuarve në momentin kur kalon gjysma e afatit e paraparë ligjor për shlyerje siç ishte e paraparë tek rehabilitimi ligjor. Në këtë procedurë kërkesa e të dënuarit është e domosdoshme.

Një kërkesë e tillë është e domosdoshme edhe kur i dënuari plotëson afatin ligjor për shlyerje nga evidenca dhe organi publik kompetent për çështje gjyqësore[40] nuk ka marrë vendim, ngase procedura për njohjen e kësaj të drejte para gjykatës mund të fillohet vetëm në bazë të kërkesës së personit të dënuar, mbrojtësit të tij apo personit të autorizuar nga i njëjti.

---

[37] Zakon o pravnim posledicama osude, kaznenoj evidenciji i rehabilitaciji, NN 143/12, 7 dhjetor 2012.Zagreb.

[38]Elezi,I.,Kaqupi,S.,Haxhia,M.,Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë,Tiranë,2009,fq.295

[39] Neni 104 i KPRK-së

[40] Organi publik kompetent për çështje gjyqësore, nuk është i përcaktuar shprehimisht me kodin e procedurës penale , realisht një gjë e tillë do të duhej të jetë kompetencë e policisë e cila merret me evidentimin e të dyshuarve për vepra penale dhe do të duhej të rregullohej çartë. Në periudhën e pasluftës asnjëherë organi publik kompetent për çështje gjyqësore nuk ka marrë ndonjë aktvendim lidhur me shlyrje nga evidenca penale të personave të dënuar sipas detyrës zyrtare, që jo vetëm bën shkelje të të drejtës së personave të dënuar por edhe ngarkohet gjykata me veprime të panevojshme, me një detyrë që dikush tjetër sipas detyrës zyrtare do ta kishte kryer me të arritur afati.

Sipas kësaj dispozite, gjykata merr aktvendim për shlyerje nga evidenca e të dënuarëve në seancë kolegji pas paraqitjes së kërkesës së të dënuarit me kalimin e gjysmës së afatit të paraparë ligjor nga neni 103 i KPRK-së. Gjykata nuk është e obliguar ta aprovoj kërkesën e të dënuarit, por kjo heqje e kufizimeve është një alternativë që mund të njihet, që do të thotë është në kompetencë të gjykatës pas vlerësimit të natyrës së veprës penale dhe rrethanave të tjera që janë të rëndësishme për përshtatshmërinë e shlyerjes së dënimit nga evidenca, të vendosë se a do ta aprovojë apo refuzojë një kërkesë të tillë të personit të dënuar.

Edhe për rehabilitimin gjyqësorë vlejnë dispozitat ligjore të nenit 103 par.1 e 2 të KPRK-së.

Në Ligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale është rregulluar edhe pushimi i pasojave juridike që ka të bëjë me rikthimin e të drejtave të kufizuara si pasojë e veprës penale e cila vihet në lëvizje me lutjen e personit juridik për të cilën vendos gjykata "pasi të kenë kaluar tre (3) vjet nga dita e dënimit të ekzekutuar apo të parashkruar....[41]", e cila lutje nuk është e domosdoshme të aprovohet nga gjykata por kjo është një alternativë që e parasheh ky ligj pasi personi juridik kërkesën e tij ta ketë arsyetuar me sjelljen e tij, të ketë përmbushur obligimet e caktuara nga sanksioni penal, të ketë kompensuar dhe kthyer përfitimin nga vepra penale.

2. Përmbajtja dhe zbulimi i të dhënave nga dosja penale

Dosja penale e një personi përfshin të dhënat personale për kryerësin e veprës penale, të dhënat mbi dënimin, vërejtjen gjyqësore, masën e trajtimit të detyrueshëm ose lirimin e kryerësit nga dënimi i shqiptuar, ndryshimet në të dhënat mbi dënimet që janë futur në dosjen penale, të dhënat mbi dënimet e mbajtura si dhe mbi shlyerjen e dënimeve të gabueshme[42]. Kjo dosje penale është konfidenciale dhe në të mund të kenë qasje vetëm organi i cili mban atë dhe e njëjta mund t'u komunikohet apo t'u bëhet e ditur vetëm gjykatës, prokurorisë dhe policisë, organeve përgjegjëse për ekzekutimin e sanksioneve penale, organeve kompetente që marrin pjesë në procedurën e dhënies së faljes apo shlyerjes nga evidenca dhe atë vetëm për dënimet të cilat nuk janë shlyer. Policisë, prokurorisë dhe gjykatës mund tu zbulohen këto të dhëna kur ndaj personit i cili është shlyer nga evidenca është duke u zhvilluar procedurë penale, mirëpo personit të dënuar me kërkesën e tij mund ti jepen këto të dhëna nëse i nevojiten përveç në raste të caktuara të parapara me ligj[43].

Shikuar nga kjo dispozitë del se organet që mund të njoftohen për dosje penale të një personi të dënuar janë vetëm policia, prokuroria dhe gjykata. Rrjedhimisht organet tjera nuk do të duhej të informoheshin përveç në bazë të kërkesës së arsyetuar mund tu zbulohen organeve publike nëse dënimet plotësuese ose masat e trajtimit të detyrueshëm janë ende në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës.

Praktika në vendin tonë duket sikur tregon të kundërtën lidhur me zbulimin e të dhënave nga dosja penale. P.sh. kur një person aplikon për një vend pune, vizë udhëtimi apo diçka të

[41] Neni 16 par.3, i ligjit për përgjegjësinë e personave juridikë të shkaktuar me vepër penale
[42] Neni 105 i KPRK-së
[43] Neni 105 par.1,2,3,4,5 i KPRK-së

ngjashme kërkohet nga i njëjti që të paraqesë një dokument se nuk është nën hetime dhe nuk ka precedent gjyqësor për ndonjë vepër penale[44]. Në këto raste konsideroj se në mënyrë direkte shkelet parimi i prezumimit të pafajësisë sepse nëse ndaj të njëjtit është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale i refuzohet kërkesa duke shkelur parimin se " askush nuk mund të konsiderohet fajtorë përderisa me aktgjykim të formës së prerë vërtetohet fajësia ". Në shumë raste në mënyrë që organet të mos akuzohen për shkelje të të drejtave, nga qytetarët që kanë pasur ndonjë interes që tu njihet ndonjë e drejtë, për udhëtim biznesi, bashkim familjarë, vend pune apo të ngjashme nga të njëjtit është kërkuar nënshkrimi i një dokumenti me të cilin pajtoheshin që ato organe të kenë të drejtë të kërkojnë dëshmi për dosje penale nga policia, prokuroria dhe gjykata. Në një mënyrë qytetarët e interesuar kanë rënë para një zgjedhje të domosdoshme sepse nëse nuk do të nënshkruanin automatikisht do të eliminoheshin nga konkurrenca edhe pse siguria e shtetit apo qytetarëve nuk vihej në dyshim nga një kërkesë e tillë siç parashihet me ligj.

Ndërsa, kur është fjala për evidencën penale të personave juridikë duhet theksuar se Personat juridik mund të përgjigjen sipas ligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, dhe dispozitat e Kodit Penal të Kosovës dhe të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës zbatohen përshtatshmërisht nëse ky ligj nuk ka paraparë ndryshe[45], nëse janë plotësuar kushtet për përgjegjësinë e personit juridik të paraparë me këtë ligj[46] dhe ndaj të njëjtëve sanksionet penale që mund të shqiptohen janë dënimet, dënimet me kusht dhe masat e sigurisë ndërsa dënimet që mund të shqiptohen janë dënime me gjobë dhe pushimi i personit juridik[47]. Për më tepër edhe ndaj personave juridikë që u është shqiptuar ndonjë nga sanksionet penale të parapara sips ligjit për përgjegjësinë penale të personit juridik mbahet evidencë penale të ciën evidencë e mban gjykata e shkallës së parë në territorin e së cilës gjendet selia e personit juridik, e përfaqësuesit apo e degës së personit juridik të huaj[48] e cila përmban të gjitha të dhënat për personin juridik si dhe të dhënat për veprën penale të kryer, gjithashtu edhe mbi sanksionet e mundshme penale që i janë shqiptuar, të dhënat mbi personin përgjegjës i cili ka kryer veprën penale për të cilën është dënuar personi juridik, të dhënat mbi ekzekutimin e dënimit apo edhe anulimin e evidencës së dënimit të gabuar.[49]

Të dhënat lidhur me evidencën penale të personave juridik mund të jepen vetëm me kërkesë të organeve shtetërore me interes të arsyeshëm dhe të bazuar në ligj dhe nëse sanksioni apo masa e sigurisë do të zgjasin gjithnjë. Me këto të dhëna mund të informohen edhe gjykata, prokuroria dhe policia por vetëm lidhur me procedurën penale që zhvillohet kundër personit juridik i cili më parë ka qenë i dënuar, organit që merret me ekzekutimin e sanksioneve penale apo faljes.

---

[44]Aq larg është shkuar në këto raste sa që edhe për aplikim për pasaportë është kërkuar dëshmi nga gjykata për precedent penal, bile edhe për pajisje me patent shofer është kërkuar një dëshmi e tillë për një periudhe më tepër se dhjetë vjeçare çka përpos dëmeve materiale që u janë shkaktuar qytetarëve u është shkaktuar edhe ndërhyrje në të drejtat e tyre të garantuara

[45] Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Vepra Penale, 04/L-030, Prishtinë 2011

[46] Neni 3 par .2 Ligji o4/L-030. Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Vepra Penale. 31 gusht 2011

[47] Neni 8 par.1 e 2 i ligjit për përgjegjësinë e personave juridik

[48] Neni 15 i LPPPJK

[49] Interpretimi i evidencës penale të personit juridik është bërë duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Vepra Penale, neni 15 par.1,2,3,4,5,6

3. Legjislacioni dhe praktika për vendosje lidhur me kërkesën për shlyerje nga evidenca e personave të dënuar në Kosovë dhe në ligjet e rajonit

3.1. Rehabilitimi , legjislacioni dhe praktika në Kosovë

Instituti i rehabilitimit sipas KPRK-së është paraparë në nenin 102 dhe nenin 103 i cili parasheh se kur mund të bëhet rehabilitimi sipas ligjit, konkretisht sipas kësaj dispozite "Me rehabilitim ligjor dënimi shlyhet nga evidenca e personit të dënuar për herë të parë, siç parashihet në paragrafin 2 të këtij neni dhe personi i tillë nuk konsiderohet i dënuar. Kjo dispozitë ligjore është mjaft konfuze dhe në praktikën gjyqësore ka shkaktuar mjaft dilema se kur personit të personit të dënuar do të duhej t'i njihej kjo e drejtë dhe sa herë ka mundësi t'i njihet kjo e drejtë'.

Sipas versionit të parë kjo e drejtë mund t'i njihet personit të dënuar vetëm njëherë dhe atë nga organi publik kompetent në çështje gjyqësore duke pasur parasysh periudhën e caktuar kohore, mundësinë e ndërmarrjes së kërkimeve për arsyeshmërinë e shlyerjes nga evidenca. Kur i dënuari për herë të dytë gjendet në një situatë të tillë atëherë organi publik kompetent në çështje gjyqësore nuk do të ketë obligim sipas detyrës zyrtare t'ia njohë këtë të drejtë pasi i dënuari nuk e arsyeton një gjë të tillë, ai përsëri ka rënë ndesh me ligjin prandaj në këto raste konsideroj se gjykata ka mundësi të ndërmerr veprime të caktuara për aprovimin apo refuzimin e kërkesës së të dënuarit.

Sipas versionit të dytë"*me rehabilitim ligjor dënimi shlyhet nga evidenca e personit të dënuar për herë të parë.."* nënkupton se personi i dënuar vetëm njëherë mund të shlyhet nga evidenca e të dënuarve çka mendoj se është një shkelje e drejtpërdrejtë që i bëhet këtyre personave pasi që të njëjtit nëse kanë kryer vepër penale nuk do të thotë se janë zhveshur nga dinjiteti njerëzor pasi nuk është e drejtë dhe humane që i dënuari vetëm një herë ti jepet mundësia për paraqitje të kërkesës për shlyerje nga evidenca.

Në këto raste shtrohet dilema si do të veprohet tek ata të dënuar që në kohën e kryerjes së veprës apo veprave penale kanë qenë të rinj dhe tek të rinjtë faza e kalimit nga mituria[50] në persona të rritur shpesh është e prirur edhe të përcillet me devijime nga rregullat e sjelljes normale . Këta të rinj bien ndesh me ligjin pasi kryejnë vepra të ndryshme penale që me kalimin e kohës tek shumë të rinj e sidomos kur u ofrohet një kujdes më i posaçëm nga familja dhe shoqëria të njëjtit arrijnë të integrohen dhe t'i kthehen jetës së rregullt dhe kontribuojnë si njerëz të dobishëm.

Si do të duhej të veprohej duke mos rënë ndesh me dispozitën ligjore dhe me të drejtat e garantuara të njeriut –ofrimin e një gjykimi të drejtë dhe në një kohë të arsyeshme[51]. Ish të dënuarit a do të duhet tërë jetën të vuajnë pasojat e gabimeve të tyre në rini, e sidomos në rastet kur ata shihet haptazi se janë integruar në shoqëri, kanë një familje stabile, kanë kryer shkollimin dhe dëshirojnë një punë të mirë e që në këto raste atyre në evidencë akoma u figuron

[50] Në këtë rast nuk bëhet fjalë për të mitur por për ata të rinjë që e kanë kaluar këtë fazë që është e prirur të sjell devijime.

[51] Dështimi i organeve gjyqësore në ofrimin e një gjykimi të drejtë dhe në një kohë të arsyeshme përbën shkelje të nenit 6 të Konventës evropiane për të drejta të njeriut , për më tepër edhe mos ofrimi i mundësisë për njohjen e një të drejte që ligji ia ka njohur në kohën e kryerjes së veprës penale do të përbënte shkelje të këtij parimi.

se kanë qenë të dënuar dhe shpeshherë në praktikë u sjell telashe në themelimin e marrëdhënies së punës!!. Edhe pse pasojat juridike të dënimit përfundojnë në rastet e mbajtjes së dënimit me burgim, faljes ose parashkrimit të dënimit, personit i cili ka bërë dëmshpërblimin[52](nëse me ligj nuk parashihet ndryshe) kanë mundësi të pajisen me një certifikatë të pastër për të kaluarën kriminale nga të cilët e njëjta dëshmi kërkohet edhe nga evidenca e policisë. Në këto raste nga policia kërkohet vendimi për shlyerje i gjykatës në mënyrë që ti shlyej nga evidenca e tyre. Në këtë rast personave të dënuar u lindin problemet sepse nëse ka pasur më tepër se një vepër penale atëherë të njëjtëve vetëm njëra do tu shlyhej ndërsa për vepra të tjera do ti refuzohej kërkesa.

Pikërisht këtu vihet në pyetje edhe shkelja e parimit të ofrimit të një gjykimi të drejtë, dhe në një afat të arsyeshëm kohor, të paraparë edhe me konventën evropiane për të drejtat e njeriut, pasi siç e theksuam edhe më lartë për rehabilitimin ligjor organi publik kompetent në çështje gjyqësore është i obliguar të kujdeset sipas detyrës zyrtare. Kjo në praktikë nuk ndodh, qoftë nga neglizhenca e administratës për tu përkujdesur që ti njoftojnë organin publik kompetent në çështje gjyqësore, apo mos mbajtja me rregull e kësaj evidence se kur arrin afati ligjor për shlyerje nga evidenca, apo edhe mos përcaktimi i saktë se kujt duhet ti paraqiten këto të dhëna dhe obligimi për paraqitjen e tyre. Me këtë institut nuk merren fare sipas detyrës zyrtare dhe me apo pa vetëdije e shkelin të drejtën e të dënuarëve, dhe në rastet kur paraqitet kërkesa dhe vihet në lëvizje procedura vërehet se dënimi veq është dashur të shlyhet për njërën vepër, që nuk do të binte në kundërshtim me dispozitën e tanishme ligjore, ngase si i tillë nuk do të figuronte më dhe nuk do të ishte shtruar dilema se si do të veprohej për veprën që tani ka arritur afatin për rehabilitim.

Kur jemi te rikthimi i të drejtave të kufizuara si pasojë e veprës penale për persona juridikë, në mënyrë të detajuar është paraparë se ndaj kujt vlen ky ligj[53], kush nuk mund të jetë përgjegjës si person juridik (por vetëm personi përgjegjës i personit juridik)[54] dhe kujt mund ti drejtohen personat juridikë, pa paraparë kufizime se sa herë mund të paraqitet një kërkesë e tillë dhe përderisa nuk parashihet se sa herë mund të paraqitet, nënkupton prezumimin në favor të personit juridik se mund të paraqitet sa herë që paraqitet e nevojshme konform periudhave të parapara kohore të përcaktuar me këtë ligj. Për më tepër ky ligj shprehimisht parasheh se gjykata është organi i autorizuar për pushimin e pasojave juridike si pasojë e ekzekutimit të dënimit me lutjen e personit juridik.

[52] Neni 102 par 1 e 2 i KPRK-së.

[53] Ligji për përgjegjësinë e personit juridik për vepër penale vlen për persona juridik të vendit dhe të huaj për vepër penale të kryer në territorin e Republikës së Kosovës, për persona juridik të huaj përgjegjës për vepër penale të kryer jashtë shtetit në dëm të Republikës së Kosovës, shtetasit të saj apo të personit juridik të vendit, personit juridik të vendit (vendor) i cili është përgjegjës për veprën e kryer penale jashtë vendit. Neni 4 , par,1 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 i Ligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepër penale

[54] Neni 3dhe 4 i Ligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepër penale

3.2.Vendosja lidhur me kërkesën për shlyerje nga evidenca e personave të dënuar

Siç e theksuam edhe më lartë, kur kemi të bëjmë me rehabilitim ligjor organi publik kompetent në çështje gjyqësore[55] merr aktvendim për shlyerje nga evidenca pasi të ketë bërë gjurmime të nevojshme nëse ndaj atij personi është duke u zhvilluar ndonjë procedurë për vepër të re penale para se të ketë kaluar afati i paraparë për shlyerje.

Nëse një gjë e tillë nuk është bërë sipas detyrës zyrtare nga organi publik kompetent për çështje gjyqësore, atëherë personi i dënuar mund të kërkojë që të konstatohet shlyerja e dënimit brenda 30 ditëve dhe të merret aktvendim për shlyerje të dënimit nga evidenca në bazë të ligjit. Në qoftë se edhe pas kësaj nuk është vepruar atëherë personi i dënuar mund të kërkojë nga gjykata që ka gjykuar në shkallë të parë të merr aktvendim për shlyerje nga evidenca. Që do të thotë se pas dështimit të organit publik kompetent për marrje të një vendimi sipas detyrës zyrtare dhe mos përgjigjes lidhur në vendosje në afatin 30 ditor pas paraqitjes së kërkesës së të dënuarit, organi publik kompetent e humb të drejtën për refuzimin e kërkesës së personit të dënuar por ai është i obliguar që sipas detyrës zyrtare të konstatojë shlyerjen. Vetëm nëse janë shterrur këto mundësi dhe afate të parapara ligjore ndërsa ky organ nuk ka marrë ndonjë aktvendim, atëherë personi i dënuar fiton të drejtën që ti drejtohet gjykatës.

4. Kompetenca dhe kriteret për vendosje lidhur me kërkesën e të dënuarit për shlyrje nga evidenca sipas KPRK-së

Kur kemi të bëjmë me rehabilitim gjyqësor por edhe me atë ligjor, nëse organi publik kompetent për çështje gjyqësore nuk ka marrë aktvendim për vendosje lidhur me kërkesën e të dënuarit, procedura për vendosje para gjykatës lidhur me shlyerjen nga evidenca e të dënuarve vihet në lëvizje me kërkesë të personit të dënuar[56] i cili i drejtohet gjykatës që ka vendosur në shkallë të parë, që t'ia njohë këtë të drejtë, duke i paraqitur edhe dëshmitë mbi arsyeshmërinë e kërkesës të cilat edhe nëse mungojnë gjykata do ti kërkojë sipas detyrës zyrtare nga organet përgjegjëse për mbajtjen e evidencës – policia, prokuroria, gjykatat dhe organi kompetent për ekzekutimin e sanksioneve penale. Pas pranimit të kërkesës, gjyqtarit të cilit i është caktuar çështja (gjyqtari raportues), së pari verifikon afatin e përcaktuar ligjor, kërkesa e paraqitur nëse është konform kritereve të parapara sipas nenit 104 lidhur me nenin 103 par.2 të KPRK-së dhe e njëjta nëse është paraqitur nga personi i autorizuar.

Kriteret e domosdoshme për vendosje lidhur me kërkesën e personit të dënuar janë:

- Të jetë paraqitur nga personi i autorizuar sipas ligjit;
- Të ketë kaluar gjysma e aftit të paraparë për rehabilitim ligjor;
- I dënuari të mos ketë kryer vepër tjetër penale në afatin e paraparë ligjor për rehabilitim;

[55] Konsiderojmë se organi publik kompetent në qështje gjyqësore është Ministria e drejtësisë në këtë rast, pasi Shërbimi korrektues i Kosovës si organ kompetent për ekzekutimin e vendimit është i obliguar ta njoftojë ministrinë e drejtësisë për çdo dënim të ekzekutuar dhe mban evidencë për to.
[56] Neni 523 par.1 i KPPRK-së

- Të ketë arsyetuar aprovimin e kërkesës me sjelljet e tij pas vërejtjes gjyqësore, dënimit me gjobë, dënimit me kusht apo dënimit me burgim dhe
- Të kenë kaluar jo më pak se dy vite nga koha kur i është refuzuar kërkesa për shlyerje nga evidenca e të dënuarve.

Kërkesa është formale dhe e njëjta duhet të përmbajë elementet qenësore të çdo parashtrese që mund ti paraqitet gjykatës- emrin e gjykatës që i drejtohet, aktgjykimin-aktgjykimet për të cilat kërkohet shlyrja, dështminë nga qendra korrektuese mbi mbajtjen e dënimit apo lirimit të parakohshëm, dështminë mbi pagesën e gjobës nëse i është shqiptuar dënim me gjobë, dështmi mbi pagesën e shpenzimeve procedurale të shkaktuara në procedurën penale të zhvilluar ndaj tij dhe dështminë për dëmshpërblimin e të dëmtuarit nëse me aktgjykim i është caktuar një obligim i tillë.

Nëse kriteret e parapara janë plotësuar, pavarësisht nëse kërkuesi i ka dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme, gjyqtari vërteton pohimet e paraqitura në kërkesë, dhe mbledh prova që do të shërbenin në marrjen e aktvendimit[57].

Kërkesa e paraqitur nga ana e personit të paautorizuar do të hidhet si e palejuar ndërsa personi i dënuar nuk e humb të drejtën që të paraqesë kërkesë[58]

Për kërkesën e personit të dënuar me propozim të arsyetuar të gjyqtarit pas kryerjes së gjurmimeve të nevojshme vendos kolegji i gjykatës e cila ka marr aktgjykimin në shkallë të parë. Nëse i dënuari plotëson këto kritere atëherë gjykata merr aktvendim me të cilën aprovohet kërkesa e të dënuarit dhe urdhërohen organet në të cilat i njëjti është i evidentuar për veprën penale që është kërkuar të shlyhet, ta shlyejnë nga evidenca e personave të dënuar.

Në rastet kur i dënuari nuk i plotëson kriteret e parapara ligjore dhe me sjelljen e tij nuk e ka arsyetuar shlyerjen e dënimit e njëjta me aktvendim i refuzohet dhe një kërkesë të tillë i dënuari mund ta përsërisë vetëm pasi të kenë kaluar dy vite nga dita kur aktvendimi për refuzimin e kërkesës së tij ka marrë formën e prerë[59] në të cilën ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit[60].

[57] Kërkohet nga policia nëse paraqitësi i kërkesës është i dyshuar për ndonjë vepër penale për të cilën është i evidentuar në këtë organ, kërkon që të dhënat e siguruara nga policia të vërtetohen edhe në prokurorinë e shtetit nga të cilët edhe kërkon mendim lidhur me vendosjen për kërkesë(edhe pse nuk është e lidhur me mendimin e tyre), edhe pse sipas ligjit (neni 524 par.4) mund të kërkojë rapor për sjelljet e të dënuarit edhe nga institucioni ku ka mbajtur dënimin një gjë të tillë pothuajse asnjëherë nuk praktikohet.

[58] Në këto raste personi i dënuar nuk është i lidhur me afatin dy vjeçar sikurse kur refuzohet kërkesa e të dënuarit si e pabazuar.

[59] Neni 523 par.6 i KPPRK-së

[60] Gjykata e Apelit ka të drejtën të vërtetojë aktvendimin e Gjykatës Themelore, ta ndryshojë apo edhe ta kthejë në rivendosje.

4.1. Kompetenca dhe kriteret për vendosje lidhur me kërkesën për shlyerje nga evidenca penale sipas ligjeve të rajonit

Pothuajse të gjitha shtetet që në sistemet e tyre pretendojnë demokracinë institutin e rehabilitimit e kanë pjesë të pashmangshme të tyre si një e drejtë humane që pretendohet tu njihet të dënuarve të risocializuar. Me këtë institut të dënuarit pas mbajtjes së sanksionit penal ligji i mundëson shlyerjen nga evidenca e të dënuarve me qëllim që i njëjti të fitojë të gjitha të drejtat po sikurse personat e padënuar ndonjëherë, duke e paraparë edhe procedurën e shlyerjes dhe kompetencën.

Siç e theksuam më lartë se KPRK, njeh të drejtën e rehabilitimit ligjor dhe gjyqësor duke i paraparë edhe kriteret dhe kompetencat e vendosjes.

Kodi Penal i Kroacisë, institutin e rehabilitimit e ka paraparë në nenin 85, duke njohur mënyrën ligjore dhe gjyqësore të rehabilitimit. Sipas këtij ligji, rehabilitimin ligjor e përfundon organi kompetent[61] (Ministria e Punëve të Brendshme) posa të arrijë afati i paraparë dhe nuk paraqet ndonjë problem, pasi evidenca penale mbahet në mënyrë elektronike dhe i dënuari do të përfitojë nga kjo e drejtë posa të ketë arritur afati ligjor pas gjurmimeve të nevojshme, ndërsa rehabilitimin gjyqësor e kryen gjykata me kërkesë të personit të dënuar.

Edhe sipas Ligjit Penal të Malit të Zi procedura lidhur me rehabilitimin është e rregulluar qartë dhe për të dënuarin nuk paraqet problem për përfitimin nga kjo e drejtë pasi e njëjta kryhet në mënyrë automatike posa të përmbushet afati i paraparë ligjor dhe pas gjurmimeve të nevojshme mbi sjelljet e kryerësit pas mbajtjes së dënimit, ndërsa për rehabilitimin gjyqësor edhe sipas këtij ligji vendos gjykata nëse i dënuari me sjelljet e tij pas mbajtjes së dënimit arsyeton shlyerjen nga evidenca. Në mënyrë të ngjashme vendoset edhe në Ligjin Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës duke paraparë edhe llojet e rehabilitimit dhe mundësitë e përfitimit nga ky institut.

Sipas Ligjit Penal Italian, vendimin për rehabilitim e merr gjykata e cila ka shqiptuar dënimin por procedura vihet në lëvizje me kërkesën e të dënuarit i cili me rastin e paraqitjes së kërkesës duhet ti paraqesë gjykatës dëshminë për vendbanimin apo vendqëndrimin e tij, se ka mbajtur dënimin apo ka paguar gjobën, ka pagur shpenzimet e procedurës së zhvilluar ndaj tij, ka kompensuar viktimën apo dëshmi se e njëjta nuk i pretendon dëmshpërblim, do të preferohej që në kërkesë të paraqitej edhe arsyeja e kërkesës. Gjykata pas disa muajsh do të vendosë lidhur me kërkesën, cakton takim me paraqitësin e kërkesës në të cilin është e nevojshme asistenca e një mbrojtësi të besuar të tij apo të atij të caktuar nga gjykata në të cilin takim do ti komunikojë vendimin për miratimin apo refuzimin e kërkesës. Nëse gjykata vendos për rehabilitimin në favor të kërkuesit, të njëjtin do ta shlyejë nga arkivi telematik i Gjykatës i cili mund të hiqet nëse qytetari në afat prej shtatë vitesh kryen vepër tjetër penale të dënueshme me të paktën dy vite burgim[62].

[61] Bačič,F.,Pavlovic,Š.,Komentar Kaznenog Zakona,Zagreb, 2004,fq.402

[62] Av.mascia salvatore., Rehabilitimi penal-si pastrohet dosja penale. Publikuar ne 20 dhjetor 2010 ne www.shqiptariitalise.com

Sipas LPJ-së shlyerja nga evidenca e personave të dënuar prej një vit burgim dhe me dënime më të larta ishte kompetencë ekskluzive e gjykatës[63] e cila vendoste vetëm në bazë të kërkesës së të dënuarit, për të cilën gjyqtari raportues kryente gjurmimet e nevojshme për sjelljet e të dënuarit dhe arsyeshmërinë e shlyerjes nga evidenca[64]. Për shlyerje nga evidenca vendoste kolegji i gjykatës .

Edhe me Ligjin Penal të Kosovës ishte paraparë rehabilitimi ligjor dhe gjyqësor i cili mund të bëhej në rrugë administrative dhe rrugë gjyqësore[65]. Për shlyerjen nga evidenca penale në rrugë administrative sipas detyrës zyrtare vendos organi i punëve të brendshme, ndërsa për rehabilitimin gjyqësor vendos gjykata me kërkesë të personit të dënuar.

Me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës rehabilitimi është paraparë në nenin 86 par.2 e që njihte edhe rehabilitimin ligjor dhe gjyqësor duke paraparë edhe peridhat kohore pas të cilave mund të shlyhej dënimi nga evidenca e të dënuarve sipas detyrës zyrtare dhe me kërkesë të të dënuarit me disa kufizime, që i referohen dënimit me më tepër se 15 vjet burgim dhe dënimit me burgim afatgjatë[66].

5. Vështrim krahasues i institutit të rehabilitimit me ligjet e rajonit

Instituti i rehabilitimit është i kohës relativisht të re, për herë të parë është paraqitur në Francë pas ngadhënjimit të Revolucionit Francez[67], prej kur edhe pothuajse është bërë pjesë përbërëse e të gjitha kodeve penale të të gjitha shteteve demokratike, në shërbim të risocializimit të personave të dënuar.

Sipas ligjit penal të RSFJ-së, rehabilitimi dhe shlyerja nga evidenca ex lege ishte paraparë për të dënuarit që është dhënë qortimi gjyqësor, janë liruar nga dënimi, dënimin me kusht, dënim me gjobë dhe të njëjtit në periudhën brenda një viti kur aktgjykimi të ketë marrë formën e prerë nuk kanë ndonjë vepër tjetër penale[68]. Për të dënuarit që u është shqiptuar dënim me burg deri në një vit burgim dhe me burg për të mitur dënimi shlyhet nga evidenca kur të kenë kaluar pesë vjet nga dënimi i vuajtur, i parashkruar ose i falur dhe të njëjtit nuk kanë kryer ndonjë vepër tjetër penale. Vlen të theksohet se sipas këtij ligji (n. 93 par.7) nëse brenda periudhës kohore të përcaktuar për shlyerje nga evidenca, të dënuarit i shqiptohet edhe një dënim me burg me mbi tri vjet, nuk do të fshihet as dënimi i mëparshëm as dënimi i mëvonshëm, përderisa për disa dënime të të njëjtit person mund të fshihen vetëm njëkohësisht nëse për secilën nga këto përmbushen kriteret e parapara ligjore[69].

Kodi i Përkohshëm penal i Kosovës institutin e rehabilitimit e parasheh në nenin 86 sipas të cilit personi i dënuar pas mbajtjes së dënimit, amnistimit apo faljes i fiton të gjitha të drejtat

[63] Neni 93 par.5 i Ligjit Penal të Jugosllavisë,v.1977
[64] Ligji mbi procedurën penale të RSFJ-së, neni 513, viti 1986
[65] Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës. Instituti i Kosovës për Integrime Euro Atlantike.Prishtinë 2001, fq.173-174
[66] Po aty., fq.145-146
[67] Salihi,I.,E drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2005, fq.552
[68] Neni 93 i Ligjit Penal të Jugosllavisë par.1,2,3,4, viti 1977
[69] Neni 93 par.7 dhe 8 tëRSFJ-së, viti 1977

që i ka pasur para kryerjes së veprës penale dhe i njëjti do të konsiderohet i padënuar nëse i plotëson kriteret e parapara ligjore dhe me sjelljen e tij e arsyeton shlyerjen[70]

Kodi Penal i Shqipërisë institutin e rehabilitimit e ka paraparë në nenin 69 sipas së cilës dispozitë të padënuar quhen personat:

a. ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga gjashtë muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale,
b. ata që janë dënuar e burgim për një kohë nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet dhe që gjatë pesë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale,
c. ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga pesë gjer në dhjetë vjet dhe që gjatë shtatë vjetëve nga dita e vuajrjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale,
d. ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga dhjetë gjer n' njëzet e pesë vjet dhe që gjatë dhjetë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale[71].

Edhe KPSH parasheh rehabilitimin gjyqësor dhe ligjor. Rehabilitimi gjyqësor bëhet me vendim të gjykatës pasi të jetë bindur gjykata me prova të mjaftueshme se personi gjatë afatit të provës është përmirësuar, ndërsa për rehabilitim ligjor, për tu quajtur personi i padënuar mjafton të ketë kaluar afati i përcaktuar sipas ligjit, pa pasur nevojë për ndonjë vendim të posaqëm të gjykatës[72].

Sipas Ligjit Penal Italian të drejtën për rehabilitim mund ta kërkojë çdo i dënuar personalisht apo përmes mbrojtësit të tij nëse janë plotësuar kushtet e parapara sipas ligjit që rezultojnë të jenë më të favorshme se në KPRK lidhur me dënimet më të ulëta pasi sipas tij mund të kërkohet shlyerja nga evidenca nëse kanë kaluar tre vjet nga vendimi përfundimtarë i cili nuk ka mundësi të apelohet, ndërsa për ata që janë dënuar për vepra të rënda penale apo janë dënuar disa herë për vepra të ndryshme penale kërkesa mund të paraqitet vetëm pasi të kenë kaluar 8 ose 10 vjet sipas rasteve të përcaktuara me ligj, nuk duhet të ketë kryer më vepra penale, të ketë kompensuar të dëmtuarin, të ketë paguar shpenzimet e procedurës penale të zhvilluar ndaj tij dhe nuk duhet ti jetë nënshtruar masave të sigurisë[73].

6. Përfundime

Instituti i rehabilitimit konsiderohet një mundësi humane që u jepet personave të dënuar të cilët pas kryerjes së një vepre penale dhe periudhës së paraparë verifikuese nuk kanë kryer ndonjë vepër të re penale. Kjo është një mundësi e dytë që ligjvënësi u ofron në disponim personave të dënuar që ti kontribuojnë në radhë të parë përmirësimit të vetvetes e me këtë ti kontribuojnë edhe familjes, rrethit dhe shoqërisë. Me analizimin e këtij instituti është përpjekur të sqarohen

[70] Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, neni 86, Prishtinë 2004
[71] Neni 69 i Kodit Penal të Shqipërisë
[72]Elezi,I.,Kaqupi,S.,Haxhia,M.,Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë,Tiranë,2009,fq.295
[73] Av.mascia salvatore., Rehabilitimi penal-si pastrohet dosja penale. Publikuar ne 20 dhjetor 2010 në www.shqiptariitalise.com,

disa dilema që paraqiten në praktikë dhe të jepen sugjerime lidhur me një vendosje pa shkelur të drejtat e personave të dënuar dhe duke pretenduar në qëllimin e dënimit, pa pretenduar se është thënë gjithqka apo janë prekur të gjitha pikat e mundshme. Rekomandimet qëndrojnë kryesisht në interpretimin e drejtë të kësaj dispozite dhe aplikimin e ligjit më të favorshëm.

1. Lidhur me zbatimin e drejtë dhe të njëjtë në tërë territorin e Republikës së Kosovës besoj se do të duhej të merrej një qëndrim parimor nga Gjykata Supreme e Kosovës.
2. Nëse sipas dispozitës ligjore të nenit 103 thuhet se personi i dënuar mund të shlyhet nga evidenca vetëm njëherë atëherë shumë më humane do të ishte të veprohej me dispozitën e paraparë në KPPRK pasi e njëjta është më e favorshme për të dënuarin sepse nuk e parasheh fjalën për herë të parë për veprat penale që janë kryer gjatë kohës kur i njëjti ligj ka qenë në fuqi.
3. Është nevojë urgjente përcaktimi strikt se cili është organi publik kompetent për çështje gjyqësore që do të merrej me rehabilitimin sipas detyrës zyrtare pasi që përveç se ish të dënuarve do ti njihej një e drejtë ligjore, në të njëjtën kohë do të shkarkoheshin edhe gjykatat nga ndërmarrja e veprimeve për njohjen e kësaj të drejte e gjithashtu do të kontribuohej dukshëm në kthimin e besimit të qytetarëve në organet publike.
4. Lidhur me zbulimin e të dhënave nga dosja penale e të dënuarve mendoj se do të duhej të intervenohej në këtë drejtim që pas shlyerjes nga evidenca mundësitë e marrjes së të dhënave për dënimet e shlyera të ishin më të kufizuara pasi me këtë instituti të rehabilitimit e humb efektin e vet dhe qytetarët e risocializuar përsëri do të paragjykoheshin.

Bibliografia

- Bačič, Franjo.,Pavlovic,Šime.,Komentar Kaznenog Zakona, Zagreb, 2004
- Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës. Instituti i Kosovës për Integrime Euro Atlantike.,Prishtinë 2001
- Elezi,Ismet., Kaqupi,Skender.,Haxhia,Maksim.,Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë,Tiranë,2009,
- Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Prishtinë 2004
- Kodi penal i Malit të Zi, nr.70/04,13/04
- Kodi Penal i Kroacisë, Zagreb 2004
- Kodi Penal i Shqipërisë. Tiranë, viti 1995.
- Kodi Penal i Bosnjës dhe Hercegovinës
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, v.2013
- Kodi i procedurës Penale të Republikës së Kosovës, v.2013
- Komentar i Kodit te Perkohshem Penal te Kosoves,Prishtine , 2012
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut
- Ligji i procedurës penale i Republikës Federale Gjermane, Botim në gjuhën boshnjake Sarajevë 2011

- Ligji o4/L-030. Ligji për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale. 31 gusht 2011
- Ligji Penal i Jugosllavisë,v.1977
- Ligji mbi procedurën penale të RSFJ-së, viti 1986
- Mascia salvatore, Rehabilitimi penal-si pastrohet dosja penale. Publikuar ne 20 dhjetor 2010 në www.shqiptariitalise.com
- Salihu, Ismet., E drejta penale, pjesa e përgjithshme.Prishtinë 2005,
- Zakon o pravnim posledicama osude, kaznenoj evidenciji i rehabilitaciji, NN 143/12, 7 dhjetor 2012.Zagreb

Msc. Fatime Dërmaku*

"FRUTGËZIMI"

ABSTRAKT

Ky punim sqaron institutin e frutgëzimit si një e drejtë sendore, e cila në masë të konsiderueshme kufizon të drejtat e pronarit të objektit të frutgëzimit. Po ashtu do të trajtohet përmbajtja e frutgëzimit, respektivisht të drejtat themelore dhe detyrimet e frytgëzuesit dhe të pronarit të sendit. Në këtë punim do të trajtohet gjithashtu krijimi i frugëzimit, mbrojtja e frugëzimit si dhe shuarja e tij. Vështrim i posaçëm në këtë punim do t'i kushtohet pozitës juridike të subjekteve të lartcekura, kufizimeve lidhur me përdorimin e objektit të frutgëzimit. Të drejtat dhe detyrimet e frutgëzuesit si dhe pronarit të sendit janë rregulluar në mënyrë të detajuar me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore të Kosovës, si dhe janë analizuar në rrafshin komparativ, duke i krahasuar ato me sistemet juridike të vendeve të tjera. Ky punim provon se e drejta e pronësisë si një e drejtë absolute, megjithatë i nënshtrohet kufizimeve gjatë ekzistimit të marrëdhënies juridike të frutgëzimit, e të cilat pronari i sendit është i detyruar t'i duroj, ashtu që të lejoj frytgëzuesin që në mënyrë të qetë të ushtroj të drejtën e tij, por që natyrisht edhe ky i fundit në instancë të fundit duhet t'i përmbahet mënyrës së shfrytëzimit të sendit ashtu siç është e përcaktuar me ligj e sidomos duhet të ketë kujdes në ruajtjen e substancës së sendit si dhe destinimit ekonomik të tij.

Fjalë kyçe: servitut personal, frutgëzimi, pronari i sendit, frutgëzuesi, gëzimi sendit, frutat, të drejtat dhe detyrimet, e drejtë sendore e kufizuar.

Hyrje

Në të drejtën pozitive të Kosovës, frutgëzimi si njëri ndër servitutet më të rëndësishme personale, është rregulluar me dispozitat e neneve 218-251 të Ligjit të Pronësisë dhe të Drejtave tjera Sendore të Kosovës[74].

Frutgëzimi është përdorimi i kufizuar në kohë i sendit të huaj dhe vjeljes së frutave të tij, pa e dëmtuar substancën e sendit dhe destinimin ekonomik të tij. Si e drejtë sendore e përdorimit më të gjerë të sendit të huaj, paraqet servitutin personal më të rëndësishëm.

---

* Kandidate për prokurore në IGJK, dhe njëherit PhD- kandidat në Universitetin e Prishtinës- Fakulteti Juridik, katedra juridike-civile.

[74] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.57/04, 2009.

Si çdo e drejtë tjetër subjektive edhe frutgëzimi përbëhet nga të drejta dhe detyrimet, për subjektet, të cilat hyjnë në marrëdhënie juridike për krijimin e tij. Përmbajtja e frutgëzimit bënë pjesë në grupin e të drejtave subjektive absolute dhe si e tillë vepron erga omnes, pra, ndaj të gjithë personave të tretë, përfshirë këtu edhe titullarin e të mirës shërbyese. Por, për dallim nga personat e tretë, veprimi i të cilëve është negativ, në mes të titullarit të së drejtës shërbyesit dhe frutgëzuesit krijohen edhe raporte relative të së drejtës subjektive. Meqenëse, frutgëzimi ka efekt të veprimit të dyfishtë, në raportet në mes të titullarit të së mirës shërbyese dhe frutgëzuesit, frutgëzimi përmban elemente të së drejtës subjektive të karakterit absolut si dhe të atij relativ[75]. Për nga përmbajtja frutgëzimi është i ngjashëm me marrëdhëniet e detyrimeve (sikurse qiraja), ndërsa për nga veprimi frutgëzimi është e drejtë sendore. Objekt i frutgëzimit mund të jenë sendet apo të drejtat.

Frutgëzimi mund të krijohet në bazë të kontratës apo të një vendimi gjyqësor[76].

Në bazë të kontratës frugëzimi krijohet në atë mënyrë që titullari i të drejtës shërbyese, mban për vete të drejtën e pronësisë mbi sendin ndërsa kalon tek frutgëzuesi të drejtën e frutgëzimit, apo, mban për vete të drejtën e frutgëzimit ndërsa tek tjetri bart të drejtën e pronësisë.

Sipas vendimit gjyqësor, frugëzimi krijohet në atë mënyrë, kur vërtetohen fakte juridike relevante që janë të parashikuara me ligj. Kjo më së miri mund të ilustrohet me faktin se, po që se i referohemi Ligjit të Trashëgimisë së Kosovës nenit 63.2, ku parashihet: "Në qoftë se uzufrukti ...është kontraktuar për ceduesin dhe bashkëshortin e tij së bashku, në rast vdekjeje të ndonjërit prej tyre uzufrukti ... në tërësi tjetrit gjerë në vdekjen e tij, po qe se nuk është kontraktuar ndonjë gjë tjetër, apo nëse nuk del ndonjë gjë tjetër nga rrethanat e rastit", e ku shihet se duhet vërtetuar faktet juridike të ekzistimit të së drejtës së frutgëzimit, në mënyrë që të realizohet kjo e drejtë.

Sipas KC të Shqipërisë neni 233 frutgëzimi mund të fitohet edhe me parashkrim fitues.

Po ashtu KC i Shqipërisë në nenin 236 ka paraparë edhe bashkuzufruktin, sipas së cilës dispozitë Uzufrukti mund të jetë në favor të më shumë se një personi. Kur e drejta e njërit prej tyre shuhet, ajo u kalon uzufruktarëve që mbeten, në përpjesëtim me pjesët. Në këtë mënyrë veprohet deri në shuarjen e së drejtës së uzufruktarit të fundit që mbetet.

Një paluajtshmëri apo një send i luajtshëm mund të ngarkohen në mënyrë që personi (shfrytëzuesi) në dobi të të cilit është ngarkuar sendi ka të drejtë ta shfrytëzoj dhe t'i vjelë të gjitha dobitë e sendit, pa e prishur substancën e sendit[77].

Frutgëzuesi nuk mundet të disponoj me esencën e sendit as juridikisht, as faktikisht[78]. Juridikisht nuk mundet të disponoj me esencën e sendit meqë frutgëzimi është servitut personal dhe është i lidhur për personalitetin e titullarit të frutgëzimit, ndërsa faktikisht frutgëzuesi duhet

[75] D.Stojanovic-O.Antic, uvod u gradjansko pravo, Beograd, 2004, 204.
[76] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Republikës së Kosovës, neni 220.
[77] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Republikës së Kosovës, neni 218
[78] Gams,Andrea ,Bazat e së Drejtës Reale,Beograd 1966,fq.151

ta ruaj esencën e sendit, nuk mundet ta ndryshoj as përbërjen fizike të sendit e as destinimin e tij ekonomik[79].

1. Pozita juridike e frutgëzuesit

1.1. Të drejtat e frutgëzuesit

Frutgëzuesi ka të drejtë të gëzoj sendin e huaj, duke e respektuar destinimin e tij ekonomik, si dhe duke e ruajtur substancën e tij, kurse pronari i sendit detyrohet të durojë një gjë të tillë. Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Kosovës parasheh**:** „Një paluajtshmëri apo një send i luajtshëm mund të ngarkohen në mënyrë që personi (shfrytëzuesi) në dobi të të cilit është ngarkuar sendi ka të drejtë ta shfrytëzoj dhe t'i vjelë të gjitha dobitë e sendit, pa e prishur substancën e sendit"[80].

Në Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore të Kosovës, konkretisht në nenin 224, parashihet:"Frutgëzuesi ka të drejtë për posedimin e sendit që është ngarkuar me frutgëzim". Pra siç shihet nga kjo dispozitë ligjore, njëra ndër të drejtat fundamentale të frutgëzuesit është edhe e drejta e posedimit të sendit të ngarkuar me frutgëzim. Po ashtu duke ju referuar formulimit ligjor të dispozitës së nenit 218 të LPDSK, shihet se frutgëzuesi ka të drejtë ta shfrytëzoj dhe t'i vjelë të gjitha dobitë e sendit.

1.1.1. E drejta e marrjes së sendit në posedim

Frutgëzuesi është i autorizuar që sendin ta ketë në posedim[81]. Parimisht frutgëzuesi ka posedimin e ligjshëm, të pavarur dhe ekskluziv. Ndërsa, mundësia e kontraktimit të posedimit të ndërmjetshëm dhe bashkëposedimit, ekziston vetëm atëherë kur me këtë lloj posedimi arrihet qëllimi i së drejtës së përdorimit dhe vjeljes së frutave[82].

E drejta për të poseduar sendin nënkupton faktin se frutëgëzuesi menjëherë vihet në marrëdhënie me sendin, në mënyrë që ta shfrytëzoj, ta administrojë, të përfitoj frytet, pa pasur nevojën e një aktiviteti ndërmjetës të pronarit të zhveshur apo të tjerëve. Kjo përfaqëson një cilësi thelbësore të frutgëzimit.

Pronari është i obliguar që sendin t`ia kaloj në posedim frutgëzuesit, nëse ai këtë nuk e bënë vullnetarisht atëherë frutgëzuesi ka të drejtë që të ngrejë padi ndaj mbajtësit për të marrë sendin në posedimin e tij[83]. Nëse frutgëzuesi dhe pronari me marrëveshje nuk e kanë paraparë detyrimin për dorëzimin e sendit në gjendje të rregullt, atëherë frutgëzuesi nuk mund të refuzoj marrjen e sendit për shkak të metave të sendit. Nëse frutgëzuesi e keqpërdorë të drejtën e tij, atëherë gjykata mund t'ia heq atij të drejtën e administrimit të sendit. Vetë shprehja frutgëzim

[79] Aliu,A., vepra e cituar, fq.168
[80] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Republikës së Kosovës Neni 218
[81] KCGJ neni 1036
[82] Kovacevic, Nemanja, Përmbajtja e frutgëzimt në të drejtën Serbe, "Glasnik Prava" Kragujevc, 2013 fq. 121.
[83] Ligji për Pronësnë dhe të Drjetat Tjera Sendore i Kosovës,neni 232.

në vete ngërthen dy elemente përbërëse thelbësore: Usus është e drejta për të përdorur sendin dhe fructus e drejta për të vjelë frutat e sendit. Janë këto dy elemente që dhe ja kanë dhënë kuptimin frutgëzimit i cili njihet me emër të tillë. Pothuaj se në të gjitha sistemet juridike – civile bashkëkohore frutgëzimin e ngrisin dhe formësojnë në bazë të këtyre dy elementeve qenësore, mbi të cilat qëndrojnë të drejtat e frutgëzuesit si p.sh. KCF, KCSH etj[84]. Qenësore është që të ruhet substanca e sendit që është objekt i frutgëzimit në esencë, pa marrë parasysh vëllimin e autorizimeve që ka titullari i të drejtës së frutgëzimit për shfrytëzimin e sendit të huaj. Kjo është fare e lehtë për tu kuptuar nga vetë definicionet që jepen për frutgëzimin. Kjo edhe shton nevojën që sendi të jetë i paharxhueshëm.

1.1.2. E drejta e gëzimit të sendit

Sa i përket të drejtës së gëzimit nga ana e frutgëzuesit kjo është një e drejtë e përgjithshme, e papërcaktuar dhe ligji bënë një përkufizim negativ, kështu duke e obliguar frutëgëzuesin në ruajtjen e substancës së sendit[85.]

Frutëgëzuesi ka autorizim që ta gëzoj sendin por nuk ka tagër që të ndryshoj destinacionin e tij ekonomik, pa pëlqimin e pronarit. E drejta për të gëzuar nënkupton të drejtën për të marrë frytet. Frutëgëzuesi ka të drejtë të mbledh frytet (qofshin ato natyrore apo civile) që prodhon sendi gjatë kohës së frutgëzimit. Frutgëzuesi ka të drejtë që sendin që është objekt frutgëzimi ta përdorë, e cila nënkupton të drejtën e frutgëzuesit që materialisht ta gëzoj një send, por ai duhet të respektoj natyrën e tij, ku frutëgëzuesi ka të drejtën e përdorimit të sendit po ashtu sikurse edhe pronari. Frutgëzuesi ka të drejtën e gëzimit të servituteve[86] që janë të lidhura për pronën mbi të cilën e ka të drejtën e frutgëzimit, si dhe të gëzoj të drejtat tjera sendore që mundet t'i gëzoj dhe vetë pronari, përveç rasteve kur me kontratën për krijimin e frutgëzimit apo edhe me ligj janë paraparë kufizime. Frutgëzuesi ka të drejtë të shërbehet me servitutet sendore në palujatëshmërinë në të cilën e ka të drejtën e frutgëzimit, qoftë atë servitut të krijuar para krijimit të frutgëzimit apo edhe gjatë kohëzgjatjes së tij[87.] Në një formë frutgëzuesi detyrohet që të shfrytëzoj servitutet sendore, në mënyrë që të ruaj të drejtën e shfrytëzimit të tyre, ashtu që të mos vij deri tek parashkrimi i kësaj të drejte për shkak të mosshfrytëzimit.[88] Ai nuk mundet të krijoj servitute të reja sendore në ngarkesë të sendit të ngarkuar me të drejtën e frutgëzimit, por ai mundet që të lejoj personin e tretë që ta shfrytëzoj sendin që është objekt frutgëzimi, sipas raporteve juridike të detyrimeve.[89]

Sa i përket të drejtës së përdorimit të sendit që është objekt frutgëzimi, shkohet aq larg sa që autorë të ndryshëm konsiderojnë se frutëgëzuesi gëzon këtë të drejtë në atë shkallë sa edhe vet pronari i sendit. Por, pa marrë parasysh të gjitha, qenësore në këtë rast është që sendi të përdoret sipas destinacionit të tij ekonomik, duke ruajtur substancën e sendit. Në fund të fundit,

[84] KCF Neni 5977, KCSH Neni 849 al.1
[85] KCSH neni 237.
[86] KCSH neni 245
[87] Stankovic, Obren & Orlic, Miodrag, Stvarno pravo, deveto izdanje, Beograd, 1996, fq.221.
[88] Stankovic, Obren & Orlic, Miodrag, vepra e cituar,, fq.221.
[89] Po aty.

ruajtja e substancës së sendit është kusht për krijimin e të drejtës së frutgëzimit si të tillë. Vetë gjeneza e frutgëzimit është e lidhur në vjeljen e frutave të sendit të huaj te marrëdhënia e frutgëzimit. E drejta e vjeljes së frutave është qenësore te marrëdhënia juridike e frutëgëzimit. Frutëgëzuesi ka të drejtën e vjeljes së frutave si ato natyrore ashtu edhe ato civile. Ai mund të disponoj lirshëm me këto fruta. Ai ka të drejtë që ato t'i shes. Frutgëzuesi ka të drejtën e vjeljes së tyre t'ia bartë një personi tjetër. Frutëgëzuesi ka të drejtë që të kërkoj që të bëhet inventarizimi me qëllim të konstatimit të gjendjes së sendit. Nëse nuk është bërë inventarizimi i sendit në fillim, konsiderohet se sendi ka qenë në gjendje mesatare[90.] Ndërsa sipas KCZ shpenzimet me rastin e inventarizimit i heqin të dy palët, pa marrë parasysh kush e ka kërkuar inventarizimin [91.] Ndërsa KCGJ ka paraparë se harxhimet lidhur me inventarizimin mund t'i heq pala që ka kërkuar inventarizimin[92].

1.1.3. E drejta e kalimit të frutgëzimit

Në qoftë se frutgëzuesi (uzufruktari) është një person fizik, atëherë ai nuk mund ta bartë frutgëzimin. Sendi i ngarkuar me frutgëzim mund t'i bartët një personi tjetër për ushtrimin e frutgëzimit[93.] D.m.th frutgëzuesi që është person fizik mund të bartë në tjetrin vetëm të drejtën e ushtrimit të frutgëzimit por jo edhe vetë të drejtën e frutgëzimit. Ku ushtrimi i përmbajtjes së të drejtës së frutgëzimit nga ana e personit të tretë zgjatë vetëm brenda për brenda kohës për sa ka qenë e paraparë të ekzistoj frutgëzimi, po ashtu me vdekjen e frutgëzuesit të parë shuhet edhe kjo e drejtë.

Ndërsa lidhur me bartjen e frugëzimit në një person tjetër, KCSH në nenin 240 ka paraparë një situatë ndryshe nga Ligji ynë për Pronësinë dhe të drejtat sendore.

Sipas KCSH: "Uzufruktari mund t'ia kalojë një tjetri këtë të drejtë për një kohë ose për gjithë kohën e qenies së saj, përveç kur në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe. Kalimi duhet t'i njoftohet me shkrim pronarit, përndryshe uzufruktari i mëparshëm dhe personi që ka fituar një të drejtë të tillë përgjigjen solidarisht ndaj pronarit.

Kur kemi të bëjmë me të drejtën e bartjes së frutgëzimit, kur frutgëzuesi është person juridik Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Kosovës ka paraparë këtë zgjidhje;

"Në qoftë se frutgëzuesi është një person juridik apo një shoqëri e përbashkët, frutgëzimi kalohet, nëse pasuria e personit juridik dhe një shoqëri e përbashkët bartët në personin tjetër në rrugën e suksesionit universal. Nëse një ndërmarrje ose pjesë e një ndërmarrje e udhëhequr nga një person juridik bartet në një person tjetër, atëherë te fituesi bartet edhe një frutgëzim, nëse ai mund t'i shërbejë qëllimit të ndërmarrjes apo të një pjese të ndërmarrjes".

KCSH parasheh mundësinë e bartjes së të drejtës së frutgëzimit për një kohë të caktuar, apo për tërë kohën e qenies së frutgëzimit përveç se me aktin themelues nuk është parashikuar

[90] Statovci,E. E Drejta e Servituteve Prishtine 2009, fq.294 cituar KC PA par.513.
[91] KCZ Neni 763
[92] KCGJ Neni 1034
[93] Ligjit të Kosovës për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore Neni 219

ndryshe. Kalimi i së drejtës së frutgëzimit në personin tjetër duhet t'i bëhet e njohur pronarit, përndryshe këta, frutgëzuesi dhe personi që ka fituar këtë të drejtë do t'i përgjigjën solidarisht pronarit[94.]

Sipas KCSH frutgëzuesi ka të drejtë t'ia kalojë të drejtën e frutgëzimit një personi tjetër ose ta tjetërsoj atë por vetëm në atë masë sa janë të destinuara për tjetërsim, ka të drejtë të jap sendin me qira si dhe ka të drejtën e gëzimit të servituteve dhe të drejtave të tjera sendore[95.]

Fruta konsiderohen sendet të cilat prodhohen periodikisht nga sendi kryesor. Ndërsa e drejta gjermane frutat i ndanë në fruta të sendeve dhe fruta të të drejtave, në mënyrë direkte apo indirekte [96]. Frutgëzuesi i një sendi trupor ka tagër që të vjel si frutat natyrore ashtu edhe ato civile si dhe të përfitimeve tjera që mund të dalin nga përdorimi i atij sendi[97.]

Frutgëzuesi ka të drejtë për posedimin e sendit që është ngarkuar me frutgëzim[98].

Frutgëzuesi ka të drejtë t'i vjelë frutat natyrore që i jep sendi shërbyes, pa e zvogëluar substancën e tij dhe pa i cenuar rregullat juridike apo doket e mira. Frutat civile, që i jep sendi në bazë të ndonjë pune juridike, i takojnë frutgëzuesit, për gjithë kohën sa zgjatë frutgëzimi. Frutat civile që lindin pas shuarjes së frutgëzimit, i takojnë pronarit të sendit. Fruta natyrore konsiderohen të gjitha ato fruta që janë produkt i vet tokës, ose si rezultat i punës së njeriut, poashtu edhe prodhimet e kafshëve merren si fruta natyrore.

Fruta natyrore konsiderohen edhe rëra, gurët, zhavorri etj. Nëse frutgëzuesi dhe pronari i sendit nuk kanë hartuar procesverbal lidhur me gjendjen e sendit shërbyes, atëherë llogaritet se frutgëzuesi e ka pranuar sendin shërbyes në gjendje përdorimi të kualitetit të mesëm, me të gjitha cilësitë për një përdorim të rregullt nga frutgëzuesi. Frutgëzuesi i bartë shpenzimet për mbajtjen e rregullt të sendit shërbyes.

Si pronari ashtu edhe frutgëzuesi mund të kërkojnë, që letra me vlerë dhe fleta e dividendës të depozitohen me përcaktimin që kthimi mund të kërkohet vetëm nga frutgëzuesi dhe pronari së bashku.[99] Sipas kësaj, autorizimin për kthim të letrës me vlerë apo fletës së dividentës kanë vetëm uzufruktari dhe pronari i sendit që është objekt frutgëzimi, edhe atë vetëm së bashku. Pronari i sendit ka të drejtë të denoncojë frutgëzimin. Denoncimi bëhet në rast se frutgëzuesi nuk ofron sigurinë e kërkuar nga ana e pronarit dhe në rastet kur kanoset një shkelje serioze e të drejtave të tij, veçanërisht kur është në pyetje e drejta e kërkesës për mbajtje dhe kthim të sendit. Nëse frutgëzimi vlen si i denoncuar, atëherë frutgëzuesi ka të drejtën e shpërblimit adekuat për dobitë e pavjelura.

KCSH parasheh:'Frutëgëzuesi merrë në dorëzim sendet në gjendjen në të cilën ndodhen para fillimit të frutgëzimit. Sendet në frutgëzim merren në dorëzim me inventar të bërë me akt noterial, në prani të pronarit, pasi të jetë njoftuar në një afat të përshtatshëm. Është e drejtë e

[94] KCSH Neni 240
[95] KCRSH, nenet 240-241
[96] KCGJ neni 962
[97] KCGJ neni 1030
[98] Ligjit të Kosovës për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore Neni 224
[99] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore i Kosovës neni 246 par.2

palëve që në procesverbal të shënohen të gjitha hollësitë që kanë lidhje me përcaktimin dhe gjendjen e sendeve që merren në frutgëzim.

Inventari mund të kryhet edhe me akt privat, kur bien në marrëveshje të dy palët, që janë të pranishme gjatë kryerjes së tij. Shpenzimet për kryerjen e inventarit i heq frutëgëzuesi përveç kur parashikohet ndryshe me aktin e krijimit "[100].

Kur kemi të bëjmë me frutgëzimin në ndërmarrje, atëherë frutgëzimi duhet të regjistrohet në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri. Frutgëzuesi ka të drejtë t'i shfrytëzoj dhe veproj me të gjitha pasuritë e ndërmarrjes dhe bëhet përfitues i të gjitha kërkesave që ndërmarrja i ka ndaj personave të tretë, përveç nëse dhënësi i frutgëzimit dhe frytgëzuesi janë pajtuar ndryshe.

Ligji për shpronësimin i Republikës së Kosovës parasheh:

,,Nëse, si rezultat i shpronësimit shuhet një servitut personal, konkretisht frutgëzimi mbi një pronë të shpronësuar, atëherë Vendimi Përfundimtar duhet të kërkojë nga Organi Shpronësues që t'u paguajë personave të cilët janë dëmtuar si rezultat i shuarjes së këtij servituti, kompensim të arsyeshëm, siç është përcaktuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në një kontratë të aplikueshme dhe të dhënë në mënyrë të ligjshme, Organi Shpronësues mund të urdhërojë Subjektin Kërkues ose Përfituesin e pritur - nëse ka të këtillë - që ta paguajë këtë kompensim"[101]. Edhe kur kemi të bëjmë me shpronësimin e një prone e cila bëhet për interes të përgjithshëm, ligjvënësi e ka paraparë mundësinë e kompensimit të titullarit të së drejtës së servitutit personal –frutgëzimit.

2. Detyrimet e frutgëzuesit

Frytgëzuesi është i detyruar që ta mirëmbajë sendin në atë mënyrë që të mos dëmtohet substanca e tij.[102] Frutgëzuesi detyrohet që të ruaj substancën e sendit, por nuk përgjigjet për zvogëlimin e vlerës së sendit e cila është pasojë e përdorimit të rregullt.[103] Frytgëzuesi nuk është i detyruar që të përkujdeset për ndreqje dhe riparime të jashtëzakonshme por është i detyruar ta lejoj pronarin që ti ndërmerr ato ndreqje ose riparime.[104] Frytëgëzuesi është i detyruar për ndreqjet dhe riparimet në atë masë që i përkasin mirëmbajtjes së zakonshme të sendit.[105] Ndërsa pronari i bartë shpenzimet të cilat janë rrjedhojë e vjetërsimit të sendit, të fuqisë madhore apo të rastësisë.[106] Ndërsa në sistemin juridik kroat parashihet edhe detyrimi i fryt gëzuesit, që pronarit t'i ofroj sigurimin përkatës kur është e rrezikuar substanca e sendit.[107] Ndryshe nga kjo parasheh KCGJ, frytëgëzuesi nuk detyrohet që ta siguroj pronarin si më lartë

[100] KCSH Neni 247
[101] Ligji për Shpronësim i Republikës së Kosovës neni 18
[102] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Kosovës neni 226 par.1.
[103] Stankovic, Obren & Orlic, Miodrag, vepra e cituar,, fq.221.
[104] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Kosovës neni 226 par.3.
[105] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Kosovës neni 226 par.2.
[106] Stankovic, Obren & Orlic, Miodrag, vepra e cituar,, fq.221.
[107] Zakon o vlasnistvo i drugim stvarnim pravima Republike Hrvatske, NN91/96, 68/98, 137/99, 22/00, 73/00, 129/00, 114.01, 79/06, 141/06, 146/08, 38/09, 153/09, 143/12, neni 209 par.1.

[108]. Edhe KCSH e parasheh detyrimin e frutgëzuesit për sigurimin e pronarit lidhur me përmbushjen e detyrimeve që i ka në bazë të frutgëzimit [109]. Poashtu, frytgëzuesi ka detyrim që ta njoftoi pronarin menjëherë për dëmtim apo për shkatërrim të sendit ose nëse është e nevojshme për ndreqje apo riparim të jashtëzakonshëm të sendit për shkak të një rreziku të paparashikuar. Informimi duhet të bëhet në të njëjtën mënyrë edhe për kërkesat e ndonjë personi të tretë mbi sendin.[110] KCGJ parasheh detyrimin e frutgëzuesit për të njoftuar pronarin nëse sendi është shkatërruar apo dëmtuar, për ndonjë riparim apo renovim të jashtëzakonshëm të sendit , ose për ndonjë masë parandaluese për mbrojtjen e sendit përballë ndonjë rreziku të paparashikuar. Frutgëzuesi duhet patjetër ta njoftoj pronarin pa vonesë të panevojshme. Njëjtë veprohet nëse një palë e tretë pretendon ndonjë të drejtë të tij ndaj sendit.[111]

Përderisa zgjat frutgëzimi, frutgëzuesi është i detyruar t`i paguaj të gjitha pagesat e rregullta publike të lidhura me sendin, siç janë tatimet dhe taksat. Frytëgëzuesi, gjithashtu është i detyruar të paguaj edhe ngarkesat në send të cilat janë krijuar në kohën e themelimit të frytëgëzimit, posaçërisht, interesin në kërkesat nga hipoteka dhe tatimet e tokës.[112]

Nëse pas përfundimit të frutgëzimit, sendi nuk është në gjendje në të cilën e ka pranuar frutëgëzuesi, ai i përgjigjet frutgëzuesit për zvogëlimin e vlerës së sendit pa marr parasysh me çfarë ajo është shkaktuar. Ndërsa, nuk përgjigjet për zvogëlimin e vlerës së sendit për shkak të vjetërsisë ose harxhimit nga përdorimi i zakonshëm i sendit i cili është i pashmangshëm, pa pasur mundësi t'i ikë përmbushjes së detyrimeve që kërkohen nga ai[113].

Frutëgëzuesi detyrohet që të paguaj vlerën e sendit të humbur ose të dëmtuar për fajin e tij. Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Kosovës e obligon frutëgëzuesi në mirëmbajtjen e sendit, kështu: "Frutgëzuesi është i detyruar që ta mirëmbajë sendin në atë mënyrë që të mos dëmtohet substanca e tij" [114].

Frutëgëzuesi kujdeset për sendin dhe e mirëmban atë si një shtëpiak i mirë dhe ndërmerr të gjitha masatë e nevojshme për të ruajtur sendin nga shkatërrimi. Frutëgëzuesi është i detyruar për ndreqjet dhe riparimet në atë masë që i përkasin mirëmbajtjes së zakonshme të sendit. Frutgëzuesi nuk është i detyruar që të përkujdeset për ndreqje dhe riparime të jashtëzakonshme, por është i detyruar ta lejoj pronarin që ti ndërmerr ato ndreqje ose riparime [115].

Frutgëzuesi është i detyruar të njoftoj pronarin në rast të dëmtimit ose shkatërrimit të sendit, apo nëse ka nevojë për ndreqje ose riparime të jashtëzakonshme të sendit (të cilat janë obligim i pronarit) për shkak të rrezikut të paparashikuar[116].

Të drejtat e frutgëzuesit nuk janë të barabarta me ato të pronarit, meqë siç cekëm edhe më lartë frutgëzuesi detyrohet në ruajtjen e substancës së sendit. Ndërsa, sa i përket respektimit të

[108] KCGJ Neni 505
[109] KCSH Neni 252
[110] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Kosovës neni 228.
[111] KCGJ neni 1042, Stankovic, Obren & Orlic, Miodrag, vepra e cituar,, fq.221-222.
[112] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Republikës së Kosovës Neni 229.
[113] Ligji i Kroacisë për Pronësinë dh te Drejtat tjera Sendore Neni 210,
[114] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Republikës së Kosovës Neni 226
[115] Po aty
[116] Ligji i Kosovës për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore ,neni 228

destinimit ekonomik të sendit nga ana e frutgëzuesit, kjo nuk paraqet thjesht detyrim të frutgëzuesit ndaj pronarit, por thjesht ky është një kufizim i të drejtës së përdorimit e të gëzimit. Pra, kjo nënkupton faktin se frutgëzuesi ka të drejtë ta përdorë dhe shfrytëzoj sendin vetëm në mënyrën e paraparë duke mos e cenuar substancën e tij si dhe pa pasur të drejtën e destinimit ekonomik të sendit. Nëse ai nuk e respekton këtë, bënë cenim të së drejtës së pronësisë, e jo mos përmbushje të detyrimit që lidhet me të drejtën e frutgëzimit. Në këtë rast përveç se kemi të bëjmë me tejkalim të autorizimeve që i janë caktuar për të drejtat që i gëzon, njëkohësisht kemi të bëjmë me shpërdorim të frutgëzimit. Prandaj, veprimet e tilla të frutgëzuesit të cilat nuk e respektojnë destinimin ekonomik të sendit nuk mund të jenë të ligjshme as përballë të tretëve [117].

Kur kërkohet që të ruhet destinacioni ekonomik i sendit, atëherë duhet përcaktuar në mënyrë të qartë kuptimin e destinacionit ekonomik. Sepse një send i njëjtë mund të jetë i përshtatshëm për më shumë funksione. Kështu një ndërtesë mund të shërbej për banim, zyrë, dyqan, dhe kjo për faktin se janë shumë rrethana që e determinojnë destinacionin ekonomik të sendit të tillë. Këto rrethana mund të jenë: mjedisi ku ndodhet sendi, pastaj kategoria sociale e pronarit, apo edhe rrethanat e momentit që kanë determinuar destinacionin ekonomik të sendit. Por është e rëndësishme të potencohet se duhet pasur parasysh destinacioni ekonomik të sendit në çastin e lindjes së frutgëzimit.

Në rast të mbarimit të frutgëzimit, frutgëzuesi duhet të i'a kthen dhënësit ndërmarrjen me të gjitha pasuritë e saj. Nëse vlera e sendeve të kthyera është më e vogël se vlera e tyre para krijimit të frutgëzimit, frutgëzuesi duhet t'ia kompensoj vlerën e humbur dhënësit të frutgëzimit[118].

3. Pozita juridike e pronarit

3.1. Të drejtat e pronarit

E drejta e pronësisë është e drejtë subjektive e karakterit absolut, prandaj kjo i jep të drejtë pronarit që ta përdorë sendin e tij sipas dëshirës, por me kusht që të mos cenoj të drejtat e frutgëzimit. Pronari ka të drejtë të disponojë lirisht sendin që është objekt frutgëzimi, ta tjetërsoj atë pa asnjë kufizim, mund ta dhuroj, ta lë trashëgim, mundet të krijoj servitut sendor, mundet ta përdorë në atë masë sa nuk prek të drejtat e frutgëzuesit. Ndërsa në sendin e paluajtshëm mundet të krijoj frutgëzim.

Po ashtu pronari ka të drejtë të kërkoj nga gjykata që të vendos masën e sigurisë, në raport me frutgëzuesin, sipas kushteve të përcaktuara, për të evituar mundësin fakultative të frutgëzuesit për përmbushjen e detyrimit të sigurimit. Mos nxjerrja e vendimit gjyqësor për masën e kërkuar të sigurisë, prezumohet e drejta e pronarit që të kërkoj nga gjykata ekzekutimin e dhunshëm.[119]

[117] Ligji i Kosovës për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore ,neni 228
[118] Ligji i Kosoves per Pronesine dhe te Drejtat tjera Sendore ,neni 251
[119] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tera Sendore I Malit të Zi, nenei 239.

Thesari i gjetur i takon pronarit e jo frutgëzuesit. Në qoftë se frutgëzuesi përdor sendin për të cilin nuk ka autorizim, pronari duhet t'ia tërheq vërejtjen. Në qoftë se frutgëzuesi vazhdon përdorimin pa autorizim përkundër vërejtjes së pronarit, pronari mund të paditë për pushimin e cenimit[120.]

Kur kemi të bëjmë me kërkesat e krijuara të cilat janë bërë të arritshme, para krijimit të frutgëzimit, atëherë dhënësi i frutgëzimit ka të drejtë që të kërkojë nga frutgëzuesi kthimin e objekteve të nevojshme për realizimin e përmbushjes së kërkesës ndaj kreditorit.

3.2. Detyrat e pronarit

Përveç të drejtave pronari ka edhe detyrime, kështu ai detyrohet që t'ia mundësoj frutgëzuesit ushtrimin e së drejtës së tij. T'ia dorëzoj frutgëzuesit sendin në posedim, si dhe sendi duhet të dorëzohet në gjendje të mirë. Pronari detyrohet që të heq shpenzimet e jashtëzakonshme (riparimin e kulmit, sanimin e dëmtimeve të mëdha e të ngjashme) dhe barrëve të jashtëzakonshme lidhur me sendin. Ku si barra të jashtëzakonshme konsiderohen p.sh shpenzimet për caktimin e kufijve midis pronarëve fqinjë, pastaj shpenzimet për riparimin apo ndërtimin e mureve, oborreve [121.] Pronari ka të drejtë të ngre padi petitore ose possessore kundër frutgëzuesit për të mbrojtur të drejtën e tij.

4. Mbrojtja e të drejtës së frutgëzimit

Në qoftë se cenohet e drejta e frutgëzuesit, atëherë frutgëzuesi ka të njëjtat të drejta sikur të ishte pronar. Varësisht prej dëmit titullari i së drejtës së frutgëzimit ka mundësi të paraqes:

a) Padi për pengim posedim

b) Padi vërtetimi-ekzistimin e servitutit

c) Actio confessoria (padi konfesore)[122]

Padia kryesore me të cilën frutgëzuesi e mbron të drejtën e tij është padia konfesore (actio confessoria), gjithashtu ai ka të drejtën e paraqitjes së padisë posedimore.

Te padia konfesore paditësi duhet të dëshmoj:

a. qenjen e të drejtës së tij
b. aktin e pengimit të të padituri [123.]

[120] Ligjit të Kosovës për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore Neni 231 al.2
[121] Statovci ,E. E Drejta e Servituteve, Prishtinë 2009, fq.295
[122] Gavela,N. Stvarno Pravo Zagreb 2008, fq.100
[123] Po aty

Në të drejtën romake servitutet si e drejte sendore janë mbrojtur me actio in rem, ndërsa në kohën e Justinianit padia për mbrojtjen e servituteve u quajt actio confessoria. Fillimisht ajo i takonte titullarit të frutgëzimit kundër pronarit të sendit shërbyes, e më vonë actio confessoria u lejua edhe kundër të tretëve që pengonin frutgëzuesin në realizimin e të drejtës së servitutit. Actio confessoria është si vindicatio servitutis, me të cilën paditësi pretendon se i takon frutgëzimi. Paditësi duhet të vërtetoj se i takon e drejta e frutgëzimit, si dhe veprimin e të paditurit me të cilin e pengon realizimin e të drejtës së frutgëzimit [124], ndërsa me këtë rast i padituri do të detyrohet që të pranoj të drejtën e të drejtës së servitutit (frutgëzimit) dhe të mundësoj paditësit realizimin e papenguar të së drejtës së frutgëzimit, si dhe në kompensimin e dëmit të shkaktuar dhe ndalimin e pengimit të mëtutjeshëm.

Actio confessoria është e ngjashme me actio negatoria. Me actio negatoria mbrohet pronari kundër çdo të tretit i cili e pengon, meqë si të themi e përvetëson të drejtën e servitutit. Actio confessoria e ngrit titullari i së drejtës së frutgëzimit kundër pronarit të sendit dhe ndaj të tretëve në mënyrë që të rezultojë me njohjen dhe realizimin e së drejtës së tij të frutgëzimit[125]. Actio confessoria i është mundësuar edhe titullarit zëvendësues të së drejtës së servitutit, e ky është personi i cili në procedurë para gjykatës ose organit tjetër kompetent dëshmon bazën juridike dhe mënyrën e vërtetë të fitimit të posedimit të sendit që është objekt servituti. Në rast se dëmtohet e drejta e servitutit me akt të pavlefshëm në librat e tokës, titullarit i mbetet në dispozicion "padia e shlyerjes"[126]. Në këtë rast i legjitimuar aktiv është frutgëzuesi, e drejta e të cilit është cenuar, ndërsa të gjithë të tjerët, qoftë edhe vetë pronarin e sendit, që pengojnë frutgëzuesin në realizimin e të drejtës së tij të frutgëzimit, janë të legjitimuar pasiv[127]. Me padinë konfesore kërkohet kthimi i sendit, kur sendi i është marrë paditësit (restitutio in integrum) ose ndërprerja e pengimit te ushtrimit të së drejtës së frutgëzimit. Kjo padi vjetërsohet në afat prej njëzet vitesh, që fillon të rrjedh nga momentit kur titullarit të servitutit i është marrë apo penguar posedimi i asaj të drejte[128]. E Drejta komparative parasheh se frutgëzuesi mund të ngre çdo padi sendore, kundër pronarit ose personave të tretë. Sipas KCGJ frutgëzimi mbrohet në të njëjtën mënyrë siç bëhet edhe mbrojtja e vetë pronësisë[129] si me: padi petitore e cila korrespondon me padinë rei vindicatio dhe actio negatoria dhe padi tjera posedimore. Të njëjtën zgjidhje parasheh edhe Ligji i Kosovës për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore: "Në qoftë se cenohet e drejta e frutgëzuesit, atëherë frutgëzuesi ka të njëjtat të drejta sikur të ishte pronar "[130].

Në të drejtën frënge e drejta e frutgëzimit mbrohet me padinë konfesore të frutgëzimit dhe me padinë possesore[131].

Sa i përket realizimit të dhunshëm dhe kompetencës së gjykatës Ligji për Procedurën Përmbarimore parasheh: " Për të vendosur për propozimin për përmbarim për të drejtën e

[124] Po aty
[125] Klarič,Vedriš , Stvarno pravo,Zagreb 2008, fq.25
[126] Klarič,Vedriš, Stvarno pravo ,zagreb 2008, fq.25
[127] Statovci,E.E Drejta e Servituteve Prishtine 2009 ,fq 300
[128] Gavela,N. Stvarno Pravo Zagreb 2008 , fq.100
[129] KCGJ Neni 1065
[130] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Republikës së Kosovës Neni 232
[131] Satovci, E. E Dreja e Servituteve, Prishtine 2009, fq 301 cituar Planiol-Ripert 665,Yiannopoulos 226.

frutgëzimit, ose për ndonjë të drejtë tjetër të ngjashme pasurore të debitorit dhe për zbatimin e këtij përmbarimi, e kompetencës tokësore është gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit të përmbarimit. Nëse debitori i përmbarimit nuk ka vendbanim në Kosovë, është kompetente gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendqëndrimi i tij. Kur debitori është person juridik e kompetencës tokësore është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e personit juridik, e nëse debitori nuk ka selinë në Kosovë është kompetente gjykata në territorin e secilës ndodhet selia e personit juridik [132].

5. Shuarja e frutgëzimit

Frutgëzimi si një marrëdhënie juridike, krijohet, ndryshon dhe pas plotësimit të rrethanave të caktuara juridike të cilat ligji i njeh si të tilla ai shuhet. Frutgëzimi përfundon me kalimin e kohës së paraparë nëse ka qenë e themeluar për kohë të caktuar e kjo kohë skadon para vdekjes së frutgëzuesit. Nëse në kohën e vdekjes së frutgëzuesit koha e kontraktuar për frutgëzim nuk ka skaduar apo frutgëzimi nuk ka qenë i kufizuar në kohë, ajo si një servitut personal shuhet me vdekjen e frutgëzuesit dhe vendoset pronësia e plotë pronarit të sendit, i cili deri atëherë kishte pronësinë e zhveshur. Shuarja e marrëdhënies juridike të frutgëzimit mbaron me mbarimin e saj, pushimin e frutgëzimit dhe heqjen dorë nga frutgëzimi.

Frutgëzimi mund të shuhet në bazë të kontratës së lidhur në mes të pronarit të sendit dhe frutgëzuesit (ku kjo marrëveshje mund të jetë me kompensim ose pa kompensim), po ashtu edhe me denoncim të frutgëzuesit[133]. Për vlefshmërinë e denoncimit, merret se bëhet fjalë për punë të njëanshme juridike, nuk është i nevojshëm pëlqimi i pronarit të sendit që është objekt frutgëzimi, mirëpo kreditorët e frutgëzuesit mund të kërkojnë anulimin e denoncimit e cila është realizuar në dëm të tyre. Interesi i frutgëzuesit që të heq dorë nga frutgëzimi qëndron në faktin se frutgëzimi është bërë jorentabil dhe është bërë vetëm barrë për të[134]. Faktet juridike të cilat janë të njohura nga ligji e që kanë për pasojë shuarjen e frutgëzimit, janë të ndryshme. Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore i Kosovës parasheh shuarjen e frutgëzimit:

a. me vdekjen e frutgëzuesit, nëse frutgëzuesi është një person fizik;
b. me shuarje, nëse frutgëzuesi është një person juridik[135].
c. frutgëzimi mbi një paluajtshmëri shuhet përmes deklaratës së frutgëzuesit ndaj pronarit, se heq dorë nga frutgëzimi dhe me regjistrimin në Regjistrin për të drejtat në paluajtshmëri.
d. për shuarjen e frutgëzimit mbi një send të luajtshëm mjafton deklarata e frutgëzuesit ndaj pronarit se heq dorë nga frutgëzimi[136].

KCSH parasheh këto mënyra të shuarjes së marrëdhënies juridike të frutgëzimit:

---

[132] Ligjit për Procedurën Përmbarimore i Kosovës Neni 175
[133] KCF neni 621,622 ; KCGJ neni 1064; KCZ al.2 neni 748
[134] Stanković,O.& Orlić,M. Stvarno Pravo,naučna Knjiga ,Beograd,1981,fq.341
[135] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Republikës së Kosovës Neni 235
[136] Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Republikës së Kosovës Neni 236

- Me vdekjen e frutgëzuesit ose me mbarimin e personit juridik frutgëzues;
- me bashkimin e cilësive të pronarit dhe të frutgëzuesit në një person të vetëm;
- me shkatërrimin tërësisht ose me humbjen e sendit të dhënë në frutgëzim dhe
- me mospërdorimin e frutgëzimit për njëzet vjet me radhë.

Vdekja e frutgëzuesit është mënyra më e natyrshme e shuarjes së frutgëzimit. Kjo mënyrë e shuarjes së frutgëzimit është e përbashkët për të gjitha sistemet juridike[137]. E drejta e frutgëzimit është e drejtë subjektive e një personi të caktuar. Ajo zgjat më së shumti gjatë jetës së frutgëzuesit dhe me vdekjen e tij shuhet edhe e drejta e frutgëzimit.

Disa kode civile[138] nuk lejojnë që e drejta e frutgëzimit të bartet në trashëgimtarët e frutgëzuesit pas vdekjes së tij. Ndërsa, sa i përket shuarjes së të drejtës së frutgëzimit kur personat juridik kanë cilësinë e frutgëzuesit, ajo shuhet me shuarjen e personit juridik[139].

Në disa sisteme juridike e drejta e frutgëzimit ka kohëzgjatje prej tridhjetë vjetësh [140] nga dita e fillimit të frutgëzimit.

Mënyrë tjetër e shuarjes së të drejtës së frutgëzimit është edhe me skadimin e kohës së caktuar, kur kemi të bëjmë me frutgëzimin e krijuar për një kohë të caktuar. Parimisht frutgëzimi shuhet me vdekjen e frutgëzuesit, por palët kanë mundësi që të caktojnë vet kohëzgjatjen e frutgëzimit.

Frutgëzimi mund të përfundoj me mos ushtrimin e kësaj të drejte nga ana e frutgëzuesit. Nëse frutgëzuesi një kohë të gjatë nuk e shfrytëzon të drejtën e tij (nuk jeton në shtëpinë ose banesën në të cilat e ka të drejtën e frutgëzimit), pronari ka të drejtë që të kërkojë që me vendim gjyqësor të konstatohet se frutgëzuesit i është ndërprerë e drejta e frutgëzimit. Frutgëzimi mund të përfundoj edhe me shkatërrimin e sendit. Frutgëzimi shuhet (ndërpritet) nën kushtet e parapara me ligj.

6. Përfundimi

Nga shtjellimi që i bëmë frutgëzimit si institut i së drejtës sendore u pa se ai përfaqëson njërin prej servituteve personale më të rëndësishme. Si servituti personal më i rëndësishëm frutgëzimi është një isnstitut mjaft kompleks i të drejtës sendore, ngase vet natyra e tij juridike është mjaft e ndërlikuar, dhe me të preken të drejtat substanciale të pronarit të sendit, andaj për këtë arsye ligjvënësi i ka kushtuar rëndësi të veçantë, duke i rregulluar në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrimet si të frutgëzuesit poashtu edhe të pronarit të sendit.

Në të drejtën komperative instituti i frutgëzimit paraqet njërin ndër servitutet personale më të rëndësishme, dhe i kushtojnë vëmendje të posaçme rregullimit ligjor të tij. Kështu është vepruar

[137] Ligji I Kosovës për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore , KCSH 235, neni 225 al. 1,KCGJ neni 1061 , KCF neni 617, Ligji Kroacisë për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore neni 201
[138] KCGJ neni 1061 ,KCF neni 617
[139] Ligji I Kosovës për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore neni 235 al.2,KCSH neni 255 ,KCGJ neni 1061
[140] KCF neni 619

edhe në sistemin tonë juridik, për faktin se me të në masë të konsiderueshme cenohen të drejtat e pronarit të sendit që është objekt frutgëzimi.

Nga ajo që u paraqit më lart u pa se, frutgëzimi mund të krijohet vetëm sipas mënyrave të parapara me ligj, si dhe ruajtja e substancës dhe mos ndërrimit të destinacionit ekonomik të objektit të frutgëzimit, ishin parakushte themelore për krijimin e këtij instituti dhe respektimi me përpikëri i tyre është i domosdoshëm. Poashtu, u pa se, gjatë ekzistimit të marrëdhënies juridike të frugëzimit, frutgëzuesi përveç të drejtave, ka për obligim që objektin e frugëzimit ta ruaj si një shtëpiak i mirë, si dhe të njoftojë pronarin për çdo gjë kur vihet në rrezik objekti i frutgëzimit, dhe njëherit ta njoftoj këtë të fundit t'i kryej të gjitha ndërhyrjet e nevojshme.

Meqenëse pas luftës në vendin tonë janë bërë transaksione të shumta me paluajtëshmëri, gjykatat duhet të kenë kujdes që me rastin e vendosjes në mënyrë meritore për pronësinë, të kujdesen për mos cenimin e të drejtave tjera sendore të titullarëve të tyre, përfshirë këtu edhe ato të frytgëzuesit

Bibliografia

- Aliu, Abdulla, E drejta Sendore, Prishtinë, 2005.
- D.Stojanovic-O.Antic, uvod u gradjansko pravo, Beograd, 2004
- Gams,Andrea ,Bazat e së Drejtës Reale,Beograd 1966.
- Gavela,Nikola, Stvarno Pravo Zagreb 2008.
- Klarič,Vedriš, Stvarno pravo,Zagreb 2008.
- Statovci, Ejup, E Drejta e Servituteve Prishtine 2009-ribotim.
- Stanković, Obren .& Orlić,Milorad Stvarno Pravo,naučna Knjiga ,Beograd,1981.
- Stanković, Obren .& Orlić,Milorad Stvarno Pravo,deveto izdanje, Beograd,1996.
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë i vitit 1994
- Kodi Civil Gjerman 1900
- Kodi Civil Francez 1804
- Kodi Civil i Luizianës 1996
- Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës''nr.57/04, 2009.
- Ligji për Shpronësimin e pronës së paluajtshme (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nri ligjit . 03/L-139)
- Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore i Malit të Zi
- Ligji për Pronësinë dhe te Drejtat tjera Sendore i Kroacisë.
- Ligjit për Procedurën Përmbarimore i Kosovës, 2013.

Ma.Sc. Naim Meholli* **Sabedin Mushica ***

MASAT E DIVERSITETIT NDAJ TË MITURVE

ABSTRAKT

Arsye e trajtimit të "Masave të Diversitetit ndaj të Miturve" është se kategoria e të miturve është shumë e ndjeshme për shkak të zhvillimit psiko fizik të tyre. Vendimtare për t'u përcaktuar në trajtimin e kësaj dukurie është fakti shqetësues se një numër i madh i kryesve të veprave penale në vendin tonë janë të moshes së re. Andaj, gjetja e masave sa më adekuate ndaj kësaj kategorie paraqet interes të studimit në fushën e drejtësisë penale. Ky punim përveç pjesës hyrëse është ndarë në dy pjesë që përfshinë përfundimin dhe literaturën e përdorur.

Në pjesën e parë të këtij punimi kryesisht kemi trajtuar historikun e masave të diversitetit që nga fillimet e tyre. Ndërkaq, në pjesën e dytë të këtij punimi kemi trajtuar format e zbatimit të masave të diversitetit sipas sistemit tonë penal dhe trajtimi i te miturve me rastin e shqiptimit te masave te diversitetit (ekzekutimi i masave të diversitetit). Pjesa përfundimtare e këtij punimi përmban konstatimet kryesore për Masat e Diversitetit ndaj të Miturve. Në fund të këtij punimi është dhënë regjistri i literaturës së përdorur për nevojat e këtij punimi.

Fjalët kyçe : Masat e Diversitetit, Format e zbatimit të masave të diversitetit, Masat e Diversitetit sipas sistemit tonë, Trajtimi i të miturve.

Hyrje

Në kryerjen e veprave penale, shpesh në çdo shtet, mund të na paraqiten edhe kategoria e moshava të reja e që njihen si të mitur. Të rinjët janë e tashmja dhe e ardhmja e çdo shoqërie, andaj për shkak të specifikave të kësaj kategorie kërkohet që të gjinden forma të ndryshme të masave që mund ti shqiptohen e që teknikisht nuk mund të emërohen si sanksione penale, por si masa të diversitetit.

Gjetja e këtyre masave ka lindur si rezultat i përpjekjeve mbarë shoqërore, që kjo kategori e delikuentëve të përjashtohet nga jurisprudenca penale me qëllim që të mbrohen nga ndikimi eventual negativ i këtyre masave. Gjithashtu, për faktin se mosha e të miturve delikuent përbënë fazën ku i mituri është në periudhën e zhvillimit të tij të vrullshëm psiko-fizik.

* Sabedin Mushica kandidat për gjyqtar.
* Naim Meholli, kandidat për gjyqtar.

Pikërisht, për këtë shkak, shoqëria me mekanizmat e vet dëshiron që ti vijë në ndihmë kryesit të mitur që ai të heq dorë nga veprimet që janë në kundërshtim me ligjin si dhe të orientohet në kahje normale të zhvillimit psiko-fizik të tij. Për kete arsye janë paraparë edhe masat e diversitetit të cilat krejtësisht e kanë të zhveshur **elementin penal.**

Masat e diversitetit i përfaqësojnë të gjitha sistemet moderne penalo-procedurale, ndërsa baza ligjore nxjerret në bazë te dispozitave ligjore por edhe konventat ndërkombëtare që i referohen të drejtave dhe lirive të njeriut.

1. Zhvillimi historik i masave të diversitetit

Ideja e gjetjes së masave më të përshtatshme ndaj kategorisë së të miturve si kryes të veprave penale ka qenë e kahershme. Idetë e para i hasim tek Dyrkemi e Weberi mbi masat e reja të reagimit shoqërorë ndaj të miturve me premisa të zhveshjes së dozës së represionit. Mirëpo, idetë e tyre në atë periudhe të zhvillimit të shoqërisë mbetën vetëm në letër për shkak të zhvillimit të ultë të shoqërisë në atë kohë.

Përpunimin permanent të masave të diversitetit në kohën më të re e beri norvegjesi Nils Cristy. Konceptet e tij parqitën nismën e idesë mbi zgjidhjen jashtëgjyqësore të konfliktit mes viktimës dhe kryesit të mitur. Sipas tij, kontesti në mes të viktimës dhe kryesit të mitur të veprës penale zgjidhet nëpërmjet barazimit në lidhje me kërkesën për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga ana e kryesit të mitur. Sipas autorit të përmendur "pozita e shtetit është pozitë e personit të tretë, i cili në një procedurë joformale intervenon në zgjidhjen e kontestit mes viktimës dhe kryesit të mitur.

Në vazhdën e kësaj, pikërisht në bazë të ideve të Nils Cristy, u hartuan shumë programe me qëllim të evitimit të delikuencës së të miturve, në orientim të shfrytëzimit të garancive në procedurën parapenale, për një sjellje më të mirë të kryerësit të mitur me rastin e lirimit të tij në institucionet sociale apo medicionale, në këshillimin për kryerësin e mitur si dhe për viktimen.

Këtë model e përfaqëson çdo sistem pa dallim, si ai kontinetal ashtu edhe ai anglo-sankson, si një qasje e re dhe progresive e orientuar në dy segmente: zvoglimin e dukurisë së kriminalitetit si preventivë dhe në ri integrimin e kryrësit të mitur në shoqëri. Zbatimi më i gjërë i masave të diversitetit është në SHBA dhe në Belgjik e sidomos nga viti 1967 sipas një programi operativ për pengimin e delikuencës së të miturve.

2. Format e zbatimit te masave te diversitetit

Masat e diversitetit mund të paraqiten në dy forma themelore si: diversitet i thjesht dhe si diversitet me intervenim.

Diversitet i thjesht aplikohet për kryesit për vepra penale më të lehta penale. Këtë formë të diversitetit e aplikon edhe vendi ynë. Sipas këtij parimi, prokurorit të shtetit i lihet mundësia që në bazë të bindjes së vet të lire, të vendos se a do të inicojë kërkesën për aplikimin e masave

të diversitetit apo ndonjë masë tjetër. Diversiteti me intervenim nënkupton ndërmarrjen e ndonjërës nga masat edukuese me propozim të prokurorit të shtetit apo nga ana e vet gjykatës ndaj kryesit të mitur.

Zbatimi i masave të diversitetit ndaj kryesve të mitur zakonisht preferohet në rast kur ata kryejnë për herë të parë ndonjë vepër penale apo kryejnë ndonjë vepër penale me rrezikshmëri më të vogël shoqërore. Keto masa shprehin reagimin e shpejt të shoqërisë ndaj kryerësit të mitur duke detyruar atë në përmbushjen e kushteve të caktuara por pa intervenimin e gjykatës. Pra, këto masa i mundësojnë të miturit që të ri integrohet në rrethin ku jeton si dhe në marrrjen e përgjegjësive të caktuara me qëllim te vetëdijësimit dhe shprehjes së ndjenjës së keqardhjes për veprimin e bërë antiligjor.[141]

3. Masat e diversitetit ndaj të miturve sipas sistemit tonë penal

Si në çdo shoqëri edhe vendi ynë ndaj kategorisë së të miturve si kryes të veprave penale ka paraparë masa të caktuara që mund të shqiptohen, e që në shkencën jurdike quhen masa të diversitetit.

Masat e diversitetit fillimisht janë paraparë në Ligjin penal për të mitur i cili me rregulloren nr.2004/8, datës 20 prill 2004 ka hyre ne fuqi. Ky Ligj është ndryshuar dhe tani masat e diversititeti janë të parapara me Kodin e Drejtësisë Për të Mitur, i cili ka hyrë në fuqi me datë 8 korrik 2010. Në dispozitat hyrëse janë paraparë parimet themelore ku ruhet dinjiteti, lira e shprehjes, ndihma juridike, evitimi i mundësisë së etiketimit të të miturit.

Konform zgjidhjeve më të reja në këtë drejtim, edhe Kodi i Drejtësisë për të mitur në kapitullin e IV taksativisht ka paraparë qëllimin, kushtet e shqiptimit dhe llojet e masave të diversitetit.

Sipas përmbajtjes së këtij Kodi dhe atë në nenin 16, qëllimi i masave të diversitetit është parandalimi i mundësisë së inicimit të procedurës penale ndaj të miturit kur ai kryen vepër penale të paraparë me Kod, ri integrimi i tij në shoqëri si dhe parandalimi i tij në përsëritjen e sjelljes antiligjore.

Në nenin 17 të këtij Kodi taksativisht janë paraparë kushtet nën të cilat mund të shqiptohen masat e diversitetit si: pranimi i përgjegjësisë nga ana e të miturit delikuent, pëlqimi i të miturit ose i prindit, prindit adoptues ose kujdestarit në emër të të miturit për të zbatuar masën e shqiptuar të diversitetit.

Në nenin 18 të këtij Kodi taksativisht janë paraparë se cilat masa mund t'i shqiptohen kryesit të mitur. Bazuar në këtë, në këto masa janë:

- pajtimi në mes të kryesit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim falje nga i mituri ndaj palës së dëmtuar,
- pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij,

[141] Rregullat standarde minimale te Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur (Rregullat e Pekinit).

- kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të mitur dhe përfaqësuesit të tij, në përputhje me situatën financiare të të miturit,
- vijimi i rregullt në shkollë,
- pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij,
- kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryesit të mitur për kryerjen e punës së tillë,
- edukimi në rregullat e trafikut dhe këshillimi psikologjik.[142]

Duke u bazuar u bazuar në natyrën, kushtet e shqiptimit të këtyre masave, lirisht mund të themi se edhe shteti ynë ka përfaqësuar sistemin më modern, më human e gjithëpërfshirës si dhe më të avancuar të masave të diversitetit që mund të shqiptohen ndaj kryesit të mitur.

4.Trajtimi i të miturve me rastin e shqiptimit të masave të diversitetit

Me rastin e shqiptimit të masës së diversitetit, automatikisht krijohet urë lidhëse mes policisë, prokurorit, të miturit delikuent, prindit të tij, të dëmtuarit, gjykatës dhe shërbimit sprovus. Në këtë rast, koordinohet aktiviteti me qëllim të zbatimit konsekuent të masës së shqiptuar të diversitetit ndaj të miturit delikuent. Në këtë rast, prokuri kompetent e fton të miturin, prindin e tij apo kujdestarin dhe mbrojtësin.

Me rastin e shqiptimit të masës së diversitetit nga ana e prokurorit publik, gjyqtarit për të mitur ose trupit gjykues për të mitur, aktvendimi si dhe të gjitha shkresat i dërgohen Shërbimit Sprovus për ekzekutimin e masës së shqiptuar të diversitetit në territorin ku edhe i mituri delikuent e ka vendbanimin.

Mbikëqyrejn në ekzekutimin e masës së diversitetit e bënë pikërisht organi i cili edhe e ka shqiptuar atë masë. Nëse eventualisht i mituri nuk e përmbush detyrimin që buron nga masa e shqiptuar e diversitetit, Shërbimi Sprovus e bënë verifikimin e fakteve si dhe arsyet e mos përmbushjes së masës të diversitetit nga ana e të miturit. Për të plotësuar raportin konform dispozitatve ligjore për të mitur, Shërbimi Sprovus e informon prokurorin publik kompetent si dhe organin gjyqësor i cili edhe ja ka shqiptuar të miturit masën e diversitetit. [143] Nëse supozoj se i mituri i ka përmbushur detyrimet që burojnë nga masat e diversitetit atëherë mund të konkludohet se masa e tillë ka qenë adekuate dhe se është arritur qëllimi i shqiptimit të këtyre masave ndaj tij.

5. Përfundim

Duke qenë se të gjithë jemi dëshmitarë të rritjes së numrit të veprave penale, ku si kryes të veprave penale janë të miturit, në këtë aspekt duhet të merren masa të menjëhershme lidhur me

[142] Kodi i Drejtësisë Për të Mitur i Kosovës 2010 neni 16, 17, 18
[143] Kodi i Drejtësisë Për të Mitur i Kosovës 2010 neni 8

parandalimin e këtij fenomeni që po ngjan në shoqërinë tonë. Edukimi i gjeneratave të reja është shumë i mangët e që është shqetësim i madhë për vendin tonë. Aplikimi masave jo penale do të ishte shumë i rëndësishëm ndaj delikuentëve të mitur, pasi që do të evitohej mundësia e etiketimit të të miturve.

Andaj, aplikimi i masave të diversitet e të cilat kanë karakter jo penal janë metoda adekuate dhe shumë të favorshme për të miturit të cilët ndeshën për herë të parë me ligjin. Këto masa do të ndikonin shumë në ngritjen e vetëdijes së të miturve që në të ardhmen mos ti përsëritin veprimet e tyre të kundërligjshme. Nëpërmjet këtyre masave, shoqëria reagon në dukurinë kriminale ndaj të miturve si dhe mundëson aplikimin e masave të zhveshura krejtësisht nga elementi represiv i vet përmbajtjes dhe qëllimit të sanksionit penal. Me aplikimin e masave te diversitetit i mundësohet të miturit ri integrimi në rrethin ku jeton duke shprehur keqardhje për veprimin e bërë antiligjor.

Bibliografia

- Kodi i Drejtësisë Për të Mitur i Kosovës
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Kodi i Procedurës Penale
- Ligjerata të autorizuara të mbajtura në Institutin Gjyqësor të Kosovës.

Ramiz Buzhala * **Kujtim Krasniqi***

MARËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJËSISË

Hyrja

Kurorëzimi i Republikës së Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur u finalizua me hyrjen në fuqi të kushtetutës me 15 Qershor 2008. Me qëllim të përafrimit dhe harmonizimit të legjislacionit tonë me atë të Bashkimit evropian dhe te drejtën ndërkombëtare si dhe garantimit te lirive dhe te drejtave te njeriut, kushtetuta si akti me i lart politik dhe juridik i shtetit, në nenet 18,19,20,21 dhe 22[144] ka inkorporuar marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare si te zbatueshme drejtpërdrejtë dhe me prioritet ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve vendore.

Pas hyrjes në fuqi të kushtetutës rrjedhimisht edhe sistemi i drejtësisë ka pësuar ndryshime reformuese e veçanërisht janë bërë ndryshime në legjislacionin penal, si: ndryshimi dhe plotësimi i Kodit Penal dhe i Kodit të Procedurës Penale, Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të cilat nga 1 janari i vitit 2013 hyjnë në fuqi. Kësisoj është ndërtuar baza juridike në fushën e drejtësisë penale. Legjislacioni i ri penal ka paraparë shumë institucione të reja, inkriminime të reja, ndryshim dhe ashpërsim të politikës ndëshkimore dhe risi të tjera.

Në Kodin e Procedurës Penale është paraparë për herë të parë në Kosovë edhe institucioni i Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë [145]. Pasi që janë inauguruar për herë të parë këto institucione juridike, e me qellim te promovimit dhe aplikimit në praktik, është i nevojshëm dhe i mirëseardhur studimi i këtij instituti në mënyre të pavarur shkencore. Për të arritur rezultatet e duhura shkencore, këtij punimi i jemi qasur me metodologji interdisiplinare. Për këtë qëllim, kemi përdorur metoda të ndryshme shkencore si atë historike, sociologjike, normative-juridike, krahasuese dhe analitike. Shpresoj që ky punim të jetë kontribut modest në avancimin e njohurive dhe aplikimin në praktikë të këtij instituti.
Me qëllim të trajtimit sa më të qartë dhe gjithëpërfshirës, objektin e këtij studimi do ta trajtojmë duke filluar nga nocioni, objekti, historiku, procedura ligjore si dhe një përfundim lidhur me rëndësinë e këtij instituti.

---

* Ramiz Buzhala, kandidatë për prokuror
* Kujtim Krasniqi, kandidate për prokuror
[144] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 18- 22.
[145] Kodi i Procedurës penale, Neni 233 par.1.

1. Nocioni, objekti dhe historiku i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Me qëllim të lehtësimit të punëve në sistemin e drejtësisë penale, e cila është fushë e ndjeshme dhe tejet serioze, Republika e Kosovës ka përcaktuar me ligj dhe po e aplikon institucionin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Marrëveshja e shkruar në mes të personit ndaj të cilit është ngritur aktakuza e deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor dhe Prokurorit të shtetit me ç'rast pra anohet fajësia për veprën penale, nën kushte të caktuara që Prokurori shtetit të tërhiqet nga disa pika të aktakuzës, të përcaktojë kufijtë e zbutjes së dënimit ose të tërhiqet në tërësi nga dënimi në
rast se i akuzuari pranon të jetë dëshmitarë bashkëpunues. Në këtë rast pranimi i tillë ndikon që personat tjerë të pengohen në kryerjen e veprës penale ose të provohet se kanë kryer vepra penale dhe kjo paraqet objektin thelbësor të marrëveshjes për pranim të fajësisë. Kësisoj, marrëveshja për pranimin e fajësisë është institucion i së drejtës së procedurës penale i cili në vete gërsheton çështje të karakterit procedural dhe material penal. Me fjalë të tjera, marrëveshja për pranimin e fajësisë i ofron mundësinë të akuzuarit që në këmbim të pranimit të fajësisë të përfitoj lehtësira në aspektin e caktimit të llojit dhe lartësisë së sanksionit penal.

Në vendet Anglo-saksone dhe ato Euro-kontinentale, institucioni i marrëveshjes së pranimit të fajësisë ka filluar të aplikohet që nga fundi i shek. 20. Shumica e këtyre shteteve kanë krijuar një praktikë solide të zbatimit të këtij institucioni, kurse edhe efektet e tij kanë qenë të mirëseardhura. Këtë institucion, ndonëse në një format më ndryshe e ka njohur edhe e drejta Romake edhe pse në esencë shumica e saj ishte e drejtë e karakterit juridik civil, por edhe të drejtat zakonore të shumë popujve. Si të tillë atë e njehë edhe e drejta jonë zakonore e përmbledhur në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe në kanunet e tjera lokale. Rrjedhimisht, kur çdo kryes i veprave të ndaluara e pranonte fajësinë, trajtohej me butë dhe dënohej më lehtë.

Në Kosovë, me ndryshim-plotësimet e bëra në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale në vitin 2008, (në tekstin e mëtejmë KP përkatësisht KPP), është inauguruar si institucion i ri edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë. Rrjedhimisht, Kodi i Procedurës Penale i cili ka hyrë në fuqi nga 1 janari i vitit 2013, për këtë institucion bën fjalë në nenin 233.

2. Motivi, interesi i palëve për lidhjen e marrëveshjes

Arsyet nga të cilat udhëhiqen palët për lidhjen e marrëveshjes mbi fajësinë dhe eventualisht përfundimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë janë të shumëfishta. Prokurori, i akuzuari dhe mbrojtësi mund të kenë interes për lidhjen e kësaj marrëveshje. Prokurori "interesin e drejtësisë", ndërkaq, i akuzuari interes personal por që përputhet me interesin e drejtësisë në çështjen konkrete penale.

Konkretisht prokurori, që sa më shpejt ta përfundoj lëndën e që si rezultat kursehen shpenzime nga zhvillimi i procedurës së rregullt, kursehen resurse njerëzore të cilët duhet të angazhohen në një rast (persona zyrtarë, ekspertet dhe bartësit e funksioneve të jurisprudencës; pastaj shpenzimeve materiale) , si dhe do te arrijë te prova kualitative kundër kryesve tjerë të veprave penale ne të cilat nuk kishte mund të ketë qasje prokurori në mënyrë tjetër. Gjithashtu si rezultat

i kësaj marrëveshje do të mundësohej akuzimi dhe dënimi i kryeseve tjerë që është shumë e rëndësishme të format e krimit të organizuar.
I akuzuari, gjithashtu ka interes që të lidh marrëveshje për pranim të fajësisë, ashtu që të merr dënim më të vogël se sa në gjykimin e rregullt, ti shmanget shpenzimeve që do të krijohen gjatë gjykimit, që mos ti nënshtrohet gjykimit publik të gjatë, që pranimi i fajësisë të shpreh pendimin e vërtetë për veprën e kryer. Qëllimi i fundit i negocimit të pranimit të fajësisë është lidhja e marrëveshjes mbi kushtet e pranimit të fajit, kontratës në formë të shkruar të cilën e përpilojnë dhe e nënshkruajnë, prokurori shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij.

3. Përfshirja e marrëveshjes për pranimin e fajësisë në të Drejtën Penale

Hyrja e institutit për Marrëveshjen e pranimit të fajësisë në Sistemin penalo-juridik të Kosovës sipas ligjeve të përmendura më lartë është reflektuar edhe në KPRK, meqë duhej të fitohej baza penalo-juridike për zbutjen e sanksionit penal me rastin e lidhjes së marrëveshjes[146].

Dispozitat në KPK në nenin 75 parag 1.3 mbi zbutjen e dënimit thekson: "Kur kryesi ka pranuar fajësinë në kushtet nga neni 233 parag.20 i KPP-së dhe marrëveshja për pranim të fajësisë në formë të shkruar përmban klauzolën në të cilën parasheh zbutjen e dënimit, gjykata do të shqiptojë një dënim më të butë. Në rast të tillë gjykata do të marrë parasysh qëndrimin e Prokurorit, të akuzuarit dhe palës së dëmtuar dhe do të udhëzohet por jo të detyrohet në kufizimet e dhëna në nenin 76 të KPK". Pra, nuk do të vlejnë limitet për zbutjen e dënimit sipas KPK neni 76 .

4. Marrëveshja për pranimin e fajësisë në aspektin e të Drejtës së Procedurës Penale

Sipas nenit 233 parag.1 i KPP-së, në çdo kohë para ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes për pranim të fajësisë, në bazë të së cilës i pandehuri dhe prokurori i shtetit pajtohen për akuzat e përfshira në aktakuzë dhe i pandehuri pajtohet të pranoj fajësinë në shkëmbim për:

1. Pajtimin e prokurorit të shtetit që të rekomandoj gjykatës dënim më të butë, por jo nen minimum e parapare me ligj ose minimumin e përcaktuar në paragrafin 7 të këtij neni, ose
2. Konsiderime të tjera në interes të drejtësisë, si është lirimi nga dënimi i parashikuar me nenin 234 të këtij Kodi (të lirohet nga dënimi kur është në pyetje dëshmitari bashkëpunues i cili ka kryer vepër penale por bashkëpunimi me te ka rezultuar me ndjekje penale të suksesshme ndaj kryeseve tjerë të veprës penale ose është arritur që të parandalohet kryerja e veprave penale të tjera).

Në rastet kur dëshiron të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me prokurorin , mbrojtësi i të pandehurit, ose i pandehuri nëse nuk përfaqësohet nga mbrojtësi, kërkon një takim paraprak me prokurorin e shtetit për të filluar negocimin për marrëveshjen për pranim të fajësisë, dhe në të gjitha këto negociata i akuzuari duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi në pajtim me paragrafin

[146] Procedura penale, Libri botuar në 2013, Prof.dr. Ejup Sahiti, fq.329.

1 të këtij neni. Prokurori i shtetit pas pranimit të kërkesës nga i akuzuari për takim preliminar do të informojë kryeprokurorin e zyrës së tij i cili do të jep autorizim për mbajtjen e takimit të tillë. Marrëveshje të tilla mbi pranimin e fajësisë duhet të jenë të shkruara dhe të pranuara nga kryeprokurori i zyrës përkatëse të prokurorisë para se formalisht ti ofrohen të akuzuarit. Ndërkaq, gjykata nuk mund të merr pjesë në negocimin e pranimit të fajësisë, por ajo sipas nevojës mund të caktojë afatet të arsyeshme kohore për të përfunduar marrëveshja e ma së gjati deri 3 muaj, në mënyrë që të mos zvarritet zgjidhja e çështjes penale.

5. Përmbajtja dhe efektet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë

E gjithë procedura për pranimin e fajësisë bëhet me qëllim që të arrihet pranimi i fajësisë nga i pandehuri, dhe që kjo çështje të marr fuqinë juridike përmes njohjes së saj nga gjykata. KPP në pjesën që i referohet çështjes së pranimit të fajësisë, ka paraparë zgjidhjen sipas të cilës arritja e marrëveshjes për pranimin e fajësisë është çështje ekskluzive e palëve, përkatësisht e prokurorit publik në njërën anë si dhe të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij në anën tjetër. Kjo zgjidhje e jetëson parimin e respektimit të autonomisë së palëve. Në këtë aspekt gjykata nuk ka ndonjë rol aktiv në arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, por ajo mund të caktoj afat të arsyeshëm brenda të cilit duhet të arrihet marrëveshja. Ky afat mund të zgjas më së shumti deri në tre muaj. Konsideroj se kjo zgjidhje është paraparë me qëllim që të ruhet autoriteti i gjykatës dhe të mos zvarritet pafundësisht dhe pa nevojë procedura penale. Rrjedhimisht, çështja e përmbajtjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe efektet e saj janë rregulluar me nenin 233 të KPP[147].

Marrëveshja për pranimin e fajësisë duhet të përpilohet me shkrim pasi që përbën dokument formal dhe zyrtar dhe është e detyrueshme për palët. Marrëveshja si e tillë duhet të përmbajë të gjitha kushtet e marrëveshjes e cila duhet të jetë e nënshkruar nga kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, mbrojtësi dhe i akuzuari, dhe është detyruese për të gjitha palët nënshkruese.

Marrëveshja mbi pranimin duhet së paku të përfshijë:

1. Pikat e aktakuzës për të cilat i akuzuari e pranon fajësinë;
2. A pranon i akuzuari të bashkëpunojë;
3. Të drejtat nga të cilat hiqet dorë;
4. Përgjegjësinë e të akuzuarit për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar dhe konfiskimin e të gjitha të mirave materiale në pajtim me nenet 489-499 të këtij Kodi.

Marrëveshja me shkrim po ashtu mund të përfshijë dispozitën me të cilën palët pajtohen për kufijtë e dëmit që do të propozohen nga ana e prokurorit publik nëse i akuzuari bashkëpunon substancialisht, ndërsa nëse gjykata cakton dënim i cili dëmton njërën palë, pala do të ketë të dre jtë ankese kundër vendimit mbi dënimin. Sipas kësaj zgjidhje, marrëveshja e arritur për

[147] Kodi i Procedurës penale, Neni 233 par.12. pika 1-4*Procedura penale, Libri botuar në 2013, Prof.dr. Ejup Sahiti, fq.226.*Internet përmes google “marrëveshja për pranimin e fajësisë”klikuar me dt;20.06.2014

pranimin e fajësisë duhet të jetë e përpiluar me shkrim si dhe të përmbajë të gjitha kushtet mbi të cilat janë pajtuar palët. Përveç kësaj, marrëveshja e tillë, për të qenë valide duhet të nënshkruhet nga kryeprokurori i prokurorisë përkatëse si dhe i akuzuari dhe mbrojtësi i tij. Si e tillë kjo marrëveshje e arritur është e detyrueshme për palët. Pra, palët nuk mund të pranojnë marrëveshjen e arritur në pjesë të caktuara e në pjesët tjera jo. Ajo i obligon palët në tërësinë e saj. Ky është aspekti parimor i përmbajtjes së marrëveshjes. Kjo do të thotë se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë mund të fokusohet në përmbajtjen e vetëm të dhënave që konsiderohen të domosdoshme.

Në këto raste marrëveshja mund të përfshijë së paku pikat e aktakuzës për të cilat i akuzuari e pranon fajësinë, faktin se a pranon i akuzuari të bashkëpunoj, të drejtat nga të cilat hiqet dorë nga ana e të akuzuarit (për shembull nga e drejta e ankesës) dhe faktin që përcakton përgjegjësinë e të akuzuarit për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar dhe faktin e konfiskimit të të gjitha të mirave materiale të fituar me veprën penale. Konform këtij paragrafi, marrëveshja mund të përfshijë edhe klauzolën me të cilën palët pajtohen për kufijtë e dënimit që do t`i propozohen gjykatës. Në këto raste është fjala për situatat kur i akuzuari shprehë gatishmëri të bashkëpunoj me gjykatën. Pjesë e kësaj klauzole mund të jetë edhe e dhëna që ia njeh të drejtën palës së dëmtuar, që të mund të atakojë aktgjykimin e marrë në pjesën që ka të bëj me vendimin mbi dënimin.

Gjykata sipas rregullit nuk merr pjesë në negocimin e pranimit të fajësisë, por mund të caktojë afate të arsyeshme brenda të cilave duhet të arrihet marrëveshja. Marrëveshja e arritur i procedohet gjykatës, e cila i ka dy mundësi veprimi.

Gjykata mund:

1. Ta aprovojë marrëveshjen e arritur për pranimin e fajësisë, ose
2. Ta refuzojë atë.

Rrjedhimisht, marrëveshja duhet të prezantohet në gjykatë në seancë të hapur publike. Ky prezantim ju mundëson palëve dhe posaçërisht gjykatës që të njihen publikisht me marrëveshjen e arritur dhe është në funksion të jetësimit të *parimit të drejtpërdrejtë, publicitetit dhe atij të transparencës* në procedurën penale. Para se të vendosë mbi pranimin e marrëveshjes, gjykata duhet ta dëgjojë të akuzuarin, në mënyrë që të bindet:

1. Nëse i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
2. Nëse pranimi i fajësisë është bërë me vullnetin e lirë e të akuzuarit ose jo, dhe
3. Nëse fajësia mbështetet në fakte e prova të dokumentuara e tjera.

Gjykata do ta refuzojë marrëveshjen nëse vlerëson se nuk është plotësuar cilado nga këto rrethana. Nëse e pranon marrëveshjen, gjykata e vendosë marrëveshjen në shkresat e lëndës dhe si e tillë ajo prodhon pasoja juridike. Nëse gjykata e refuzon pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykimi vazhdon në pajtim me procedurat që i parasheh KPP. Marrëveshja është e pavlefshme (nule) në rastet kur e cenon rendin publik dhe moralin, është lidhur në kundërshtim me rendin juridik, është ndikuar nga kanosja, dhuna, shtrëngimi ose rrethana tjera

të ngjashme. Rrethanat që i bëjnë të pavlefshme punët juridike në përgjithësi vlejnë edhe në rastin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

6. Palët në procedurë dhe pozita e tyre

6.1 I akuzuari

Sipas dispozitave të Ligjit i akuzuari mund të bëjë këtë marrëveshje vetëm me vullnetin dhe dëshirën e tij. Në këtë vështrim, është prezent barazia e armëve në pikëpamje të iniciativës dhe bisedimeve. Gjykata nuk ka të drejtën e ndërhyrjes gjatë marrëveshjes për pranimin e fajësisë me çka sigurohet parimi i pafajësisë deri sa i akuzuari të shpallet fajtor.

I akuzuari në procedurën e tillë duhet të ketë mbrojtës (parag.3 të nenit 233, të KPP) dhe për këtë arsye plotësohet me një paragraf të ri të nenit 57 parag.1 pika 1.5 të KPP ku flitet për mbrojtjen e obligueshme në procedurën penale.

I akuzuari ka të drejtë që të merr iniciativë mbi takimin paraprak me Prokurorin Shtetit për përcaktimin e bazave të marrëveshjes për pranim të fajësisë dhe fiton imunitet të kufizuar për deklarimet e tij, dëshmitë në rast se marrëveshja është e pasuksesshme, ose nuk pranohet nga gjykata, nuk do të merren si prova. Po ashtu, ka të drejtën e ankesës ndaj vendimit mbi dënimin të gjykatës kur nuk është respektuar ky kriter, i cili ka të bëjë me faktin se gjykata me rastin e caktimit të dënimit ndaj të akuzuarit që ka arrit marrëveshjen për pranimin e fajësisë ka dhënë një dënim më të rëndë ose më të butë nga ai i përcaktuar në marrëveshje.

6.2 I dëmtuari

Me rastin e lidhjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë, prokurori obligohet që të informoj të dëmtuarin, ndërkaq do të merr pjesë në seancën e shqyrtimit të marrëveshjes në gjykatë dhe do të deklarohet, nëse është seancë e mbyllur ma së voni deri para seancës së caktimit të dënimit. Pra, do të njoftohet se është pranuar marrëveshja dhe kushtet e saj ose është refuzuar e njëjta.

Pavarësisht se ekziston obligim ligjor për prokurorin që të njoftoj të dëmtuarin për negocimin e marrëveshjes për pranim të fajësisë dhe gjykatës për seancën e shqyrtimit të marrëveshjes si dhe deklarimit të dëmtuarit në ketë seancë lidhur me marrëveshjen, nuk paraqet kusht për aprovimin e marrëveshjes nga gjykata.

Prokurori publik detyrohet të informojë palën e dëmtuar me marrëveshjen që arrin formën përfundimtare, dhe kur ekziston kërkesa pronësore juridike që rrjedhë nga vepra penale për të cilën akuzohet, marrëveshja patjetër duhet ti referohet kërkesës së palës së dëmtuar. Me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë gjykata duhet të dëgjojë pikëpamjet e prokurorit, mbrojtësit dhe palës së dëmtuar. Nëse marrëveshja për bashkëpunimin dhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është e mbyllur, gjykata do ti lejojë palës së dëmtuar të jep deklaratën në përfundim të bashkëpunimit të akuzuarit, para shqiptimit të dënimit.”

I dëmtuari do të deklarohet për kërkesën pasurore juridike në gjykatë para se gjykata ta aprovoj marrëveshjen për pranimin e fajësisë, dhe përgjegjësia e të akuzuarit për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar dhe konfiskimi i të gjitha të mirave materiale në pajtim më nenet **489 – 499** të këtij Kodi."

Kur gjykata shqyrton marrëveshjen për pranimin e fajësisë duhet të dëgjojë pikëpamjet e palëve por edhe të dëmtuarit, ndërkaq në rast se seanca është e mbyllur (për shkak se ka objekt edhe shpalljen e të akuzuarit dëshmitarë bashkëpunues), të dëmtuarit do t'i mundësohet deklarimi me përfundim të bashkëpunimit me të akuzuarit, gjithsesi para shqiptimit të dënimit të akuzuarit.

7. Vendimet e gjykatës me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes

Marrëveshja e arritur i procedohet gjykatës, e cila i ka dy mundësi veprimi. Rrjedhimisht ajo mund:

a. Ta aprovojë marrëveshjen e arritur për pranimin e fajësisë, ose
b. Ta refuzojë atë.

Marrëveshja duhet të prezantohet në gjykatë në seancë të hapur publike. Ky prezantim ju mundëson palëve dhe posaçërisht gjykatës që të njihen publikisht me marrëveshjen e arritur dhe është në funksion të jetësimit të *parimit të drejtpërdrejtë, publicitetit dhe atij të transparencës* në procedurën penale.

Para se të vendosë mbi pranimin e marrëveshjes, gjykata duhet ta dëgjojë të akuzuarin, në mënyrë që të bindet:

1. Nëse i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
2. nëse pranimi i fajësisë është bërë me vullnetin e lirë e të akuzuarit ose jo, dhe
3. nëse fajësia mbështetet në fakte e prova të dokumentuara e tjera.

Gjykata do ta refuzojë marrëveshjen nëse vlerëson se nuk është plotësuar cilado nga këto rrethana. Nëse e pranon marrëveshjen, gjykata e vendosë marrëveshjen në shkresat e lëndës dhe si e tillë ajo prodhon pasoja juridike. Nëse gjykata e refuzon pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykimi vazhdon në pajtim me procedurat që i parasheh KPP.

Marrëveshja është e pavlefshme (nule) në rastet kur e cenon rendin publik dhe moralin, është lidhur në kundërshtim me rendin juridik, është ndikuar nga kanosja, dhuna, shtrëngimi ose rrethana tjera të ngjashme. Rrethanat që i bëjnë të pavlefshme punët juridike në përgjithësi vlejnë edhe në rastin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

8. Caktimi dhe matja e dënimit në rastet e negocimit

Me marrëveshje mund te përcaktohet lartësia dhe lloji i dënimit i cili është paraparë në dispozitat e KPK-së. Në radhë të parë do të respektohen dispozitat ligjore mbi minimumin dhe maksimumin ligjor të posaçëm dhe të përgjithshëm. Në raste të caktuara sikurse te "bashkëpunimi substancial" mund të negociohet edhe nën minimumin ligjor të përgjithshëm dhe të posaçëm për caktimin e dënimit. Në rastet e bashkëpunimit substancial por edhe të bashkëpunimit në përgjithësi për përcaktimin e dënimit në negociata merren parasysh këto rrethana:

4. Rëndësia e pranimit të veprës penale;
5. Rrethana se vepra penale nuk do të mund të provohej në mënyrë ose mjetet të tjera;
6. Pranimi i fajësisë do të ndikojë në pengimin e kryerjes, zbulimin dhe provimin e veprave penale tjera dhe
7. Nëse në rastin konkret ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese.

Sipas marrëveshjes janë të mundshme këto variante për përcaktimin e dënimit:

a. Prokurori shtetit mund të propozoje dënimin dhe masën tjetër ose vetëm dënimin saktësisht,
b. Dënimi kryesor se bashku me dënimin plotësues.
c. Gjykim me kusht, vërejtje gjyqësore etj.

Prokurori i shtetit nuk ka të drejtë caktimin e dënimit (ius puniendi), prandaj duhet t'i përmbahet rregullave të përcaktuara me ligjin penal material në pikëpamje të matjes së dënimit, rregullave të zbutjes së dënimit etj. me rastin e negocimit të marrëveshjes. Kjo për arsye se pavarësisht se emërtohet akti i shkruar si marrëveshje për pranimin e fajësisë, që fajësinë ka element qendror, po ashtu edhe marrëveshja për dënimin është e rëndësisë së njëjtë. Njëra pa tjetrën në këtë rast nuk mund të qëndrojnë, meqë të dyja burojnë prej vullnetit të akuzuarit dhe prokurorit publik e që janë të mbështetura në dispozitat ligjore, në të kundërtën akti i marrëveshjes pa këto dy elemente nuk mund qëndroje.

9. Tërheqja nga marrëveshja e negociatorëve

Palët, pra prokurori ose i akuzuari mund ta refuzojnë marrëveshjen për pranim të fajësisë të cilën e kanë lidhur vet, para se ajo të paraqitet në gjykatë (parag.11)[148]. Në rastin e tillë vazhdohet me procedim të rregullt sikurse edhe në rastet kur negociatat kanë dështuar ose marrëveshja për pranim të fajësisë nuk pranohet nga gjykata. Dëshmitë e dhëna nga i akuzuari, pranimet e fajësisë për pika të caktuara të aktakuzës ose të aktakuzës në tërësi në rastet kur marrëveshja nuk është pranuar nga gjykata, ose palët janë tërhequr nga marrëveshja para paraqitjes së saj në gjykatë do të jenë dëshmi (prova) të papranueshme në procedurën penale në të cilën janë kryer bisedimet dhe në çdo procedurë tjetër.

[148] Kodi i Procedurës penale, Neni 233 par.11

10. Sigurimi i ekzekutimit të marrëveshjes

Garancinë se do të realizohet marrëveshja për pranimin e fajësisë nga të dy palët, në vështrim të dispozitave procedurale që rregullojnë ketë materie, janë evidente. Së pari marrëveshja për pranim të fajësisë hyn në fuqi juridike vetëm pas aprovimit nga gjykata. Palët në çdo kohë, para se gjykata të aprovoj marrëveshjen për pranimin e fajësisë, mund ta refuzojnë/anulojnë/ marrëveshjen. Edhe pse gjykata nuk merr pjesë në negocim për pranim të fajësisë, në paralajmërim të palëve që janë në procedurë të tillë, mund të shtyjë fillimin e seancës ma së shumti tre muaj (par.10).

Pasi që gjykata ka aprovuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, mund të mos lejoj të akuzuarin të tërheq pranimin e fajësisë ose prokurorin të anuloj marrëveshjen, përveç në rast se bindin gjykatën se ndonjëri nga kushtet e par. 18, nuk është përmbush, për çka barra e provës bie mbi palën që kërkon zgjidhjen e marrëveshjes (parag.22). Pas aprovimit të marrëveshjes, gjykata mund të caktojë një datë kur palët do të japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin. Mirëpo, gjykata me qëllim që të realizohet obligimi nga marrëveshja për pranim të fajësisë e të akuzuarit që të shërbejë si dëshmitarë bashkëpunues, seancën e dënimit do ta shtyjë në kohën që në ligj nuk është e kufizuar afati. Kjo dispozitë do të merret padyshim si sigurim se do të realizohen obligimet e të akuzuarit nga marrëveshja.

Por, shtrohet pyetja pas kryerjes së obligimeve të palëve sipas marrëveshjes dhe pas aprovimit të saj nga gjykata, posaçërisht në rastin kur është shfrytëzuar cilësia e dëshmitarit bashkëpunues përkatësisht "bashkëpunim substancial" në një çështje penale tjetër, ndërkaq gjykata shqipton dënim tjetër nga marrëveshja e aprovuar nga gjykata, vetëm e drejta në ankesë e palëve për dënimin a mund të quhet sigurim i ekzekutimit të marrëveshjes.

11. Mjetet juridike në procedurat e marrëveshjes

Në vendimin e gjykatës për hedhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ankesa nuk lejohet, më që kemi të bëjmë me vendim procesual i cili merret në procesverbal në të cilin palët nuk kanë të drejtën e ankesës. Nga dispozitat që rregullojnë marrëveshjen për pranimin e fajësisë nuk del se në rast se gjykata të njëjtën e hedhë, të ushtrohet ankesë. Përkundrazi, vetëm do të vazhdohet me shqyrtimin gjyqësor në procedurë të rregullt.

12. Ankesa ndaj aktgjykimit që ka bazë marrëveshjen

Domosdoshmërisht shtrohet pyetja, në rast se marrëveshja është pranuar nga gjykata dhe aktgjykimi është marrë mbi ketë bazë, në çfarë drejtimi ose baze mund të ushtrohet ankesë si mjet i rregullt juridik ? Prandaj, nëse gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet për pranimin e marrëveshjes, do ta aprovoj dhe do të konstatoj me vendim në procesverbal duke caktuar shqyrtimin për shqiptimin e dënimit dhe masave tjera të parapara me marrëveshje. Pas mbajtjes së shqyrtimit merret aktgjykimi me përshkrimin faktik të veprës dhe cilësimin juridik të

aktakuzës. Duke pasur parasysh këto rrethana mund të konstatohet se ankesa në pikëpamje të dënimit të paraparë me marrëveshje nuk lejohet, për çka ekziston ndalesë ligjore. Për këtë i akuzuari edhe udhëzohet. Në rast se i akuzuari ne ketë bazë ankohet, e njëjta do të hedhet si e palejuar.

Në rast se marrëveshja për pranim të fajësisë ka zgjidhur çështjen e marrjes së përfitimit pasuror, shpalljen e aktgjykimit me mjete të informimit publik, vendimin mbi kërkesën pasurore –juridike si dhe mbi shpenzimet procedurale, dhe gjykata aprovon ketë marrëveshje në këto baza, nuk mundet po ashtu të ushtrohet ankesa.

Po ashtu, nuk mundet në këto situata të ushtrohet ankesë në bazë të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për arsye se i akuzuari ka pranuar fajësinë në mënyrë të padyshimtë dhe me vetëdije ka heqë dorë nga gjykimi i rregulltë. Ndërkaq, pa gjykim dhe administrim të provave në procedurë si fazë qenësore e saj, nuk ka dhe vërtetim të gjendjes faktike e as që aktgjykimi mund të ankimohet në ketë bazë.

Ankesa për të tjera baza nuk është shprehimisht e ndaluar, edhe pse e drejta e ankesës është e garantuar me KEDNJ. Ankesa për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe për shkak të cenimit të ligjit penal është e mundur të ushtrohet, edhe pse kjo bazë ankimore vështirë mund të ndikoj në ndryshimin e vendimit të gjykatës mbi ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale. Pa zhvillimin e procedurës penale parimisht nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale edhe pse nuk është e pamundur. Bazuar në këtë p.sh përbërja e trupit gjykues e parregullt, ose në shqiptimin e dënimit. (gjykatësi i cili nuk ka marrë pjesë në shqyrtim kryesor ose është përjashtuar nga gjykimi, përkatësisht ka marrë pjesë gjykatësi i cili duhej të përjashtohej, shqyrtimi është majtë në mungesë të personit që ishte e obliguar prezenca e tij, është cenuar e drejta në mbrojtje, gjykata ka gabuar në pikëpamje të ekzistimit të lejes së ndjekjes nga organi kompetent etj). Situatë e njëjtë paraqitet të shkeljet e ligjit penal. Mund të paraqitet situatë, që vepra për të cilën i akuzuari ndiqet, a është vepër penale, a ekzistojnë rrethanat të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale, a është arrit parashkrimi, është shkelë parimi ne bis in idem, gabimisht është aplikuar ligji material, është tejkaluar autorizimi që ka gjykata sipas ligjit me vendimin për dënim, masën e sigurisë, marrjen e përfitimit pasuror, a janë zbatuar dispozitat mbi llogaritjen e paraburgimit?.

Në pikëpamje të drejtës së prokurorit publik, pavarësisht se nuk ndalohet shprehimisht ankesa në bazë të vendimit mbi dënimin, në rastin kur vetë ka përpiluar marrëveshjen për pranimin e fajësisë të cilin gjykata e ka aprovuar, ankesa do të hidhej si e palejuar.

13. Përfundim

Shikuar në aspektin historik dhe zhvillimor të këtij institucioni, në sistemet juridike me të cilat është aplikuar deri me tani ka dhënë sukses në ndjekjen e kryesve të veprës penale sidomos te krimi i organizuar. Kryerja e veprave penale në bashkë ekzekutim janë tipare te veprat penale të korrupsionit, larjes së parave e tjera, si në ndjekje por edhe në shpalljen fajtor, pasi që është

lehtësuar mënyra e zbulimit të veprave dhe janë siguruar prova të forta dhe të pranueshme në procedurën penale.

Konsiderojmë se pasi që të zbatohen drejtë këto dispozita nga organet e judikatures me siguri se nuk do të mungojnë sukseset në zbulimin e kryesve të veprës penale, gjykimin dhe parandalimin e kryesve të veprave penale. Me zgjidhjet që i ka ofruar Ligji, të cilat edhe mund të plotësohen edhe më tutje, (mund të aplikohet edhe në këtë mënyrë) do të realizohet interesi i Drejtësisë që për çdo rast është më i madh edhe kur një personi i zbutet dënimi ose i hiqet fare në rast se kontributi i tij është rezultat i zbulimit dhe vënies nën përgjegjësi penale të kryesve të veprave penale, veçanërisht te krimi i organizuar, korrupsioni, larjes së parave, trafikimit me njerëz e tjerë.

Në raport me të pandehurin *Marrëveshja për pranimin e fajësisë* i mundëson që të përfitoj lehtësira të rëndësishme procedurale, trajtim më të favorshëm e madje edhe dënim të natyrës më të butë. Meqenëse marrëveshja për pranimin e fajësisë aplikohet në procedurën penale, në masë të konsiderueshme i kursen gjykatat nga një pjesë e madhe e punës. Njëkohësisht, i akuzuari përveç favoreve që i përfiton në këtë aspekt, ky institucion e përmirëson në masë të madhe pozitën e tij si i pandehur në procedurën penale.

Ndërsa sa i përket aplikimit të këtij institucioni të rëndësishëm, sipas të dhënave që i posedojmë, institucioni i marrëveshjes për pranimin e fajësisë në vendin tonë është aplikuar fare pak, përkatësisht në disa raste individuale. Mbetet që në të ardhmen të promovohet më shumë ky institucion i ri, dhe të inkurajohen organet e drejtësisë në shtetin tonë që ta aplikojnë atë në çdo rast kur plotësohen kushtet e parapara me ligj.

Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Kodi Penal i Kosovës
- Kodi i Procedurës Penale i Kosovës
- E drejta e procedurës penale, Ejup SAHITI
- Literaturë të ndryshme nga internet dhe google.

-

Fatime Hasani – Ruhani* **Qefsere Berisha***

KONVENTA EVROPIANE PËR LIRITË DHE TË DREJTAT THEMELORE TË NJERIUT

-DISKRIMINIMI ME THEKS TË VEÇANTË NE DISKRIMINIMIN NDAJ GRUAS-

ABSTRAKT

Përmes këtij punimi është synuar që të paraqesim diskrimimin, llojet e diskriminimeve e posaçërisht diskriminimin ndaj gruas. Përkundër faktit se jetojmë në shekullin XXI, përkundër asaj që shoqëria njerëzore ka bërë progres të madh dhe ka përparuar jashtëzakonisht (dhe po ec me hapa të mëdhenj përpara), për fat të keq nuk mund të themi se diskriminimi në këto kohëra moderne i përket së kaluarës. Fatkeqësisht, diskriminimi e sidomos diskriminimi ndaj gruas (femrës) është i pranishëm, diku më pak e diku më shumë, diku në disa forma e aspekte tjera jetësore varësisht nga rajoni apo vendi ku ato jetojnë apo veprojnë. Përmes një rasti konkret jemi munduar që të prekim këtë temë në thelbin e sajë, të pasqyrojmë vuajtjet e personit të gjinisë femërore e cila të gjitha këto vuajtje, gjithë këtë diskriminim e ka përjetuar për të vetmin fakt që ishte femër. Po ashtu, kemi prekur edhe disa aspekte vendore të diskriminimit, bazën ligjore, ku në këtë drejtim ka pozitivitet dhe lëvizje për të mirë. Diskriminimi është temë aktuale çdo herë, në çdo shoqëri, shtet apo qoftë edhe komunitet. Matësi kryesor i këtij përparimi është edhe pozita dhe roli i gruas në një shoqëri sepse avancimi i saj varet shumë edhe nga roli, edukimi, barazimi i rolit të saj në te. Pra kemi trajtuar këtë çështje në aspektin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Fjalët kyçe: diskriminimi, barazia, gjinia, barazia gjinore, etj.

HYRJE

1. Për diskriminimin në përgjithësi

Shpesh është më lehtë të zemërohesh nga padrejtësitë që ndodhin në gjysmën tjetër të botës, sesa nga shtypjet dhe diskriminimi që ndodh një gjysmë rruge larg nga shtëpia jonë. Provoni

* Fatime Hasani-Ruhani, kandidate për gjyqtare
* Qefsere Berisha, candidate për gjyqtare

të mendoni për ndonjë person të cilin ju e njihni dhe i cili, e cila gjatë gjithë jetës së tij /saj nuk ka qenë ndonjëherë subjekt i ndonjë forme të diskriminimit. Do ta shihni se nuk do të mund ta gjeni asnjë të tillë.

Në kuptimin më të gjerë, të drejtat e njeriut merren si të drejta të cilat i takojnë çdo individi. Si pasojë e të qenit njeri, pavarësisht nga aktet ligjore, duke e pohuar ekzistencën e të drejtave të njeriut, themi se çdo qenieje njerëzore me vet faktin se ai ose ajo është e tillë i takon diçka. Të çmuarit e vlerës unike të çdo qenieje njerëzore nga ana e bashkësisë ndërkombëtare qon jo vetëm kah përpjekjet për eliminim e elementeve destruktive për individin por edhe kah ato për krijimin e kushteve të cilat do t`i mundësonin atij ose asaj që të zhvillohet dhe përparojë. Të drejtat dhe liritë themelore si të drejta imanente ekzistojnë pavarësisht nga vullneti i një individi apo grupi të njerëzve. Ato as nuk fitohen as nuk dhurohen nëpërmes te çfarëdo veprimi. Ato mund të mos njihen apo respektohen por ato prapë se prapë i takojnë një individi. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nuk janë të lidhura me norma ligjore të miratuara sipas rregullit, por miratimi i normave të përshtatshme bëhet me qëllim që t`i mbrojë të drejtat e njeriut dhe t`i përcaktojë mënyrat e realizimit të tyre.

Normat ligjore të të drejtave të njeriut nuk i përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore, ato vetëm i garantojnë ato. Veprimet e caktuara, apo heqja dorë nga ato, i takojnë një njeriu dhe e ka bazën e vet primare në veçantinë e të qenit njeri. Kjo veçanti, gjithashtu është bazë për caktimin e dinjitetit të çdo qenieje njerëzore. Çdo qenie njerëzore konsiderohet si qëllim në vete, prandaj askush nuk duhet të trajtohet si një mjet i thjeshtë dhe nëse një trajtim i tillë do të ishte shumë i dobishëm për shoqërinë apo për vet personin.

Barazia është një element tjetër me rëndësi i konceptit të të drejtave të njeriut, të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave.

Parimi sipas të cilit të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejta të barabarta dhe duhet të trajtohen njësoj, paraqet bazën e kuptimit të të drejtave të njeriut dhe rrjedh nga dinjiteti i barabartë njerëzor i çdo individi. Mirëpo kjo e drejtë natyrore, e barazisë, qoftë në të kaluarën ose tani, asnjëherë nuk u është ofruar të gjitha qenieve njerëzore në mënyrë të plotë.

Që nga fillimi i njerëzimit, diskriminimi, qoftë në një formë qoftë në tjetrën ka paraqitur problem. Diskriminimi është bërë gjithkund, ndaj njerëzve autoritativ dhe ndaj minoriteteve, kundër zezakëve, hebrenjve, kundër aborigjenëve të Australisë, romëve edhe në fise të ndryshme të Afrikës, punëtorëve emigrantë, refugjatëve, azilkërkuesve. Diskriminimi ndodh ndaj fëmijëve, femrave të cilat trajtohen si qenie njerëzore më pak të vlefshme, njerëzve të infektuar me HIV- AIDS, kundër atyre që kanë të meta fizike dhe psikike, diskriminimi ndaj punëtorëve, diskriminimi gjinor në punë, diskriminimi ndaj grave me rastin e asistencës në rast të papunësisë, e shumë e shumë diskriminime të tjera.

Diskriminimi shfaqet në aq shumë forma, sa që mund të supozojmë se secili në një farë forme dhe sasie ka qenë i prekur nga diskriminimi. Diskriminimi është një akt ç'njerëzor, poshtërues e degradues dhe është prezent që nga krijimi i njerëzimit. Në përgjithësi diskriminimi konsiderohet çdo formë e dallimit, përjashtimit, kufizimit ose ndonjë referimi me qëllim të mohimit ose refuzimit të drejtave të barabarta dhe mbrojtjes si dhe paraqet ndikim të parimit të barazisë dhe fyerje ndaj dinjitetit njerëzor. Varësisht nga arsyeja për

trajtim kemi diskriminimin në baza racore, fetare, kombëtare, ngjyre, gjinie, religjioni, orientim seksual etj.

2. Diskriminimi ndaj gruas

Diskriminimi i bazuar në gjini është i rëndomtë dhe përkundër përparimit të bërë në këtë aspekt në shumë vende ekzistojnë sisteme të cilat ndër të tjera u mohojnë femrave të drejtën e përfaqësimit të pasurisë martesore - bashkëshortore, të drejtën e trashëgimisë në kushte të barabarta me meshkuj dhe të drejtën për punë dhe udhëtim pa leje të burrit. Gratë janë po ashtu subjekt i dhunës dhe i praktikave të keqpërdorimit çka vazhdon me të njëjtin vrull në shumë vende dhe me këtë ato zakonisht vuajnë diskriminim e dyfishtë si për shkak të racës apo origjinës së tyre ashtu edhe për shkak se janë femra. Në Azi (si dhe në shumë vende tjera të botës) shumica e prindërve preferojnë të kenë djem e jo vajza. Sipas një raporti të OKB-së për vitin 2011, popullsia në këtë pjesë të botës kishte afro 134 milionë gra më pak për shkak të abortit, vrasjes foshnjore dhe për shkak të lënies pas dore.

Arsimimi. Në mbarë botën, gratë dhe vajzat përbëjnë dy të tretat e njerëzve me më pak se katër klasë shkollë.

Ngacmimi seksual. Mbi 2,6 miliardë gra jetojnë në vende ku përdhunimi nga bashkëshorti ende nuk konsiderohet krim.

Shëndeti. Në vendet në zhvillim, afërsisht çdo dy minuta një grua vdes nga ndërlikimet gjatë shtatzënisë ose gjatë lindjes ngaqë nuk merr kujdesin e duhur mjekësor.

Të drejtat për pronën. Megjithëse gratë kultivojnë më tepër se gjysmën e prodhimeve në mbarë botën, në shumë vende ato nuk kanë të drejta ligjore për të zotëruar një pronë ose për të trashëguar tokën.

Gruaja lind e lirë dhe gëzon të drejta të barabarta me mashkullin në çdo aspekt. Andaj, diskriminimi ndaj grave nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim të bazuar në gjini, që ka për efekt ose qëllim të komprometoje ose të asgjësojë njohjen e pozitës së gruas, cilado qoftë gjendje e saj, martesore mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në fushat politike ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër.

Një pjesë e madhe e popullatës botërore i nënshtrohet në mënyrë rutinore torturës, urisë, terrorizmit, poshtërimit, gjymtimit madje edhe vrasjeve, thjeshtë se janë femra

Rasti Miriam

Miriam është 36 vjeçe dhe është nënë e gjashtë fëmijëve. Ajo është rritur në një fshat larg nga qendrat urbane. Miriam e ndërpreu shkollimin pas përfundimit të klasës së dytë. Prindërit e saj kanë qenë të varfër, kurse shkolla ishte 4 (katër) km. larg nga shtëpia e sajë. Babai i saj besonte se arsimimi i femrës është vetëm humbje kohe dhe përpjekjesh, pasi fati i femrave është martesa e jo për të punuar për mbijetesë.

Kur Miriam ishte 12 vjeçe, sipas zakoneve lokale i ishte bërë rrethprerja (gjymtimi gjenital). Ajo u martua si 16 vjeçe me një njeri rreth të 50-tave. Babai i saj mori nga dhëndri një sasi të mirë parash si pajë për nusen. Vitin e ardhshëm ajo lindi një djalë. Fëmija kishte lindur i vdekur. Klinika regjionale ishte 10 km. larg fshatit dhe nuk bënte mbikëqyrjen e lindjeve. Gjatë shtatzënisë, Miriamin e rrahtë bashkëshorti shpesh dhe ajo besonte se fëmija lindi i vdekur për këto arsye. Sidoqoftë familja e saj dhe shumë të tjerë nga fshati e fajësuan Miriamin për dështim. Miriami nuk kishte dëshirë të kishte marrëdhënie seksuale me bashkëshortin e saj. Ajo frikësohej nga ai dhe nga shtatzënësia. Bashkëshorti i saj konsideronte se ka të drejtë për marrëdhënie seksuale me atë dhe rregullisht e detyronte Miriamin. Ajo nuk dëshironte të mbetej shtatzëne përsëri, por nuk kishte tjetër zgjidhje. Ajo vizitonte mjekët popullorë dhe merrte përzierje të ndryshme të bimëve dhe gjithashtu mbante hajmali që nuk kishin sukses. Ajo rrallë kishte kohë të shkonte për kontroll në klinikë dhe atëherë kur shkonte këtë e bënte për shkak të fëmijëve që i sëmureshin, por kurr nuk arrinte të bisedonte me motra medicinale për kontracepcion. Ajo (motra medicinale) edhe pse dukej se e kuptonte gjuhën lokale të Miriamit, preferonte të bisedonte në gjuhën dominuese që flitej në kryeqytet dhe mes klasës së edukuar të njerëzve. Ajo e kishte frikësuar Miriamin.

Jeta e saj ka qenë një sagë e gjatë e dhunës, varfërisë dhe skamjes. Miriami gjatë disa shtatzënësive që kishte dhe gjatë rritjes së fëmijëve të saj përpiqej të mbante shpirtin dhe trupin bashkë. Ajo mbolli një parcelë të vogël me gjëra për të ushqyer fëmijët e sajë, pasi që bashkëshorti kurrë nuk i epte para të mjaftueshme për këtë. Ajo kërkoi ndihmë nga prindërit e saj dhe nga një misionar vizitues. Të gjithë i thanë asaj ta dëgjojë bashkëshortin e saj dhe i kujtuan asaj se ka obligim ndaj bashkëshortit dhe familjes.

Një ditë bashkëshorti akuzoi Miriamin për shoqërim me një njeri tjetër ai pretendonte ta ketë parë atë duke qeshur dhe biseduar me një fshatar në një ditë tregu. Kur ajo u përgjigj, ky filloi ta godasë pa ndërprerë duke i thënë lavire dhe duke u zotuar se do t`i hakmerrej për atë çnderim që ajo i kishte bërë. Miriam kishte pësuar lëndime të rënda ajo mendonte të kishte thyer edhe brinjët. Për disa javë rresht, ajo nuk kishte mundur të dilte jashtë shtëpisë. Ajo nuk kishte para të shkonte në klinikë për trajtim, ose për të arritur deri atje. Askush në fshat nuk i ndihmoi asaj edhe pse kishte disa që mendonin se bashkëshorti i saj e kishte tepruar. Gruaja është punë e burrit të sajë. Në pamundësi për të shkuar në treg për të shitur ose për tu kujdesur për kopshtin e sajë, Miriami dhe fëmijët e saj gati sa vdiqën nga uria.

Miriami e dinte se do të ketë dhunë edhe në të ardhmen. Ajo frikësohej për jetën e saj dhe jetën e fëmijëve të saj. Ajo pa në ëndërr vdekjen e saj dhe e dinte se duhej të shkonte. Posa filloi të ecte, ajo mori me vete dy më të vegjlit dhe e lëshoi fshatin. Ajo tani jeton në një fshat tjetër, si refugjate brenda shtetit të saj duke jetuar në frikë se bashkëshorti i saj do ta gjej dhe do ta kthej në shtëpi...

A thua edhe sa femra në botë vuajnë fatin e njëjtë ose të ngjashëm me atë të Miriamit?

Gratë vuajnë më së shumti në kushte të varfërisë, ato kanë më pak qasje se burrat në përkujdesje shëndetësore, në arsim dhe në ushqim. Diskriminimi gjinor ka lulëzuar përkundër trendit drejt të drejtave të barabarta në instrumentet e të drejtave të njeriut. Diskriminimi ndaj gruas definohet si çdo dallim, ekskluzivitet apo kufizim që bëhet në bazë të gjinisë që ka për

efekt e qëllim ndryshimin apo anulimin e njohjes, të gëzimit apo të ushtrimit nga gratë, pa dallim të statusit martesor, në bazë të barazisë së burrit dhe gruas, të të drejtave të njeriut dhe të lirive fondamentale në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo të çfarëdo fushe tjetër.

Pavarësisht ndryshimeve që kanë pasuar zhvillimin e gruas sot, jo vetëm në Kosovë, por edhe në botë, ende vihet re një hendek mes kapacitetit dhe nevojave të tyre dhe burimeve që ato disponojnë, arsimimit, punësimit, përfshirjes në vendimmarrje. Niveli i ulët i përfaqësimit i gruas në vendimmarrje është një çështje e ndikuar nga shumë faktorë social- kulturor, ekonomik, strukturor, shoqëror etj.

Vendi i parë në botë i cili i ua ka lejuar femrave të drejtën e votës ka qenë Zelanda e Re në vitin 1893. Sot pas afërsisht 100 vjet pas fitimit të drejtës së votës dhe të drejtës për tu zgjedhur, gratë në Kosovë kanë një nivel të ulët përfaqësimi në nivel vendimmarrës.

Barazia gjinore nuk është një çështje e grave siç cilësohet, por është një çështje e barazisë mes grupeve të burrave dhe grave e shanseve të barabarta mes tyre në të gjitha fushat e jetës duke filluar nga drejtimi i familjes tek qeverisja e një shteti. Ajo është një proces integrimi që synon zhvillimin e shoqërisë, në nivelin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në nivel social, në nivel të drejtash civile dhe politike duke pasur mundësi të barabartë për të ushtruar të drejtën për të zgjedhur dhe për t u zgjedhur.

3. Përfshirja e diskriminimit në legjislacionin vendor dhe më gjerë si dhe disa vështrime në këtë aspekt.

Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë të gëzojnë mbrojtje të barabartë para ligjit pa asnjë dallim. Në lidhje me këtë, ligji do të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë mbrojtje të efektshme kundër diskriminimit mbi çfarëdo baze siç është raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, bindjet politike apo bindje të tjera, prejardhja kombëtare apo shoqërore, pasuria, apo një gjendje tjetër.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës si tekst i parë kushtetues i Kosovës së pavarur dhe sovrane, përmban parime dhe norma të përgjithshme me të cilat sigurohen të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të drejtave të njeriut- kapitulli II-të i KRK-së. Qëllimi i garancive kushtetuese për të drejtat dhe liritë themelore është mbrojtja e dinjitetit të njeriut, lirisë dhe barazisë. Përveç që janë këto të drejta të garantuara me kushtetutë, po ashtu është në fuqi dhe zbatim edhe Ligji për Barazi Gjinore, (Nr.2004/3).

Mirëpo, edhe përkundër faktit se këto të drejta janë të garantuara me kushtetutë, dallimet gjinore në vendin e punës mund të përdoren si një tregues i barazisë gjinore, ngase gratë nuk trajtohen në mënyrë të ndershme në tregun e punës dhe përballen me pengesa indirekte të tilla si stereotipet dhe diskriminim gjinor. Gratë hasin ende diskriminim në të dyja format e veçimit horizontal dhe vertikal, ngase shumica e tyre vazhdojnë të jenë të punësuara në sektorë ku tradicionalisht punojnë gra, si shëndetësia dhe arsimi. Një masë e rëndësishme për përmirësimin e gjendjes së gruas është ekzistenca e punëve të cilësisë së mirë për gratë, në pozita menaxheriale apo nivele të larta drejtimi. Një studim i bërë në Harëward, ka treguar se

rendimentet profesionale të grave janë më të mira se ato të kolegëve meshkuj, ngase bankat e vetme që nuk janë përfshirë në krizën e kredive kanë qenë ato që kanë qenë gra në pozicionet drejtuese, ka shpjeguar një specialiste financiare Heather Mc.Gregor në bankën /City/ në Londër, pikërisht se gratë kanë një raport më racional me paranë , më pak emotive dhe janë më shumë të prirura ndaj kursimeve. Në terminologjinë e Konventës së Kombeve të Bashkuara, për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Gruas (CEDAWË), Neni 11 i kësaj konvente specifikon detyrimet e shteteve palë në fushën e punësimit duke kërkuar që shtetet palë të marrin të gjitha masat për eliminimin e diskriminimit të gruas në fushën e punësimit.

Ndërsa në vendin tonë, edhe përkundër specifikimit dhe rregullimit sa i përket barazisë ligjore në fushën e punësimit, prapë nuk respektohen të drejtat e grave të punësuara në sektorin privat edhe pse një gjë e tillë është e rregulluar me Ligjin e Punës, Nr.03/L-212–Pushimi i Lehonisë, neni 49. Femrat e punësuara në sektorin privat nuk mund ta gëzojnë këtë të drejtë sepse kjo dispozitë ligjore fare nuk vlen për punëdhënësit privat pasi nënat pas lindjes menjëherë duhet të paraqiten në vendin e tyre të punës ose në të kundërtën ju ndërpritet marrëdhënia e punës. Punonjësit e sektorit privat kanë raportuar përqindje më të lartë të diskriminimit gjinor në vendin e punës me 30.7% krahasuar 16.7% të raportuar në sektorin publik. Nga shumë anketime perceptohet se pushimi i lehonisë kushtëzon zhvillimin në karrierë dhe po ashtu cilësia e punës në periudhën e shtatzënisë ulet.

Përqindja e femrave të punësuara ndër vite, për periudhën 2009 e deri më tani nuk ka pasur rritje, dhe mundësitë e ngritjes në karrierë për femrat pas pushimit të lehonisë janë të pakta ,për shkak se duke marrë parasysh që vetëm 27% të punësuarve në Kosovë janë të gjinisë femërore, raporti gjinor në punë rrezikon të bëhet edhe më i dukshëm. Andaj, pushimi i lindjes me një kohëzgjatje modeste rrit mundësinë e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, në mënyrë të theksuar ku pushimi është i paguar. P.sh reforma gjermane e lehonisë e quajtur ELTERNGEL, e cila zëvendësoi 67% të ardhurave për deri 14 (katërmbëdhjetë) muaj pas lindjes së fëmijës, ka treguar një rritje të konsiderueshme në probabilitetin e nënave të punësuara në fund të kësaj periudhe. Ashtu që pushimi i lehonisë është në thelb të një procesi i cili ndikon dhe përcakton dëshirat e grave që të kthehen në punë dhe ti kryejnë punët e tyre me sukses.

4. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) -është një traktat ndërkombëtar në bazë të të cilit shtetet anëtare të Këshillit të Evropës premtojnë t`u sigurojnë të drejtat themelore jo vetëm qytetarëve të tyre por edhe çdo individi brenda juridiksionit të tyre.

Garancitë dhe ndalimet - Kjo konventë mbron në veçanti:

1. Të drejtën për jetën,
2. Të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor,
3. Të drejtën për të respektuar jetën private dhe atë familjare,
4. Lirinë e shprehjes dhe të mendimit, ndërgjegjes dhe fesë dhe
5. Të drejtën e pronës.

Konventa ndalon:

1. Torturën dhe trajtimin ose dënimin ç'njerëzor ose poshtërues
2. Skllavërinë dhe punën e detyruar,
3. Ndalimin arbitrar dhe të paligjshëm dhe
4. Diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara me Konventë.

Konventa u nënshkrua më 4 nëntor 1950 në Romë, ndërsa hyri në fuqi në vitin 1953.

5. Disa fjalë për Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është një gjykatë ndërkombëtare e themeluar në vitin 1959. Kjo gjykatë merr vendime për kërkesat individuale ose ndërshtetërore të cilat pretendojnë shkelje të drejtave civile dhe politike të përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata është më seli në Strasburg – Francë nga ku monitoron respektimin e të drejtave të njeriut të 800 milionë evropianëve në 47 shtete anëtare të Këshillit të Evropës, që e kanë ratifikuar konventën.

Numri i gjyqtarëve është i njëjtë me numrin e shteteve anëtare. Në fillim të themelimit të kësaj gjykate kanë qenë vetëm 7 shtete, ndërsa sot përbëhet gjithsej nga 47 shtete, dhe është instrument kryesor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjyqtarët zgjidhen për një kohë prej 6 vjetësh, ata mund të rizgjidhen, por mandatet e gjysmës së gjyqtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë mbarojnë në fund të tre vjetëve. Në secilin rast merrë pjesë edhe një gjyqtarë vendorë me qëllim të lehtësimit të kuptimit të legjislacionit vendorë. Secili gjyqtarë, i emëruar vepron në kapacitetin e tij/saj personal.

Kushtet të cilat duhet të plotësohen për t`ia adresuar një çështje Gjykatës së Strasburgut janë:

- Shkelja e një të drejte të mbrojtur me KEDNJ dhe protokollet e saj.
- Parashtruesi(t) të jetë (janë) viktimë e asaj shkelje.
- Ankesa të bëhet brenda afatit kohor më të shkurtër se gjashtë muaj pas përdorimit të plotë të mjeteve vendore.

Në qoftëse rasti konsiderohet i pranueshëm, dhoma e përbërë nga 7 gjyqtarë vendos mbi bazën e rastit. Aktvendimi i tyre lidhur me atë nëse rasti konsiderohet veçanërisht i rëndësishëm ose paraqet ndonjë risi për juridiksionin ekzistues, është final, me ç'rast dhoma e madhe prej 17 (shtatëmbëdhjetë) gjyqtarësh shqyrton kërkesën.

Aktgjykimet janë të detyrueshme dhe gjithashtu mund të ofrojnë kompensim të dëmeve. Implementimi i aktgjykimeve është detyrë e Komitetit të Ministrave, i cili bën mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve të gjykatës. Mirëpo problem kryesor i kësaj gjykate është numri shumë i madh i ankesave, i cili është rritur shumë viteve të fundit duke rezultuar në mbingarkesën e sistemit.

6. Përfundimi

Mos diskriminimi është njëra prej fushave më të rëndësishme dhe më dinamike nga praktika juridike për shkak se ndryshe nga shumë traktate të tjera për të Drejtat e Njeriut, konventa nuk e ndalon diskriminimin në ushtrimin – gëzimin e të drejtave të tjera të garantuara me traktatin në fjalë, por e bën lirinë nga diskriminim si të drejtë njerëzore në vetvete. Kjo është njëra nga arsyet pse procedura sipas Protokollit Fakultativ ka mbetur tërheqëse edhe për personat që janë në jurisdiksionin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas së cilës shkelja për mos diskriminimin mund të konstatohet vetëm kur diskriminimi kryhet në lidhje me gëzimin e ndonjë të drejte të mbrojtur me këtë Konventë.

Bibliografia

- WHO- training curriculum gender rights in reproductive health
- Europian Convention on Human Rights- Cases, materials and commentary- Prof. Alaistar Mowbray (Prof.of Public Laë, University of Nottingham), article 14- Prohibition of Discrimination, page 815.
- CEDAW- Convention the elimination of all forms of discrimination against women, art.11
- www.un.org/women
- www.healthorganization.com
- www.etc-graz.at
- Rastet kryesore të Komitetit për të Drejtat e Njeriut përmbledhur nga Raija Hanski dhe Martin Scheinin
- Kushtetuta e Repulikës së Kosovës
- Ligji kundër diskriminimit Ligji Nr.2004/ 3
- Ligji i punës Ligji Nr. 03/L-212

Mustaf Tahiri* **Ilir Bytyqi***

MASAT E FSHEHTA

TEKNIKE TË HETIMIT DHE VËZHGIMIT

ABSTRAKT

Një hyrje e shkurtë rreth institutit procedural juridik të masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, ku vihen në pah ekzekutimi i këtyre masave para ose pas autorizimit të hetimeve penale, pavarësisht se a dihet emri i të dyshuarit apo jo. Këtu kemi përmendur edhe llojet masave të fshehta teknike të hetimit dhe të vëzhgimit, ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe mënyra e përdorimit dhe rregullimit të masave të fshehta dhe teknike të hetimit, përmbajtjen e kërkesës dhe procedurat për lëshimin e urdhrit për masa të fshehta, të drejtat e personave ndaj të cilëve zbatohen urdhëresa për masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, për pranueshmërinë e provave të siguruara me anë të urdhrit për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, Panelin për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit si dhe për organet tjera të cilat ndihmojnë në zbatimin e këtyre masave.

Fjalet kyçe: Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit**,** Hetimet**,** Prokurori i Shtetit**,** Gjyqtari i Procedurës Paraprake**,** Kërkesa e prokurorit per masa te fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, Urdhëresa e gjyqtarit për masa të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit

Hyrje

Në kapitullin e IX të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës janë përfshirë masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit. Shikuar nga aspekti i rregullimit procedural, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit janë relativisht të reja. Arsyeja e hartimit të këtyre dispozitave, sikurse e dispozitave lidhur me mbrojtjen e të dëmtuarve, të dëshmitarëve si dhe dëshmitarëve bashkëpunues qëndron në domosdoshmërinë shoqërore për shtimin e efikasitetit procedural në luftimin e kriminalitetit të rëndë, të krimit të organizuar dhe të korrupsionit.[149] Duke pasur parasysh nevojën për parandalimin dhe luftimin e krimit në Kosovë, dhe me qëllim të përmirësimit dhe efektivitetit të hetimeve penale, këto masa për herë të parë në Kosovë kanë filluar të aplikohen me rregulloren UNMIK RREG/2002/6 të datës 18 mars 2002. Pastaj është

* Mustafë Tahiri, kandidat për gjyqtar
* Ilir Bytyqi, kandidat për prokuror
[149] Dr.Ejup Sahiti dhe Dr.Rexhep Murati, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013, faqe 211

vazhduar me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës UNMIK/RREG/2003/26 të datës 6 korrik 2003, dhe tash së fundi edhe me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës nr. 04/L-123 i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar të 2013.

1. Llojet e masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës nr. 04/L-123 parashihen këto masa të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit:

1. Fotografim të fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike,
2. Monitorim të fshehtë të bisedave në vende publike,
3. Hetim të fshehtë,
4. Regjistrimi i bisedave telefonike,
5. Fotografim të fshehtë ose vëzhgim me video në vende private,
6. Monitorim të fshehtë të bisedave në vende private,
7. Kontrollim të dërgesave postare,
8. Përgjim të telekomunikimeve, përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet e tjera elektronike,
9. Përgjim të komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik,
10. Dërgim i kontrolluar të dërgesave postare,
11. Shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes,
12. Blerje të simuluar të ndonjë sendi,
13. Simulim të ndonjë vepre të korrupsionit ose
14. Zbulim i të dhënave financiare.

Natyrisht se me aplikimin e masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit ndërhyhet, apo cenohen të drejtat dhe liritë e njeriut si kategori kushtetuese e sidomos e drejta e privatësisë së personave. Prandaj me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës në kapitullin e IX janë paraparë kushtet, metodat dhe mënyrat e përdorimit të urdhrit dhe zbatimit të masave. Çdo cenim i këtyre dispozitave të procedurës penale paraqet cenim të drejtave individuale, private dhe personale të parapara me kushtetutën e Republikës së Kosovës, konventa dhe instrumente tjera ndërkombëtare.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 36 |E Drejta e Privatësisë| paragrafi 1 parshehë që: "*Çdokush gëzon të drejtën që t`i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespodencës, telefonisë dhe e komunikimeve tjera*" ndërsa paragrafi 2 i këtij neni parasheh: "*Kontrollet e cilësdo banesë ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domososhme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas një shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj…*"

E drejta e privatësisë përfshinë në vete disa të drejta të tjera, në pikëpamje të të cilave Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 12) dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe

Politike (neni 17) parashikojnë "Askush nuk bën t`i ekspozohet ndërhyrjes arbitrare dhe të paligjshme në jetën private, familje, banesë apo letërkëmbim…".[150]

Po ashtu edhe Kodi Penal i Kosovës në kapitullin e XVII te veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, e ka përcaktuar si vepër të posaçme penale "*shkelja e urdhrave për masat e fshehura ose teknike të vëzhgimit ose hetimit, neni 206 i KPK-së".* Inkriminimi i kësaj vepre penale është paraparë për shkak të mos keqpërdorimit të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, pra si objekt mbrojtës i kësaj vepre penale janë kushtet dhe zbatimi i këtyre masave.

Sipas nenit 88 paragrafit 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit mund të urdhërohen kundër një personi apo vendi të caktuar, nëse:

Pika 1.1. Ekziston dyshimi i bazuar se vendi është përdorur ose personi i tillë ka kryer vepra penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ose ka tentuar të kryej vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare (tentativa për kryerjen e veprës penale është e ndëshkueshme) dhe

Pika 1.2. Informacioni i cili mund të merret nga masat e urdhëruara ka gjasë të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa te tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi te paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit mund të urdhërohen ndaj të dyshuarve për vepra penale të dënueshme me 5 (pesë) ose më shumë vjet burgim ose ndaj atyre të dyshuarve që dyshohen se kanë kryer një apo me shumë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 90 paragrafi 1 pika 1.2 të këtij kodi.

Të gjitha provat e siguruara nga Prokurori i Shtetit, para ose gjatë zbatimit formal të hetimit me aplikimin e masave të fshehta të cilat ligjërisht janë urdhëruar sipas nenit 88 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor, pa marrë parasysh nëse janë apo jo të përfshira në aktakuzë për veprat penale të cekura në nenin 90 të KPPK-së.

Sipas nenit 91 paragrafi 2, është përcaktuar se kompetentë për lëshimin e masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit është Gjyqtari i procedurës paraprake, i cili me kërkesën e prokurorit të shtetit mund të urdhërojë zbatimin e këtyre masave. Përjashtimisht paragrafi 1 i këtij neni, ka paraparë se prokurori i shtetit në raste urgjente të ngutshme mund të urdhërojë njërën nga masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit. Gjithashtu në procedura penale të cilat janë duke u hetuar nën kapitullin XXIV (krimi i organizuar) ose kapitullin XXXIV (korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare) të Kodit Penal të Kosovës dhe rasteve të shpëlarjes së parasë, nëse pritja e lëshimit të urdhrit nga gjyqtari i procedurës paraprake do ta rrezikonte sigurinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e palës së dëmtuar, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre. Urdhri i tillë i përkohshëm i lëshuar nga prokurori i shtetit pushon të ketë efekt nëse nuk konfirmohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda 3 (tre) ditëve nga data e lëshimit të tij. Kjo është një risi në Kodin

[150] Prof.Dr. Enver Hasani / Prof.Dr.Ivan Cukalovic, Komentar Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Botimi 1.

e ri të Procedurës Penale të Kosovës në krahasim me Kodin e vjetër të KPPPK-së ku sipas nenit 258 paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 4 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, prokurori publik kishte autorizim për të urdhëruar këto masa:

1. Fotografimin e fshehtë ose vëzhgimin me video në vende publike, 2. Monitorimin të fshehtë të bisedave në vende publike, 3. Hetim të fshehtë dhe 4. Regjistrim të bisedave telefonike.

Ndërsa masat tjera si 1. Fotografim të fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike, 2. Monitorim të fshehtë të bisedave në vende private, 3. Kontrollim të dërgesave postare, 4. Përgjim të telekomunikimeve, 5. Përgjim të komunikimeve nga rrjeti kompjuterik, 6. Dërgim të kontrolluar të dërgesave postare, 7. Shfrytëzimin e përcjelljes ose vendosjes së mjeteve të përgjimit, 8. Blerje të simuluar të ndonjë sendi, 9. Simulim të një vepre të korrupsionit dhe 10. Zbulim të të dhënave financiare, janë urdhëruar nga Gjyqtari i procedurës paraprake me kërkesën e prokurorit publik.[151]

2. Personat ndaj të cilëve mund të zbatohen masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

I. *Vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video, monitorimi i fshehtë i bisedave në vende publike, regjistrimi i thirrjeve telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare:* mund të urdhërohet kundër një personi apo vendi të caktuar, nëse:

a. ekziston dyshimi i bazuar se vendi është përdorur ose personi i tillë ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ose në rastet kur tentativa është e ndëshkueshme, ka tentuar të kryejë vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare; dhe

b. informacioni i cili mund të merret nga masat e urdhëruara ka gjasë të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

II. *Regjistrimi i bisedave telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare* po ashtu mund të urdhërohet kur ekziston dyshimi i bazuar se:

a. personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit apo që merr pjesë në transaksionet financiare të të dyshuarit; ose
b. i dyshuari përdor telefonin e personit të tillë.

III. *Monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, ndërhyrja e komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, blerja e*

[151] Neni 258 i Kodit të përkohshëm i procedurës penale të Kosovës *UNMIK/RREG/2003/26*

simuluar e ndonjë sendi, simulimi i një vepre të korrupsionit apo hetimi i fshehtë mund të urdhërohen kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse:

a. ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë vepër penale nga neni 90 i KPPK-së;
b. informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

IV. *Kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve ose përgjimi i komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik* po ashtu mund të urdhërohen kundër personit, përpos të dyshuarit, kur ekziston dyshim i bazuar se:

a. personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit; ose
b. i dyshuari përdor telefonin e personit të tillë ose ka qasje në sistem kompjuterik.

3. Përmbajtja e kërkesës dhe procedurat për lëshimin e urdhrit për masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

Kërkesa e prokurorit të shtetit për lëshimin e ndonjërës nga masat e fshehta duhet bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë këto të dhëna:

a. Identitetin e zyrtarit të autorizuar policor, zyrtarit të organit të autorizuar për ta zbatuar ligjin penal ose prokurorit të shtetit që e bën kërkesën,
b. Emërtimi zyrtar i masës dhe baza ligjore e saj,
c. Arsyet dhe faktet që mbështesin kërkesën dhe përmbushin kushtet nga nenin 88 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe
d. Të dhënat lidhur me çfarëdo kërkese paraprake të njohur për paraqitësin e kërkesës që ka të bëjë personin e njëjtë dhe veprimet e ndërmara nga zyrtari i autorizuar gjyqësor lidhur me kërkesën e tillë.

Urdhëresa e gjyqtarit të procedrës paraprake për zbatimin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit përmban:

a. Emrin dhe adresën e personit ose personave të dyshuar që i nënshtrohen urdhrit, nëse dihet numri i personave të prekur nga të dhënat dhe vendi i ngjarjes,
b. Emërtimi zyrtar i masës dhe baza ligjore e saktë e saj,
c. Në veçanti gjetjet e tanishme dhe gjasat reale[152],
d. Masa dhe koha e saktë e fillimit dhe e përfundimit të saj nëse zbatohet dhe

[152] Sipas nenin 19 par.1 nënparagrafi 1.11 shprehja **"gjasa reale"** nënkupton – baza për urdhër kontroll ose për të justifikuar ndërhyrjen e qeverisë në privatësinë e ndonjë personi. Posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka gjasë të konsiderueshme të ketë kryer veprën penale.

e. Personin e autorizuar për zbatimin e masës dhe zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të tillë.

Urdhëresa e lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake për ndonjërën nga masat nuk duhet të kaloj periudhën kohore prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e lëshimit të urdhrit, dhe për të njëjtën masë nga zyrtari i autorizuar i policisë kërkohet të paraqesë raport gjyqtarit mbi zbatimin e urdhëresës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e lëshimit të urdhëresës.

Urdhëresa për masat e përgjimit të telekomunikimeve, përgjimin e komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, regjistrimin e thirrjeve telefonike, kontrollin e dërgesave postare, dërgimin e kontrolluar të dërgesave postare, ose zbulimin e të dhënave financiare, duhet të përfshijë si shtesë udhëzimin e veçantë me shkrim për personat përgjegjës për punën me telekomunikime ose shërbime postare dhe punonjësit përgjegjës në institucionin finaciar të cilët janë të obliguar të lehtësojnë zbatimin e urdhëresës nën mbikëqyrjen e këtyre personave përgjegjës të institucioneve përkatëse. Udhëzimi i tillë me shkrim i dërgohet drejtorit ose zyrtarit përgjegjës të sistemit të telekomunikimeve, rrjetit kompjuterik, shërbimit postar, bankës apo institucioneve tjera financiare dhe duhet të përmbajë vetëm informacione për ndihmë në zbatimin e urdhëresës.

Urdhëresa për masa të fshehta nuk mundë të zgjatet, përveç nëse parakushtet sipas nenit 88 të KPPK-së vazhdojnë të vlejnë ende dhe ka shpjegim të arsyeshëm për dështimin në sigurimin e disa të dhënave apo të të gjitha të dhënave të kërkuara sipas urdhrit të mëparshëm. Urdhëresa për vëzhgim të fshehtë fotografik ose me video në vende publike, monitorim të fshehtë të bisedave, kontroll të dërgesave postare, përgjim të komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, dërgim i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, hetim të fshehtë, regjistrim të thirrjeve telefonike ose zbulim i të dhënave financiare mund të zgjatet më së shumti deri në 60 (gjatëdhjetë) ditë, e cila urdhëresë mund te ripërtërihet brenda një afati prej 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e lëshimit të urdhëresës.

Urdhri për vëzhgim të fshehtë fotografik ose me video në vende private apo përgjim i telekomunikimeve mund të zgjatet deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë, por mund të ripërtërihet edhe për 60 (gjashtëdhjetë) ditë tjera.

Urdhri për blerje të simuluar të sendit ose për simulim të veprës se korrupsionit autorizohet vetëm për një blerje të sendit ose për një vepër të simuluar të korrupsionit, d.m.th. nëse gjatë zbatimit të kësaj mase dështon dhe nuk ka sukses, atëherë duhet që të lëshohet urdhëresë e re siç parashihet në nenin 88 të KPPK-së dhe ka shpjegim të arsyeshëm për dështimin.

4. Pezullimi i zbatimit të urdhëresave dhe materialet e siguruara me masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

Zyrtari i autorizuar gjyqësor në çdo kohë mund ta pushojë urdhëresën kur çmon se parakushtet për urdhërimin e masës siç janë paraparë me nenin 88 të KPPK-së pushojnë të vlejnë, p.sh informata për të cilën arsye është lëshuar masa tani mund të merret me ndonjë veprim tjeter

procedural. Vazhdimi i urdhrit për masën e urdhëruar nga gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërohet vetëm me propozim të prokurorit të shtetit.

Pasi të përfundojë zbatimi i masës sipas urdhëresës së gjyqtarit të procedurës paraprake, zyrtari i autorizuar i policisë duhet t`ia dërgojë prokurorit të shtetit të gjitha materialet e mbledhura, shkresat, shiritat dhe sendet tjera të mbledhura me urdhërin dhe zbatimin e tij.

Materialet e mbledhura mund të mbyllën dhe të mbahen në fshehtësi nëse prokurori i shtetit konsideron që qasja dhe bërja publike e tyre do ta pengonte hetimin ose do të paraqes rrezik për të dëmtuarin, dëshmitarët hetuesit apo personave tjerë. Po ashtu gjyqtari i procedurës paraprake me kërkesën e prokurorit të shtetit mund të urdhëroj që për të njëjtat arsye edhe personit ndaj të cilit është zbatuar masa ti ndalohet qasja në materialet dhe sendet e mbledhura me anë të masave të fshehta. Ndërsa dërgesat postare të cilat nuk përmbajnë të dhëna që do ta ndihmonin hetimin e një vepre penale menjëherë duhet dërguar marrësit të dërgesës.

5. Të drejtat e personave ndaj të cilëve zbatohen urdhëresa për masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

Me dispozitat e nenit 96 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës është përcaktuar se personat ndaj të cilëve janë zbatuar masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit nga neni 86 e deri neni 100 të këtij kodi duhet të informohen. Kjo do të thotë që përveç personave që janë synuar duhet të informohen edhe personat tjerë që janë prekur ndjeshëm me këtë. Kjo vjen në shprehje me rastin e e zbatimit të nenit 87 nën-paragrafet 1.1 dhe 1.7 i KPPK-së vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video dhe shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjës. Po ashtu me rastin e nenit 87 nënpar.1.2 të KPPK-së nësë ka pasur monitorim të fshehtë të bisedave në vende private, përveç personave të synuar duhet të informohen edhe personat tjerë që janë prekur në mënyrë të ndjeshme d.m.th. personat tjerë që kanë qenë nën vëzhgim, personat që kanë poseduar ose jetuar ne lokale private në kohën kur masa ka hyrë në fuqi.

Në rastin e zbatimit të masës nga neni 87 nënpar 1.3 të KPPK-së - kontrollimi i dërgesave postare, duhet informohet edhe dërguesi e edhe i adresuari i dërgesës postare, ndërsa në rastin e zbatimit të masës nga neni 87 nënpar 1.10 - hetimi i fshehtë, duhet të informohet personi i synuar dhe personat e prekur ndjeshëm në këtë mënyre, ky njoftim përjashtohet kur interesat thelbësore të një personi të prekur i cili meriton mbrojtjen përbejnë pengesë me këtë.

Njoftimi konform nenit 96 par.5 të KPPK-së bëhet sa me shpejt që mund të fuqizohet pa e rrezikuar qëllimin e hetimit, jetën, integritetin fizik dhe lirinë personale të tjetrit ose pasuritë e rëndësishme. Nëse njoftimi vonohet arsyet dokumentohen në dosje. Njoftimi duhet të bëhet brenda 12 muajve pas përmbushjes së masës dhe se çdo vonesë tjetër e njoftimit duhet ti nënshtrohet miratimit të gjykatës e cila vendos për kohëzgjatjen e vonesave tjera. Nëse disa masa janë zbatuar brenda një periudhe kohore, afati kohor fillon pas përfundimit të masës së fundit i cili do të jetë 6 (gjashtë) muaj.

Vendimet gjyqësore merren nga gjykata kompetente për ta urdhëruar masën, rastet tjera Gjykata e cila shtrihet në vendin ku gjendet edhe zyra e prokurorisë së shtetit do të jetë

kompetente. Pas përfundimit të masës deri në 2 (dy) javë pas njoftimit personat vijues të cilët janë prekur me zbatimin e masave mund të paraqesin kërkesë në gjykatën kompetente për rishikimin e ligjshmërisë së masës si dhe mënyrën dhe zbatimin e saj. Një ankesë e menjëhershme eshtë e pranueshme. Nëse akuzat publike janë parashtruar dhe se personi i akuzuar është njoftuar, gjykata që ka marrë rastin vendos për kërkesën në vendimin e saj përfundimtar. Të gjitha të dhënat personale të marra me anë të masës e cila nuk është e nevojshme për qëllimin e ndjekjes penale fshihen pa ndonjë vonesë. Prokurori i shtetit duhet ta njoftojë me përpikëri me shkrim me anë të postës rekomande çdo person të ndonjë urdhri, në pajtim me nenin 4 të KPPK-së, nëse ai ose ajo ka qenë subjekt i atij urdhri dhe se ka të drejtë të paraqesë padi në gjykatën kompetente brenda 6 (gjatë) muajve nga data e njoftimit.

6. Pranueshmëria e provave të siguruara me anë të urdhrit për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit

Të gjitha provat e mara nëpërmjet masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit janë të papranueshme nëse urdhri për masën dhe zbatimin e saj është i kundërligjshëm. Pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues vlerëson kundërshtimet e të pandehurit lidhur me pranueshmërinë e provave të mbledhura, nëse kundërshtimi paraqitet para shqyrtimit të dytë gjyqësor dhe kundër këtij vendimi mbi kundërshtimin mund të paraqitet ankesë.

Në çdo kohë, para se aktgjykimi të marrë formë të prerë, gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues, sipas detyrës zyrtare mund ta shqyrtojë pranueshmërinë e materialeve të mbledhura nga neni 88 i KPPK-së për shkelje të të drejtave Kushtetuese të të pandehurit nëse ka indikacione se materialet janë mbledhur në mënyrë të kundërligjshme. Kur aktvendimi për paligjshmërinë e urdhrit ose të zbatimit të tij merr formën e prerë, gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues i cili drejton procedurën heq tërë materialin e mbledhur nga procesverbali dhe materialet e tilla konform nenit 97 par.5 të KPPK-së ia dërgon Panelit për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit nëpërmjet kryetarit të gjykatës themelore për vendimin mbi kompensim.

Kur një person konsideron se i është nënshtruar një mase të kundërligjshme sipas kapitullit për masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit apo një urdhri të kundërligjshëm për një masë nga ky kapitull, ai mund të paraqesë ankesë te kryetari i gjykatës themelore, i cili, nëse pretendohet ndonjë shkelje e ligjit, emëron Panelin për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit për të vendosur lidhur me këto pretendime të palës.

Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit duhet të:

- Marrë vendimin mbi ankesën e ushtruar sipas nenit 98 par.5 te KPPK-së, lidhur me masën ose urdhrin për masën sipas këtij kapitulli dhe të vendos për kompensimin përkatës, ose
- Vendos mbi kompensimin për personin ose personat që i nënshtrohen urdhrit sipas këtij kapitulli kur gjyqtari ka marrë aktvendim të formës së prerë sipas nenit 97 paragrafi 3 i KPPK-së se urdhri ose zbatimi i tijë është i kundërligjshëm.

Paneli për shqyrtimin e vëzhgimit dhe hetimit përbëhet nga tre gjyqtarë të cilët i emëron kryetari i gjykatës themelore për të vendosur mbi ankimin konkret ose kompensimin ndaj aktvendimit konkret nga neni 97 par.3. Asnjëri prej tre anëtarëve të panelit për Shqyrtimin dhe Vëzhgimin e Hetimit nuk duhet të jetë profesionalisht i lidhur me personin që i nënshtrohet ankesës ose me materialet e mbledhura që i nënshtrohen aktvendimit nga neni 97 par.3 të KPPK-së. Zyrtarët e policisë dhe prokurori i shtetit i sigurojnë këtij paneli dokumente të cilat ky panel i kërkon për kryerjen e funksioneve të tij dhe sipas kërkesës i sigurojnë edhe deklarime gojore. Kur merr formën e prerë aktvendimi i gjyqtarit sipas të cilit urdhri është i kundërligjshëm, aktvendimi i tillë është detyrues per panelin.

Paneli për shqyrtimin e Vëzhgimit dhe hetimit me ratin e vendosjes mbi ankesën konstaton se masa është e kundërligjshme ose urdhëri për masën e tillë është i kundërligjshëm mund të vendos që:

1. ta pushoj urdhrin nëse ende është në fuqi,
2. të urdhëroj asgjësimin e materialeve të mbledhura dhe
3. të kompensojë personin ose personat që i janë nënshtruar urdhrit.

7. Ndihma nga organet tjera për zbatimin e masave

Me dispozitat e kodit të procedurës penale është përcaktuar se për zbatimin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, policia sipas nevojës mund të kërkojë ndihmën e organeve tjera përgjegjëse për zbatimin e ligjit, siç janë ndihma nga zyrtarët e shërbimeve doganore dhe shërbimeve tjera të ngjashme.

Bibliografia

- Sahiti, Ejup dhe Murati, Rexhep, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013
- Hasani, Enver dhe Cukalovic, Ivan, Komentar: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Botimi 1. Prishtinë, 2014.
- Udhëzues i shkurtër i Konventës për të drejtat e njeriut, Donna Gomien, edicioni i 3-të.
- Aktet juridike
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut 1966.
- Kodi i Procedurës Penale të Kosovës nr.04/L-123, Gazeta zyrtare nr.
- Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës UNMIK/RREG/2003/26
- Rregullorja nr.2002/6 mbi masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.04/L-082, Gazeta zyrtare nr. e Repubikës së Kosovës,
- Udhëzues i shkurtër i Konventës për të drejtat e njeriut, Donna Gomien, edicioni i 3-të, vendi dhe viti I botimit

Ma. Sc. Ilir Berisha*

MASAT PËR SIGURIMIN E KËRKESËPADISË

ABSTRAKT

Në këtë punim jam përpjekur që të shtjellojë masat për sigurimin e kërkesëpadisë, si institut i procedurës civile nëpërmes të cilave palëve të interesuara gjykata ju ofron mbrojtje juridike, atëherë kur nevojat e rastit e imponojnë që të veprohet me urgjencë.

Në përmbajtje të këtij punimi lexuesi mund të gjejë, hyrjen përmes të cilës është përpjekur që të jepet ideja dhe arsyeja e rregullimit të kësaj çështje si dhe situatat se kur një palë mund të kërkoj nga gjykata një mbrojtje gjyqësore përmes këtij instituti të së drejtës procedurale civile.

Pastaj është dhënë kuptimi i masave për sigurimin e kërkesëpadisë, kushteve ligjore nën të cilat gjykata mund të caktoj, dhe procedurën që duhet ndjekur me rastin e caktimit të saj.

Në përfundim të këtij punimi janë shkoqitur disa çështje të cilat konsiderohet se janë esenciale për këtë institut të së drejtës procedurale civile, dispozitat e të cilit përbëjnë risitë në Ligjin e Procedurës Kontestimore,

Hyrje

E drejta e pronës është e garantuar.[153] Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë ta gëzoj pasurinë e tij në mënyrë paqësore. Askush nuk duhet të privohet nga pasuria e tij, përveç kur kjo bëhet për interesin publik dhe në përputhje me kushtet e parashikuara me ligj dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.[154] Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.[155] Pronësia është e drejta e tërësishme në një send.

---

* Ilir Berisha, kandidat për gjyqtar

[153] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 9 prill 2008, e cila ka hyrë në fuqi me 15 qershor 2008, neni 46 (mbrojtja e pronës).

[154] Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, miratuar me 4 nëntor 1950 në Romë, Protokolli nr.1 miratuar me 20 mars 1952 në Paris, neni 1., e cila në bazë të nenit 22 të Kushtetutës, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

[155] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 9 prill 2008, e cila ka hyrë në fuqi me 15 qershor 2008, neni 54 (mbrojtja gjyqësore e të drejtave).

Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti.[156]

Është filluar kështu me hyrjen në këtë punim duke cituar disa prej rregullave sistemore të mbrojtjes së pronës në rendin tonë juridik, për ti dhënë idenë lexuesit për arsyen e nxjerrjes së këtyre normave juridike, sepse jo rrallë here e drejta e pronës si kategori kushtetuese bëhet pre e cenimit të saj nga ana e subjekteve të ndryshëm të së drejtës.

Andaj, për mbrojtjen e të drejtave pronësore ligjdhënësi ka nxjerr dispozita përkatëse, të cilat shprehin rrugën të cilën duhet ndjekur palët e interesuara për të siguruar mbrojtjen e nevojshme gjyqësore duke miratuar Ligjin e procedurës kontestimore nr.03/L-006 (më tutje LPK).[157]

Me këtë ligj përveç dispozitave të përgjithshme të zhvillimit të procedurës së rregullt kontestimore, ai përmban një kapitull të veçantë nga neni 296 deri në nenin 318, me të cilat rregullohet sigurimi i kërkesëpadisë në rastet kur palët e interesuara kërkojnë mbrojtje të ngutshme gjyqësore (procedurë sumare).

1. Kuptimi i masës për sigurimin e kërkesëpadisë

Gjykata u jep subjekteve të së drejtës mbrojtje juridike edhe në situatat në të cilat ekziston rreziku, se zbatimi i sanksionit juridik civil nuk do të jep rezultatin e duhur. Me fjalë të tjera, ajo jepet në rastet kur ka gjasa se e drejta subjektive civile nuk do të realizohet përkundër zbatimit të forcës nga organi kompetent. Në rastet e tilla mbrojtja juridike qëndron në caktimin e masave siguruese të parapara me dispozitat e LPK-së. Kur plotësohen rrethanat e caktuara me ligj, masat e përmendura mund të shqiptohen jo vetëm gjatë zhvillimit të procesit kontestimor, por edhe para vënies së saj në veprim. Mirëpo, edhe pse kemi të bëjmë me dhënien e mbrojtjes juridike, duhet theksuar se ajo ka karakter të përkohshëm. Ajo zgjatë derisa gjykata në procedurën kontestimore ta jap vendimin me të cilin e refuzon si të pathemeltë kërkesën për mbrojtje juridike, apo derisa të mos e realizojë kreditori kredinë e tij ndaj debitorit.[158]

Realizimi faktik i të drejtave subjektive private merr zakonisht kohë relativisht të gjatë. Kjo për faktin, se për realizimin e një të drejte subjektive civile duhet parimisht të zhvillohet procedura e rregullt, në të cilën konstatohet e drejta subjektive private. Dhe tek pas kësaj procedure, do të duhej të zhvillohej procedura e realizimit faktik të së drejtës subjektive private (procedura përmbarimore). Pra, deri te realizimi faktik i së drejtës subjektive private kalon kohë e gjatë, në të cilën pala e pandërgjegjshme dhe i cili nuk ka vullnet për ta përmbushur prestimin në mënyrë vullnetare mund të përdorë metoda të ndryshme për të vështirësuar,

[156] Ligj për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore nr.03/L-154, publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 4 korrik 2009, neni 18 (pronësia).

[157] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë nr. 38, e datës 20 shtator 2008 Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, Shpallur me dekretin nr. DL-045-2008, datë 29.07.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu., i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin mbi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit të procedurës kontestimore nr. 04/L-118, me datë 13 shtator 2012.

[158] Dr. Brestovci, Faik, E drejta procedurale civile I, Prishtinë 2004, fq.13.

mënjanuar ose privuar nga mundësia e realizimit të paditësit-kreditorit për të realizuar të drejtën e tij subjektive. Për këtë arsye janë paraparë rregulla të ndryshme të cilat i mundësojnë paditësit-kreditorit sigurimin e kërkesës së tij.[159]

Më kërkesën-propozimin e paditësit, gjykata lejon marrjen e masave për sigurimin e kërkesëpadisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Një kërkesë e këtillë lejohet në faza të ndryshme të zhvillimit të procedurës kontestimore, përkatësisht kërkesa për sigurimin e kërkesëpadisë mund të ushtrohet para ushtrimit të padisë, gjatë procedurës kontestimore, gjatë procedurës ankimore dhe pasi që aktgjykimi të ketë marrë formën e prerë. Për kërkesën për sigurimin e kërkesëpadisë vendos gjykata kompetente, varësisht se në cilën fazë të procedurës është ushtruar një kërkesë e tillë.

Sipas neni 296.1 dhe 2 të LPK-së, në mënyrë të qartë është përcaktuar kompetenca e gjykatës për të vendosur përkitazi me propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë. Pra, kompetente është vetëm gjykata e shkallës së parë dhe të dytë, e assesi edhe gjykata e nivelit të tretë, përkatësisht gjykata e cila vepron sipas mjeteve të jashtëzakonshme, nga se në kuptim të paragrafit 2 të nenit 296 të LPK-së, në mënyrë të qartë është përcaktuar që "pasi të jetë bërë i formës së prerë aktgjykimi mbi kërkesëpadinë, për propozimin e sigurimit vendos gjykata që do të ishte kompetente për të vendosje mbi kërkesëpadinë në shkallë të parë"

2. Baza juridike për caktimin e masës së sigurimit

Për të vendosur masën për sigurimin e kërkesëpadisë dispozitat e LPK-së, kërkojnë që të përmbushën në mënyrë kumulative dy kushte dhe atë:

- kur propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive dhe
- kur ekziston rreziku se pa caktimin e masës siguruese pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesëpadisë.[160]

Pra, gjykata mund të marr aktvendim mbi caktimin e masës së sigurimit:

- në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme, që do të thotë e argumenton me prova përkatëse kërkesën apo të drejtën subjektive të tij.
  (*lat.* ***fomus boni iuris*** *– probabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar – presupozimi i bazës së mjaftueshme ligjore).*[161]

- në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e kësaj mase do të pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesës.

---

[159] Dr. Morina, Iset, Komentar i Ligjit për Procedurën Kontesitimore, Botimi i parë, Prishtinë 2012, fq.541.
[160] Neni 297 par.1 i LPK-së.
[161] http://en.wikipedia.org/wiki/Periculum_in_mora, *fumus boni iuris* është një frazë latine, e përdorur në gjykatat evropiane, që do të thotë "prezumimin e baza të mjaftueshme ligjore" (fjalë për fjalë do të thotë "tymin e një të drejte të mirë"), ekzistenca e këtij supozimi duhet të shqyrtohet nga gjykata e cila do të vendosë në bazë të rezultateve të fakti të kryer.

(lat. ***periculum in mora*** *– rreziku i dëmtimit të pashmangshëm ndaj kësaj të drejtë).*[162]

Mirëpo, sot ekziston një debat në mesin e shkencëtarëve dhe praktikuesve të procedurës civile, sa i përket nocionit që është përdorur në kushtin e parë ligjorë i cili parasheh: "në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive".[163] Që marrja e vendimit nga ana e gjykatës për vendosjen e masës së sigurisë, a e prejudikon apo jo vendosjen për çështjen kryesore. Ata kanë argumentet e tyre pro dhe kontra kësaj çështje.

Profesori Iset Morina mendon se: "në këtë moment ende nuk mund të dihet dhe nuk guxon të prejudikohet, se cili është kreditori dhe cili është debitori, deri në shpalljen e vendimit meritor nga gjykata, ky është edhe parim i drejtësisë".[164]

Mënyrat e pamundësimit, vështrimit apo privimit nga realizimi i kërkesëpadisë janë të ndryshme, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Gjykata mund ta cakton masën e sigurimit nën kushtet që propozuesi i sigurimit, brenda afatit të caktuar nga gjykata, jep garanci në masën dhe llojin e caktuar nga gjykata për dëmin që mund t' i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit. Në të kundërtën nëse propozuesi i sigurimit nuk ofron në afatin e caktuar garancitë e kërkuara, gjykata mundë të refuzoj propozimin e sigurimit. Mirëpo, nëse propozuesi i sigurimit nuk ka mjete, me kërkesë të tij ai mund të lirohet nga detyrimi i dhënies së garancisë sikur që janë të liruar edhe Bashkësitë e Pushtetit Lokal.[165] Kjo garanci kthehet në afat prej 7 ditësh nga dita në të cilën shuhet masa e sigurimit.

Përmes kësaj dispozite ligjdhënësi synon që edhe ndaj kundërshtarit të sigurimit gjykata të jep mbrojtje. Sepse siç dihet me vendosjes e masës së sigurimit, mund të ndodhë që atij ti vështirësohet gjendja apo eventualisht nga kufizime të caktuara ai edhe të pësoj dëm eventual dhe në rast se kërkesëpadia rezulton të jetë e pabazuar me vendim të formës së prerë, atëherë atij i lind e drejta e shpërblimit të dëmit nga mjetet e garancisë.

Po ashtu kjo kërkesë ligjore, që propozuesi i masës së sigurimit të jap garanci që kundërshtari i sigurimit nuk do të pësoj dëm dhe në rast të pësimit të tij do ti shpërblehet dëmi eventual nga garancia e ofruar, konsiderojmë se propozimin e tij e bënë edhe më të besueshëm për gjykatën. Sepse askush më shumë se palët nuk e dinë të vërtetën rrethe objektit të kontestit edhe askush më shumë se propozuesi i masës së sigurimit nuk mund ta ndjejë rrezikun nga kundërshtari i sigurimit rreth objektit të kontestit. Andaj, gatishmëria e tij për ta ofruar (deponuar) garancinë,

---

[162] http://en.wikipedia.org/wiki/Periculum_in_mora, *periculum in mora*, latinisht për "rrezik në vonesë", është një nga dy kushtet të cilat duhet të pohohen në veprimet që kanë për qëllim marrjen e një urdhër mbrojtës apo vendim gjyqësor që do të jepet ndihma e kërkuar. Barra e provës së rrezikut në vonesë bie për personin që e propozon masën siguruese-mbrojtëse, duke demonstruar ekzistencën e dy kërkesave, njoftimin pericolum, dhe rrezikun e pësimit të dëmit serioze dhe të pariparueshme.
[163] Neni 296, paragrafi 1, pika a), i LPK-së.
[164] Dr. Morina, Iset, Komentar i Ligjit për Procedurën Kontesitimore, Botimi i parë, Prishtinë 2012, fq.543.
[165] Neni 297 i LPK-së.

tregon njëkohësisht besueshmërinë e kërkesës së tij dhe vendosmërinë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore për objektin e kërkesëpadisë së tij.

Lidhur me mënyrën e dhënies së garancisë, kjo dispozitë referon tek Ligji mbi procedurën përmbarimore. Sipas këtij ligji, në rastet në të cilat parashihet dhënia e garancionit, atëherë ai jepet në para të gatshme. Gjykata mund ta lejojë dhënien e garancionit në formë të garancionit bankar, letrave më vlerë, si dhe sende të çmueshme, vlera e të cilave lehtë caktohet në treg dhe që mund të shndërrohet shpejtë në të holla.

3. Llojet e masave për sigurimin e kërkesëpadisë

Ligji i procedurës kontestimore i rregullon por nuk është i kufizuar në tri format themelore të masave të sigurimit të kërkesëpadisë, gjë që nuk e kishte Ligji i procedurës kontestimore i vitit 1976 (ligji i vjetër). Në vazhdim të këtij punimi do ti paraqesim tri format kryesore të masave të sigurisë, si dhe llojet e tyre të cilat i mbulojnë mjaftë mirë kontestet nga marrëdhëniet juridike civile.

a) Sigurimi i kërkesës në të holla[166]

Për sigurimin e kërkesës në të holla, gjykata mund të caktojë këto masa të sigurimit dhe atë:

- ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që të tjetërsoj, fshehë, ngarkojë ose disponoi me pasurin e caktuar deri në vlerën e kërkesëpadisë;
- ruajtja e pasurisë nga vetë kundërshtari i sigurimit, propozuesi i sigurimit apo nga personi i tretë;
- Ndalimi i debitorit të kundërshtarit të sigurimit që këtij të fundit të i përmbushet kërkesa apo dorëzimi i sendit;
- konstatimi i të drejtës së pengut mbi sendin e paluajtshëm gjerë në vlerën e kërkesëpadisë.

Gjykata me aktvendim cakton masën e sigurimit e cila i dërgohet kundërshtarit të sigurimit apo debitorit të kundërshtarit të sigurimit e në raste të caktuara edhe regjistri publik, nëse ka të bëjë me një masë të këtillë, e cila konsiderohet e zbatuar në momentin e dorëzimit të aktvendimit.

b) Sigurimi i kërkesave në sendet e caktuara[167]

Për sigurimin e kërkesës së drejtuar sendit të caktuar apo një pjese të tij, nga gjykata mundë të caktohen këto masa:

- ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që të tjetërsoi, fshehë, ngarkojë apo disponojë me pasurinë ndaj të cilës është drejtuar kërkesa;
- ruajtja e pasurisë nga vetë kundërshtari i sigurimit, propozuesi i sigurimit, personi i tretë apo depozitimi në gjykatë;

[166] Neni 299 i LPK-së.
[167] Neni 300 i LPK-së.

- ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që të kryej veprime me të cilat mund të dëmtohet pjesa e pasurisë;
- autorizimi i propozuesit të sigurimit që të kryej aktivitete të caktuara mbi sendin e caktuar.

Masat e sigurimit nuk guxojnë në tërësi ta përfshijnë kërkesën që sigurohet përmes këtyre masave të sigurimit.

c) Sigurimi i të drejtave të tjera[168]

Për sigurimin e të drejtave tjera apo për ruajtjen e gjendjes ekzistuese të rrethanave mund të caktohen këto masa sigurimi dhe atë:

- ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që të kryej aktivitete të caktuara pa urdhër për kryerjen e aktiviteteve të tilla;
- autorizimi i propozuesit të sigurimit që të i ndërmarrë aktivitete të caktuara;
- lënda e pasurisë së caktuar të kundërshtarit të sigurimit për ruajtje dhe përkujdesje personit të tretë;
- masa të tjera si të domosdoshme për sigurimin e kërkesëpadisë.

Pas parashtrimit të ndalimit, e deri sa vendimi mbi lejimin e masës së sigurimit të jetë në fuqi, nuk është i mundur regjistrimi në regjistrat publik apo çfarëdo ndryshimi eventual, në të kundërtën do të i nënshtrohet përgjegjësisë sipas rregullave të së drejtës civile. Përndryshe, çfarëdo veprimi që do të ndërmerret derisa vendimi është në fuqi, nuk kanë efekt juridik.

Gjykata mund të lejoj sigurimin e kërkesëpadisë me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, për një vlerë apo send të caktuar, por jo më madhe se atë të kërkesëpadisë.

4. Propozimi i masës së sigurimit

Procedura për caktimin e masave për sigurimin e kërkesëpadisë fillon me paraqitjen e propozimit në formë të shkruar (parashtresë) dhe në formë gojore (gjatë rrjedhës së procedurës në seancë gjyqësore). Propozimi i paraqitur në formë të shkruar dhe gojore gjatë seancës gjyqësore duhet ti përmbajë të gjitha elementet e parapara me dispozitat e nenit 304 al.3 të LPK-së.[169]

Mirëpo, duke u mbështetur në faktin se propozimi i masës së sigurimit mund të paraqitet gjatë të gjitha fazave të zhvillimi të procedurës, ai mund të paraqitet edhe gojarisht gjatë seancës gjyqësore, por gjithherë duke dhënë arsye bindëse mbi bazën në të cilën mbështetet një propozim i tillë. Përveç kësaj në propozim duhet të jetë e qartë masa e sigurimit që propozohet, mjetet dhe objekti i kësaj mase.

Masën e sigurimit gjykata e cakton kryesisht, pasi të deklarohet për masën e propozuar kundërshtari i sigurimit, përveç në rastet kur kjo nuk është e mundur. Përkatësisht kur propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe

[168] Neni 301 i LPK-së.
[169] Sylejmani, Shukri, Procedura Kontestimore, Pjesa e dytë, Ligjërata të autorizuara nga Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë 2014.

urgjente dhe se çfarëdo shtyrje e humb qëllimin e saj. Për propozimin për caktimin e masës së sigurimit, kundërshtari i sigurimit ka të drejtë të paraqet përgjigje me shkrim në afat prej 7 ditësh.

5. Për masën e sigurimit veprohet me urgjencë

Gjykata ka mundësi që sipas propozimit të palës mund të nxjerrë aktvendim mbi caktimin e masës së përkohshme pa e marrë deklarimin e palës kundërshtare. Pala kundërshtare ka të drejtë që ta kundërshtojë atë brenda afatit prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit mbi masën e përkohshme, të japë përgjigje dhe të kundërshtoj arsyet për caktimin e saj. Ndërsa, gjykata pas pranimit të kësaj përgjigje ka për detyrë që brenda 3 ditësh ta caktojë seancën, ti ftojë palët, ti dëgjoj pretendimet e dy palëve dhe të nxjerrë aktvendim përkatësisht të vendosë mbi masën e sigurimit duke e aprovuar apo refuzuar propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë.[170]

Në të vërtetë, gjykata me aktvendim mbi caktimin e masës së sigurimit e përcakton llojin e masës, mjetet me të cilat ajo do të realizohet dhe objektin e masës së sigurimit, natyrisht duke i aplikuar rregullat e procedurës përmbarimore.

Pra, nga ajo që theksuam më lartë rezulton se gjykata ia dërgon aktvendimin gjykatës përmbarimore kompetente me qëllim të ekzekutimit të masës së sigurimit dhe regjistrimit të saj në Regjistrin e të drejtave në patundshmëri.

Nëse masa e sigurimit është caktuar para se të jetë ngritur padija, me vendim me të cilin është caktuar masa e sigurimit, caktohet edhe afati i cili nuk mund të jetë më i vogël se 30 ditë, brenda të cilit afat propozuesi i masës së sigurimit duhet të ushtrojë padi, ndërsa gjykatës duhet të i ofroi dëshmi nga të cilat provohet se ka vepruar sipas rekomandimeve të saj.[171]

Masa e sigurimit mbetet në fuqi deri sa mos të jepet vendim tjetër mbi nxjerrjen e saj jashtë fuqisë e më së largu në afat prej 30 ditësh pasi të jenë krijuar kushtet për ekzekutimin e detyrueshëm. E në rast të refuzimit të padisë mund të mbetet në fuqi deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit. Ndërkaq masën e sigurimit mbi regjistrat në librat publike gjykata e fshinë kryesisht.[172]

6. Mjetet juridike

Kundër vendimit mbi caktimin e masës së sigurimit është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit. Pala e kundërt në afat prej 3 ditësh nga pranimi i ankesës ka të drejtë të paraqes përgjigje në ankesë. Ndërkaq, gjykata e shkallës së dytë në afat prej 15 ditësh duhet të vendos mbi ankesën e paraqitur kundër aktvendimit mbi masën e sigurimit.

[170] Neni 306 i LPK-së.
[171] Neni 308 i LPK-së.
[172] Neni 309 i LPK-së.

Ankesa kundër aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit nuk e shtynë ekzekutimin e saj.[173]

Në kuptim të dispozitës së nenit 312, e në pajtim me kundërshtarin e sigurimit, në vend të caktimit të masës së sigurimit mund të themelohet e drejta e pengut mbi ndonjë send të caktuar.

7. Shpenzimet

Shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës siguruese paraprakisht i bartë propozuesi i sigurimit. Mirëpo, nëse në afatin e caktuar me aktvendim mbi caktimin e masës ës sigurimit, propozuesi i sigurimit nuk i përmbushë këto shpenzime, gjykata do të përfundoi procedurën dhe do të anulon veprimet e marra. Një vendim të këtillë gjykata do ta marr edhe atëherë kur rrethanat për shkak të cilave është caktuar masa e sigurisë kanë pushuar apo janë ndryshuar edhe e kanë bërë të panevojshme ekzistimin e mëtutjeshëm të saj. Sipas kundërshtarit të sigurimit gjykata e përfundon procedurën dhe anulon veprimet e kryera edhe atëherë kur:

- në gjykatë kundërshtari i sigurimit e deponon shumën e detyruar të kërkesës që sigurohet me kamatë dhe shpenzime,
- e bënë të besueshme së kërkesa është realizuar ose ka qenë e siguruar,
- me vendim të formës së prerë është vërtetuar se kërkesa nuk është krijuar apo se është shuar.

8. Shpërblimi i dëmit

Sikurse propozuesi i sigurimit po ashtu edhe kundërshtari i sigurimit kanë të drejtë sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës pasurore që të ju shpërblehet dëmi që u është shkaktuar me mosrespektimin e aktvendimit mbi masën e sigurimit apo nëse është konstatuar se aprovimi i masës së sigurimit ka qenë e pabazë apo e pa justifikuar. Këto kërkesa për shpërblim të dëmit parashkruhen në afat prej 1 viti, nga dita e mbarimit të efektit të aktvendimit me të cilin masa e sigurimit ka qenë e caktuar.

Masat për sigurimin e kërkesëpadisë, i zbaton gjykata që do të ishte kompetente për ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë.

9. Përfundim

- Instituti i masës së sigurimit në këtë version të cilin e ka sjellë Ligji i Procedurës Kontestimore është padyshim risi në mesin e shumë risive që ka sjellë ky ligj, për dallim nga ligji i vjetër i procedurës kontestimore 1977 (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr.4/77)i cili nuk e rregullonte këtë institut të procedurës civile. Mirëpo kjo fushë rregullohej me dispozitat e Ligjit të Procedurës së Përmbarimit 1978 (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr.20/78).

[173] Neni 310 i LPK-së.

- Ligji i Procedurës Kontestimore, përveç dispozitave të përgjithshme të zhvillimit të procedurës së rregullt kontestimore, ai përmban një kapitull të veçantë, me të cilat rregullohet sigurimi i kërkesëpadisë në rastet kur palët e interesuar kërkojnë mbrojtje të ngutshme gjyqësore (procedurë sumare).
- Masën për sigurimin e kërkesëpadisë e caktont nga gjykata, kur përmbushen në mënyrë kumulative dy kushte, kur propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive dhe kur ekziston rreziku se pa caktimin e masës siguruese pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesëpadisë.
- Caktimi i masës për sigurimin e kërkesëpadisë nga ana e gjykatës nuk mundet dhe nuk guxon ta prejudikoj përfundimin e çështjes kryesore, sepse përkundër faktit se gjykata cakton masën e sigurisë në favor të paditësit, ai mund ta humb kontestin.
- Në mes të masës së përkohshme dhe masës së sigurisë ekziston dallim thelbësor, sepse gjykata ka mundësi që sipas propozimit të palës mund të nxjerrë aktvendim mbi caktimin e masës së përkohshme pa e marrë deklarimin e palës kundërshtare. Pala kundërshtare ka të drejtë që ta kundërshtojë atë brenda afatit prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit mbi masën e përkohshme të japë përgjigje dhe ta kundërshtoj arsyet për caktimin e saj. Ndërsa, gjykata pas pranimit të kësaj përgjigje ka për detyrë që brenda 3 ditës ta caktojë seancën, ti ftojë palët, ti dëgjoj pretendimet e dy palëve dhe të nxjerrë aktvendim përkatësisht të vendosë mbi masën e sigurimit duke e aprovuar apo refuzuar propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë.
- Më qëllim që gjykatës ti krijoj hapësirë, sipas rrethanave të rastit konkret, ligjdhënësi i ka krijuar mundësi që në raste të caktuara të caktoj disa masa të sigurisë, që të arrihet qëllimi final, efikasiteti dhe funksionaliteti i sigurimit të kërkesëpadisë.

Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 9 prill 2008
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 4 nëntor 1950, Protokolli nr. 1, 20 mars 1952
- Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore nr. 03-L-154
- Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03-L-006
- Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit të Procedurës Kontestimore nr. 04/L-118
- Dr. Brestovci, Faik. E Drejta Procedurale Civile I, Prishtinë 2004
- Dr. Morina, Iset. Komentar i Ligjit për Procedurën Kontestimore, botimi i I, Prishtinë 2012

Fatos Ajvazi*

SHKAQET TË CILAT SJELLIN ZGJIDHJEN E MARTESËS ME ANULIM

ABSTRAKT

Në materien e këtij punimi, janë të sqaruara shkaqet të cilat shkaktojnë zgjidhjen e martesës me anulim, duke u fokusuar në shkaqe të cilat shkaktojnë anulimin absolut të martesës dhe të shkaqeve që shkaktojnë anulimin relativ të martesës. Fillimisht në këtë punim trajtohen shkaqet të cilat shkaktojnë anulimin absolut të martesës, duke u fokusuar në: martesën ekzistuese si shkak i anulimit absolut; dallimin e sekseve, ku është trajtuar edhe problemi i ndryshimit të gjinisë (seksit) nga individët; sëmundja psikike dhe paaftësia për të vepruar; gjinia si shkak i anulimit absolut, ku në këtë pjesë janë dhënë edhe dy tabela në të cilat në mënyrë grafike paraqiten shkallët e gjinisë së gjakut, si të asaj në vijë të drejtë, ashtu edhe asaj në vijë të tërthortë. Është trajtuar pastaj mituria deri në moshën 16 vjeqare si shkak i anulimit absolut; mos respektimi i procedurës për lidhje të martesës; mosrespektimi i kompetencës; si dhe ikja nga qëllimi i martesës, ku janë dhënë edhe shembuj të ikjes nga qëllimi i martesës. Më vonë janë sqaruar edhe shkaqet të cilat shkaktojnë anulimin relativ të martesës siç janq: mungesa e vullnetit për të lidhur martesë duke e sqaruar dhunën, kanosjes dhe lajthimin; miturinë nga mosha 16 deri 18 vjeçare; si dhe sëmundja psikike dhe paaftësia për të vepruar, duke e sqaruar se në cilat raste kjo paraqet shkak të anulimit relativ.

Fjalët kyçe: martesa,gjinia e gjakut,zgjidhja, anulimi,s hkaqet abolute, relative, gjinia, gjykata.

Hyrje

Çështja e lidhjes së martesave në kundërshtim me dispozitat ligjore është një çështje mjaft problematike dhe me pasoja të rënda, si për familjen, ashtu edhe për shoqërinë. Për shkak të lidhjes së martesave, me gjithë ekzistimin e pengesave martesore, kemi si pasojë një numër të madh të martesave të anuluara. Për fat të mirë, Kosova ka një traditë të mirë shekullore të martesave të qëndrueshme, që është trashëguar brez pas brezi. Kjo traditë ka ndikuar që Kosova të ketë martesa të shëndosha dhe një shoqëri të shëndoshë.

* Fatos Ajvazi, Master në shkencat juridiko –civile, kandidat për prokuror

Kjo traditë ka filluar të zbehet pas luftës së fundit në Kosovë. Jemi dëshmitarë të një numri të madh të martesave të zgjidhura me shkurorëzim, por edhe me anulim. Problem edhe më i madh është fakti kur në martesat absolute apo relative nule lindin fëmijë, e fëmijët janë ajo kategoria që më së shumti pësojnë nga këto martesa, që janë të lidhura në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Kosova, më 16 shkurt 2006, ka nxjerrë Ligjin për rregullimin e marrëdhënieve familjare dhe martesore, i cili në detaje i rregullon çështjet familjare dhe martesore. Kjo është edhe një bazë e fortë që martesa të tilla në kundërshtim me këtë ligj të mos lejohen të lidhen. Në këtë punim synohet të studiohen shkaqet që shpien në anulimin e martesave të tilla dhe të japim mendime e ide të reja lidhur me pengimin me kohë të lidhjes së martesave të tilla nga organet kompetente shtetërore.

Punimi, përveç pjesës hyrëse, përmban shkaqet e zgjidhjes së martesës me anulim, përfundimin, dhe literaturën e përdorur gjatë punimit.

Në hyrje kemi paraqitur çështjen e lidhjes së martesës në kundërshtim me dispozitat ligjore si dhe anulimi i tyre. Janë dhënë arsyet pse është objekt studimi pikërisht zgjidhja e martesës me anulim, shkaqet e zgjidhjes së martesës me anulim, duke përfshirë këtu anulimin absolut të martesës, pastaj shkaqet të cilat e bëjnë një martesë absolut nule, si dhe anulimin relativ të martesës dhe shkaqet të cilat e bëjnë këtë martesë relativisht nule. Gjithashtu është paraqitur metodologjia e punës që është përdorur në këtë punim

Arsyeshmëria e hulumtimit të zgjidhjes së martesës me anulim: Arsyet e hulumtimit të zgjidhjes së martesës me anulim qëndrojnë në faktin se kjo materie nuk është aq e trajtuar në literaturën juridike dhe nuk ka ndonjë punim të veçantë për këtë temë, të paktën në Kosovë. Arsye tjetër është se anulimi i martesës mund të ndodhë vetëm për shkaqe shprehimisht të parapara me dispozita ligjore. Me lidhjen e martesës në kundërshtim me dispozita ligjore shkelen interesat e përgjithshme shoqërore dhe të drejtën në padi e ka si prokurori publik, bashkëshortët dhe çdo person i interesuar.

Metodologjia e punës: Para se ta filloja punimin shkencor, së pari kam grumbulluar literaturën juridike, e cila është e ndryshme dhe i dedikohet përgjithësisht pavlefshmërisë së martesës dhe shkaqeve që shkaktojnë këtë pavlefshmëri.

1. Zgjidhja e martesës me anulim

Martesa ka një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e familjes. Bazë e krijimit të familjes është martesa, kurse bazë e krijimit të shoqërisë është familja, e bazë e krijimit të shtetit është shoqëria. Pra, shteti është ai institucion që kujdeset për krijimin e martesës e që me anë të normave ligjore përcakton kushtet të cilat duhet të plotësohen për lidhjen e martesës, në mënyrë që ajo martesë të jetë e vlefshme dhe të mos prodhojë pasoja negative në shoqëri. Në të kundërtën, lidhja e martesës pa iu përmbajtur normave ligjore, të cilat i përcakton shteti, martesa do të konsiderohet e pavlefshme (nule).

Quhet e pavlefshme një martesë e cila është lidhur pa u plotësuar kushtet e kërkuara në ligj për plotfuqishmërinë e saj.[174] Përveç sanksionit të natyrës juridike- familjare të anulimit të martesës, ligji ka paraparë edhe sanksione penale-juridike.[175] Kjo nënkupton se personat që kanë lidhur martesën (bashkëshortët), si dhe personat që kanë lejuar lidhjen e martesës (personat zyrtarë), në kundërshtim me kushtet e parapara me ligj, do të bartin, përveç pasojave juridike familjare, ata do të përgjigjen edhe penalisht për veprimet e tyre.

Anulimi i martesës është mënyrë gjyqësore e zgjidhjes së martesës së pavlefshme dhe trajtohet se martesa fare nuk është lidhur.[176] Kjo do të thotë se bashkëshortët, pas anulimit të martesës, nuk do të konsiderohen si të shkurorëzuar, por si persona që nuk kanë lidhur kurrë martesë dhe martesa do të konsiderohet si e paqenë (inekzistente), kurse bashkëshortët konsiderohen se fare nuk kanë pasur martesë të lidhur (beqarë)[177].

Deri në çastin e anulimit të saj, martesa shkakton njëlloj pasoja juridike sikurse martesa e vlefshme, edhe sa u përket fëmijëve (ata janë martesorë), edhe sa u përket bashkëshortëve (paraqiten pasojat sikurse është fjala për zgjidhje të martesës).[178]Këto do të trajtohen në mënyrë të veçantë kur të bëhet fjalë për efektet juridike të anulimit të martesës.

Shkaqet që e bëjnë një martesë si të pavlefshme, janë të parapara shprehimisht me ligj (nulla nullitas sine lege). Në teorinë juridike, si shkaqe të anulimit të martesës konsiderohen pengesat martesore. Pengesat martesore duhet të kenë ekzistuar përpara lidhjes së martesës ose, të paktën, në kohën e lidhjes së saj.[179]

Nga shkaqet që shkaktojnë anulimin e martesës, në teorinë juridike familjare ekzistojnë dy lloje të anulimit të martesës : anulimi absolut i martesës dhe anulimi relativ i martesës.

2. Shkaqet të cilat shkaktojnë anulimin absolut të martesës

Anulimi absolut i martesës ekziston atëherë kur ekzistojnë shkaqet të cilat sipas ligjit shkaktojnë nulitetin absolut të martesës.”[180] LFK nuk e parasheh në mënyrë të veçantë se cilat janë ato shkaqe që shkaktojnë pavlefshmëri absolute të lidhjes së martesës. Por, duke u bazuar në faktin se shkaqet të cilat shkaktojnë pavlefshmërinë e martesës, a janë të evitueshme apo të paevitueshme, atëherë edhe mund të konstatojmë se shkaqet të cilat shkaktojnë pavlefshmërinë absolute të martesës janë ato shkaqe, që nuk mund të evitohen (sanohen). Po qe se nuk respektohen kushtet e parapara në ligj për mbrojtjen e interesave të përgjithshme shoqërore, zbatohet sanksioni juridiko-familjar, martesa e lidhur shpallet nule absolute.[181] Nga kjo edhe mund të vijmë në konkludim se: nëse lidhet një martesë dhe nuk respektohen kushtet e parapara

[174] Hamdi Podvorica: “*E drejta familjare*”,Prishtin,2006, f.114.
[175] Po aty, f.114.
[176] Abdulla Aliu & Haxhi Gashi: *“ E drejta familjare*”, Prishtinë,2007, f. 150.
[177] http://family-law.lawyers.com/divorce/Can-This-Marriage-be-Annulled.html.
[178] Hamdi Podvorica: “*E drejta familjare*”,Prishtinë, 2006, f.114.
[179] Po aty, f.114.
[180] Abdulla Aliu & Haxhi Gashi: “*E drejta familjare*”,Prishtinë,2007, f.151.
[181] Hamdi Podvorica: “*E drejta familjare*”,Prishtinë, 2006, f.114.

me ligj, të cilat janë të paevitueshme dhe cenojnë interesin e përgjithshëm shoqëror, martesa është kundërligjore dhe duhet të anulohet.

Shkaqet e nulitetit absolut janë pengesa të parapara në ligj, por mund të jenë edhe fakte të tjera.[182] LFK, shkaqet të cilat shkaktojnë anulimin e martesës i parasheh në dispozitat e neneve nga 62 deri në nenin 67, por , siç e cekëm edhe më parë, nuk bën ndonjë specifikim se cilat shkaqe shkaktojnë nulitet absolut apo relativ. Shkaqet të cilat shkaktojnë nulitetin absolut të martesës janë:

a. martesa ekzistuese,
b. mosdallimi i sekseve,
c. sëmundjet psikike dhe paaftësia për të vepruar,
d. gjinia (e gjakut, krushqisë, adoptimit),
e. mituria, dh) mungesa e vullnetit për të lidhur martesë,
f. ikja nga qëllimi i martesës,
g. mosrespektimi i kompetencës së organit kompetent, dhe
h. mosrespektimi i procedurës për lidhjen e martesës.

2.1. Martesa ekzistuese si shkak i anulimit absolut të martesës

Çdo martesë e lidhur në kohën kur ka ekzistuar martesa e mëparshme e vlefshme, martesa e re do të konsiderohet nule. Kjo është paraparë shprehimisht edhe në nenin 62. paragrafi 1, të LFK-së, ku thuhet: "Martesa e lidhur në kohën e ekzistimit të martesës së mëparshme të njërit nga bashkëshortët është nule". Paragrafi 2, i po këtij neni, parasheh se martesa e re e lidhur në kohën e ekzistimit të martesës së mëparshme të njërit nga bashkëshortët nuk do të anulohet, nëse martesa e mëparshme është zgjidhur ndërkohë.

Nëpunësi i gjendjes civile ka për detyrë të vërtetojë nëse bashkëshortët e ardhshëm janë të lidhur me një martesë tjetër.[183] Këtë e bën me anë të certifikatës së lindjes, e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj.[184]

Janë disa raste kur martesa e re nuk anulohet. Së pari, nëse gjatë gjykimit për ta shpallur martesën e re të pavlefshme, bashkëshorti që ka qenë në lidhje martesore pretendon se martesa e mëhershme ka qenë nule, gjykata me këtë rast duhet së pari të shqyrtojë këtë pretendim të këtij bashkëshorti.[185] Një rast tjetër është kur martesa e parë ka pushuar për shkak të vdekjes së bashkëshortit të mëparshëm, ose është shpallur si i vdekur, martesa e dytë, edhe pse është lidhur para se të mbarojë martesa e parë, merr vlerën e një martese të ligjshme.[186] Mirëpo edhe nëse bashkëshorti që është shpallur i vdekur ndërkohë kthehet apo vërtetohet se është gjallë, martesa e dytë e bashkëshortit jetë e vlefshme.[187]

---

[182] Po aty, f.114.
[183] Po aty , f.82.
[184] Po aty. f.82.
[185] Valentina Zaqe: "Marrëdhënjet familjare sipas legjislacionit shqipëtar",Tiranë,1999, f.72.
[186] Valentina Zaqe: "Marrëdhënjet familjare sipas legjislacionit shqipëtar",Tiranë,1999, f.73.
[187] Po aty, f. 73.

Sa i përket të drejtës islame (sheriati) ka një përjashtim në këtë aspekt. E drejta islame lejon lidhjen e martesës edhe me më shumë gra , deri në katër gra në të njëjtën kohë [188], që nënkupton lidhjen e katër kurorave në të njëjtën kohë.

Meqenëse gjatë përhapjes së fesë islame janë zhvilluar shumë luftëra dhe kanë rënë dëshmorë një numër i madh i burrave myslimanë, si pasojë e këtyre luftërave mbetën një numër i madh i vejushave. Me qëllim që edhe këtyre grave t'iu sigurohet jetesa përmes martesës ligjore, e drejta islame lejoi lidhjen e martesës me disa gra (deri në katër gra).[189] E drejta jonë pozitive dhe e drejta pozitive e shteteve perëndimore e njohin monogaminë dhe e parashohin si parim të së drejtës martesore.

Pas zgjidhjes apo pushimit të martesës së parë, në mënyrë të parashikuar në ligj, legjislacioni ynë nuk parasheh kalimin e afatit të pritjes-postmartesore, si kusht për të fituar të drejtën për lidhjen e martesës së re, që ka si qëllim shmangien e kontesteve rreth vërtetimit të atësisë.[190] Këtë afat e parasheh Kodi Civil Francez në nenin 228 al.1, sipas të cilit gruaja duhet pritur 300 ditë pas zgjidhjes së martesës së parë, për të lidhur martesën e dytë.[191] Koha e pritjes prej 300 ditësh buron nga fakti se brenda kësaj kohe mund të lindë fëmijë, e me qëllim që të mos kontestohet atësia e fëmijës është paraparë koha e pritjes prej 300 ditësh, e cila llogaritet si kohë më e gjatë e shtatzënësisë. Kodi Civil Francez, edhe pse është nxjerrë që në vitin 1804 e i cili me pak ndryshime është në fuqi edhe sot, mund të themi se është një prej kodeve më të përsosura i të gjitha kohëve. Një numër i madh i shteteve të cilat kanë kodet e tyre civile, e kanë marrë si model Kodin Civil Francez, siç janë: Holanda (1837), Italia (1866), Egjipti (1875), Spanja (1889), etj.[192]

2.2. Mos dallimi i sekseve si shkak i anulimit absolut të martesës

Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave me sekse të kundërta, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes, neni 14, parag. 1 i LFK-së.

Mosrespektimi i dallimit të sekseve në mes të bashkëshortëve gjatë lidhjes së martesës, shkakton pavlefshmëri absolute, nëse martesë nuk kanë lidhur personat me sekse të kundërta.[193]

Kur nuk ekziston një kusht i tillë për lidhjen e martesës së plotfuqishme, kemi të bëjmë me jomartesë, kështu që një veprim i tillë nuk duhet të shkaktojë asnjë efekt juridik në fushën e së drejtës martesore.[194] Martesa do të jetë e vlefshme vetëm nëse në gjendjen civile figuron se bashkëshortët që dëshirojnë të lidhin martesë janë me sekse të kundërta.[195] Një gjë të tillë e parasheh edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut në nenin 12, ku thotë: "Burrat dhe

[188] Resul Rexhepi: "*E drejta martesore islame*", Prishtinë, 1996. f .47.
[189] Po aty, f. 48.
[190] Hamdi Podvorica: "*E drejta familjare*",Prishtinë,2006, f.82.
[191] Po aty, f. 82.
[192] Andrija Gams:"Hyrje në të drejtën civile",Prishtinë,1986, f,31.
[193] Gani Oruqi: "E drejta familjare-ligjërata të autorizuara", Prishtinë,1994, f. 78.
[194] Hamdi Podvorica: "*E drejta familjare*",Prishtinë, 2006, f.115.
[195] Valentina Zaqe: "Mardhënjet familjare sipas legjislacionit shqipëtar",Tiranë,1999, f.53.

gratë në moshën e martesës kanë të drejtën e martesës dhe krijimit të familjes, sipas ligjeve kombëtare që e përcaktojnë ushtrimin e kësaj të drejte".

Kohëve të fundit, kanë vërshuar pakënaqësitë e personave homoseksualë me anë të protestave të ndryshme, që kanë si kërkesë legalizimin e martesave në mes të homoseksualëve. Tendencat e lejimit të martesave me sekse të njëjta, kanë ndikuar që në disa vende perëndimore të lejohen disa modele të bashkëjetesës së personave me sekse të njëjta, në kuptimin e një bashkëjetese civile (Civil Union), p.sh. në Vermont.[196] Mirëpo, duhet theksuar se: "Qëllimi natyror i martesës ka qenë, është dhe do të mbetet lindja dhe mirërritja e fëmijëve, si dhe kryerja e marrëdhënieve seksuale.[197]

2.2.1. Ndryshimi i seksit (gjinisë) si dukuri e re shoqërore

Nganjëherë dëshirat e njeriut janë aq të forta, saqë këtë dëshirë e shpien në ekstrem, duke praktikuar edhe ndërrimin e seksit (gjinisë). Fenomeni i ndryshimit të seksit është shfaqur si rezultat i zhvillimit të lartë të mjekësisë, e cila mundëson ndryshimin e seksit të njeriut me anë të operacionit.[198]

Transeksualizimi është një fenomen që e çon një individ të një seksi të përcaktuar, në një dëshirë seksuale, për të ndryshuar seksin, që i korrespondon kështu, një ndjenjë intime dhe autentike për të qenë i seksit tjetër".[199] Sipas pikëpamjes së doktrinës franceze, martesat e tilla nuk duhet lejuar, për shkak të mungesës së sekseve të kundërta gjenetike, si kusht dhe presupozim i domosdoshëm për lidhjen e martesës së vlefshme.[200] Sepse, me anë të operacionit vetëm mund të imitohet organi tjetër seksual, ngase, në realitet, në aspektin biologjik mbetet po ai organi gjenetik seksual që ka qenë më parë.[201] Organi kompetent për lidhjen e martesës para se të lejojë lidhjen e martesës të personave të interesuar, së pari duhet të vërtetojë në librat e gjendjes civile se a janë personat e interesuar për lidhje të martesës me sekse të kundërta, dhe nëse vërtetohet se janë me sekse të kundërta dhe të jenë plotësuar edhe kushtet e tjera ligjore, lejon lidhjen e martesës, në të kundërtën ua refuzon lidhjen e martesës personave të interesuar për lidhje të kësaj martese. Mirëpo, nëse ndryshimi i seksit bëhet pas lidhjes së martesës, atëherë kjo mund të jetë shkak për anulimin e kësaj martese, sepse heteroseksualiteti është kusht që një martesë të jetë e vlefshme.[202]

2.3. Sëmundjet psikike dhe paaftësia për të vepruar si shkak i anulimit absolut të martesës

Anulimi absolut i martesës, për shkak të sëmundjes psikike dhe paaftësisë për të vepruar, ekziston atëherë kur personi që ka lidhur martesë ka qenë i paaftë për të gjykuar për shkak të

[196] Abdulla Aliu & Haxhi Gashi: "E drejta familjare", Prishtinë,2007, f.153.
[197] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.73.
[198] Po aty, f.74.
[199] Valentina Zaqe: "Marrëdhënjet familjare sipas legjislacionit shqipëtar",Tiranë,1999, f.53.
[200] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.74.
[201] Po aty,f.74.
[202] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.74.

ndonjë sëmundje të rëndë psikike, apo ndonjë shkak tjetër.[203] Këtë e parasheh edhe LFK në nenin 64, para. 1. si shkak të anulimit të martesës nëse bashkëshortët gjatë lidhjes së martesës nuk kanë pasur aftësi për të vepruar, për shkak të ndonjë sëmundje psikike të diagnostikuar apo ndonjë shkak tjetër. Të njëjtën gjë e parasheh edhe KFSH në nenin 12, ku shprehimisht thuhet: "Nuk mund të lidhë martesë personi që vuan nga ndonjë sëmundje e rëndë psikike ose ka zhvillim mendor të metë, që e bën të paaftë të kuptojë qëllimin e martesës".

Nuk mund të lidhë martesë ai që ka humbur zotësinë për të vepruar, për shkak të ndonjë sëmundje të rëndë psikike, po ashtu është e pavlefshme martesa, nëse në momentin e lidhjes së saj personi ka qenë në një rrethanë të tillë, e që nuk ka qenë në gjendje për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tij.[204] Duke marrë parasysh faktin se martesa është një akt vullneti i dy bashkëshortëve, e ka munguar ky vullnet në atë masë, saqë nuk ka mundur të kuptojë qëllimin e martesës, shërimi i tij i mëvonshëm nuk mund të përjashtojë këtë shkak të pavlefshmërisë dhe t'i merret e drejta këtij personi që të ngrejë padi për anulim të kësaj martese të lidhur në kohën kur ka qenë mendërisht i paaftë për të gjykuar.[205]

Legjislacionet bashkëkohore, me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik dhe të eugenizmit, ndalojnë lidhjen e martesës në mes të personave që janë të prekur nga disa sëmundje të rënda (si, p.sh., sëmundjet veneriane ose për defekte fizike ose psikike).[206] Kurse ka legjislacione, si, p.sh., legjislacioni francez, me qëllim që bashkëshortët të njoftohen për shëndetin e tyre, kërkon një ekzaminim mjekësor para lidhjes së martesës ku dhe iu lëshohet certifikata mjekësore, e cila i prezantohet nëpunësit të gjendjes civile, e cila quhet certifikatë paramartesore.[207] Kjo është një praktikë e mirë, sepse shmang lidhjen e martesës me ndonjë person, i cili nuk është i aftë në pikëpamje psikike dhe ka zhvillim mendor të metë.

Paaftësia për të gjykuar për shkak të ndonjë sëmundje të rëndë psikike apo ndonjë sëmundje tjetër, është shkak i anulimit absolut të martesës, vetëm nëse sëmundja e tillë ka ekzistuar në momentin e lidhjes së martesës. Në të kundërtën, shërimi i mëvonshëm i bashkëshortit bën që ky shkak të sjellë anulimin relativ të martesës dhe jo anulimin absolut.[208] Për t'u konsideruar një person i paaftë për të vepruar, duhet që paraprakisht të ketë një vendim gjyqësor me të cilin i është marrë aftësia për të vepruar. Mirëpo, edhe pse ka një vendim gjyqësor me të cilin i është marrë zotësia për të vepruar, LFK parasheh një përjashtim në nenin 20, parag. 2, ku gjykata mund të lejojë personin e tillë që të martohet, me kërkesë, pas marrjes së mendimit të prindit, të mbikëqyrësit, apo të organit të kujdestarisë.

2.3.1. Arsyet e ekzistimit të sëmundjeve psikike si shkak i anulimit të martesës

Ka disa arsye të anulimit të martesës për shkak të sëmundjeve psikike, e të cilat sëmundje kanë një ndikim mjaft të madh në shoqëri:

[203] Gani Oruqi: "E drejta familjare-ligjërata të autorizuara", Prishtinë,1994, f. 76.
[204] Franqesko Gallgano, f. 919.
[205] Valentina Zaqe: "Marrëdhënjet familjare sipas legjislacionit shqipëtar",Tiranë,1999, f.75.
[206] Po aty, f.54.
[207] Valentina Zaqe: "Marrëdhënjet familjare sipas legjislacionit shqipëtar",Tiranë,1999, f. 55.
[208] Po aty, f.75.

E para, nuk ekziston shprehja e vullnetit në mënyrë relevante juridike, sepse personat me shëndet mental të metë nuk janë të vetëdijshëm dhe nuk mund ta kuptojnë rëndësinë e veprimeve të tyre.[209] Këto veprime mund t'i kuptojnë vetëm personat me zotësi të plotë veprimi dhe mendërisht të aftë dhe të cilët janë të gatshëm t'i kryejnë të gjitha obligimet që burojnë nga lidhja e martesës.

E dyta, sipas analizave të kryera, 16 për qind e fëmijëve të sëmurë nga skizofrenia kanë trashëguar sëmundjet nga prindërit.[210] Te disa sëmundje të tjera mentale shkalla e trashëgimisë së sëmundjes nga prindërit arrin shkallë 60 deri 80 për qind .[211] Kjo është, me të vërtetë, një përqindje e lartë, e cila sjell pasoja në shoqërinë tonë. Mu për këtë arsye, legjislacionet parashohin kufizimin e lidhjes së martesës në mes të këtyre personave që vuajnë nga këto sëmundje të rënda psikike. Këtë e parasheh edhe LFK në nenin 64, parag.1.

Është shumë logjike që personave me sëmundje të rëndë psikike dhe me zhvillim mendor të metë, mos t'i lejohet lidhja e martesës, sepse personi i tillë nuk është në gjendje që të kujdeset as për interesat i tija personale, e të mos flasim për t'u kujdesur për detyrimet martesore që burojnë me lidhjen e martesës.

2.3.2. Veçoritë themelore të sëmundjeve psikike si shkak i anulimit të martesës

Ka disa sëmundje, të cilat ndikojnë dukshëm në jetën normale të një njeriu dhe e pengojnë që të jetë efikas në jetën e tij normale, siç janë: epilepsia, skizofrenia, narkomania, alkoolizmi kronik etj. Për t'u konsideruar sëmundja psikike shkak për anulim të martesës, duhet së pari të vërtetohet se sëmundja psikike ose zhvillimi mendor i metë ekziston në çastin e lidhjes së martesës, përkatësisht në momentin e deklarimit të vullnetit para nëpunësit të gjendjes civile.[212]

Nëse sëmundja është krijuar pas lidhjes së martesës (gjatë jetës bashkëshortore), atëherë ky shkak mund të jetë shkak i shkurorëzimit të martesës, e jo i anulimit.[213] Kjo, për faktin se në kohën e lidhjes së martesës personat e interesuar për lidhje të martesës kanë qenë të aftë në pikëpamje psikike për të shprehur vullnetin për të lidhur martesë dhe në qoftë se pas lidhjes së martesës njëri prej bashkëshortëve sëmuret psikikisht, kjo nuk i jep të drejtë bashkëshortit tjetër për ta anuluar këtë martesë, bashkëshorti mund të kërkojë vetëm zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, nëse kjo sëmundje ka ndikuar në marrëdhëniet bashkëshortore.

Gjithashtu, duhet theksuar se sëmundjet psikike apo zhvillimi mendor i metë përbëjnë shkakun e pavlefshmërisë absolute vetëm në qoftë se në kohën e ngritjes së padisë vazhdon efektiviteti i kësaj sëmundjeje ose zhvillimi mendor i metë.[214] Në qoftë se kjo sëmundje gjatë martesës ka pushuar së ekzistuari, atëherë përbën shkak të nulitetit relativ të martesës.

---

[209] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.83.
[210] Po aty, f.83.
[211] Po aty, f.83.
[212] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f 83.
[213] Gani Oruqi: "E drejta familjare-ligjërata të autorizuara", Prishtinë,1994, f.76.
[214] Santhipi Begeja: "E drejta familjare e RPS të Shqipërisë" ,Tiranë, 1984, f.127.

Do theksuar se sëmundja psikike dhe zhvillimi mendor i metë dhe pazotësia për të vepruar shkaktojnë pavlefshmërinë absolute, por të përkohshme, nëse sëmundja është e shërueshme.[215]

3. Gjinia si shkak i anulimit absolut të martesës

Gjinia është shkak i anulimit të martesës , kur martesa është lidhur ndërmjet personave në lidhje gjinie në mes vete në shkallë të paraparë me ligj, siç janë: gjinia e gjakut, e krushqisë dhe gjinia e adoptimit.[216]

E drejta islame parasheh edhe gjininë e qumështit si pengesë martesore, bile edhe në të njëjtën shkallë siç është edhe gjinia e gjakut. Në një ajet Kur'anor thuhet: "(…..ju është ndaluar juve të martoheni) edhe me nënat tuaja, të cilat ju kanë dhënë gji, si dhe me motrat tuaja nga qumështi…."[217] E drejta kanonike ka njohur edhe gjininë shpirtërore (kumbarinë) si lidhje gjinie.[218]

Ligji i Familjes i Kosovës parasheh gjininë e gjakut, gjininë e krushqisë dhe gjininë e adoptimit si lloje të gjinisë. Por, edhe shumica dërrmuese e legjislacioneve botërore i parashohin këto lloje të gjinisë. Ne do të ndalemi te këto tri lloje të gjinisë si shkak të anulimit të martesës: gjinia e gjakut, gjinia e krushqisë dhe gjinia e adoptimit.

3.1. Gjinia e gjakut

Gjinia e gjakut është shkak për anulimin e martesës në vijë të drejtë deri në pakufi, ndërsa në vijë të tërthorët, deri në shkallën e katërt.[219] Këtë e parasheh edhe LFK në nenin 21, ku thuhet: "Nuk mund të lidhin martesë personat në gjini gjaku në vijë të drejtë dhe në vijë të tërthortë siç janë vëllai dhe motra prej një ati dhe një nëne ose vetëm prej atit ose prej nënës, xhaxhai dhe mbesa, daja dhe mbesa, tezja dhe nipi, as fëmijët e vëllezërve dhe të motrave prej një ati dhe një nëne ose vetëm prej ati ose prej nëne". Nga kjo shihet se LFK nuk bën dallimin në mes të vëllezërve dhe motrave, që janë të lindur prej atit dhe nënës së tyre të përbashkët, nga ata që kanë vetëm njërin prind të përbashkët, qoftë atin ose nënën.

Gjinia e gjakut, përveç në dispozitat e LFK-së, parashihet edhe në dispozitat e legjislacioneve të tjera pozitive si shkak të anulimit të martesës, në KFSH, LFM etj. Sa i përket KFSH-së në vijë të tërthortë ka një dallim nga LFK, ku KFSH, në raste të përcaktuara me ligj, lejon edhe lidhjen e martesës në vijë të tërthortë edhe në shkallë të katërt për shkaqe të arsyeshme, ku në nenin 10 thotë: "Gjykata, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën midis fëmijëve të vëllezërve dhe të motrave". Si shkaqe të rëndësishme ligjdhënësi shqiptar duhet të ketë pasur

[215] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.84.
[216] Gani Oruqi: "E drejta familjare-ligjërata të autorizuara", Prishtinë,1994, f. 76.
[217] Resul Rexhepi: "E drejta martesore islame" Prishtinë, 1996, f. 38.
[218] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f. 50.
[219] Gani Oruqi: "E drejta familjare-ligjërata të autorizuara", Prishtinë,1994, f.77.

parasysh: " qenien e vajzës shtatzënë ose lindjen e fëmijëve nga marrëdhëniet intime të kryera midis tyre".[220]

Nuk është përcaktuar rastësisht gjinia e gjakut si pengesë martesore në vijë të drejtë pa kufi, kurse në vijë të tërthortë deri në shkallë të katërt. Shkencërisht është vërtetuar se lindja e fëmijëve në vijë të drejtë pa kufi si dhe në vijë të tërthortë brenda shkallës së katërt, mund të ketë pasoja shumë të rënda, sepse fëmijët mund të lindin qoftë me deformime fizike apo psikike.Për ta pasur sa më të qartë lexuesit, po e paraqesim në mënyrë skematike, si në vijë të drejtë, ashtu edhe në vijë të tërthortë gjininë e gjakut si pengesë martesore.

[220] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.84.

Pengesat martesore në vijë të drejtë:



Nga kjo shihet se në asnjë shkallë nuk lejohet lidhja e martesës

Pengesat martesore në vijë të tërthortë:



Shenjat që janë paraqitur me ngjyrë të kuqe tregojnë se martesat në ato shkallë nuk lejohen, kurse shenjat e paraqitura me ngjyrë të gjelbër tregojnë se martesat në këto shkallë lejohen të lidhen.

3.2. Gjinia e krushqisë

Gjinia e krushqisë krijohet me martesë dhe është lidhja e njërit bashkëshort me të afërmit në gjini gjaku të bashkëshortit tjetër.[221] Mirëpo, gjinia e krushqisë, e krijuar një herë, nuk mund të pushojë edhe nëse ka pushuar martesa, në bazë të së cilës ajo ka lindur.[222] Gjinia e krushqisë është pengesë martesore deri në shkallë të parë. LFK këtu bën një lëshim, duke lejuar lidhjen e martesës edhe në gjini të krushqisë, ku në nenin 23 al. 2 thotë se " për shkaqe të arsyeshme, gjykata kompetente mund të lejojë lidhjen e martesës ndërmjet personave në gjini krushqie, pasi të ketë marrë vendimin e organit të kujdestarisë".

KFSH nuk krijon mundësi ligjore për lidhje të martesës në gjini të krushqisë, po edhe sikur kjo martesë të ketë pushuar me anulim apo në ndonjë mënyrë tjetër ligjore, neni 11 i KFSH-së. Nga kjo shihet se KFSH i ka qëndruar më besnik moralit shoqëror të krijuar ndër shekuj, edhe pse lejimi i kësaj lidhjeje nuk ka ndonjë pasojë biologjike.

Gjinia e krushqisë në aspektin juridik paraqet një lidhje të krijuar me martesë në mes të njërit bashkëshort me të afërmit e gjinisë së gjakut të bashkëshortit tjetër, dhe është pengesë martesore deri në shkallën e parë. Ekzistimi i lidhjeve martesore në vijë të gjinisë së krushqisë si ajo ndërmjet vjehrrit dhe resë, dhëndrit dhe vjehrrës, njerkut dhe thjeshtrës (vajza të cilën gruaja e ka pasur në martesë tjetër) i njerkës dhe thjeshtrit (djali të cilin burri e ka pasur në martesën e mëhershme) brenda gjinisë së krushqisë, e bëjnë martesën absolutisht të pavlefshme.

3.3. Gjinia e birësimit

Gjinia e birësimit krijohet si rezultat i lidhjes juridike civile (artificiale, jobiologjike) në mes të birësuesit me të afërmit e tij dhe të birësuarit me pasardhësit e tij. Kjo lidhje juridike i prodhon të njëjtat efekte po sikurse edhe gjinia e gjakut. Çdo gjë që vlen për gjininë e gjakut, vlen edhe për gjininë e birësimit. Në teorinë juridike kemi dy lloje të birësimit: birësimin e plotë dhe birësimin jo të plotë. LFK njeh vetëm birësimin e plotë, për dallim nga ligji i mëhershëm i KSA të Kosovës nr. 10/84 i datës 23 mars vitit 1984, që e njihte edhe birësimin jo të plotë. Në LFK, në nenin 22, parag. 2 thuhet: "Gjinia e themeluar me birësim është pengesë për martesë sikurse edhe gjinia e gjakut".

Birësimi i plotë si pengesë martesore është i karakterit të përhershëm, i paevitueshëm dhe shkakton pavlefshmërinë absolute të martesës.[223] Ndryshe nga birësimi i plotë, birësimi jo i plotë shkakton nulitetin relativ, por mund të jetë pengesë martesore e përkohshme dhe e evitueshme, sepse mund të shkëputet dhe birësuesi e i birësuari, për shkaqe të arsyeshme, mund të lidhin martesë me leje të organit kompetent .[224] Por, nuk duhet harruar se së pari duhet të ndërpritet marrëdhënia e birësimit nga organi kompetent dhe pastaj të lejohet lidhja e kësaj martese.

[221] Abdulla Aliu & Haxhi Gashi:" E drejta familjare", Prishtinë,2007, f.107.
[222] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.85.
[223] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.87.
[224] Po aty, f.87.

4. Mituria si shkak i anulimit absolut të martesës

Lidhja e martesës nën moshën 16-vjeçare të bashkëshortëve bën që kjo martesë të jetë absolutisht e pavlefshme. Lidhja e martesës nga personat nën moshën 16-vjeçare është absolute nule dhe konsiderohet se fare nuk kanë lidhur martesë.

Personat me zotësi veprimi kanë aftësinë e plotë për të lidhur martesë. LFK, neni 15, parag. 2 dhe neni 16 parag. 2, ka paraparë minimumin e moshës 16- vjeçare për të lidhur martesë. Personat e mitur nën 18 vjeç dhe më shumë se 16 vjet, mund të lidhin martesë me vendim të gjykatës. Personat që dëshirojnë të lidhin martesë në këtë moshë, duhet të paraqesin kërkesën në gjykatë. Këtë e parasheh LPJ-së, neni 114, ku thotë: "Në procedurën e dhënies së lejes për lidhjen e martesës, gjykata vendos mbi propozimin për dhënien e lejes për lidhjen e martesës ndërmjet personave të caktuar kur me anë të ligjit parashikohet se martesa midis tyre mund të lidhet vetëm në bazë të lejes së gjykatës. Pasi të vërtetohet se ata kanë aftësi psiko-fizike për të kuptuar rëndësinë e martesës, gjykata ua lejon lidhjen e martesës personave që kanë paraqitur kërkesë". Mirëpo, është për t'u habitur se një minimum të tillë nuk e kufizon KFSH, ku në nenin 7, parag. 2 thuhet: "Gjykata e vendit ku lidhet martesa , për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë lidhjen e martesës edhe përpara kësaj moshe". Kjo, sepse të miturit nuk janë në gjendje për të kuptuar rëndësinë e deklarimit të vullnetit të lirë, për shkak të moshës së re, papjekurisë psikike dhe fizike e as për të kuptuar pasojat që rezultojnë nga moskryerja e të drejtave dhe detyrave martesore .[225] Sipas të drejtës zakonore shqiptare, djemtë e fitonin zotësinë për të vepruar nga çasti i marrjes së armës, e që ishte mosha rreth 15-vjeçare dhe nga ky moment ata konsideroheshin burra dhe mund të kryenin po ato punë që i kryenin edhe burrat e tjerë të familjes që kishin zotësinë për të vepruar.[226]

5. Mosrespektimi i procedurës për lidhjen e martesës

Mosrespektimi i procedurës me rastin e lidhjes së martesës është shkak i anulimit absolut të kësaj martese, kur nuk janë kryer veprimet që e vërtetojnë lidhjen e martesës me rastin e kurorëzimit.[227] Sipas LFK-së, neni 27, parag.1, lidhja e martesës bëhet në mënyrë solemne dhe në lokalet posaçërisht të caktuara për këtë qëllim. Po ashtu, neni 28. parag.3 i LFK-së kërkon që gjatë lidhjes së martesës duhet të jenë të pranishëm bashkëshortët, dy dëshmitarë të moshës madhore dhe ofiqari. Mosprania e njërit bashkëshort apo që të dyve, është shkak për pavlefshmëri absolute të kësaj martese, për faktin se askush nuk mundet ta shprehë më mirë vullnetin për martesë se vetë bashkëshortët që lidhin martesë. Po ashtu, LFK, për të qenë një martesë e vlefshme, kërkon formën civile të lidhjes së martesës. Bashkëshortët të cilët dëshirojnë të lidhin martesë religjioze, sipas LFK-së, neni 36, së pari duhet të lidhin martesë ligjore me certifikatë të lëshuar si dëshmi, pastaj të lidhin martesë religjioze. Në të kundërtën, martesa e lidhur në formë religjioze para lidhjes së martesës civile, është joekzistuese (inegzistente).

[225] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.87.
[226] Aleks Luarasi: "Marrëdhënjet familjare" ,Tiranë,2001, f.59.
[227] Gani Oruqi: "E drejta familjare-ligjërata të autorizuara", Prishtinë,1994, f.79.

6. Mosrespektimi i kompetencës së organit kompetent si shkak i anulimit absolut të martesës

Mosrespektimi i kompetencës së organit para të cilit lidhet martesa, shkakton nulitet absolut të martesës, kur martesa nuk është lidhur para organit kompetent të parashikuar me ligj për lidhjen e martesës.[228] Pra, në qoftë se martesa është lidhur para organit i cili ka qenë jokompetent për lidhjen e martesës, kjo martesë është absolut e pavlefshme. Lidhjen e martesës përpara organit kompetent e parasheh edhe LFK në nenin 28, parag. 1, ku thuhet se martesa duhet të lidhet përpara organit të ofiqarisë (ofiqarit).

7. Ikja nga qëllimi i martesës si shkak i anulimit absolut të martesës

Ikja nga qëllimi i martesës është shkak që martesën e bën absolut nule, nëse bashkëshortët nuk kanë lidhur kurorë me qëllim të jetës së përbashkët, por për ndonjë qëllim tjetër.[229] Këto janë martesa ku bashkëshortët nuk kanë qëllim të bashkëjetojnë si bashkëshort, por të nxjerrin ndonjë përfitim apo të realizojnë ndonjë qëllim tjetër. Në nenin 66, parag. 1 i LFK-së, martesat e lidhura pa qëllim të bashkëjetesës në mes bashkëshortëve, është nule. Në paragrafin 2 të po këtij neni thuhet: ”Martesa është e pavlefshme kur bashkëshortët me anë të martesës, në të vërtetë, nuk kanë qenë të interesuar të krijojnë bashkëjetesë, por të fshehin disa veprime juridike ose fillimisht dëshirojnë të arrijnë qëllime të tjera (siç janë trashëgimia ligjore, pensioni familjar, ikja nga përgjegjësia penale dhe keqpërdorimi i çfarëdo të drejte tjetër)”. Ne jemi dëshmitarë se ç’po ndodh me bashkatdhetarët, që janë shtetas tanë në botën e jashtme, ku një pjesë e tyre, me qëllim të fitimit të leje qëndrimit, po lidhin martesa të simuluara me shtetase të huaja, e që janë shtetase të atij shteti ku qëndrojnë këta. Vetëm në vitin 2007, në kantonin e Cyrihut janë anuluar 500 martesa për shkak të dyshimit se ato janë të rrejshme.[230] Si pasojë e kësaj, në Republikën e Kosovës po ndodhin një numër i madh i shkurorëzimeve, po i quaj kushtimisht “shkurorëzime të simuluara”, për arsye se faktikisht prapë vazhdojnë të jetojnë së bashku, por kjo bëhet me qëllim të fitimit të letrave (leje qëndrimit) të ndonjë shteti.

Nga hulumtimet e bëra nëpër gjykata, 90 % e rasteve kanë qenë martesa të anuluara për shkak të ikjes nga qëllimi i martesës.

Sipas LFK-së, në nenin 66, parag. 3, parashihet një përjashtim nga rregulla e paragrafit 1, të nenit 66 të këtij ligji. Ky përjashtim ndodh kur bashkëshortët më vonë vendosin të çojnë jetë të përbashkët martesore (për të bashkëjetuar). Kjo nënkupton faktin se martesa lidhet me qëllim që bashkëshortët të kenë jetë të përbashkët,[231] e jo për të arritur ndonjë qëllim, i cili është në kundërshtim me institucionin e martesës.

[228] Gani Oruqi: “E drejta familjare-ligjërata të autorizuara”, Prishtinë,1994, f.79.
[229] Po aty, f. 77.
[230] Koha ditore, 22 janar 2009 Nr.4168.
[231] Abdulla Aliu & Haxhi Gashi: “*E drejta familjare*”Prishtinë,2007, f. 154.

8. Shkaqet të cilat shkaktojnë anulimin relativ të martesës

Anulimi relativ i martesës ekziston atëherë kur ekzistojnë pengesa martesore të cilat ligji i parasheh shprehimisht, të cilat shkaktojnë anulimin e martesës vetëm sipas padisë private.[232] Pavlefshmëria relative e martesës nuk mund të kërkohet nga çdo person, por vetëm nga bashkëshortët të cilët kanë interes për paraqitjen e kësaj kërkese.[233] Mirëpo, duhet theksuar se bashkëshorti i cili ka ngritur padi për anulimin relativ të martesës, mund të heqë dorë nga padia, nëse dëshiron që kjo jetesë bashkëshortore të vazhdojë.[234] Anulim relativ të martesës kemi atëherë kur shkaqet të cilat shkaktojnë pavlefshmëri janë të evitueshme dhe në procedurë gjyqësore gjykata mund të mos e anulojë martesën, por të vërtetojë lidhjen e saj. LFK nuk e specifikon se cilat janë ato shkaqe që shkaktojnë anulimin relativ të martesës, por janë specifikuar si shkaqe që shkaktojnë në mënyrë të përgjithshme anulimin e martesës. Duke u bazuar nga fakti i pasojave që shkaktojnë disa shkaqe të anulimit të martesës, atëherë si shkaqe të anulimit relativ të martesës mund t'i veçojmë:

a. gjinia e krushqisë,
b. mituria dhe
c. sëmundjet psikike dhe paaftësia për të vepruar.

8.1. Gjinia e krushqisë si shkak i anulimit relativ të martesës

Gjinia e krushqisë është pengesë martesore në shkallën e parë. Gjinia e krushqisë është shkak për anulim absolut të martesës, mirëpo ka legjislacione të cilat lejojnë lidhjen e martesës edhe në këtë gjini, si lidhja e martesës në mes të resë dhe vjehrrit, dhëndrit dhe vjehrrës, e kjo mund të jetë edhe shkak për anulim relativ të martesës. Personave në gjini të krushqisë, mund t'iu lejohet lidhja e martesës edhe në këtë gjini për shkaqe të parashikuara me ligj. LFK, në nenin 23, al. 2 thotë : se për shkaqe të arsyeshme, gjykata kompetente mund të lejojë lidhjen e martesës ndërmjet personave në gjini krushqie, pasi të ketë marrë vendimin e organit të kujdestarisë.

8.2. Mituria si shkak i anulimit relativ të martesës

Mituria si shkak i anulimit relativ të martesës ekziston nëse personi i cili ka lidhur martesë është nën moshën 18-vjeçare, por jo më i ri se 16-vjeçar, sepse në të kundërtën do të shkaktohet pavlefshmëria absolute.

Gjatë procedurës së anulimit të kësaj martese, gjykata, për shkaqe të arsyeshme, mund të refuzojë padinë për anulim dhe martesën e tillë ta lërë në fuqi.[235] Kjo, për faktin se personi në këtë moshë, pra prej moshës 16 e deri në moshën 18-vjeçare, edhe pse ligjërisht nuk e ka aftësinë për të vepruar, por është i pjekur fizikisht dhe në pikëpamje psikike dhe nga analizimi i gjendjes

[232] Gani Oruqi: "E drejta familjare-ligjërata të autorizuara", Prishtinë,1994, f.79.
[233] Santhipi Begeja: "E drejta familjare e RPS të Shqipërisë" ,Tiranë, 1984, f.129.
[234] Po aty, f.129.
[235] Gani Oruqi: "E drejta familjare-ligjërata të autorizuara", Prishtinë,1994, f.81.

së tij vërtetohet se është në gjendje t'i përmbushë detyrat martesore, gjykata mund ta vërtetojë një martesë të tillë. Nga kjo shihet se mituria prej moshës 16 deri 18-vjeçare është e evitueshme dhe është shkak i anulimit relativ të martesës.

8.3. Sëmundjet psikike dhe paaftësia për të vepruar si shkak i anulimit relativ të martesës

Sëmundja psikike dhe paaftësia për të vepruar, përveç si shkak i anulimit absolut të martesës, ka raste kur shkaktojnë edhe anulim relativ të martesës, si, p.sh., nëse njëri bashkëshort ka qenë me paaftësi veprimi për shkak të ndonjë sëmundje psikike, e cila sëmundje nuk është vërtetuar gjatë lidhjes së martesës, mirëpo gjatë jetës martesore bashkëshorti shërohet, atëherë një martesë e tillë mund të anulohet dhe të drejtë padie ka vetëm bashkëshorti i cili ka pësuar sëmundje psikike apo për shkaqe të tjera ka qenë i paaftë për të vepruar, LFK, neni 67, paragrafi 2. Kjo nënkupton se kemi të bëjmë me nulitet relativ të martesës, për faktin se kemi të bëjmë me një shkak të evitueshëm. Po i njëjti nen dhe paragraf thotë: "Padia duhet të parashtrohet brenda një viti nga data kur shkaqet e lartpërmendura shuhen". Nëse bashkëshorti tjetër nuk kërkon anulimin e martesës, martesa e tillë nuk anulohet dhe mbetet e vlefshme.

Nuk është edhe e arsyeshme që një martesë e këtillë të anulohet, kjo për faktin se personi i cili ka qenë me ndonjë sëmundje, e cila ka qenë edhe si pengesë për lidhje të martesës, mirëpo kjo sëmundje është shëruar dhe personi është në gjendje t'i kryejë të gjitha të drejtat dhe detyrat që dalin nga martesa dhe jeta bashkëshortore.

8.4. Mungesa e vullnetit për të lidhur martesë si shkak i anulimit relativ të martesës

Për të qenë një martesë e vlefshme, LFK në nenin 31, parag. 2, kërkon që bashkëshortët lirisht të shprehin vullnetin e tyre për të lidhur martesë. Në qoftë se martesa lidhet pa deklarimin e lirë të vullnetit të secilit bashkëshort veç e veç, pra që ata të pëlqejnë të martohen njëri me tjetrin, martesa është e pavlefshme.[236]

Deklarimi i vullnetit para organit kompetent shtetëror për lidhje të martesës, nuk duhet bazuar vetëm në vullnetin e brendshëm të bashkëshortëve, por edhe që vullneti të jetë i shprehur saktësisht dhe qartazi, saqë midis tyre të ketë përputhje e unitet të plotë.[237] Sipas LFK-së, neni 18, martesa nuk do të jetë e plotfuqishme, nëse bashkëshortët kanë lidhur martesë përmes shtrëngimit, kërcënimit, lajthimit, apo ndonjë mungesë tjetër të vullnetit të lirë nga ana e bashkëshortëve. Mirëpo, duhet theksuar se këto shkaqe duhet të kenë ekzistuar gjatë lidhjes së martesës, sepse nëse do të kemi, p.sh., dhunë fizike pas lidhjes së martesës (gjatë jetës bashkëshortore), atëherë kemi të bëjmë me dhunë familjare, e cila mund të paraqitet si shkak për shkurorëzim, jo për anulim. Nga gjithë kjo, mund të vijmë në përfundim se kemi mungesë të vullnetit nëse martesa është lidhur nën ndikimin e dhunës, kanosjes, mashtrimit apo lajthimit.

[236] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.115.
[237] Valentina Zaqe: "Marrëdhënjet familjare sipas legjislacionit shqipëtar",Tiranë,1999, f.72.

8.5. Dhuna ose kanosja si shkak i anulimit relativ të martesës

Dhuna si shkak i anulimit relativ të martesës, nënkupton faktin se martesa është lidhur me dhunë, e cila i është shkaktuar njërit bashkëshort nga bashkëshorti tjetër, ose ushtrimi i dhunës ndaj të dy bashkëshortëve nga ndonjë person i tretë. Shembull: nëse njëri bashkëshort rrahet fizikisht nga bashkëshorti tjetër në mënyrë që të bindet për të lidhur martesë, apo keqtrajtohet në ndonjë mënyrë tjetër fizike. Dhuna që ushtrohet për lidhjen e martesës, në kundërshtim me vullnetin e brendshëm të vërtetë të bashkëshortit, mund të jetë e natyrës psikologjike dhe fizike .[238]

Dhuna psikologjike manifestohet me kanosje, sepse me kanosje ushtrohet dhunë psikologjike, por jo edhe dhunë fizike.[239] Kjo për faktin se nëse kemi të bëjmë me ushtrimin e dhunës fizike në mënyrë të drejtpërdrejtë, atëherë kemi të bëjmë me dhunë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës dhe jo me kanosje. Dhuna dallohet nga kanosja, sepse te kanosja, e keqja paraqitet si mundësi, kurse te dhuna, e keqja shkaktohet,[240] me qëllim të lidhjes së martesës. Kanosje kemi, për shembull, kur bashkëshorti ose ndonjë person tjetër i kërcënohet bashkëshortit tjetër se do ta vrasë atë ose ndonjë anëtar të familjes së tij, nëse nuk lidh martesë. Kanosja duhet të jetë aq serioze, sa personi i kanosur, edhe pse nuk e dëshiron lidhjen e martesës, asaj nuk mund t'i shmanget, për shkak të manifestimit të frikës së madhe.[241] Kanosja duhet të jetë e mundshme, që nënkupton se e keqja që i kanoset të kanosurit është potenciale që t'i shkaktohet, p.sh., i kërcënohet se do ta vrasë nëse nuk lidh martesë, por nuk mund të konsiderohet kanosje e mundshme nëse kanosësi i kërcënohet të kanosurit se do t'ia vrasë prindërit e në realitet prindit i ka të vdekur qysh moti. Kanosja duhet të jetë e kundërligjshme, ashtu që kërcënuesi është në kundërshtim me ligjin,[242] e kjo sjell edhe përgjegjësinë penale të kërcënuesit. Martesa e lidhur nën ndikimin e këtyre rrethanave shkakton nulitet relativ të martesës, sepse kemi mungesë të vullnetit të vërtetë me rastin e lidhjes së martesës.

Në qoftë se vullneti për të lidhur martesë është arritur nën ndikimin e një frike të shkaktuar nga një kanosje, atëherë nuk mund të themi se martesa është lidhur me vullnetin e lirë të bashkëshortëve, e një martesë e tillë mund të shpallet e pavlefshme.[243] Po ashtu, edhe LFK në nenin 63, thotë se martesa do të anulohet nëse bashkëshorti e ka dhënë pëlqimin me anë të frikës, dhunës ose kërcënimit serioz.

8.6. Lajthitja si shkak i anulimit relativ të martesës

Lajthimi ekziston kur njëri bashkëshort ka pasur mendim të gabueshëm mbi rrethanat, faktet dhe mbi cilësitë thelbësore të bashkëshortit tjetër në momentin e lidhjes së martesës, ekzistenca e të cilave jetesën e përbashkët e bëjnë të padurueshme .[244] Këto fakte janë të intensitetit të atillë, saqë bashkëshorti tjetër po t'i dinte, nuk do të lidhte martesë dhe nuk do të shprehte

[238] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.77.
[239] Valentina Zaqe: "Marrëdhënjet familjare sipas legjislacionit shqipëtar",Tiranë,1999, f.78.
[240] Andrija Gams: "Hyrje në të drejtën civile", Prishtinë, 1986, f. 310.e d.c.
[241] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.78.
[242] Abdulla Aliu & Haxhi Gashi: "*E drejta familjare*",Prishtinë,2007,f. 102.
[243] Santhipi Begeja: "E drejta familjare e RPS të Shqipërisë" ,Tiranë, 1984, f.130.
[244] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.79.

vullnetin para organit kompetent.[245] Lajthimi është një pasqyrim i gabuar i realitetit objektiv, pra, te rastet e lajthimit ekziston shpërputhje ndërmjet vullnetit të vërtetë dhe veprimit juridik, në të kundërtën po të ishin të njohura këto fakte, veprimi juridik nuk do të ndodhë.[246] Kur përmendet veprimi juridik, nënkuptohet lidhja e martesës.

Duhet bërë dallimin në mes të lajthimit dhe mashtrimit, sepse derisa te lajthitja njëri nga bashkëshortët bie në lajthim pa qëllim të ndonjërit prej tyre, kurse te mashtrimi kemi të bëjmë me fshehjen e fakteve dhe rrethanave me paramendimin e njërit prej bashkëshortëve. Mund t'i ndajmë tri lloje të lajthimit:

a. lajthimi në personin fizik
b. lajthimi në personin qytetarë dhe
c. lajthimi në cilësitë thelbësore.

8.6.1. Lajthitja për personin fizik

Lajthitja në personin fizik ekziston kurë njëri nga bashkëshortët e ardhshëm ka menduar se po lidh martesë me një person të caktuar, e martesa është lidhur me një person krejt tjetër.[247] Shembull: kur njëri nga bashkëshortët mendon se po lidh martesë me personin A, kurse martesa është lidhur me personin B, edhe pse kjo është e paimagjinueshme, mirëpo raste të tilla mund të ekzistojnë, sidomos në vendet të cilat e zbatojnë lidhjen e martesës me përfaqësues të njërit bashkëshort (prokurë). Ose, në raste të tjera, kur njëri prej të fejuarve ndodhet në botën e jashtme, kurse tjetri në vendlindje, ndërsa martesën e lidhin me prokurë, pa prezencën e njërit prej tyre. [248]

Martesa të tilla, pa prezencën e njërit bashkëshort, janë realizuar sidomos në Kosovë gjatë viteve tetëdhjetë dhe nëntëdhjetë, kur një numër i madh i të rinjve kosovarë kanë emigruar jashtë Kosovës për shkaqe ekonomike dhe politike. Martesa të tilla janë realizuar edhe pas luftës së fundit në Kosovë, sa ka qenë në fuqi LFMM i vitit 1984, e derisa është aprovuar LFK, i datës 06.09.2004.

Mundësia e lidhjes së martesës në lajthim për personin fizik në Republikën e Kosovës është zero, sepse LFK në nenin 28, parag.3, parasheh pjesëmarrjen e të dy bashkëshortëve me rastin e lidhjes së martesës.

8.6.2. Lajthitja për personin qytetar

Lajthitja në personin qytetar ekziston atëherë kur njëri nga bashkëshortët ka lidhur martesë me një person të caktuar, e në fakt nuk është ai person për të cilin mendon, sepse personi i tillë ka prezantuar shënime të rreme për emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendbanimin ose shtetësinë.[249]

[245] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f. 79.
[246] Ruzhdi Berisha:"Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës",Prishtinë, 2004.f.499.
[247] Po aty, f.499.
[248] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare", Prishtinë,2006, f.80.
[249] Gani Oruqi: "E drejta familjare-ligjërata të autorizuara", Prishtinë,1994, f. 81.

Ky lajthim nënkupton prezantimin e rremë, domethënë, kur bëhet fjalë për fshehje të identitetit të vërtetë përkitazi me veçoritë esenciale që posedon.[250] Shembull: nëse një person i prezanton në mënyrë të rrejshme moshën, vendbanimin me anë të lejes së njoftimit të rremë, p.sh., personi paraqitet me dokumente 24- vjeçar, kurse në realitet është 30 vjeçar, atëherë këtu kemi të bëjmë me lajthitje për personin qytetar.

8.6.3. Lajthitja për cilësitë thelbësore të personit

Lajthimi për cilësitë thelbësore të personit ekziston nëse njëri nga bashkëshortët është në lajthitje (ka mendim të gabuar) për disa cilësi të personit tjetër, të cilat po t'i ishin të njohura në çastin e lidhjes së martesës, gjithsesi që do të ndikonin në të dhe ai nuk do ta lidhte martesën.[251] Këto janë ato cilësi të cilat bashkëshorti tjetër nuk i ka treguar apo i ka fshehur, e të cilat cilësi me një bisedë të rëndomtë në mes të bashkëshortëve, bashkëshorti tjetër nuk ka mundur t'i vërejë, për arsye se janë të natyrës së tillë që nuk mund të shihen nga jashtë, por janë brendapërbrenda njeriut, si p.sh.: paaftësia e përhershme për krijimin e familjes (steriliteti), amoraliteti, profesioni i pamoralshëm (prostitucioni), narkomania etj.

Lajthitja mbi cilësitë e personit duhet të jetë serioze, ashtu që bashkëshorti i lajthitur nuk ka ditur ose nuk ka pasur mundësi të dijë për cilësitë e tilla të bashkëshortit tjetër në momentin e lidhjes së martesës.[252]

Sa i përket LFK-së, ai nuk e cek në mënyrë shprehimore se kush ka të drejtë të parashtrojë padi në rast të lajthimit në cilësitë thelbësore, kurse këtë e cek në mënyrë shprehimore LFM, neni 36, parag. 3 dhe KFSH, në nenin 44, parag. 2, të drejtën e parashtrimit të padisë ja lejon vetëm bashkëshortit, i cili ka qenë në lajthim. Padia duhet të paraqitet brenda 1 (një) viti nga dita e marrjes në dijeni për lajthitje. Nëse nuk shfrytëzohet ky afat ligjor, humbet e drejta për të kërkuar anulimin e martesës

9. Përfundim

Pas zhvillimit, hulumtimit dhe trajtimit të lëndës, kam ardhur në këto përfundime:

Së pari, Shkurorëzimi ka të bëjë me zgjidhjen e një martese të vlefshme, dhe pas shkurorëzimit bashkëshortet figurojnë në gjendjen civile si të shkurorëzuar. Kurse anulimi ka të bëjë me zgjidhjen e një martese të pavlefshme dhe se konsiderohet se fare nuk kanë pasur martesë të lidhur, d.m.th., bashkëshortët pas anulimit të kësaj martese konsiderohen si beqarë dhe jo si të shkurorëzuar.

Së dyti, një çështje, e cila është përfolur mjaft shumë në Kosovë pas miratimit të Kushtetutës, është neni 24, paragrafi 2. i cili thotë: " Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a

[250] Ruzhdi Berisha:"Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës",Prishtinë, 2004, f.499.
[251] Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006, f.80.
[252] Abdulla Aliu & Haxhi Gashi: "*E drejta familjare*"Prishtinë,2007, f.100.

shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal". Nga kjo që thuhet me të vërtet shihet se Kushtetuta nuk iu ndalon personave me sekse të njëjta që të kenë ndonjë lidhje personale, por jo edhe duke ua legalizuar këtë lidhje me martesë, siç është përfolur. Për ta vërtetuar këtë, mund t'i referohemi nenit 37, paragrafët 1 dhe 2, me të cilin përcaktohet se çdokush ka të drejtë të lidhë martesë dhe të krijojë familje në pajtim me ligjin. Në këtë rast, Ligji mbi Familjen i Kosovës është ai i cili i rregullon çështjet familjare dhe martesore dhe ai nuk e lejon lidhjen e martesës në mes të personave me sekse të njëjta, si dhe është shkak i anulimit absolut të martesës.

Porosia për fund: "Lidhni martesë ma atë që e doni, por jo me atë që ligji ua ndalon ".

Bibliografia

- Hamdi Podvorica: "E drejta familjare",Prishtinë,2006.
- Gani Oruqi: "E drejta familjare-ligherata të autorizuara", Prishtinë,1994.
- Abdulla Aliu & Haxhi Gashi: "E drejta familjare", Prishtinë, 2007.
- Valentina Zaqe: "Mardhenjet familjare sipas legjislacionit shqipëtar",Tiranë,1999.
- Santhipi Begeja: "E drejta familjare e RPS të Shqipëris", Shtëpia botuese e librit univerzitar, Tiranë, 1984.
- Aleks Luarasi: "Mardhënjet familjare",Tiranë, 2001.
- Resul Rexhepi: "E drejta martesore islame". Prishtinë,1996.
- Ruzhdi Berisha:"Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprodencës",Prishtinë, 2004.
- Muhammed Sharif:"Femra nën mbrojtjen e islamit", Prishtinë, 2004, f . 87.
- Francesko Gallgano: "E drejta private", shtepia botuese "Luarasi", Tiranë,1999.
- Andrija Gams : "Hyrje në të drejtën civile", Prishtinë, 1986.
- Ligji për mardhënjet familjare i Kosovës, 16 shkurt 2006.
- Ligji i familjës i Republikës së Shqipërisë , nr.90/62 i datës 08.05.2003.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15.06.2008.
- KOHA DITORE, 22 janar, 2009 Nr.4168.
- http://family-law.lawyers.com/divorce/Can-This-Marriage-be-Annulled.html
- Ligji mbi martesën dhe mardhënjet familjare, Gazeta Zyrtare e KSAK nr.10/84, i datës 28 mars 1984 (i shfuqizuar).
- Ligji për familjen, Gazeta zyrtare e Republikes së Maqedonisë nr.80/92, i plotësuar dhe ndryshuar 38/04.
- Ligji për procedurën jokontestimore i Kosovës . Nr. 03/ L-007 datë 13.12.2008.

Mentor Bajraktari* **Besnik Bislimaj***

SHQYRTIMI FILLESTAR SIPAS PROCEDURËS PENALE

ABSTRAKT

Arsyeja e trajtimit të Shqyrtimit Fillestar sipas Procedurës Penale është sepse gjykatat e ndryshme të Kosovës kanë pasur qasje të ndryshme të zbatimit të këtij instituti sa i përket shqyrtimit të aktakuzës me hyrjen në fuqi të Kodit të Procedurës Penale, me 1 Janar 2013. Andaj, zbatimi i dispozitave që parasheh Kodi i Procedurës Penale për mbajtjen e shqyrtimit fillestar paraqet interes të studimit në fushën e procedurës penale. Ky punim, përveç pjesës hyrëse përmban trajtimin rreth arritjes së aktakuzës në gjykatë, caktimin e shqyrtimit fillestar, udhëzimet që duhet ti jepen të pandehurit për të drejtat e tij gjatë shqyrtimit fillestar, vlerësimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë nga gjykata, pranimin e fajësisë nga i pandehuri, shqiptimin e dënimit gjatë shqyrtimit fillestar pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri. Gjithashtu përmban kundërshtimin e provave të aktakuzës, kërkesën për hudhjen e aktakuzës nga i pandehuri, paraqitjen e aktakuzës së ndryshuar nga Prokurori i Shtetit, hudhjen e aktakuzës dhe Përfundimin. Në fund të këtij punimi është dhënë regjistri i literaturës së përdorur për nevojat e këtij punimi.

Fjalët kyçe :

Shqyrtimi Fillestar, i pandehuri, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, kundërshtimi i provave të aktakuzës, hudhja e Aktakuzës.

Hyrje

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, një vëmendje të theksuar i ka kushtuar Shqyrtimit Fillestar. Ky shqyrtim, e bën procedurën penale të jetë me efikase, pasi menjëherë pas ngritjes së aktakuzës në shqyrtimin fillestar, në rastet kur i pandehuri e pranon fajësinë, procesi gjyqësorë mund të përmbyllet në këtë seancë me shqiptimin e dënimit nga gjyqtari i vetëm ose kryetarit të trupit gjykues.

* Mentor Bajraktari – Kandidat për Gjyqtar, bashkëpuntorë profesional në Gjykatën Themelore në Prizren

* Besnik Bislimaj – Kandidat për Gjyqtar, bashkëpuntorë profesional në Gjykatën Themelore në Prizren

Duke e ditur se Shqyrtimi Fillestar mbahet menjëherë pas ngritjes së aktakuzës, Kodi i Procedurës Penale i ka paraparë me saktësi madje dhe në detaje si mbahet Shqyrtimi fillestar, pranimi i fajësisë nga i pandehuri, kundërshtimi i provave, kërkesa për hudhje të aktakuzës, hudhja e aktakuzës, ndryshimi i aktakuzës nga prokurori i shtetit dhe detaje tjera që do trajtohen gjatë këtij punimi.

Për ta parë se si është rregulluar kjo materie sipas këtij Kodit të Procedurës Penale, po e vështrojmë më në hollësi, prej ngritjes së aktakuzës e deri në caktimin e shqyrtimit të dytë, edhe për ndonjë ndryshim, plotësim apo sugjerim eventual që është në të mirë të përsosjes së mëtejme të mbajtjes së Shqyrtimit Fillestar.

1. Shqyrtimi fillestar

Prokurori i Shtetit pas përfundimit të hetimeve, ose kur konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryesin e saj paraqesin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale e ngrite aktakuzën. Këtë aktakuzë ia paraqet gjykatës kompetente në kopje aq sa ka të pandehur dhe mbrojtës të tyre dhe një kopje shtesë për gjykatën. Me ngritjen e aktakuzës përfundon përfshirja e gjyqtarit të procedurës paraprake në procedurë.

Gjykata menjëherë pas pranimit të aktakuzës e cakton gjyqtarin ose trupin gjykues me kryetarin.

Nëse aktakuza ngritet në Departamentin e Përgjithshëm, shqyrtimin fillestar e mban gjyqtari i vetëm gjykues duke përfshirë edhe shqyrtimin e dytë dhe shqyrtimin gjyqësor. Ndërsa, nëse aktakuza paraqitet pranë Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore, shqyrtimin fillestar e mban kryetari i trupit gjykues duke përfshirë shqyrtimin e dytë. Shqyrtimi gjyqësor mbahet nga trupi gjykues i përbërë nga kryetari i trupit gjykues dhe dy gjyqtarë profesional.

Gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit përcakton sipas detyrës zyrtare nëse ka kompetencë mbi çështjen që përmban aktakuza dhe nëse gjen se për çështjen që është objekt i aktakuzës është kompetent për të vendosur, atëherë menjëherë e cakton shqyrtimin fillestar i cili duhet të mbahet brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktakuzës. Në rastet kur i pandehuri gjendet në paraburgim, shqyrtimi fillestar duhet të mbahet në mundësin e parë, por jo më vonë se 15 ditë pas ngritjes së aktakuzës.

Shqyrtimi fillestar rregullohet me nenin 245 të Kodit të Procedurës Penale.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit fillestar njoftohet Prokurori i Shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit nga ana e gjyqtarit të vetëm ose kryetarit të trupit gjykues. Si rregull, shqyrtimet mbahen në selinë (ndërtesën) e gjykatës. Përjashtimisht, në rastet e caktuara kur lokalet në ndërtesën e gjykatës nuk janë të përshtatshme, për shkak të mungesës së hapësirës ose për shkaqe tjera të arsyeshme, kryetari i gjykatës mund të caktojë që shqyrtimet të mbahen në ndonjë ndërtesë tjetër. Kjo çështje është e rregulluar me nenin 286 të KPP-së me të cilën përcaktohen për vendin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e që përshtatshmërishtë zbatohen edhe për shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë.

Në shqyrtimin fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit. Pavarësisht që në nenin 245 par.1 nuk është paraparë në mënyrë

shprehimore prania e të dëmtuarit, konsiderojmë se nuk është pengesë ligjore që në shqyrtimin fillestar të jetë i pranishëm edhe i dëmtuari[253]. Kjo për faktin se në rastet kur parashihet që i pandehuri mund të pranojë fajësinë në shqyrtimin fillestar sipas KPP-së në nenin 248 paragrafi 2, parashihet që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i turpit gjykues mund të kërkojë edhe mendimin e të dëmtuarit në vlerësim të pranimit të fajësisë.

Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues i jep kopjen e aktakuzës të pandehurit apo të pandehurve, nëse ata nuk e kanë pranuar këtë kopje të aktakuzës më parë dhe po ashtu vendos për të gjitha propozimet për të vazhduar apo për të zbatuar masat për sigurinë e pranisë së pandehurit. Gjithashtu, siguron që prokurori i shtetit të ketë përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 të KPP-së. Me nenin 244 të KPP-së është parapare se cilat materiale i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës, ku jo më vonë se nga ngritja e aktakuzës, prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit apo mbrojtësin kryesorë materialet e mëposhtme ose kopjet e tyre të cilat janë në posedim në kontroll ose në mbrojte të tij, nëse këto materiale nuk janë dhënë mbrojtjes gjatë hetimit e ato janë:

a. procesverbalet mbi deklarimin ose pohimet, të nënshkruara apo të panënshkruara nga i pandehuri,
b. emrat e dëshmitarëve të cilët prokurori i shtetit ka ndërmend ti thërret për dëshmim në çdo deklarim të mëhershëm të dhënë nga dëshmitarët e tillë,
c. të dhënat mbi identifikimin e personave për të cilët prokurori i shtetit e di se posedon prova të pranueshme dhe shfajësuese ose informata lidhur me çështjen dhe çdo procesverbal të deklarimeve, të nënshkruar apo të panënshkruar nga personat e tillë për këtë çështje,
d. rezultatet e ekzaminimit fizik dhe mendor, testet shkencore ose eksperimentet e bëra lidhur me çështjen,
e. kallëzimet penale dhe raportet e policisë dhe
f. përmbledhjet ose referencat për provat materiale të mbledhura gjatë hetimit.

Pra ky material dhe të gjitha deklarimet e dëshmitarëve i jepen të pandehurit në gjuhen që ai e kupton dhe e fletë.

2. Udhëzimi i pandehurit për të drejtat e tij gjatë shqyrtimit fillestar

Në fillim të shqyrtimit fillestar gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e udhëzon të pandehurin për të drejtat tij:

a. të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetjet,
b. nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë,
c. të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, dhe
d. ta kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura me aktakuzë.

Pasi që të jetë udhëzuar i pandehuri me këto të drejta në vijim gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues çmon nëse e drejta e të pandehurit në mbrojtës është respektuat dhe nëse

[253] E drejta e procedurës penale- Prof.Dr.Ejup Sahiti dhe Prof.Dr.Rexhep Murati, Faqe.339

prokurori i shteti ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 të KPP.

Pas kësaj prokurori i shtetit duhet të lexojë aktakuzën të pandehurit.

Pasi që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, të pandehurit i ofron mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm. Nëse i pandehuri nuk e ka kuptuar aktakuzën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues thërret prokurorin e shtetit që t'ia shpjegojë aktakuzën të pandehurit në mënyrë që ai ta kuptojë pa vështirësi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron të bëjë ndonjë deklarim lidhur me fajësinë e tij, konsiderohet se ai nuk e pranon fajësinë[254].

Në rastet kur i pandehuri nuk e pranon fajësinë në shqyrtimin fillestar atëherë gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues e njofton të pandehurin dhe mbrojtësin se para shqyrtimit të dytë, ata duhet që:

a. të paraqesin kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë;
b. të paraqesin kërkesat për hudhjen e aktakuzës nëse është e ndalur ligjërisht; dhe
c. të paraqesin kërkesat për hudhjen e aktakuzës për shkak të mospërshkrimit të veprës penale sipas ligjit.

Vlen të theksohet se gjatë shqyrtimit fillestar asnjë dëshmitar apo ekspert nuk merret në pyetje dhe asnjë provë nuk paraqitet gjatë shqyrtimit fillestar, përveç nëse dëshmitari është i nevojshëm për marrjen e vendimit mbi vazhdimin ose zbatimin e masave për të siguruar praninë e të pandehurit nga neni 245 paragrafi 3 i KPP-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar[255].

Për atë se a është e domosdoshme të shkohet në shqyrtim të dytë në rastet kur është vendosur lidhur me kundërshtimet në shqyrtimin fillestar ose kur nuk ka ngelur asnjë kërkesë pa vendosur për këtë, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerr një Qarkore lidhur me shqyrtimin e aktakuzës GJ.A 5/2014, të datës 03.01.2014, ku me këtë ka dhënë një sqarim sa i përket shkuarjes në shqyrtimin e dytë dhe ka këtë përmbajtje: Shqyrtimi i dytë nuk është çdo herë i domosdoshëm, mund edhe të mos shkohet fare në shqyrtimin e dytë, nëse për kundërshtimet e paraqitura, gjyqtari ka vendosur në shqyrtimin parë dhe nuk ka ngelur asnjë kërkesë e pa vendosur, nuk ka nevojë të shkohet në shqyrtimin e dytë, po mund të shkohet në shqyrtimin gjyqësor (neni 245 par.5 të KPP), në shqyrtimin e dytë shkohet vetëm kur gjykata eventualisht nuk ka vendosur për të gjitha kundërshtimet e palëve që janë parashtruar në shqyrtimin e parë fillestarë[256].

[254] Neni 245 paragrafi 6 i KPP.
[255] Neni 245 paragrafi 5 i KPP.
[256] Gjykata Supreme e Kosovës, Qarkorja lidhur me shqyrtimin e aktakuzës Gj.A 5/2014, e datës 03.01.2014, Faqe.2

3. Vlerësimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar

Prokurori i Shtetit së bashku me aktakuzë mund t'ia paraqes Gjykatës edhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Ky rast paraqitet në nenin 247 të KPP-së. Në rast kur marrëveshja mbi pranimin e fajësisë nga neni 233 të KPP-së paraqitet së bashku me aktakuzë, gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues vlerëson marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe merr këto vendime:

a. e pranon marrëveshjen
b. e refuzon marrëveshjen, ose
c. cakton shqyrtim të veçantë në pajtim me procedurat për pranimin e fajësisë nga neni 248 dhe procedurat për negocim të fajësisë nga neni 233 të KPP-së.

Në rastet kur i pandehuri deklarohet i pafajshëm, gjykata nuk mund ta dënojë të pandehurin, përveç nëse i pandehuri e ndryshon deklaratën e tij dhe pranon fajësinë, ose nëse gjykata e shpall fajtor të pandehurin pas shqyrtimit gjyqësor, pavarësisht nga marrëveshja mbi pranimin e fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shqyrtimet lidhur me kontrollin e aktakuzës nga kapitulli XV mund ti mbajë nën masa të fshehta sipas kërkesë së prokurorit të shtetit nga kapitulli XIII i KPP-së[257,] kapitull ky që ka të bëjë me mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve. (neni 247 par.3 KPP-së)

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë nga neni 233 i këtij kodi ose pranimi i fajësisë nga neni 248 të KPP-së mund të shqyrtohen nga gjykata në çdo kohë para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor[258].

4. Pranimi i fajësisë nga i pandehuri në shqyrtimin fillestar

Pasi që i është lexuar aktakuza të pandehurit dhe pasi që është udhëzuar për të drejtat tij sipas nenit 246 par.1 të KPP-së, të pandehurit i ofrohet mundësia që ta pranojë fajësinë në shqyrtimin fillestar.

Në rastet kur i pandehuri e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës sipas nenit 246 ose 247 të KPP-së, gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues duhet të shikojë se a janë përmbushur kushtet që përcaktohen me nenin 248 par.1 të KPP-së, pra nëse :

a. i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
b. pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës;
c. pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri, dhe
d. aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

[257] E drejta e procedurës penale- Prof.Dr.Ejup Sahiti dhe Prof.Dr.Rexhep Murati, Faqe.341
[258] Neni 247 paragrafi 4i KPP

Në këtë rast, gjyqtari është mbrojtësi i të drejtave të pandehurit, pra siguron se janë përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara më lartë.

Vlen të theksohet, se autorët e librit "E drejta e procedurës penale" në librin tyre kanë zëvendësuar formulimin e paragrafi 1.4 të nenit 248 të KPP-së, që në këtë punim paraqitet nën d) ku thuhet se: aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, duke formuluar dispozitën nga paragrafi 1.4 të nenit 248 me atë se: d) nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat për hedhjen e aktakuzës të parapara nga neni 253 par.1 KPP-së, me arsyetimin se dispozita e paragrafit 1.4 të nenit 248 të KPP -së është tejet e përgjithësuar e për me tepër edhe e paqartë dhe si e tillë mundë të shkaktojë dilema gjatë zbatimit të praktikës gjyqësore, duke theksuar se propozimin për formulim ligjor në fjalë, me formulimin nën d), me të drejtë e ka paraqitur dhe argumentuar gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prizren Xhevdet Elshani, në Tubimin e gjyqtarëve dhe prokuror të shtetit, avokat dhe të tjerë, të mbajtur kohë më parë në kuadër për shqyrtimeve për zbatim sa me të lehtë dhe pa pengesë të dispozitave të KPP-së në praktikë[259].

Në rastet kur i pandehuri e ka pranuar fajësinë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit mund të kërkojë mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Në qoftë se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk bindet se janë vërtetuar faktet nga neni 248 paragrafi 1 të KPP-së, ai merr aktvendim me të cilin refuzon pranimin e fajësisë dhe procedon shqyrtimin fillestar sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë.

Pavarësisht që i pandehuri nuk e pranon fajësinë në shqyrtimin fillestar, ai mund të ndryshojë deklaratën e tij dhe të pranojë fajësinë në çdo kohë dhe në këtë rast për cilin do të pandehur që dëshiron të pranojë fajësinë nga neni 248 i KPP-së, gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues zbaton përshtatshmërish procedurën e pranimit të fajësisë nga neni 248 të KPP-së.

5. Shqiptimi i dënimit gjatë shqyrtimit fillestar pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri

Kur i pandehuri pranon fajësinë gjatë shqyrtimit fillestarë dhe kur gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar faktet nga neni 248 paragrafi 1 i KPP-së, ai merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vazhdon me shqiptimin e dënimit, caktimin e seancës për vërtetimin e ndonjë fakti relevant për dënimin ose pezullon dënimin deri në përfundimin e bashkëpunimit të të pandehurit me prokurorin e shtetit. Kjo mundësi parashihet ne nenin 248 paragrafi 4 të KPP-së, me çka e bën procedurën me efikase dhe me praktike.

Me hyrjen në fuqi të Kodit të Procedurës Penale me 01.01.2013, zbatimi i nenit 248 par.4 të KPP-së ka krijuar huti duke e kuptuar në mënyra të ndryshme dhe interpretuar në mënyra të ndryshme sidomos rreth asaj se nëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar,

[259] E drejta e procedurës penale- Prof.Dr.Ejup Sahiti dhe Prof.Dr.Rexhep Murati, fusnota 322, Faqe.341

për të shqiptuar dënimin a duhet të shkohet në fjalën përfundimtare dhe për rastet kur vendos turpi gjykues prej 3 gjyqtarëve a duhet të formohet turpi gjykues.

Për këtë çështje Gjykata Supreme e Kosovës, ka dhënë mendim juridik GjA.nr.207/2013, të datës 19.03.2013 me këtë përmbajtje: Nëse i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar para gjyqtarit të vetëm ose kryetarit të trupit gjykues dhe gjyqtari i vetëm përkatësisht kryetari i trupit gjykues, vlerëson se pranimi është bërë në pajtim me ligjin d.m.th janë përmbushur të gjitha parakushtet ligjore për pranimin e fajësisë që kërkohet me ligj, në një situatë të tillë, gjyqtari i vetëm, përkatësisht kryetari i trupit gjykues mund ta vazhdojë procesin me shqiptimin e dënimit, pa shkuar fare në shqyrtim si dhe pa plotësuar fare trupin gjykues edhe kur ligji për vepra të tilla parashikon që trupi gjykues ta përbëjnë tre (3) gjyqtarë profesionistë [260].

6. Kundërshtimi i provave të aktakuzës

I pandehuri para shqyrtimit të dytë mund të paraqes kundërshtim ndaj provave të caktuara në aktakuzë. Në rastet kur i pandehuri ka avokat mbrojtës, poashtu edhe ai e ka mundësinë që t'i sfidojë provat. Avokati mbrojtës është mbrojtës jetik i të drejtave të të pandehurit.

Sipas nenit 249 të KPP-së i pandehuri mund të paraqes kundërshtime për këto arsye:

a. provat nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit ose organi tjetër qeveritar;
b. provat janë në kundërshtim me rregullat nga Kapitulli XVI i këtij Kodi; ose
c. ka bazë të artikulueshme që gjykata të çmojë provën si thelbësisht të pambështetshme.

Për kundërshtimin e paraqitur, prokurorit të shtetit i jepet mundësia që t'i përgjigjet kundërshtimit gojarisht ose me shkrim, poashtu këtë përgjigje në kundërshtimin mund ta bëjë edhe gjatë shqyrtimit të dytë gojarisht ose me shkrim. Gjithashtu, ekziston mundësia që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i jep prokurorit të shtetit kohë prej një (1) javë për të paraqitur përgjigje me shkrim ndaj kundërshtimit (neni 251 par.3 i KPP-së).

Për të gjitha provat për të cilat është paraqitur kundërshtimi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim me shkrim të arsyetuar për lejimin ose përjashtimin e provës. Në rastet kur gjykata merr aktvendim me të cilin e shpallë prova të papranueshme atëherë ato prova i ndan nga shkresat e lëndës dhe i mban të ndara nga shkresat dhe provat tjera. Vlen të theksohet se provat që shpallën të papranueshme nuk mund të shqyrtohen apo shfrytëzohen në procedurë penale, përveç në rastin e ankesës kundër aktvendimit me të cilin është shpall e papranueshme prova.

Për hir të efikasitetit të procedurës penale të gjitha provat kundër të cilave nuk është paraqitur kundërshtim sipas Kodit të Procedurës Penale janë të pranueshme në shqyrtimin gjyqësor. Përjashtimisht, nga kjo rregull përbëjnë rastet kur gjykata sipas detyrës zyrtare përcakton se

[260] Gjykata Supreme e Kosovës, Mendimi Juridik Gj.A nr.207/13, i datës 19.03.2013, Faqe.1

pranueshmëria e provës së caktuar do të cenonte të drejtat e të pandehurit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës[261].

Kundër aktvendimit me të cilën është vendosur lidhur me pranueshmërinë e provave, secila palë mundë të paraqes ankesë në afat prej 5 dite nga pranimi i aktvendimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet Gjykatës që ka marr vendimin.

7. Kërkesa për hudhjen e aktakuzës nga i pandehuri

Në nenin 250 të KPP-së, është paraparë mundësia që i pandehuri mund të paraqes kërkesë për hudhjen e aktakuzës për 4 arsye bazë dhe për atë se:

a. vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale,
b. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale,
c. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra penale është e përfshirë në falje ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen, ose
d. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.

Po ashtu sikurse te kundërshtimi i provave, edhe te kërkesa për hudhjen e aktakuzës prokurorit të shtetit i jepet mundësia që t'i përgjigjet ndaj kërkesës gojarisht ose me shkrim, poashtu këtë përgjigje ndaj kërkesës mund ta bëjë edhe gjatë shqyrtimit të dytë gojarisht ose me shkrim. Gjithashtu ekziston mundësia që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i jep prokurorit të shtetit kohë prej një (1) javë për të paraqitur përgjigje me shkrim ndaj kërkesës, (neni251 par.3 i KPP-së). Përveç kësaj në këtë rast prokurori shtetit në vend të përgjigjes ndaj kërkesës për hudhjen e aktakuzës mund të paraqesë edhe aktakuzë të ndryshuar.

Për kërkesën për hudhjen e aktakuzës të paraqitur nga ana e pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim me shkrim të arsyetuar me të cilin refuzon kërkesën ose hudh aktakuzën.

8. Paraqitja e aktakuzës së ndryshuar nga prokurori i shtetit

Nëse i pandehuri paraqet kërkesë për hudhjen e aktakuzës para shqyrtimit të dytë, prokurori i shtetit në vend të përgjegjës në kërkesë mund të paraqesë aktakuzë të ndryshuar. Aktakuzën e ndryshuar në pajtim me nenin 241 të KPP e paraqet brenda 1 jave nga shqyrtimi i dytë.

Në rastet kur aktakuza e ndryshuar paraqitet kundër një të pandehuri apo disa të pandehurve, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtim fillestar nga neni 245 të KPP-së sikurse aktakuza të ishte e re.

[261] E drejta e procedurës penale- Prof.Dr.Ejup Sahiti dhe Prof.Dr.Rexhep Murati, Faqe.343

Po ashtu i pandehuri mund të paraqesë kundërshtime të reja rreth provave nga neni 249 të KPP-së ose kërkesa për hudhjen e aktakuzës nga neni 250 i këtij kodi, por vetëm për ato pjesë të aktakuzës të cilat janë ndryshuar. Në rastet kur i pandehuri nuk i paraqet sërish kundërshtimet, apo i paraqet kërkesat e mëparshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendosë që ato kundërshtime apo kërkesa nuk janë relevante për aktakuzën e ndryshuar dhe nuk i shqyrtojnë më tej.
Po ashtu prokurori i shtetit mund të ndryshojë aktakuzën një herë, përveç në rastet kur siguron të dhëna të reja që bëjnë të nevojshme ndryshimin e aktakuzës.

9. Hudhja e aktakuzës

Gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues për çdo kërkesë për hudhjen e aktakuzës të paraqitur nga i pandehuri sipas nenit 250 të KPP-së merr aktvendim për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale kur çmon se:

a. vepra me të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale,
b. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale,
c. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është përfshirë me amnisti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen, ose
d. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.

Me rastin e marrjes së aktvendimit për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk detyrohet me cilësimin juridik të veprës penale siç është parashtruar nga prokurori i shtetit në aktakuzë.

Kundër aktvendimit me të cilën është vendosur për kërkesën për hudhjen e aktakuzës secila palë mundë të paraqes ankesë në afat prej 5 dite nga pranimi i aktvendimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet Gjykatës që ka marr vendimin.

Duhet theksuar se përveç gjyqtari i vetëm dhe kryetari i trupit gjykues, po ashtu edhe prokurori i shtetit mund të hudhë aktakuzën kur në përgjigjen ndaj kërkesës për hudhjen e aktakuzës të paraqitur nga i pandehuri nga neni 250 të KPP-së gjen se kërkesa për hudhjen e aktakuzës është e bazuar andaj merr aktvendim për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës.

10. Përfundim

-Zbatimi i Shqyrtimit Fillestar, nga ana gjyqtarëve që ngarkohen me këtë përgjegjësi si dhe zbatimi i dispozitave të Kodit të Procedurës Penale me përpikëri, është lehtësim edhe për palët në procedurën penale dhe gjykatën që në fund sjell vendimin, të mbështetur në faktet dhe provat e elaboruara.

-Një vendim meritor, gjithnjë mbështetur në prova dhe dëshmi,mbron të gjitha palët po, edhe rritë autoritetin e Gjyqësorit si dhe afirmon drejtësinë në vend.

-Është shumë e rëndësishme që, Shqyrtimi fillestar të caktohet dhe të mbahet në afatin e paraparë ligjorë, dhe ta ketë përfundimin meritor, mbështetur në Kodit e Procedurës Penale.

-Rrethanat lehtësuese me këtë rast si, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë nga i pandehuri, në këtë fazë e bën procedurën penale shumë të efektshme dhe praktike pra vetë kontributi i palëve në procedurë ka rëndësinë e vet për një përfundim të drejtë dhe të pranuar nga të gjitha palët, prandaj efikasiteti i procedurës penale mbase ka nevojë që edhe më tej të përsoset, të harmonizohet me aktet më të avancuara ndërkombëtare dhe, gjithnjë duke pasur parasysh edhe respektimin e të drejtës humane.

Bibliografia

- Kodi i Procedurës Penale nr.04/L-123
- Udhëzimi për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës 2013
- E drejta Procedurës Penale – Prof.Dr.Ejup Sahiti dhe Prof.Dr.Rexhep Murati
- Qarkoja Gjykatës Suprme të Kosovës GJ.A 5/2014, e datës 03.01.2014
- Qarkoja Gjykatës Suprme të Kosovës GJ.A194/2014, e datës 08.05.2014

Mc. Albina Shabani - Rama*

KODI I ETIKËS GJYQËSORE SI FAKTOR I DOMOSDOSHËM PËR RRITJEN E BESIMIT TË PUBLIKUT NË SISTEMIN GJYQËSORË

ABSTRAKT

Ky punim synon të paraqes rolin e etikës gjyqësore si një faktor i rëndësishëm për rritjen e besimit të publikut ne sistemin gjyqësor. Gjyqtaret, në përmbushje të funksioneve të tyre, duhet të veprojnë gjithmonë në mënyrë që të ruajnë dinjitetin, përgjegjësinë, pavarësinë dhe paanësinë e organeve gjyqësore. Ata kanë të drejtën dhe detyrimin t'i zgjidhin çështjet që iu parashtrohen me paanësi, duke u mbështetur në fakte dhe sipas ligjit, pa qenë objekt ndikimesh, presionesh, kërcënimesh apo ndërhyrjesh të padrejta direkte apo indirekte. Procesi gjyqësor duhet të zhvillohet jashtë çdo ndërhyrjeje. Drejtësia përveç se jepet duhet edhe të duket që po jepet. Mbrojtja e pavarësisë efektive të çdo gjyqtari është e lidhur me formën e duhur të përgjegjshmërisë së tij, esenciale për to për mendimin tim është etika. Për një gjyqtar nuk mjaftohet të thuhet se çfarë është e ligjshme është edhe etike. Rregullat etike vendosin shpeshherë kritere më të larta se ligji. Etika përfaqëson standardet më të larta, të cilat gjyqtarët veçanërisht duhet të përpiqen të ruajnë.

Hyrje

1. Kodi i etikës gjyqësore si domosdoshmëri në sistemin gjyqësor

Gjyqtarët janë zyrtarë të rëndësishëm shtetëror autoriteti i të cilëve shtrihet në çdo sferë të jetës shoqërore, të cilët përmes procesit të zgjedhjes së kontesteve që paraqiten mes njerëzve dhe zbatimit të ligjeve, ata definojnë të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, vendosin për çështje të rëndësishme në sektorin publik dhe privat, si dhe vendosin lidhur me veprimet e zyrtarëve tjerë shtetëror. Kështu që, vendosja e një pushtetit kaq të madh tek gjyqtarët kërkon që ata të kenë standarde të larta të sjelljes së tyre, si brenda ashtu edhe jashtë gjykatave.

* Mc. Albina Shabani Rama, nga Prishtina, Inspektore në Zyrën e Prokurorit Disiplinor ne Prokurorin e Shtetit, kandidate per gjyqtare.

Për të përcaktuar këto standarde të sjelljes tanimë është pranuar ideja se është e domosdoshme nxjerrja e një kornize të rregullave të etikës gjyqësore, që siguron se gjyqtarët dhe publiku janë të vetëdijshëm për parimet që udhëheqin gjyqtarët në jetën e tyre personale dhe profesionale.

Nxjerrja e rregullave të etikës gjyqësore nëpër shtete të ndryshme jo gjithherë është mirëpritur, edhe atë kryesisht duke e ndërlidhur me ndeshjen që këto rregulla kanë me parimin e pavarësisë së gjyqësorit. Dihet se parimi i pavarësisë së gjyqësorit konsiderohet si standard i domosdoshëm për çdo shoqëri demokratike, dhe në këtë kontekst është përmendur shpesh si argument që nëse nxjerrën rregulla të sjelljes për gjyqtarët, atëherë kufizohet kjo pavarësi e tyre. Ekziston një bindje që përcaktimi i standardeve gjyqësore të sjelljes dhe kërkimi i përgjegjësisë për shkeljen e tyre ndërhynë në pavarësinë e gjyqësorit. E në anën tjetër, që të ekzistojë besimi i qytetarëve tek sistemi gjyqësor, gjyqtaret duhet të jenë në gjendje që të ofrojnë besueshmëri, e cila arrihet përmes respektimit të rregullave dhe parimeve etike.

Sidoqoftë, në pjesën më të madhe të shteteve, këto dy elemente, pra pavarësia e gjyqësorit dhe përgjegjësia e gjyqtarëve shihen si plotësuese për njëra tjetrën dhe që kanë të njëjtin qëllim, avancimin e gjyqësisë së pavarur dhe rritjen e besimit të publikut në kapacitetin e gjyqtarëve.

Jo vetëm besimi i publikut por edhe suksesi i gjykatave varet në një masë të madhe në bazë të zbatimit të kodit të etikës. Nëse gjyqtarët e kryejnë funksionin e tyre etik, duke mos anashkaluar edhe atë profesional, publiku do të ketë besim dhe respekt në institucionet gjyqësore dhe do të veprojnë në përputhje me vendimet e tyre.

Ky besim nuk mund të mbahet dhe të përforcohet në qoftë se gjyqtarët nuk janë në përputhje me këtë kod dhe në qoftë se ata nuk i respektojnë standardet më të larta të sjelljes korrekte etike. Gjithashtu, në qoftë se shteti nuk siguron se gjyqësori i ka në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme dhe burimet për të iu mundësuar atyre për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efikase dhe në kohë të arsyeshme.

Në kohën kur u paraqiten si nevojë e domosdoshme rregullat etike, krahas përgatitjes profesionale ka qenë dileme se kush duhet ti nxjerr këto rregulla duke marrë parasysh se kjo kornizë e rregullave gjyqësore direkt ndikon në pavarësinë e gjyqësorit.

Marrë parasysh se çështja e pavarësisë gjyqësore duhet të rregullohet nga vet kjo degë e pushtetit shtetëror dhe të mos lejohet intervenimi nga ana e pushtetit legjislativ apo ekzekutiv, atëherë edhe çështja e kodifikimit të etikes që është thelbësore për përcaktimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe hyn në pjesën ku prek pavarësinë e gjyqësorit duhet të rregullohet nga vet pushteti gjyqësor. Duke u nisur nga fakti i sipërpërmendur, gjyqësori është ai që duhet të merr rol proaktiv në nxjerrjen e kodeve dhe rregullave të etikës, pa pritur ndërhyrjen e legjislativit ose ekzekutivit. Është pikërisht procesi i nxjerrjes së këtij kodi që ndikon në zbatimin e tij, prandaj ky proces duhet të reflektoj domosdo edhe diskutimet dhe mendimet e gjyqtarëve dhe këto parime të nxjerrën me miratimin e tyre.

Etika është element thelbësor për rolin e gjyqtarëve. Njohja dhe zbatimi i rregullave të etikes është thelbësore për të garantuar sundimin e së drejtës, demokracinë dhe qeverisjen e mirë në çdo shoqëri.

3. Historiku i paraqitjes se kodit të etikës gjyqësore

Përderisa të gjitha shtetet e pranojnë se rregullat etike dhe morale janë më se të domosdoshme jo vetëm për sigurim të besimit të publikut por edhe për ti udhëzuar vet gjyqtaret se si te sillen në situatë të ndryshme, jo të gjitha shtetet e kanë rregulluar këtë çështje njëjtë, disa me kode gjyqësore, pjesa dërmuese kanë nxjerrë vetëm rregulla të etikës për të siguruar një gjyqësor më të mirë.

Kodi i Etikës Gjyqësore si përmbledhje e rregullave etike, për herë të parë është paraqitur në SHBA, në vitin 1924, nga Asociacioni i Avokatëve Amerikan (American Bar Association) i cili e bënë çështjen e etikës problem qendror. Këto përpjekje në SHBA nuk janë ndalur që atëherë dhe rregullat e tilla janë rishkruar dhe ndryshuar shumë herë dhe së fundi në vitin 2010 është nxjerrë kodi më i ri. Tani në botë thuajse janë nxjerrë kudo kode të etikës gjyqësore, të cilat shihen si garantues të integritetit gjyqësor. Iniciativat për nxjerrjen e tyre kanë ardhur në momente të ndryshme, duke filluar nga takime të ndryshme ndërkombëtare, nga vet gjyqtarët, gjykatat e gjithashtu edhe nga avokatët. Në vitin 1998 është nxjerrë Karta Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve. Në vitin 1999 është nxjerrë një kod i tillë në Indi, pastaj në vitet në vijim edhe në Afrikë të Jugut, Australi, etj.

Edhe në Kosovë me 25 prill 2006 është nxjerr Kodi i Etikes Gjyqësore nga Këshilli Gjyqësorë i Kosovës, i cili paraqet një tërësi të standardeve dhe normave morale që ju ndihmon gjyqtarëve që të pajisen me një ndër aftësitë me themelore, aftësinë për të gjykuar dhe vendosur me ndershmëri e paanësi, pa u ndikuar nga faktorët e jashtëm dhe të liruar nga çdo formë e presionit.

Gjyqtarët, gjithashtu janë edhe të obliguar të veprojnë në përputhje me këtë Kod të Etikës dhe mosrespektimi i tij sjell deri te përgjegjësia disiplinore.

3. Përmbajtja e Kodit të Etikës Gjyqësore

Kodi i etikës gjyqësore ka për qellim që ti përcaktoj standardet për sjelljet etike të gjyqtarëve përmes parimeve të cilat shërbejnë si instrumente për të mbajtur gjyqtarët në binarët e pavarësisë, paanësisë, profesionalizmit dhe transparencës. Parimet themelore janë parimi i pavarësisë, parimi i paanësisë, parimi i integriteti, respektimi i të drejtave të palëve në procedurë etj. Gjyqtarët duhet që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ti respektojnë parimet etike të sjelljes profesionale. Këto parime nuk përfshijnë vetëm detyrime që mund të sanksionohen me masa disiplinore por gjithashtu ofrojnë udhëzime për gjyqtarët se si duhet të sillen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

4. Parimi i pavarësisë

Pavarësia e gjyqësorit është parakusht për sundimin e ligjit dhe një garanci themelore për një gjykim të drejtë. Pavarësia e gjyqësorit duhet të jetë ligjore, funksionale dhe financiare. Ajo duhet të garantohet dhe mbrohet nga degët tjera të pushtetit, nga palët që kërkojnë drejtësi, nga

gjyqtaret tjerë dhe shoqëria në përgjithësi përmes rregullave kombëtare të nivelit më të larte. Shteti dhe secili gjyqtar janë përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit.[262] Pavarësia e gjyqësorit garantohet në veçanti me mënyrën e rekrutimit, nominimit deri në moshën e pensionimit, ngritjen në pozitë, pamundësinë e shkarkimit, trajnimin, imunitetin gjyqësor, disiplinën, kompensimin dhe financimin e gjyqësorit.

Pavarësia e gjyqësorit nuk është privilegj i gjyqtarit individual. Ajo është përgjegjësi e çdo gjyqtari që i mundëson atij për të gjykuar një kontest me ndershmëri dhe paanshmëri ne bazë të ligjit dhe provave, pa presion apo frike për ndërhyrje nga jashtë. Thelbi i parimit të pavarësisë së gjyqësorit është liria e plotë e gjyqtarit për ti shqyrtuar dhe vendosur rastet para gjykatës dhe asnjë palë e huaj duke përfshirë pushtetin legjislativ, qeverinë, individët apo gjyqtaret e tjerë nuk duhet të ndërhyjnë ose të përpiqen për të ndërhyrë në mënyrën se si një gjyqtar zhvillon një rast dhe merr vendim. Pra, gjyqtari ushtron funksionin gjyqësor në mënyrë të pavarur në bazë të vlerësimit të fakteve dhe sipas kuptimit të ndërgjegjshëm të ligjit, i lirë nga çdo ndikim i jashtëm, shtytje, presion, kërcënim ose ndërhyrje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë nga cilido kënd dhe për çfarëdo arsye. Gjyqtari duhet të inkurajoj dhe të mbrojë ushtrimin e detyrave gjyqësore dhe të ruaj pavarësinë institucionale të gjyqësorit. Ai duhet të promovoje standarde të larta të sjelljes gjyqësore në mënyrë që të rris besimin e publikut në sistemin gjyqësor që është parakusht thelbësor për ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit.

5. Parimi i paanshmërisë

Paanshmëria është thelbësore për ushtrimin e rregullt të funksionit gjyqësorë. Kjo vlen jo vetëm për vendimin por edhe për procesin përmes të cilit është marrë vendimi. Për të kuptuar më mirë parimin e pavarësisë, duhet të kihet parasysh se pavarësia është parakusht i domosdoshëm i paanshmërisë. Një gjyqtar mund të jete i pavarur dhe të mos jetë i paanshëm, mirëpo një gjyqtar që nuk është i pavarur nuk mundet assesi të jetë i paanshëm.

Paanshmëria është cilësi themelore që kërkohet nga një gjyqtar dhe është atribut thelbësorë i gjyqësorit, ajo duhet të ekzistoj edhe si çështje faktike por edhe si çështje e perceptimit të arsyeshëm. Nëse përceptohet se gjyqtari nuk ka vepruar në mënyrë të paanshme, atëherë ky përceptim shkakton krijimin e një ndjenje të padrejtësisë që ndikon në dëmtimin e besimit në sistemin gjyqësorë. Ky perceptim mund të lind për disa arsye si konflikti i interesit, sjellja e gjyqtarit gjatë detyrës apo edhe nga veprimet ose aktivitetet e gjyqtarit jashtë gjykatës.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka sqaruar se ka dy aspekte të parimit të paanshmërisë[263]. Së pari gjyqtari duhet të jete subjektivisht i paanshëm d.m.th nuk duhet të këtë ndonjë paragjykim apo anshmëri personale. Paanshmëria personale duhet të supozohet, përveç kur ka arsye për të besuar të kundërtën. Së dyti, gjyqtari duhet gjithashtu të jetë i paanshëm nga një këndvështrim objektiv, pra ai duhet të ofroj garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim, duke përfshirë nga paraqitja e tij e deri te sjellja personale. Nëse një gjyqtar duket të jetë i anshëm kjo e dëmton besimin e publikut ne sistemin gjyqësorë. Prandaj, gjyqtari duhet

[262] Magna Karta për Gjyqtarët, 17-19 nëntor 2010 Strasburg
[263] Gregory vs Mbretëria e Bashkuar, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (1997)

të përjashtoj veten nga të gjithë aktivitetet të cilat mund të perceptohen se vendimi i gjyqtarit mund të ndikohet nga faktorët e jashtëm. Vet termi anshmëri përkufizohet si një prirje, aftësi apo predispozitë ndaj njërës apo tjetrës palë për një rezultat të caktuar. Anshmëria është gjendje mendore, qëndrim apo pikëpamje e cila ndikon tek gjyqtari për të ushtruar funksionin e tij në mënyrë të paanshme. Njëanshmëria mund të manifestohet gojarisht apo fizikisht përmes përdorimit të epiteteve, fyerjeve, pseudonimeve, gjuhës trupore dhe shprehjes së fytyrës. Gjyqtari do të sigurojë se sjellja e tij si brenda ashtu edhe jashtë gjykatës ruan dhe rrit besimin e publikut, profesionisteve ligjor dhe të palëve në paanshmërinë e tij dhe atë përmes shmangies nga komunikimi ex parte, nga "kontrollimi" i sjelljeve edhe fjalëve të tij edhe jashtë gjykatës dhe kujdesi për konflikt te interesit aty kur është i domosdoshëm.

6. Integriteti

Integriteti është element thelbësor për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, është atribut i ndershmërisë dhe drejtësisë. Komponentët e integritetit janë ndershmëria dhe morali gjyqësorë. Gjyqtari duhet gjithmonë dhe jo vetëm gjate ushtrimit të detyrës zyrtare, të veproj me nder dhe të jetë i virtytshëm në sjellje dhe karakter. Integriteti si koncept nuk mund të shkallëzohet, ai është absolut. Në gjyqësor integriteti është më shume se virtyt është një domosdoshmëri, sepse besimi i publikut tek institucionet e drejtësisë nuk varet vetëm nga profesionalizimi i gjyqtarëve por edhe nga integriteti i tyre moral. Është detyrë e tyre që jo vetëm të vendosin për çështje në mënyrë të ndershme dhe të paanshme por edhe ta bëjnë punën e tyre në mënyrë të tille që të mos ngjallin asnjë dyshim për të kundërtën. Prandaj, aftësia e tyre profesionale është vetëm njëra anë e medaljes, ana tjetër po aq e rëndësishme është sigurimi i besimit të publikut në paanshmërinë e tyre. Andaj, nga gjyqtaret pritet që të jenë jo vetëm një "gjyqtar i mirë' por edhe një "qytetar i mirë" sepse sjellja dhe imazhi i tij ndikojnë edhe në sistemin gjyqësor në tërësi. E gjithë kjo arrihet përmes një standardi të lartë në jetën private dhe publike, sjelljes në gjykatë dhe respektimit rigoroz të ligjit.

Integriteti është një karakteristikë e brendshme që do të thotë se një person vepron në përputhje me parimet dhe vlerat specifike, se nuk bën kompromise, as në punë, as në jetën private. Do të thotë një kryerje e detyrave të punës në mënyrë të ndershme, me mirëbesim, korrektësi dhe me zell. Në fakt, integriteti manifestohet në kryerjen e akteve gjyqësore me objektivitet, me barazi të plotë, duke plotësuar kushtet e ligjit, të gjitha këto për ligjshmërinë e aktit.

7. Konkludimi

Drejtësia është shtylla vertebrale e çdo shoqërie demokratike. Sundimi i ligjit dhe pranimi i vlerave dhe parimeve të tij nënkupton besimin tek drejtësia. Që të ekzistojë besimi i qytetarëve tek sistemi, profesionistët e sistemit të drejtësisë duhet të jenë në gjendje që të ofrojnë besueshmëri. Ata duhet të kenë sjellje të paqortueshme dhe sjellje profesionale shembullore sepse perceptimi i publikut lidhur me punën e gjyqësorit ndikon direkt në besueshmërinë ndaj sistemit gjyqësor dhe është publiku ai që gjykon përfundimisht për përformancën etike të

gjyqësorit. Prandaj, secili gjyqtar duhet të sillet dhe të veproj në bazë të ligjit dhe rregullave etike të Kodit të Etikes Gjyqësore.

Si përfundim, duhet ritheksuar se etika gjyqësore është brengë e përbashkët e gjyqtarëve dhe tërë komunitetit të juristëve dhe për më tepër nuk konsiderohet privilegj për gjyqtarët, por si e drejtë e qytetarëve që kanë të drejtë të binden se gjykatat janë institucioni më legjitim dhe më i besuari që trajton çështjet e tyre. Etika gjyqësore është bashkëshoqëruese e sundimit të së drejtës, qeverisjes së mirë dhe demokracisë që krijon besueshmëri të publikut për garantim kushtetues të të drejtave të tyre dhe vendosje të paanshme e të drejtë të kontesteve që kanë.

Sidoqoftë, përkundër dobisë që kanë kodet e etikës, ato nuk janë dhe nuk duhet kuptuar si zëvendësime të etikës individuale të gjyqtarëve, pasi që sistemi gjyqësor nuk mundet të mbështetet në gjyqtar të cilët vetëm respektojnë rregullat e përcaktuara me kod dhe nuk kanë vlera etike individuale. Sepse edhe gjyqtarët janë qenie njerëzore që kanë përparësi dhe mangësi si çdo qenie tjetër njerëzore. Ata duhet gjithnjë të bëhen objektiv në ushtrimin e detyrave të tyre, mirëpo nuk mund të ikin nga formësimi personal që kanë marrë gjatë përvojave të tyre jetësore.

Bibliografia

- Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut,1948, KB
- Parimet Bazë të KB mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, 1985, KB
- Standardet Evropiane për Pavarësinë e Sistemit Gjyqësorë, Komisioni i Venecias, 2010
- Rekomandimi i Këshillit të Evropës 94/12 lidhur me pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtareve, 1994,
- Magna Karta për Gjyqtaret, 2010,
- Parimet e Bangalorit, Komentar, 2007, KB,
- Kodi i Etikes Gjyqësorë dhe Sjelljes Profesionale, Prill 2006,
- Etika Gjyqesore, Jetish Maloku, 2013

Naime Ahmeti*

I PANDEHURI -TË DREJTAT E PANDEHURIT NË PROCEDURËN PENALE

ABSTRAKT

Të drejtat e të pandehurit në procedurën penale, janë të garantuara me Kushtetutë dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, si dhe me Konventa Ndërkombëtare, e që si të tilla organet të cilat zbatojnë procedurën penale janë të obliguara që t'i respektojnë në tërsi. Në këtë punim, në mënyrë të detajuar do të trajtohen këto të drejta, pozita juridike e të pandehurit në procedurë penale, në faza të ndryshme të procedurës. Vëmendje e posaçme do t'i kushtohet të drejtave të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës penale, si dhe mjetet juridike të cilat ka të drejtë t'i përdor i pandehuri për mbrojtjen efikase të të drejtave të tij.

Fjalët kyçe: i pandehur, procedurë penale, mjete juridike, mbrojtës, prokuror, gjykatë, policia.

Hyrja

Procedurën penale e përbejnë subjektet, Gjykata, Prokuroria, i pandehuri si dhe subjektet tjerë gjatë fazave të ndryshme të procedurës penale si i dëmtuari, eksperti, dëshmitarët etj.

Procedura penale vihet në lëvizje kundër të pandehurit si subjekt kur ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer vepër penale. Personi që kryen vepër penale është subjekt i veprës penale, njëkohësisht subjekt aktiv i procedurës penale.

Ndërsa, person i dyshuar është personi i mundshëm për kryerjen e veprës penale apo që ka informacion për veprën penale. Ndaj këtij personi formalisht nuk ka filluar procedura penale por edhe ky ka disa të drejta qoftë në fazën parapenale apo në ndonjë faze tjetër të procedurës. Kështu i dyshuari nuk mund të merret në pyetje pa ju sqaruar arsyeja e ndalimit të tij e po ashtu edhe të merret në pyetje pa iu siguruar mbrojtësi, pasi që kjo përbën provë të papranueshme, e cila në një faze të mëvonshme mund të shpallet si e tillë, përveç nëse është fjala për heqje dorë nga mbrojtja e detyrueshme-mirëpo edhe në këtë rast i caktohet një avokat në cilësi të këshilltarit.

Me ekzistimin e dyshimit të bazuar se një person ka kryer vepër penale, dhe kur për këtë ekzistojnë prova të mjaftueshme ndaj tij, fillon edhe zbatimi i procedurës penale dhe zbatimi i

* Naime Ahmeti, bashkepuntore profesionale ne Gjykaten e Apelit në Prishtinë, kandidate per gjyqtare.

normave proceduralo-juridike që ndërlidhen me të drejtat dhe detyrimet e të pandehurit por edhe të organeve që e venë në veprim këtë procedurë. Kështu, organet që zhvillojnë procedurën penale Gjykata, Prokuroria, Policia duhet të bëjnë individualizimin e të pandehurit dhe mundësisht edhe identifikimin si person i cili dyshohet se ka kryer veprën penale, e që duhet të vërtetohet identiteti dhe vendbanimi i tij në mënyrë që të fillohet procedura hetimore. Të gjitha këto pasi procedura penale nuk mund të zbatohet ndaj dy personave nëse veprimet i ka ndërmarr vetëm njëri. Ndaj personit që zhvillohet procedura penale nuk është pengesë që hetimi të filloj, të zbatohet edhe si personi NN nëse ekziston figura e tij, veprimet që i ka ndërmarrë apo edhe pasoja por që nuk i dihet identiteti dhe vendbanimi.

Cilësinë e personit të dyshuar mund ta fitoj çdo person pavarësisht moshës. Pra, i dyshuar mundet me qenë edhe fëmija, ndërsa i pandehuri këtë cilësi e fiton prej moshës 18 vjeçare, pa marrë parasysh se a ka aftësi të veprimit apo jo, dhe nëse është i mitur sepse sipas ligjit edhe ndaj të miturit mbi moshën 14 vjeçare zhvillohet procedura penale. I pandehuri, njëkohësisht është edhe person aktiv i procedurës penale pasi që personalisht duhet të marrë pjesë gjatë zhvillimit të procedurës penale. Ky rol aktiv i tij vije në shprehje sidomos në rastin e detyrimit të tij që ti bindet kufizimeve të të drejtave të tij.

Pozita e të pandehurit është e rregulluar dhe avancuar gjate dekadave të kaluara me të drejtën pozitive ndërkombëtare dhe i pandehuri është subjekt i barabartë me subjektet e tjerë në procedurën penale. Aktet kryesore ndërkombëtare që garantojnë standardet për gjykim të drejtë janë:

- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Politike dhe Civile (PNDPC) neni 14 pika 1, i cili ka përcaktuar “se të gjithë janë të barabartë përpara organeve të drejtësisë”.
- Deklarata mbi të drejtat e njeriut e OKB-së të vitit 1948, të cilin e hasim në nenin 11 paragrafi 1 të deklaratës me formulimin “çdo kush që është akuzuar për vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm derisa në bazë te ligjit në shqyrtim publik në të cilin ka pasur të gjitha garancitë për mbrojtjen e vet të mos provohet pafajësia:
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut neni 6 paragrafi 1, E drejta për proces të rregullt “çdo kush ka të dejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht”.

Këto parime janë të implementuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe janë të ngritura në parime të standardizuara, në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

KPP i ka paraparë si parime kryesore në dispozitat e përgjithshme :

Kufizimi i të drejtave të pandehurit, para marrjes së aktgjykimit të formës së prerë liritë dhe të drejtat tjera të pandehurit mund të kufizohen vetëm sipas kushteve të përcaktuara me këtë kod[264].

[264] KPP neni 1 par. 3

Vetëm gjykata kompetente e pavarur dhe e paanshme mund ti shqiptoj sanksion penal kryesit të veprës penale në procedurë të filluar dhe të zbatuar sipas këtij kodi[265].

Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe in dubio pro re, çdo person i dyshuar ose që akuzohet për vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa te vërtetohet pafajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës[266].

Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit (in duio pro reo)[267].

Parimi ne bis in idem, askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale nëse është liruar ose për të cilin është dënuar me vendim të formës së prerë ose nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë[268].

Me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike vetëm në favor të personit të dënuar[269].

Gjykim i drejtë , i paanshëm dhe në afat të arsyeshëm, "çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkoj procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme[270]

Parimi i pavarësisë së gjykatës e cila duhet të jetë e pavarur dhe të vendos në bazë të ligjit[271]

Parimi i barazisë së palëve, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë[272].

Ligjshmëria e privimit nga liria dhe vendosja në procedurë të përshpejtuar "çdo person i privuar nga liria me arrest ose me ndalim, sipas procedurës së paraparë me këtë Kod ka të drejtë të ndërmarrë masa sipas të cilave për ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të tij të vendos gjykata në procedurë të përshpejtuar ose urdhëron lirimin e tij kur ndalimi është i paligjshëm.[273]

Parimi i publicitetit shqyrtimi gjyqësor është i hapur, përveç në rastet kur kjo është e paraparë më dispozita ligjore mund edhe të kufizohet[274].

Parimi i sanksionit penal "vetëm gjykata e pavarur dhe e paanshme mund të shqiptoj sanksion penal kryerësit të veprës penale në procedurë të filluar dhe të zbatuar sipas këtij Kodi"[275].

Sipas Kodit të Procedurës Penale janë përcaktuar edhe shprehjet: i dyshuar -personi për të cilin policia dhe prokurori i shtetit dyshojnë se ka kryer vepër penale, por ndaj të cilit nuk është

[265] KPP neni 2
[266] KPP neni 3 par.1
[267] KPP neni 3 par.2
[268] KPP neni 4 par.1
[269] KPP neni 4 par.2
[270] KPP neni 5 par. 1,2,3,4
[271] KPP neni 8 par. 1,2
[272] KPP neni 9 par. 1
[273] KPP neni 12 par. 1,2
[274]KPP neni 293 par.1
[275] KPP neni 2

filluar hetimi, i pandehur- personi kundër të cilit zbatohet procedura penale, i akuzuar- personi kundër të cilit është paraqitur aktakuza dhe është caktuar shqyrtimi gjyqësor, person i dënuar- personi i cili me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale.

Të drejtat e të pandehurit

E drejta për t'u konsideruar i pafajshëm

Kjo e drejtë e të pandehurit mbrohet në të gjitha fazat e procedurës penale përderisa për fajësinë e tij nuk vendoset me vendim të formës së prerë. Në bazë të këtij detyrimi, i pandehuri është i liruar nga detyrimi i të provuarit të pafajësisë, nuk ka detyrim që të prezantoj prova dhe të mbrohet se është i pafajshëm, që të mos akuzoj veten, mirëpo kjo e drejt nuk e mbron nga zbatimi i procedurës penale kundër tij dhe nga kufizimi i të drejtave të tij. Në promovimin e këtij parimi i pandehuri:

- Nuk është i detyruar për tu mbrojtur
- Nuk është i detyruar që ta pranoj fajësinë
- Ka të drejtë për tu mbrojtur
- Ka detyrim që të marrë pjesë në procedurë
- Nuk është pengesë për pranimin e fajësisë

I pandehuri nuk është i detyruar ta provoj pafajësinë e tij, mirëpo, prezumimi nuk është pengesë që ai ta pranoj fajësinë, ky parim shpesh herë shkelet dhe paragjykohet nga policia, prokuroria, gjykata, mjetet e informimit etj.

E drejta në prova dhe fakte vendimtare

Kjo e drejtë e të pandehurit konsiston në obligimin e prokurorisë, gjykatës dhe organeve tjera që zbatojnë procedurën penale që të vërtetojnë faktet që shkojnë në dëm të pandehurit dhe faktet që shkojnë në favor të pandehurit nga të cilat varet vendimi përfundimtar. Nëse një fakt i cili shkon në dëm te pandehurit dhe nuk është vërtetuar në mënyre të plotë, interpretohet në favor të pandehurit edhe pse nuk është vërtetuar plotësisht por duhet të jetë fakt vendimtar.

E drejta e të pandehurit sipas parimit ne bis idem

Mundëson që askush nuk mund të ndiqet e as të gjykohet për vepër penale për të cilën është liruar, ose akuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës. Kur është fjala te kjo e drejtë duhet cekur se me rastin e zbatimit të këtij parimi duhet të ekzistoj identiteti subjektiv dhe objektiv i aktakuzës me aktgjykim që d.m.th se procedura e përfunduar vepron kundër personit të përcaktuar ndërsa identiteti objektiv nënkupton se duhet të ekzistoj përputhshmëri e plotë e elementeve të veprës penale për të cilat ka përfunduar procedura penale me elemente të veprës penale për të cilën nuk mund të zbatohet një procedurë tjetër penale.

E drejta për t'u njoftuar me shkaqet e ndalimit apo akuzës

Nënkupton të drejtën e të pandehurit për të mos u vet fajësuar, e drejta për të heshtur, mos fajësuar veten apo të afërmit e tij, ndalimi për imponimin e fajësisë apo çdo deklarimi përmes torturës, forcës, kërcënimit, premtimit etj.

E drejta për t'u njoftuar me të drejtat e tij

Është e drejta e të pandehurit që me rastin e privimit të tij nga liria menjëherë të njoftohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestit të tij, të drejtën në mbrojtës sipas zgjedhjes së tij, të drejtën që të njoftohet anëtari i familjes së tij lidhur me arrestimin dhe të gjitha këto duhet të shënohen në procesverbal.

E drejta për të heshtur

Kjo e drejtë e të pandehurit konsiston në mosdhënien e deklaratës për të mos dhënë përgjigje në pyetje, për të mos e fajësuar veten apo pranuar fajësinë. Organet që zhvillojnë procedurën penale janë të obliguara të bëjnë individualizimin e personit ndërsa që sipas këtij obligimi ligjor i pandehuri duhet ta bëjë identifikimin e tij në bazë të deklarimit. Këto të dhëna duhet të jenë të sakta, por sipas këtij obligimi as sesi nuk ka mundësi që ai të detyrohet që këto të dhëna ti paraqes saktësisht, por kjo nuk është pengesë për zhvillimin e procedurës penale pasi që kjo nuk do të thotë se ai në ndonjë fazë të mëvonshme të procedurës penale të hesht pasi që kjo nuk është dhe interesi më i mirë i tij. Kjo e drejtë ka përjashtim nëse shpallet dëshmitar bashkëpunues.

E drejta për të pasur mbrojtës

Nënkupton të drejtën për të pasur një mbrojtës gjatë gjithë procedurës, për këtë të drejtë udhëzohet para çdo marrje në pyetje dhe gjatë marrjes së tij në pyetje. Mbrojtja e domosdoshme është në rastet e mbrojtjes së detyruar në procedurat kur të miturit janë të pandehur për dhune në familje kur i pandehuri tregon shenja të çrregullimeve mendore. E drejta në mbrojtës nuk shuhet asnjëherë, kjo e drejtë nënkupton mbrojtjen edhe kur i pandehuri heq dorë nga kjo e drejte. I pandehuri ka të drejtë në mbrojtës në shpenzime publike në rast se procedura penale zhvillohet për vepër penale të dënueshme me 8 ose më shumë vjet, në rastet kur caktimin e mbrojtjes e diktojnë interesat e drejtësisë dhe në rastet kur i pandehuri nuk mund ti përballoj shpenzimet e mbrojtjes, po ashtu i pandehuri ka të drejtë për të pasur më së shumti deri në tre mbrojtës. Ndërsa mbrojtësit duhet ti jepet kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes.

E drejta për qasje në prova

I pandehuri dhe mbrojtësi në çdo kohe të kenë qasje në shkresa të lëndës para hetimit formal, pas fillimit të hetimit nga prokurori, pas përfundimit të hetimit dhe pas ngritjes së aktakuzës.

E drejta për të propozuar prova

I pandehuri ka të drejtë të propozojë prova dhe dëshmi në favor të tij ndërsa mbrojtësi e ka për obligim ti kundërshtoj provat nga prokurori dhe i dëmtuari dhe të propozoj prova të cilat shkojnë në favor të pandehurit.

Të drejtat e të pandehurit pas ngritjes së aktakuzës

Pas ngritjes së aktakuzës i pandehuri ka të drejt :

Ti dorëzohet kopja e aktakuzës, që gjyqtari të siguron që i pandehuri të ketë mbrojtës dhe të kuptoj akuzat ndaj tij të përfshira në aktakuzë, si dhe ti mundëson atij që të deklarohet fajtor apo i pafajshëm. Të njoftohet nga gjyqtari për të drejtën e tij që të paraqes kërkesë për hedhjen e aktakuzës apo për të kundërshtuar provat brenda 30 ditëve ose para shqyrtimit të dytë gjyqësor. Të njoftohet me të drejtën për të propozuar dëshmitar dhe prova të cilat shkojnë në favor të tij.

Të drejtat e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor

I pandehuri ka të drejtë për t'u njoftuar me kohë për shqyrtim gjyqësor. Prania e të pandehurit në procedurë sigurohet përmes thirrjes, afati është tetë ditor para shqyrtimit gjyqësor. Thirrja i dorëzohet personalisht dhe njoftohet për të drejtën në mbrojtës si dhe për pasojat e mosardhjes së tij pasi që gjykata ka tagër që të pandehurin ta sjell edhe forcërisht. Kjo për faktin se asnjë seancë e shqyrtimit gjyqësor nuk mund të mbahet pa praninë e të pandehurit, nëse është thirrur me rregull dhe nuk i është përgjigjur ftesës. Detyrimi për mbajtjen e rendit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe e vetmja mundësi që ligji ka paraparë që shqyrtimi gjyqësor të mbahet pa praninë e të pandehurit, është largimi i tij nga shqyrtimi gjyqësor për shkak të mos mbajtjes së rendit gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor.

Të drejtat e të pandehurit para gjykatës së shkallës së dytë

I pandehuri ka të drejtë të marrë pjesë në seancën që vendoset sipas ankesës në shkallë të dytë por nuk ka detyrim për këtë. Nga kjo e drejtë rrjedh se është i detyruar që ta njoftoj gjykatën për ndryshimin e adresës ndërsa seanca mund të mbahet edhe pa praninë e tij.

E drejta për mjete të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike

Mjetet e rregullta juridike që mund ti ushtroj i pandehuri është ankesa kundër aktgjykimit dhe ankesa kundër aktvendimit, ndërsa mjete të jashtëzakonshme juridike i pandehuri ka të drejtë të ushtroj:

1. Kërkesën për rishikim të procedurës penale, kur me rastin e paraqitjes së provave për të cilat nuk ka ditë apo ska mund ti prezantoj gjatë shqyrtimit gjyqësor e të cilat do të kishin ndikuar në marrjen e një vendimi tjetër.
2. Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit, kur pas formës së prerë të aktgjykimit paraqiten rrethana të reja të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë, gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato do të mund të ndikonin në dënimin më të ulët.
3. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila është mjet efikas kur me rastin e vendosjes në procedurë gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë ka shkelje të ligjit penal dhe shkelje të dispozitave procedurale.

Heqja dorë nga të drejtat

Bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pasi të jetë njoftuar me të drejtat e tij.
Duhet të jetë në formë të shkruar dhe pasi të jetë njoftuar më të drejtat e tij.
Njoftohet për efektet e heqjes dorë nga të drejtat e tij, në fazat e mëvonshme të procedurës penale.

I pandehuri si subjekt pasiv i procedurës penale

Detyrimi për t'u përgjigjur thirrjeve të organeve që zbatojnë procedurën penale

Detyrimi që t'u bindet kufizimit të të drejtave të tij.

Përfundimi

Pozita dhe roli i të pandehurit në procedurë penale ka ndryshuar në përshtatshmëri me rrethanat kohore të nxjerrjes se Kodeve, përkatësisht duke u nisur nga Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës dhe më pas me Kodin aktual të Procedurës Penale. Kështu, me Kodin e ri Penal i cili ka filluar te zbatohet nga 01.01.2013, të drejtat e të pandehurit janë më të theksuara dhe më të avancuara në çdo fazë të procedurës penale. Pra qysh në fazën parapenale atëherë kur ende nuk ka filluar të zbatohet formalisht procedura penale e deri në fazat e më vonshme, kur ndaj tij formalisht fillojnë te zbatohen hetimet dhe masat e tjera në procedurë penale e deri kur përfundon ajo, por edhe sipas mjeteve te rregullta juridike dhe në fazat me mjete të jashtëzakonshme juridike.

Bibliografia

- Konventa Evropiane për lirit dhe të drejtat themelore të njeriut
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Kodi i Procedurës Penale
- Ligjërata të autorizuara të mbajtura në Institutin Gjyqësor të Kosovës

Mevlide Kosumi* **Rukije Sheshivari***

PROCEDURA PENALE NDAJ TË MITURVE

ABSTRAKT

Në këtë punim kemi trajtuar nocionin dhe kuptimin e termit i mitur në procedurën penale, karakteristikat e procedurës penale ndaj të miturve siç është urgjenca në kryerjen e veprimeve procedurale, parimi i interesit më të mirë për të miturin dhe parimet tjera. Pastaj, arresti i përkohshëm, ndalimi dhe paraburgimi qe zbatohet ndaj të miturve, kur mund të zbatohet dhe si mund të zbatohen këto masa. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përbërjes së trupit gjykues; fazave të procedurës penale ndaj të miturve, procedurës përgatitore, roli dhe kompetencat e prokurorit në procedurën përgatitore, veprimet procedurale që i ndërmerr prokurori si dhe masat që mund ti shqiptoj prokurori. Gjithashtu janë trajtuar masat e diversitetit dhe llojet e tyre; faza e shqyrtimit gjyqësor si fazë ku administrohen provat dhe vendoset lidhur me çështjen penale dhe merret vendim për shqiptimin e masës edukative apo dënimit për te mitur si dhe procedura sipas mjeteve juridike dhe procedura e ndërmjetësimit.

Fjalë kyçe: I mitur, vepër penale, procedure penale, prokuror, gjyqtar, masa edukative, dënim për te mitur.

Hyrje

Trajtimi i të miturve në procedurë penale të veçantë është relativisht i vonshëm dhe rrjedhimisht fillon të aplikohet krahas avancimeve shkencore, para së gjithash duke iu referuar zhvillimeve të shkencave si pedagogjia, psikologjia, sociologjia, penologjia etj.

Tendencat e para të ndarjes së procedurës për të mitur nga procedura penale standarde datojnë në fund shekullin e XIX dhe fillimin e shekullit të XX. Gjatë kësaj periudhe ishin aplikuar një numër i madh i masave, që kryesisht ishin të fokusuara në shkallën e dënimit më të butë.[276]

* Mevlide Kosumi, kandidate për gjyqtare
* Rukije Sheshivari, kandidate për prokurore
[276] E drejta e procedures penale, Rexhep Murati & Ejup Sahiti

Në vijim çështja u bart në studimet më të hollësishme për të hulumtuar jo vetëm masat dhe sanksionet me adekuate për të miturit por edhe të zhvendoset procedura në tërësi si e tillë duke u paraparë komplet procedurë e veçantë për të miturit.

Republika e Kosovës në lidhje me rregullimin e procedurës penale ndaj të miturve ka të miratuar Kodin e Drejtësisë për të Miturit (tutje KDM), me të cilin rregullohen masat, sanksionet, procedura si dhe ekzekutimi i masave dhe sanksioneve penale ndaj të miturve.

Infrastruktura tjetër ligjore që trajton çështjet në lidhje me masat, procedurën etj. për të mitur siç janë Kodi Penal i Kosovës, Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve penale mund të zbatohen me kusht që nuk janë në kundërshtim me dispozitat e KDM.

Karakteristikat e procedurës penale ndaj të miturve

Kodi i Drejtësisë për të Mitur bënë dallimin e termeve fëmijë që përfshin personat nën moshën 18 vjeçare. I mitur është personi ndërmjet moshës nga 14 deri 18 vjeç ku edhe është kufiri i përgjegjësisë penale, që do të thotë se penalisht përgjegjës janë vetëm fëmijët nga kjo moshë, por jo edhe ata nën moshën 14 vjet.

Tutje i mitur i ri është personi ndërmjet moshës 14 deri 16 që nënkupton se ndaj kësaj kategorie mund të shqiptohen masa adekuate, por jo edhe dënimet.

I mitur i rritur konsiderohet personi ndërmjet moshës 16 (gjashtëmbëdhjetë) dhe 18 (tetëmbëdhjetë), kjo kategori ka rëndësi pasi ndaj tyre përveç masave mund të shqiptohen edhe dënimet.

Po ashtu me ligjet në fuqi përfshihet kategoria e madhorëve të ri që nënkupton personat ndërmjet moshës 18 (tetëmbëdhjetë) dhe 21 (njëzetenjë) vjet. Parimisht procedura gjyqësore nuk mund të zbatohet ndaj madhorit i cili ka mbushur moshën 21 vjet për vepër penale të kryer si i mitur nën moshën 16 vjet, mirëpo ndaj tij mund të zbatohet procedura për vepër të kryer si i mitur nën 16 vjet nëse vepra penale është e dënueshme me më shumë se 5 vjet burgim. Ndërkaq në procedurën gjyqësore të zbatuar ndaj madhorit për vepër penale të kryer si i mitur i cili i ka mbushur 16 vjet, gjykata mund të shqiptoj qoftë ndonjë masë apo dënim, duke pasur parasysh edhe kohën që ka kaluar nga kryerja e veprës penale.

Personat që e kanë arritur moshën 18 vjeçare konsiderohen madhorë. Në procedurën gjyqësore të zbatuar ndaj madhorit të ri i cili nuk e ka arritur moshën 21 vjet për vepër të kryer si madhor i ri, gjykata mund të shqiptoj masë ose dënim për të mitur nëse çmon se qëllimi që do të arrihej me shqiptimin e burgimit do të arrihej edhe me masë a dënimin për të mitur mirëpo duke marrë edhe mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri dhe interesin e tij më të mirë, masa a dënimi i shqiptuar mund të zgjas derisa personi të arrij moshën 23 vjet.

Procedura ndaj të miturve siç u përmend më lartë ka disa specifika të cilat e dallojnë nga procedura penale ndaj madhorëve. Disa nga specifikat më të rëndësishme janë:

- Urgjenca e procedurës, ngase institucionet që merren me zbatimin e procedurës ndaj të miturve duhet të veprojnë në afat sa më të shkurtër. Për këtë Kodi i Drejtësisë për të Mitur, ka paraparë afate më të shkurtra për dallim prej atyre që zbatohen ndaj kryerësve tjerë madhor.
- I mituri nuk mund të gjykohet në mungesë dhe duhet të jetë i shoqëruar nga prindi në të gjitha fazat e procedurës penale;
- Mbrojtja në procedurën për të mitur është e detyrueshme prej marrjes së parë në pyetje, kur procedura zhvillohet për vepër penale që parashihet dënim deri në 3 vite burgim ose prej marrjes së aktvendimit për fillimin e procedurës përgatitore për vepër për te cilën është parashikuar dënim më i butë, nëse gjyqtari për të mitur konsideron se i mituri ka nevoje të këtë mbrojtës dhe mbrojtje adekuate;
- Në qoftë se i mituri, apo përfaqësuesi i tij ligjor si dhe personat tjerë që me ligj janë të obliguar për mbrojtjen e të miturit, nuk angazhojnë mbrojtës, atë e cakton sipas detyrës zyrtare organi para të cilit është duke u zhvilluar procedura penale;
- Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve me burgim për të miturit është më i shkurtër.
- Interesi më i lartë i fëmijës është parim kryesor, që e karakterizon procedurën ndaj të miturve, e që është kategori kushtetuese e përcaktuar me nenin 50, paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Duke pasur parasysh këto që u thanë më lartë, veprimet e organeve shtetërore që zbatojnë procedurën penale ndaj të miturit si i dyshuar duhet të marrin parasysh se interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.[277]

Arresti i përkohshëm, ndalimi policor dhe paraburgimi

Procedura ndaj të miturit posaçërisht në lidhje me këto masa duhet të zhvillohet me urgjence dhe parashihen afate që dallojnë me ato tek madhoret. Këto janë parapare me KDM që është në harmoni edhe me instrumentet ndërkombëtare që trajtojnë të drejtat e fëmijëve para së gjithash me Konventën e të Drejtave të Fëmijës.
Këto masa mund të urdhërohen ndaj të miturit vetëm si masë e fundit dhe në afat sa më të shkurtër të mundshëm.

I mituri mund të ndalohet apo të arrestohet përkohësisht jo më gjatë se 24 orë dhe pas kësaj ai duhet të lirohet nëse nuk ka vendim të ligjshëm për paraburgim.

Paraburgimi si masë ndaj të miturit mund të caktohet në pajtim me dispozitat e KPP-së dhe vetëm nëse masat tjera alternative nuk do të ishin të mjaftueshme për të siguruar prezencën e tij dhe parandalimin e kryerjes së serishme të veprës si dhe sigurimin e zbatimit të suksesshëm të procedurës.

[277] Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 40
Kodi i Drejtësisë për të Mitur neni 10

Gjyqtari shqyrton masat tjera alternative, si vendosjen e fëmijës në strehimore, transferimin në familje tjetër etj. dhe në aktvendimin për caktimin e paraburgimit duhet të shpjegohen arsyet për pamjaftueshmërinë e masave alternative.

Paraburgimi si masë ndaj të miturit mund ti shqiptohet nga gjyqtari për të mitur për një periudhe maksimale prej 30 ditësh dhe kjo mund të vazhdohet nga kolegji për të mitur edhe për 60 ditë tjera.

Kolegji për të mitur duhet që brenda afatit prej 30 ditëve të rishqyrtoje aktvendimin për caktimin e paraburgimit, në seancë ku të pranishëm duhet të jenë i mituri, prokurori, dhe mbrojtësi.

Paraburgimi ndaj të miturit në asnjë rrethane nuk mund të jetë më i gjatë se 12 muaj dhe ai duhet të mbahet në hapësirë të ndarë në institucionin edukativ - korrektues nëse gjyqtari për të mitur konsideron se kjo është në interes të të miturit.

Gjatë qëndrimit në paraburgim të miturit varësisht prej nevojës i ofrohet ndihmë adekuate sociale, edukative, psikologjike, mjekësore etj.

Përbërja e trupit gjykues për të mitur

Trupi gjykues për të mitur i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë, me përjashtim të kolegjeve të Gjykatës Supreme, përbëhen nga 1 gjyqtar për të mitur dhe 2 gjyqtar porotë. Gjithherë kryetar i trupit gjykues është gjyqtari për të mitur.
Ndërsa kolegji për të mitur në Gjykatën Supreme të Kosovës përbehet nga 3 gjyqtar, ku njëri nga këta është gjyqtar për të mitur. Kur trupi gjykues i Gjykatës Supreme, gjykon në shqyrtim gjyqësor atëherë përbërja e tij është 2 (dy) gjyqtar për të mitur dhe 3(tre) gjyqtar porotë[278].

Fazat e procedurës penale ndaj të miturve

Procedura penale ndaj të miturve rregullohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Parimet themelore që duhet të respektohen gjatë zhvillimit të procedurës penale ndaj të miturve kanë të bëjnë me mirëqenien e të miturit për shkak të moshës se re dhe zhvillimit psikologjik në mënyrë që procedura që zhvillohet ndaj tij të mos ndikoj negativisht ose të jetë me sa më pak pasoja për personalitetin e tij.
Prandaj trajtimi i të miturit me humanizëm gjatë secilës fazë të procedurës penale është kërkesa kryesore për zbatuesit dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurën ndaj të miturit.

Parimi në fjalë duhet të mbizotëroj edhe në rastet e shqiptimit të masave të diversitetit dhe masave edukative, ndërkaq privimi nga liria është mjet i fundit, duke u kufizuar në një afat sa më të shkurtër.

[278] Përbërja e trupit gjykues sipas KDM

Nëse ndaj të miturit shqiptohet dënim me burgim, atëherë të miturit i sigurohet edukim, ndihmë psikologjike dhe mbështetje tjetër varësisht nga nevojat që ai ka në mënyrë që i mituri të rehabilitohet.

Të miturit duhet ti sigurohet mbrojtës para çdo organi që zhvillon procedurën penale.

Në procedurën penale, të miturit duhet dhënë mundësinë që të shprehet lirisht, kjo obligon organin para të cilit zhvillohet procedura që të miturin ta njoftoj për të drejtat e tij të garantuara me ligj dhe procedura të mos vazhdohet deri sa të sigurohet se i mituri i ka kuptuar këto të drejta.

Gjate privimit nga liria i mituri duhet të ndahet nga madhoret nëse vlerësohet se është në interesin e tij më të mirë.

E drejta e të miturve në privatësi për të mos u shfaqur publikisht gjatë një procedure është e drejtë të cilën duhet ta zbatojnë të gjitha organet si dhe personat tjerë që mund të jenë pjesë e një procedure ndaj të miturve.

Procedura përgatitore

Roli dhe kompetencat e prokurorit

Prokurori i shtetit në rastin kur merr informacionin, propozimin nga pala e dëmtuar, ose kallëzimin penal se i mituri ka kryer vepër penale apo i mituri është viktimë e veprës penale vepron shpejtë dhe pa vonesa, duke zbatuar dispozitat e KDM dhe dispozitat e KPPRK-së përshtatshmërisht.

Kompetencë e prokurorit të shtetit në procedurën penale ndaj të miturve ashtu si në procedurën ndaj madhorëve, është zbulimi dhe ndjekja e kryerësve të veprave penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare dhe sipas propozimit.

Nëse ekziston dyshimi i bazuar se është kryer vepra penale nga kryerësi i cili nuk ka mbushur moshën 14 vjeçare, nuk fillohet procedura penale, dhe nëse është filluar nga se nuk është ditur për moshën e te miturit, me të kuptuar për moshën e tij procedura pushohet menjëherë, dhe njoftohet organi i kujdestarisë dhe Shërbimi Sprovues për rastin nga prokurori. Pastaj organi i kujdestarisë ndërmerre veprimet e mëtejme, në pajtim me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare për trajtimin kryerësve të veprave penale nën moshën 14 vjeçare, në bazë të programeve të tij.

Prokurori i shtetit duke u nisë nga parimi, si që është interesi më i mirë për të miturin, parimi se reagimi duhet të jetë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale dhe parimit të arsyeshmërisë, në bazë të nenit 56 të KDM, mund të mos filloj procedurën përgatitore edhe pse ekziston dyshimi i bazuar se i mituri ka kryer veprën penale të dënueshme me burgim prej më pak se tre (3) vite ose me gjobë. Në këtë rast, prokurori mendon se nuk do te ishte e përshtatshme të zbatohet procedura penale ndaj të miturit për shkak të natyrës së veprës penale, të rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, mungesës së dëmit të rëndë apo pasojave për të dëmtuarin, duke pas parasysh të kaluarën e të miturit si dhe karakteristikat e tij

personale. Gjithashtu kur ndaj të miturit është duke u ekzekutuar dënimi ose masa, prokurori mund të vendos të mos filloj procedurën përgatitore për një vepër tjetër të kryer nga i mituri, nëse duke pas parasysh peshën e asaj vepre penale, si dhe dënimin apo masën e cila është duke u ekzekutuar, zbatimi i procedurës dhe shqiptimi i dënimit ose masës për veprën penale nuk do t'i shërbente ndonjë qëllimi.

Për të vërtetuar rrethanat për të vendos që të mos filloj procedurën përgatitore ndaj të miturit, prokurori mund të kërkoj nga Shërbimi Sprovues të bëjë anketë sociale, si dhe nëse është e nevojshme të thirre prindin, prindin adoptues ose kujdestarin e te miturit, si dhe personat dhe institucionet e tjera dhe palën e dëmtuar. Edhe me këtë raste kur vendos te mos filloj procedurën përgatitore e njofton organin e kujdestarisë.

Nëse nuk zbaton ndonjërën nga veprimet e lartpërmendura prokurori në bazë të Nenit 57 te KDM merre Aktvendim për fillimin e procedurës përgatitore. Në aktvendim përcaktohet i mituri ndaj të cilit zbatohet procedura përgatitore, përshkrimi i veprës penale që përcakton elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e arsyetojnë dyshimin e bazuar, provat dhe informatat e mbledhura dhe raporti për ndonjë dënim ose masë të shqiptuar më parë ndaj të miturit. Një kopje e vulosur e aktvendimit për fillimin e procedurës përgatitore i dërgohet pa vonesë gjyqtarit për të mitur, si dhe njoftohet Qendra për Punë Sociale dhe Shërbimi Sprovues në kuptim të nenit 8 te KDM me qëllim të përpilimit të anketës sociale. Në procedurën përgatitore prokurori kujdeset për të gjitha të drejtat e të miturit, që i takojnë sipas KDM dhe LPPK-së. Nëse i mituri është në arrest, prokurori pa vonesë bënë kërkesë për shqiptimin e masës së paraburgimit nëse ka bazë, tek gjyqtari për të mitur, duke pas kujdes që të mos kaloj afati prej 24 orësh, në të kundërtën nëse kalohet ky afat dhe nuk merret aktvendim për caktimin e paraburgimit nga gjyqtari për të mitur, i mituri lirohet menjëherë. Këtu duhet pas parasysh se arresti i përkohshëm ndalimi policor dhe paraburgimi janë masa që duhet të përdoren si të fundit dhe vetëm në rastet e domosdoshme, kur masat e tjera të sigurimit të pranisë së të miturit në procedurë nuk janë të mjaftueshme.

Gjatë zhvillimit të procedurës përgatitore prokurori mundet ta pezulloj procedurën e hetimit ndaj të miturit dhe të shqiptoj masën e diversitetit për atë vepër për të cilën është paraparë dënimi me gjobë apo me burgim deri ne tre (3) vite burgim ose për vepër penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën është paraparë dënimi deri ne pesë (5) vite burgim, me përjashtim të atyre të cilat sjellin si pasojë vdekjen. Kushte tjera për shqiptimin e kësaj mase janë edhe pranimi i përgjegjësisë nga i mituri, shprehja e gatishmërisë nga i mituri që të pajtohet me palën e dëmtuar, pëlqimi i të miturit ose i prindit, prindit adoptues ose kujdestarit në emër të te miturit për të zbatuar masën e diversitetit. Nëse masa e shqiptuar nuk zbatohet, prokurori njoftohet për moskryerjen e detyrimeve të masës së diversitetit nga i mituri, dhe mund të vendos për rifillimin e ndjekjes së rastit.

Masat e diversitetit që mund të shqiptohen ndaj kryerësit të mitur janë:

- pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;
- pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;

- kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, te miturit, përfaqësuesit ligjor të tij, në përputhje me situatën financiare të të miturit;
- vijimi i rregullt në shkollë;
- pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij;
- kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme, në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë(10) deri gjashtëdhjetë(60) orë;
- edukimi në rregullat e trafikut; dhe
- këshillimi psikologjik.

Po ashtu, gjatë procedurës paraprake, prokurori mund të pezulloj procedurën, dhe palëve d.m.th. të miturit dhe palës së dëmtuar mund t'iu propozoj procedurë të ndërmjetësimit, nëse vlerëson se është më mirë duke pas parasysh natyrën e veprës penale rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, personalitetin e të miturit, zvogëlimin dëmit për palën e dëmtuar dhe rehabilitimin e të miturit. Palëve duhet shpjeguar parimet dhe rregullat e ndërmjetësimit si dhe efektet ligjore që arrihen përmes ndërmjetësimit. Palët duhet të japin pëlqimin për të shkuar në procedurë te ndërmjetësimit. Procedura e ndërmjetësimit nuk mund të zgjasë më tepër se nëntëdhjetë(90) ditë nga dita e marrjes së aktvendimit për ndërmjetësim. Për rezultatin njoftohet zyrtarisht prokurori, dhe nëse procedura e ndërmjetësimit nuk ka sukses atëherë prokurori vazhdon procedurën nga aty ku është pezulluar.

Gjate procedurës përgatitore prokurori mund ta pushoj procedurën kurdo që nga provat e mbledhura konstaton se (Neni 60 i KDM):

- nuk ka dyshim të bazuar se i mituri ka kryer veprën e caktuar penale;
- ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekjen penale;
- vepra penale është përfshirë me falje;
- janë prezentë kushtet e parapara në nenin 56, në paragrafin 1 të këtij Kodi; ose
- ekzistojnë rrethana tjera që pengojnë ndjekjen.

Prokurori menjëherë e informon gjyqtarin për të mitur për pushimin e procedurës, si dhe të miturin përveç rasteve kur nuk janë ndërmarrë veprime në procedurë përgatitore.

Procedura përgatitore duhet të përfundohet në afat prej gjashtë (6) muajve, nëse nuk mund të përfundoj në këtë afat prokurori i bënë kërkesë gjyqtarit për të mitur për vazhdimin e procedurës përgatitore, dhe procedura mund të vazhdohet në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Prokurori pas përfundimit të procedurës përgatitore e njofton mbrojtësin e të miturit për qëllimin e tij që të përfundoj procedurën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, ku mbrojtësi mund të parashtroj kërkesë për marrjen e ndonjë fakti apo prove të re.

Dhe pas përfundimit të procedurës përgatitore, prokurori mund të paraqes propozim të arsyetuar pranë trupit gjykues për të mitur për shqiptimin e masës edukative ose dënimit.

Propozimi i paraqitur duhet të përmbajë të dhënat personale të të miturit, përshkrimin e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, provat, anketën eventuale, propozimin për shqiptimin e masës edukative apo dënimit si dhe arsyet pse nuk janë shqiptuar masat e diversitetit.

Shqyrtimi gjyqësor

Kjo fazë e procedurës penale paraqet pjesën kryesore në të cilën i jepet zgjidhje çështjes penale përkatësisht bëhet nxjerrja e provave që në shkallë të fundit sqarohet çështja penale.

Pasi të merr propozimin nga prokurori, gjyqtari për të mitur mund ta hedhë propozimin apo transferimin e lëndës në gjykatën tjetër (kompetente) nëse konstaton in kompetencën e gjykatës.

Nëse asnjëra nga mundësitë e sipërpërmendura, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për përdorimin e tyre, gjyqtari për të mitur, brenda afatit prej 8 ditëve nga pranimi i propozimit, cakton shqyrtimin gjyqësor.

Gjyqtari për të mitur mundet që në çdo kohë gjate zhvillimit të procedurës penale, të ndërpres procedurën gjyqësore dhe të shqiptoje masën përkatëse të diversitetit nëse i mituri pranon përgjegjësinë penale, shpreh gatishmërinë për pajtim me palën e dëmtuar dhe në fund nëse për këtë pajtohet i mituri apo prindi, prindi adoptues apo kujdestari.

Shqyrtimi gjyqësor përveç personave të paraparë edhe me KPP në seancë thirren edhe prindi, prindi adoptues ose kujdestari dhe përfaqësuesi i Shërbimit Sprovues. Mos prania e tyre në seancë nuk përbenë pengesë për mbajtjen normale të seancës.

Në lidhje me ndryshimin e propozimit apo zgjerimin e të njëjtit vlejnë dispozitat e KPP për ndryshimin ose zgjerimin e aktit akuzues ndonëse në procedurën për të mitur trupi gjykues autorizohet nga ligji për të nxjerr vendim në bazë të fakteve dhe provave të prezantuara në seancë duke treguar se në bazë të tyre gjendja nga propozimi ka ndryshuar.

Shqyrtimi gjyqësor për të mitur gjithmonë bëhet pa praninë e publikut, ndonëse trupi gjykues mund të bënë disa përjashtime duke i lejuar prezencën e personave të cilët në mënyrë profesionale merren me trajtimin e çështjeve të mirëqenies, edukimit dhe sjelljeve delikuente të të miturve.

Trupi gjykues mundet që të urdhëroj largimin e pjesëmarrësve në shqyrtimin gjyqësor, me përjashtim të prokurorit, mbrojtësit, përfaqësuesit të organit të kujdestarisë dhe përfaqësuesit të Shërbimit Sprovues. Kjo mund të ndodhë në rrethana të jashtëzakonshme dhe kur besohet se kjo është në interesin e të miturit.

Trupi gjykues nuk është i lidhur për propozimin e prokurorit në marrjen e vendimit në lidhje me shqiptimin e masës apo dënimit. Me aktvendim trupi gjykues e pushon procedurën gjyqësore nëse kemi të bëjmë me arsyet nga KPP (prokurori tërhiqet nga ndjekja, vepra për te cilën akuzohet i mituri nuk përbenë vepër penale, i dëmtuari tërhiqet nga propozimi etj.).

Masat edukative, trupi gjykues i shqipton me aktvendim, ku në dispozitivin e tij shënohet vetëm urdhri për masën edukative dhe masën tjetër eventuale ose dënimin, ndërsa që i mituri nuk shpallet fajtor për veprën penale nga propozimi i prokurorit.

Ndërsa arsyetimi i aktvendimit përmban përshkrimin e veprës penale si dhe rrethanat të cilat kanë ndikuar në shqiptimin e masës edukative.

Dënimin ndaj të miturit, trupi gjykues e shqipton me aktgjykim i cili merret konform dispozitave të KPP i cili përfshinë edhe masat apo dënime siç janë p.sh. Masat e trajtimit të detyrueshëm etj.

Aktvendimi ose aktgjykimi për të miturit përpilohet me shkrim brenda afatit prej 8 ditëve nga dita e shpalljes, ndërsa me lejen e kryetarit të gjykatës ky afat mund të jetë jo me i gjatë se 15 ditë.

I mituri mund të detyrohet nga gjykata të paguajë shpenzimet e procedurës dhe të plotësoj kërkesën pasurore – juridike me kusht që atij i është shqiptuar dënimi. Nëse kemi të bëjmë me masa edukative të shqiptuara këto paguhen nga buxheti i shtetit, ndërsa pala e dëmtuar udhëzohet që ketë të realizoj në kontestin civil.

Pa marr parasysh këto që u thanë, i mituri mund të detyrohet nga gjykata që të paguaj shpenzimin e procedurës dhe përmbushjen e kërkesës pasurore-juridike nëse i njëjti realizon të ardhura financiare ose ka pronë të tij.

Procedura sipas mjeteve juridike

Vendimet e marra nga gjykata e shkallës së parë mund të atakohen me ankesën në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit apo aktgjykimit. Bazat e paraqitjes së ankesës janë të njëjta si në procedurën për të rritur.

Rrethi i personave të cilët mund të ushtrojnë ankesë është relativisht i gjerë dhe përfshinë, mbrojtësin, prokurorin, bashkëshortin, prindin, prindin adoptues, të afërmin e gjakut në vijë të drejtë në cilëndo shkallë, vëllain, motrën këta të fundit mund të ushtrojnë ankesë madje edhe kundër vullnetit të të miturit. Veçantia e ankesës tek të miturit është se i mituri nuk mund të heq dorë nga e drejta për ankesë

Ankesa e paraqitur kundër aktvendimit me të cilin është shqiptuar masa edukative dhe e cila është duke u ekzekutuar në institucionin përkatës pezullohet, ndonëse gjykata mund të vendosë që të vazhdoje ekzekutimi i masës nëse konstaton se kjo është ne interesin e të miturit, pasi që paraprakisht ta merr mendimin e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit.

Vendimin e shkallës parë, gjykata e shkallës dytë mund ta ndryshoj duke shqiptuar mase më të rëndë vetëm me kusht që kjo të jetë kërkuar me ankesën e paraqitur nga prokurori.

Gjykata e shkallës së dytë mund të shqiptoje dënim të miturit nëse kjo nuk është bërë nga shkalla e parë vetëm nëse mbahet shqyrtim, kjo vlen edhe për masat edukative.

Procedura sipas mjeteve tjera, si kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, rishikimi i procedurës zhvillohet sipas dispozitave të KPP të cilat zbatohen përshtatshmërisht. Ndërsa kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, zbatohet vetëm me kusht që me aktgjykim të miturit të jete shqiptuar dënimi.

Procedura e ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi si institut është paraparë me KDM që konceptohet si procedurë jashtëgjyqësore e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e KDM dhe ligjit për ndërmjetësim.

Ekzistojnë disa kushte në mënyrë që të mund të aplikohet procedura e ndërmjetësimet, ndërsa si kusht kryesor është që për këtë të ekzistojë pajtimi në mes të miturit si kryerës dhe palës së dëmtuar.

Ligjdhënësi nuk e ka përcaktuar në mënyrë të qartë se për cilat vepra penale mund të aplikohet ndërmjetësimi por që në mënyrë orientuese ka paraparë rrethanat që duhet të merren parasysh për ndërmjetësim siç janë natyra e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale historia e të miturit, mundësia e kthimit të raporteve normale në mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësia e rehabilitimit dhe re integrimit të të miturit në shoqëri.

Kur ka pajtueshmëri nga palët për aplikimin e ndërmjetësimit kjo shënohet në procesverbal dhe prokurori apo gjyqtari varësisht se në cilën fazë është procedura nxjerr aktvendim me të cilin e emërojnë ndërmjetësuesin nga lista e ndërmjetësuesve në pajtim me Ligjin për Ndërmjetësimin.

Paraprakisht prokurori apo gjyqtari duhet ti njoftoje palët në lidhje me parimet dhe rregullat e ndërmjetësimit, procesin si dhe efektet ligjore të marrëveshjeve eventuale që arrihen përmes këtij procesi.

Ndërmjetësuesi i caktuar me aktvendim, vë kontaktet me të miturin dhe palën e dëmtuar për filluar procedurën e ndërmjetësimit e cila nuk mund të zgjatë më shume se 90 ditë nga dita e nxjerrjes së aktvendimit për emërimin e ndërmjetësuesit. Në lidhje me rezultatet e ndërmjetësimit duhet të informohen prokurori ose gjyqtari për të mitur.

Shpenzimet e bëra në lidhje me procedurën e ndërmjetësimit janë pa pagesë për palët dhe paguhen nga buxhetet përkatëse varësisht se cili organ e ka iniciuar ndërmjetësimin.

Procedura e ndërmjetësimet, gjithherë përfundon :

- Nëse kryhet me sukses ndërmjetësimi;
- Ka kaluar afati prej 90 ditëve;
- Ndërmjetësuesi konsideron se vazhdimi i procedurës së ndërmjetësimet nuk është i mundur ose është i pa arsyeshëm;
- I mituri ose pala e dëmtuar deklarojnë se dëshirojnë të ndërpresin ndërmjetësimin.

Në bazë të kësaj kuptohet se ndërmjetësimi mund të ndërpritet me vullnetin e njëanshëm të njërës palë nëse ketë ajo e kërkon.

Procedura penale gjithherë vazhdon në rast të mos suksesit të ndërmjetësimit në fazën ku është pezulluar, ndërsa në rast të suksesit procedura ndërpritet me aktvendim dhe për këtë njoftohen palët.

Gjithashtu, nëse palët kanë arritur marrëveshje për kompensimin e dëmit, ajo dorëzohet tek organi që ka propozuar ndërmjetimin dhe nëse e njëjta miratohet atëherë bëhet dokument në bazë të cilit mund të bëhet ekzekutimi në bazë të ligjit.

Po ashtu, gjatë procedurës paraprake prokurori mund të pezulloj procedurën, dhe palëve d.m.th. të miturit dhe palës së dëmtuar mund t'iu propozoj procedurë të ndërmjetësimit, nëse vlerëson se është më mirë duke pas parasysh natyrën e veprës penale rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, personalitetin e të miturit, zvogëlimin e dëmit për palën e dëmtuar dhe rehabilitimin e të miturit.

Palëve duhet shpjeguar parimet dhe rregullat e ndërmjetësimit si dhe efektet ligjore që arrihen përmes ndërmjetësimit. Palët duhet të japin pëlqimin për të shkuar në procedurë të ndërmjetësimit. Procedura e ndërmjetësimit nuk mund të zgjasë më tepër se nëntëdhjetë (90) ditë nga dita e marrjes së aktvendimit për ndërmjetësim. Për rezultatin njoftohet zyrtarisht prokurori, dhe nëse procedura e ndërmjetësimit nuk ka sukses atëherë prokurori vazhdon procedurën nga aty ku është pezulluar.

Bibliografia

- Kodi i Drejtësisë për të Mitur
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Kodi i Procedurës Penale
- Konventa evropiane e të drejtave të njeriut
- Konventa e të drejtave të fëmijës
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- E drejta e Procedurës Penale, Rexhep Murati
- Kushtetua e Republikës së Kosovës





Bekim Avdimetaj* **Fatmir Dobraj*** **Lumnije Krasniqi***

PËRJASHTIMI I KUNDËRLIGJMËRISË

ABSTRAKT

Arsyeja e trajtimit të përjashtimit të Kundërlishmërisë është sepse në disa raste, situata dhe rrethana, kryesi i veprës ndodhe që ta ketë kryer vepër penale që është e sanksionuar më ligj, dhe do të lirohet nga përgjegjësia penale, nëse ka vepruar në kushtet e parapara më ligj.

Këto situata janë atëherë kur kryersi ka vepruar në mbrojtje të nevojshme më qëllim për ta mbrojtur vetveten apo dikë tjetër nga sulmi realë dhe i pa provokuar nga ai apo që ka vepruar në nevojë ekstreme apo nën ndikimin e dhunës, kanosjes të shkaktuar pa fajin e ti.

Ky punim përveç pjesës hyrëse, në pjesën e parë do të flasim për veprat e përjashtimit të kundërligjshmërisë dhe situatat në të cilat ndodhet kryerësi gjatë kryerjes së vepres penale, pjesa përfundimtare e këtij punimi përmban arsyet e Përjashtimit të kundërligjshmërisë sipas KPRK-ës për këto vepra penale. Në fund të këtij punimi është edhe përfundimi ku japim konstatimet tona për përjashtimin e kundërligjshmërisë dhe në fund është dhënë regjistri i literaturës së përdorur për nevojat e këtij punimi.

Fjalët kyçe :

Perjashtim i kundërligjshmërisë, shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë, shkalla e rrezikshmërisë, mbrojtja.

1. Hyrje

Përjashtimi i kundërligjmërisë për këto vepra penale ka qenë i paraparë edhe më ligjet e më hershme të Republikës së Kosovës, për shkak se kryesi është i obliguar ta mbroj vetveten apo dike tjetër nga një rrezik që i vjen nga një person i cili rrezik është serioz dhe drejtuar drejtpërdrejtë atij apo personit tjeter. Ky rrezik mund të vij përveç nga njerëzit, mund të vi

* Bekim Avdimimeta, kandidatë për gjyqtar
* Lumnije Krasniqi, kandidate për gjyqtare
*Fatmir Dobraj, kandidatë për gjyqtar

edhe nga kafshët, dukurit natyrore si vërshimet, tërmetet, zjarri, eksplodimet e ndryshme etj, pa u provokuar nga kryesi i veprës penale.

Kundërligjshmëria është element i përgjithshëm, i çdo vepre penale. Nuk konsiderohet si vepër penale çdo vepër shoqërore e rrezikshme. Për t'u konsideruar një veprim i rrezikshëm si vepër penale, është e domosdoshme që ai veprim të manifistohet më një shkallë të lartë të rrezikshmërisë dhe të jetë i përcaktuar më ligj si vepër penale.

Shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë sipas pjesës së përgjithshme të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në pjesën e tij të përgjithshme parasheh dy norma përmes të cilave përjashtohet kundërligjshmëria në rast se përmbushen kushtet e caktura. Këto janë mbrojtja e nevojshme (neni 12) dhe nevoja ekstreme (neni 13).

Si shkaqe apo rrethana që e përjashtojnë kundërligjshmërinë sipas pjesës së përgjithshme të KPRK, janë edhe dhuna dhe kanosja (neni 14), vepra e rëndësisë së vogël (neni 11) dhe urdhrat nga lartë (neni 16).

2. Objektivat

Pas përfundimit të këtij punimi, lexuesit do të jenë në gjendje që :

- Të njohin kuptimin e kundërligjshmërisë,
- Të përkufizojnë kundërligjshmërinë,
- Të bëjmë dallimet në mes të kundërligjshmërisë dhe rrezikshmërisë dhe
- Të përshkruajnë shkaqet të cilat e perjashtojnë kundërligjshmërinë.

3. Kundërligjshmëria

Kundërligjshmëria është element i përgjithshëm, i çdo vepre penale. Ajo paraqet bazë juridike për përcaktimin e veprës penale, dhe sipas natyres së saj është tipar i çdo delikti, andaj ky është tipar edhe i delikteve penale-veprave penale.

Nuk konsiderohet si vepër penale çdo vepër shoqërore e rrezikshme. Për tu konsideruar një veprim i rrezikshëm si vepër penale, është e domosdoshme që ai veprim të manifestohet më një shkallë të lartë të rrezikshmërisë dhe të jetë i përcaktuar më ligjë si vepër penale.

4. Rrezikshmëria (shkalla e rrezikshmërisë)

Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale mund të jetë e intensitetit të ndryshëm. Disa vepra penale janë më pak të rrezikshme e disa më shumë. Shkalla e rrezikshmërisë shoqërore përcaktohet duke pasur parasysh:

- Mënyra e kryerjes së veprës penale,
- Mjetet me të cilat është rrezikuar apo dëmtuar e mira juridike,
- Koha e kryerjes së veprës,
- Vendi i kryerjes,

- Motivi i kryerjes së veprës,
- Jeta e tij e mëparshme,
- A është recidiv apo jo.

Duke u bazuar në shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, përcaktohet pesha e veprës penale, kur rrezikshmëria është e madhe edhe vepra penale konsiderohet më e rëndë dhe anasjelltas, kur rrezikshmeria është më e vogël edhe vepra konsiderohet më e lehtë.

5. Shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë sipas pjesës së përgjithshme të Kodit Penal

Shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë janë të shumta dhe do ti përmendim disa nga ato:

- Mbrojtja e nevojshme
- Nevoja ekstreme,
- Dhuna,
- Kanosja,
- Vepra e rëndësisë së vogël,
- Urdhrat nga lartë etj.

6. Mbrojtja e nevojshme

Në neni 12 par 1.të KPRK, thuhet shprehimisht se nuk është vepër penale ajo vepër e cila është kryer në mbrojtje të nevojshme.

Sipas nenit 12 par 2 të KPRK, mbrotja e nevojshme është mbrotja e cila është e domosdoshme për të zmbrapsur sulmin e kundërligjshëm, realë dhe të atëçastshëm ndaj vetës ose personit tjetër, më kusht që karakteri i mbrotjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.

Mbrojta e nevojshme do të ekzistojë p.sh. në rast kur personi A sulmon më thikë personin B, mirëpo personi B duke e mbrojtur jetën e vet e privon nga jeta personin A.

Nga ky shembull rezulton se në situatën e përshkruar janë për mbushur të gjitha tiparet e veprës penal të vrasjes, mirëpo meqë vrasja është kryer në mbrotje të nevojshme, konsiderohet se vepra penal nuk ekziston, meqë i sulmuari ka të drejt ta zbrapsë sulmin e kundërligjshëm.

Për të ekzistuar mbrojta e nevojshme duhet të ekzistojë sulmi dhe mbrojta

7. Sulmi

Sulmi është çdo veprim i njeriut i cili është i drejtuar në dëmtimin apo rrezikimin e ndonjë të mire juridike.

Sulmi zakonisht kryhet me veprim, mirëpo përjashtimisht sulmi mund të kryhet edhe me mos veprim p.sh (mjeku i ndihmës së shpejtë refuzon ti japë ndihmë mjekësore personit që gjendet

në gjendje rreziku për jetë). Në raste të tilla, çdo person mund ta detyrojë mjekun që ta kryejë detyrën e vet.

Sulmusi duhet të jetë njeriu- Për të ekzistuar mbrojtja e nevojshme, sulmi duhet të ndërmerret nga njeriu.

Sulmi mund të jetë i drejtuar kundër çdo të mire. Kësisoj sulmi mund të jetë i drejtuar ndaj të mirave juridike që i përkasin personit fizik, personit juridik, sigurisë apo integritetit territorial të Kosovës etj. Mirëpo në jetën e përditshmë më së shpeshti sulmohet jeta e njeriut, inegriteti trupor dhe pasuria.

Sulmi duhet të jetë i kundërligjshëm- Sulmi është i kundërligjshëm kur sulmusi nuk ka kurrëfarë autorizimesh juridike për veprimtarinë e vet, kur veprimtaria e vet cenon sistemin juridik të një vendi.

Sulmi duhet të jetë i atëçastshëm- Sulmi është i atëçastshëm kur në çdo moment pritet të fillojë, kur ka filluar të veprojë dhe gjersa zgjatë, përkatësisht gjersa të përfundojë.

Kur sulmi pritet të fillojë- Sulmi konsiderohet se mund të pritet në çdo moment në rastet kur mund të fillojë aty për aty, menjëherë p.sh në grindje e sipër midis dy përsonave, njëri prej tyre mbush revolen apo nxjerrë thikën nga këllëfi.

Kur sulmi ka filluar- Situata është më qartë në rastet kur sulmi ka filluar të veproj p.sh. personi A e ndjek me thikë personin B dhe ky posa i ofrohet nxerr revolen dhe privon atë nga jeta, ketu sulmi ka filluar e jo se pritet të fillojë.

Sulmi duhet të jëtë i vërtetë- Për tu konsideruar se ekziston mbrojtja e nevojshme sulmi duhet të jetë i vërtetë, që të ekzistoj realisht.

8. Mbrojtja

Mbrojtja është çdo veprim i njeriut më të cilin dëmtohet apo rrezikohet ndonjë e mire e sulmusit. Mbrotja e nevojshme ekziston edhe nga përkufizimi i këtij insititcioni, mbrotja e nevojshme ekziston edhe në rastet kur sulmi zmbrapset edhe nga personi i tretë.

Mbrojtja duhet të jetë drejtuar kundër sulmusit- Për tu konsideruar se ekziston mbrotja e nevojshme, veprimet e mbrotjes duhet të jenë të drejtuara kundër sulmuesit, kundër asaj të mire juridike të sulmuesit, e cila është e nevojshme për zmbrapsjen e sulmit (p.sh kundër trupit,jetës pasurisë etj).

Mbrojtja duhet të jetë domosdo e nevojshme për zmbrapsjen e sulmit- Për tu konsideruar një mbrotje si e nevojshme ajo duhet të jetë domosdo e nevojshme që personi prej vetes apo tjetrit ta zmbrapsë sulmin.

Mbrojtja duhet të jetë proporcionale me intesitetin e sulmit- Për të qenë mbrojtja domosdo e nevojshme, ajo duhet të ekzistojë në proporcionalitet (përpjestueshmëri) midis intensitetit të sulmit dhe mbrojtjes (në proporcion me mjetet që i perdorë sulmuesi, forcës fizike të sulmuesit, mjetet që i posedon sulmusi).

9. Tejkalimi i mbrojtjes së nevojshme

Tejkalimi apo kapërcimi i mbrotjes së nevojshme shprehet në rastet kur mbrotja nuk është proporcionale me sulmin, apo kur mbrojtja ndërmerret pasi që është zbrapsur ose ka pushuar së vepruari sulmi.

Në të gjitha rastet kur i sulmuari i tejkalon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme, çdo dëmtim që i shkakton sulmuesit konsiderohet vepër penale dhe personi i ketillë përgjigjet penalisht sikur për çdo vepër tjetër penale.[279]

10. Nevoja ekstreme

Neni 13 par. 2 KPRK - Nevoja ekstreme është rrethanë e dytë që e përjashton kundërligjmërinë. Sipas përkufizimit ligjor, nevoja ekstreme ekziston kur vepra është kryer me qëllim që kryesi ta mënjanojë, ta zmbrapsë prej vetes apo tjetrit rrezikun e atëçastshëm dhe të paprovokuar i cili nuk ka mundur të evitohet në ndonjë mënyrë tjetër, më kusht që e keqja e shkatuar nuk është më e madhe se e keqja që është kanosur

P.sh.personi A me qëllim që të shpëtojë jetën e fëmijës, depërton më dhunë në shtepinë e personit B, të cilën e ka kapluar zjarri, shembull tjetër personi A me qellim që ta shpetojë jetën e fëmijës që po fundosej merr barkën e huaj.

Për ekzistimin e këtij institucioni duhet të shprehet rreziku dhe mënjanimi i rrezikut.

11. Rreziku

Si parakusht për ekzistimin e nevojës ekstreme është ekzistimi i rrezikut. Rreziku zakonisht përkufizohet si situate në të cilën në bazë të rrethanave ekzistuse objektive me arsye supozohet se në çdo moment, aty për aty, mund të demtohet e mira juridike e personit fizike apo juridik.

Rreziku mund të vijë edhe nga fuqitë dhe dukuritë natyrore siç janë**:**

-Vërshimet

-Tërmetet

-Acaret e mëdha

-Shembja e dheut apo ortekët e borës

-Sulemet e shtazëve apo egërsirave

-Vërshimet etj.

Rreziku nuk duhet të jetë i provokuar apo i shkaktuar- Nuk mund të konsiderohet se personi ka vepruar në nevojën ekstreme nëse me fajin e tij më dashje apo nga pakujdesia e ka

[279] Sipas Kodit Penal të Repubikës së Kosoves pjesa e Përgjithshëm Neni 12

shkaktuar rrezikun, p.sh. personi vetë e shkakton zjarrin dhe duke u gjendur edhe vetë në rrezik, për të shpëtuar e lëndon personin tjetër.

Rreziku mund ti kanoset çdo të mire – Rreziku parimisht mund ti kanoset çdo të mire juridike që është e mbrojtur në sistemin jurdik, mirëpo në praktikë rreziku më së shpeshti është i drejtuar kundër jetës, trupit, shëndetit, lirisë dhe pasurisë.

Reziku duhet të jetë i vërtetë - Rreziku konsiderohet i vërtetë kur ai realisht ekziston është objektiv, nëse personi gabimisht mendon se rreziku ekziston atëherë fjala është për të ashtuquajturën nevojë ekstreme putative.

12. Mënjanimi i rrezikut

Mënjanimi i rrezikut, konsiderohet veprim që ndërmerret më qëllim që të shpëtohet e mira juridike së cilës i kanoset rreziku.

Mënjanimi i rrezikut duhet të jetë i atëçastshëm aktual me ekzistimin e rrezikut

Konsiderohet se është përmbushur ky kusht në rastet kur veprimi me të cilin mënjanohet rreziku është ndërmarre gjatë kohës kur vepron rreziku, ose kur pritet, kanoset që rreziku të fillojë në çdo moment.

Në mes të keqes së kanosur dhe të keqes së shkaktuar duhet të ekzistojë proporcionaliteti i caktuar

Nevoja ekstreme ekziston atëherë kur e keqja e shkatuar është e vlerës së njejtë apo më të vogël se e keqja që është kanosur të shkatohet. p.sh.për t'a shpëtuar jeten e një përsoni dëmtohet pasuria e përsonit tjetër.

13. Tejkalimi i nevojës ekstreme

Sikundër te mbrojtja e nevojshme edhe të nevoja ekstreme mund të shprehet tejkalim:

- kur e keqja e shkaktuar është më madhe se keqja e kanosur
- kur rreziku ka mundur të mënjanohet duke e dëmtuar në përmasa më të vogla, të mirën juridike të personit tjetër dhe
- kur dëmtimi i të mirës juridike të personit tjetër është bërë pasi ka pushuar, pasi që ka kaluar rreziku.

Vepra e cila kryhet më rastin e tejkalimit të kufijeve të nevojës ekstreme konsiderohet vepër penale dhe nëse tejkalimi është bëre më dashje, përgjigjiet për dashje e nëse është bërë nga pakujdesia përgjigjiet për pakujdesi.

14. Detyrimi për t'u ekspozuar rrezikut

Ekzistojnë disa kategori njerzëzish të cilët për shkak të detyrës, profesionit apo pozitës sociale që kanë në shoqëri, nuk mund të thirren në nevojën ekstreme por janë të obliguar ti ekspozohen rrezikut (Neni 13 par. 4 KPRK).[280]

15. Dhuna dhe kanosja-Neni 14 KPRK

15.1. Dhuna, nocioni dhe llojet e dhunës

Dhuna është përdorim i forcës ndaj një personi më qellim që të detyrohet të ndërmarrë apo të mos ndërmarre një veprim me të cilin realizohen tiperet e një vepre penale.

Dhuna mund të jetë fizike apo mekanike, ndërsa si force, dhunë konsiderohet edhe përdorimi i hipnozës ose mjeteve tjera dehëse, më qëllim që ndokush kundër vullnetit të vetë të vihet në gjendje të pavetëdijshme ose bëhet i paaftë për rezistencë.

15.1.1 Dhuna mund të jetë Absolute dhe Kompulsive

Dhuna është apsolute në rastë kur ndaj atij të cilit është përdorur dhuna, në tërsi ka qenë i privuar nga mundësia që të merr vendim për veprim apo mos veprim, ose nëse ka qenë i penguar që vendimin e tij të realizoj.

P.sh personi A e lidh punëtorin e autorizuar të hekurudhës, i cili nuk mund të jap sinjal që treni duhet të ndalet dhe kështu shkaktohet ndeshja e trenave, me ç 'rast shkaktohen viktima njerëzish dhe dëme materiale.

Dhuna kompulsive shprehet në rastet kur personi ndaj të cilit përdoret dhuna nuk është absolutisht i privuar nga mundësia për të vendosur, mirëpo dhuna që aplikohet bënë presion të tillë që e shtrëngon të ndërmarrë apo mos të ndërmarrë veprimin e caktuar.

15.1.2. Kanosja

Kanosja është deklarata e ndonjë personi me të cilën i bëhet me dije dikujt se do ta gjejë ndonjë e keqe, nëse nuk vepron ashtu si dëshiron personi që kanoset. Kanosja më së shpeshti kryhet në mëyre verbale më gojë. Mirëpo mund të kryhet me shkrim, apo me veprime konkludente.

15.1.3. Rëndësia penale juridike e dhunës dhe kanosjes

Në rastin e përdorimit të dhunës absolute nuk ka vepër penale, meqë nuk e ka njërin element themelor "Veprimin e vullnetshëm të personit".

[280] Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës pjesa e Përgjithshëm Neni 13

Sipas kësaj, personi i cili nën ndikimin e dhunës kryen vepër e cila përmban të gjitha tiparet e ndonjë vepre penale të caktuar më ligj, nuk do të ndëshkohet personi i tillë, ngase do të konsiderohet se ai ka qenë vetëm mjet për kryerjen e veprës penale. Ndërsa, kur bëhet fjalë për dhunën kompulzive dhe kanosjen, ato duhet vlerësuar në kuadër të mbrojtjes së nevojshme dhe nevojës ekstreme.[281]

16. Vepra e rëndësisë së vogël

Mund të ndodhë që një person të kryejë një vepër e cila i ka të gjitha tiparet e veprës penale të përcaktuar më ligjin penal, mirëpo, për shkak se vepra posedon rrezikshmëri tejet të vogël shoqërore, ajo nuk konsiderohet vepër penale. P.sh. personi A në një restorantë vjedh një pirun të thjeshtë. Në veprimet e personit A arrihen të githa elementet e veprës penale të vjedhjes, mirëpo meqë shkalla e rrezikshmërisë së kësaj vepre është e parëndësishme, kjo vepër nuk konsiderohet vepër penale

Për ekzistimin e veprës rëndësisë së vogel, duhet plotësuar në mënyrë kumulative të dy kushtet:

- Vepra duhet të jetë e rëndësisë së vogël dhe
- Nuk ka pasur fare pasoja të dëmshme, apo pasoja dëmtuese ka qenë e parëndësishme.

Se a është një vepër e rëndësisë së vogël varet nga shumë rrethana. Si bazë orientuese për vlerësimin se çfarë rëndësie është një vepër penale të shërbejë qëndrimi i ligjdhënësit i cili manifestohet në dënimin e parashikuar për veprën penale.

Për tu konsideruar një vepër e rëndësisë së vogël përveç peshës se veprës, duhet plotësuar edhe kushtet tjera të cilat kryesisht kanë të bëjnë më:

- Mjetet më të cilat është kryer vepra penale,
- Rrethanat në të cilat një vepër penale është kryer,
- Raportet psikike të kryerësit ndaj veprës (Forma e fajit, qëllimi dhe motivi i tij) etj.

Nuk është e nevojshme që të gjitha këto kushte të përmbushen më çdo rast, është e mundur që të ekzistojë vetë një kusht dhe vepra të trajtohet e rëndësisë së vogël.

Kushti i dytë, që një vepër penale të konsiderohet më rrezikshmëri shoqërore të parëndësishme kërkohet që të mos jetë shkaktuar pasoja e ndaluar, apo ajo të jetë e parëndësishme p.sh. te vepra penale tentative e marrjes së automjetit të huaj, personi A hynë në veturën e personit B dhe dëshiron që të shkojë diku mirëpo pengohet në realizimin e qëllimit të tij (ai nuk ka shkaktuar fare pasojën). [282]

[281] Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës pjesa e Përgjithshëm Neni 14

[282] Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës pjesa e Përgjithshëm Neni 11

17. Urdhrat nga lartë

Personat që për nga hierarkia janë në pozitë vartëse, janë të obliguar ti ekzekutojnë urdhrat e eprorëve të tyre. Mirëpo, mund të ndodhë që më ekzekutimin e atyre urdhrave të kryhet vepra penale.

Sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosoves edhe kur vartësi kryen vepra penale sipas urdhrit të eprorit do të konsiderohet penalisht përgjegjës dhe do të dënohet, mirëpo në tri nënparagrafe të këtij neni janë paraparë rastet kur vartësi edhe pse ka kryer vepër penale nuk konsiderohet penalisht përgjegjës dhe nuk denohet nëse:

1 Personi ishte i detyruar ligjërisht t'u bindej urdhrave të tillë.
2 Personi nuk e dinte që urdhri ishte i paligjshëm dhe
3 Urdhri nuk ishte në mënyrë të dukshme i paligjshëm.

18. Vetlëndimi

Vetlëndimi ekziston në rastet kur një person e dëmton të mirën juridike, të mirën personale, p.sh. i shkakton vetës lëndime trupore apo e shkatërron pasurinë e vet. Të mirat juridike personale konsiderohen p.sh. jeta, integriteti trupor, nderi autoriteti, liria e qarkullimit, pasuria indivduale etj.

Në të drejtën penale vetëlëndimi nuk paraqet vepër penale më kusht që mos të paraqesë rrezik për shoqërinë.

Do të përgjigjet penalisht ai i cili më qëllim që ti shmanget shërbimit ushtarak e plagos veten, në këtë situate konsiderohet se personi i tillë ka kryer vepër penale shmangie nga shërbimi ushtarak duke e bërë veten të paaftë.

19. Përfundim

Duke u bazuar në temën konkludojmë se:

Nuk konsiderohet si vepër penale çdo vepër shoqërore e rrezikshme. Për tu konsideruar një veprim i rrezikshëm si vepër penale, është e domosdoshme që ai veprim të manifistohet më një shkallë të lartë të rrezikshmërisë dhe të jetë i përcaktuar më ligj si vepër penale.

Edhe pse këto vepra penale të lartëshenuara janë të parapara më KPRK, si vepra penale, kryerësit e veprës do të lirohen nga përgjegjësia penale apo do të dënohen më lehtë nëse provohet se ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, nevojë ekstreme, ndikimin e dhunës apo kanosjes për ta evituar rrezikun që i është drejtuar atij drejtpërdrejtë apo dikujt tjeter, i cili rrezik ka qenë i atëçastshem dhe kundërligjshëm.

Çdo herë kur vërtetohet që në momentin e kryerjes së veprës penale nga kryesi ka qenë i ndikuar nga keto shkaqe apo situata të lartëshënuara do të lirohet nga përgjegjësia penale, apo do të dënohet më lehtë.

Bibliografia

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Ligjerata të autorizuara të mbajtura në Institutin Gjyqësor të Kosovës

Drilon Haraçia*

PARASHKRIMI I NDJEKJES PENALE DHE EKZEKUTIMIT TË SANKSIONIT PENAL

ABSTRAKT

Duke pas parasysh rëndësinë e ndjekjes penale dhe sanksioneve penale si fazë e procedurës penale ku shteti pas kalimit të afatit të paraparë ligjor e humb të drejtën për ndjekjen e kryrësve të veprave penale dhe ekzekutimin e sanksioneve penale, kjo në të drejtën penale quhet parashkrim. Në këtë punim do të bëhet fjalë se si rrjedh parashkrimi i ndjekjes penale dhe parashkrimi i sanksioneve penale. Pastaj, kur rrjedh parashkrimi i ndjekjes penale, ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale, parashkrimi absolut dhe relativ i ndjekjes penale, veprat penale të cilat nuk mund të parashkruhen, afatet e parashktimit të ndjekjes penale. Gjithashtu, është një aktvendim se si parashkruhet ndjekja penale. Këto vlejnë edhe te parashkrimi i sanksioneve penale. Duke marrë parasysh të gjitha këto, me këtë punim lexuesi do ta kuptojë rëndësinë e parashkrimit dhe me këtë do të jete në gjendje që në praktikë ta aplikojë këtë institut të drejtës penale.

Hyrja

Kosova si shtet i ri, dita ditës është duke e rregulluar sistemin juridik dhe duke i kushtuar rëndësi shtetit ligjor. Mirëpo, ende ka probleme me parashkrimin e ndjekjes penale dhe parashkrimin e sanksioneve penale me ç'rast qytetarët humbin besimin te sistemi gjygjësor për shkak të mos efikasitetit. Kjo vjen si pasojë e përballjes së gjyqtarit kosovar me ngarkesa të mëdha të lëndëve dhe afati i cili është interval kohor nuk ndalet. Gjithashtu, duhet pas parasysh se edhe Policia e Kosovës duhet të formojë task forcë për realizimin e urdhëresave të gjykatës e cila është shqetësuese për mos realizimin e tyre. Prandaj, instituti i parashkrimit në procedurën penale ka një rëndësi të madhe dhe më anë të këtij punimi do të njihemi më shumë rreth parashkrimit dhe hapat të cilat duhet të ndërmerren për të mos ardhur te parashkrimi.

1. Parashkrimi i ndjekjes penale

Parashkrimi i ndjekjes penale konsiston në atë se për shkak të kalimit të afatit i cili është paraparë më ligj nuk mund të ndërmerret ndjekja penale dhe personit nuk mund t'i shqiptohet dënim për vepër penale që e ka kryer. Andaj, parashkrimi apo vjetërsimi është institut juridik

* Drilon Haraçia, kandidatë për gjyqtar

ku shteti pas kalimit të afatit e humb të drejtën e zbatimit të ndjekjes penale. E drejta penale i njeh dy lloje të parashkrimit: parashkrimin e ndjekjës penale dhe parashkrimin e sanksioneve penale.

2. Fillimi i parashkrimit të ndjekjes penale

Parashkrimi i ndjekjes penale fillon prej ditës kur është kryer vepra penale. Për përcaktimin e fillimit të afatit të parashkrimit është vendos koha e kryerjes së veprës penale. Shumë kode penale në botë e pranojnë teorinë e veprimit dhe jo të pasojës. Te veprat penale të vazhduara dhe veprat penale kolektive parashkrimi fillon me ndërmarrjen e veprimit të fundit p.sh. te vepra penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332, parshkrimi i veprës penale të falsifikimit të dokumenteve fillon prej ditës së shfrytëzimit të dokumentit, te veprat penale të gjendjes fillimi i parashkrimit fillon në momentin e paraqitjes së pasojës, për veprimet në bashkëpjesëmarrje është koha e ndërmarrjes së veprimit për veprën kryesore dhe jo koha kur është ndërmarr vet veprimi bashkëpjesëmarrës, te deliktet omisive garantuese me paramendim fillimi i parashkrimit përputhet me mos plotësimin e obligimeve garantuese. [283]

Sipas Kodit Penal të Kosovës fillimi i parashkrimit të ndjekjes penale rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale. Nëse ndonjë pasojë që përbën element të veprës penale shfaqet më vonë, afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga ajo kohë neni 107 par.1 të KPRK-së. Në rast se vepra penale është kryer kundër personit nën moshën tetëmbëdhjetë vjet, afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga dita kur viktima të ketë mbushur tetëmbëdhjetë vjetë neni 107 par.2 të KPRK-së. [284]

3. Ndalja e parashkrimit të ndjekjes penale

Ndalja e parashkrimit të ndjekjes penale paraqitet atëherë kur për shkak të disa rrethanave të parapara me ligj ndjekja penale nuk mund të fillohet apo nëse është filluar nuk mund të vazhdohet sipas ligjit. Gjatë asaj kohe derisa janë të pranishme ato rrethana të cilat e pengojnë fillimin apo vazhdimin e ndjekjes penale, parashkrimi nuk rrjedh. Kjo ngecje e afatit të parashkrimit për shkak të efektit të rrethanave të caktuara, quhet ndalja e parashkrimit. Kur pushojnë pengesat që kanë shkaktuar ndaljen e parashkrimit, afati i parashkrimit vazhdon të ecë. Në atë mënyrë se për aqë kohë sa ka zgjatur ndalja, për aq kohë vazhdohet edhe afati i parashkrimit.

Në të drejtën penale njihen dy lloje të pengesave të cilat mund të shkaktojnë ndaljen e afatit të parashkrimit: pengesat faktike dhe pengesat juridike.

Pengesat faktike janë ato rrethana dhe situata reale të cilat e bëjnë të pamundshëm fillimin apo vazhdimin e ndjekjes penale, të tilla janë p.sh. arratisja e kryesit të veprës penale, kur nuk dihet

[283] E drejta penale. Prof.Dr. Vllado Kambovski, Shkup, 2006, fq. 1068
[284] Kodi penal i Republikës së Kosovës, Nr.04/L-082, fq. 46

vendbanimi i kryesit, okupimi i territorit nga ana e armikut, tërmeti, vërshimet, zjarri dhe rrethanat e tjera të ngjashme të cilat e bëjnë të pamundur punën e gjykatës.

Pengesat juridike ekzistojnë kur është fjala për ndonjë rrethanë apo situatë të natyrës juridike, për shkak të cilave nuk mund të fillohet apo të vazhdohet ndjekja penale të tilla p.sh janë imuniteti i deputetit të parlamentit, sëmundja psikike e të pandehurit gjatë procedurës penale etj. Në raste kur vepra penale është kryer në bashkëpunim, ndalja e parashkrimit mund të paraqitet vetëm ndaj atij bashkëpunëtori te i cili ekzistojnë rrethanat apo situatat e sipërpërmendura, kurse ndaj të tjerëve afati i parashkrimit vazhdon të ecë.[285]

4. Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale

Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale në kodin tonë penal është paraparë në dy raste ku parshkrimi ndërpritet në çdo veprim të organit kompetentë shtetëror, i cili ndërmerret me qëllimin të ndjekjes së kryesit të veprës penale, dhe rasti i dytë ku kryesi gjatë afatit të parashkrimit kryen vepër të re penale, ku vepra e re penale nga pesha duhet të jetë e njëjtë apo më e rëndë se ajo që është kryer më parë.[286]

Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim procesor që ndërmerret për shkak të ndjekjes së kryesit për shkak të veprës së kryer. Veprimi procedural duhet të ndërmerret kundër personave konkret në cilësinë e kryesit për vepër konkrete penale, janë të përjashtuara veprimet e ndërmarra kundër kryesit të panjohur ose kundër personit konkret p.sh. kryesi vërtetë është thirr në bisedë informative në polici, por pa shkas që biseda të jetë konkretisht për veprën penale. Veprimi i ndërprerjes së parashkrimit për dallim nga ndalja përbëhet në atë që për secilën ndërprerje (secili veprim procedural, ose vepër e re penale) parashkrimi fillon të rrjedh, kështu që në afat të parashkrimit nuk llogaritet koha e parashkrimit para paraqitjes së ndërprerjes.[287]

Në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, afati i parashkrimit ndërpritet me qdo veprim i cili ndërmirret për qëllime të ndjekjës penale të veprës penale të kryer (neni 107 par.5). Afati i parashkrimit po ashtu ndërpritet kur kryesi para skadimit të afatit të parashkrimit kryen një vepër tjetër penale me peshë të njejtë ose më të rëndë se sa vepra penale e mëparshme (neni 107 par.6), pas çdo ndërprerje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.

5. Parashkrimi absolut i ndjekjes penale

Ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit mund të shpijnë praktikisht që kur njëherë të mos shkaktohet parashkrimi. Për këtë arsye, Kodi Penal e ka paraparë parashkrimin absolut të ndjekjes penale, i cili lind kur kalon dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrimin (neni 107 par.8), kështu p.sh. nëse për ndonjë vepër penale është paraparë parashkrimi relativ për 2 vite, parashkrimi absolut do të jetë 4 vite, apo nëse për një vepër është paraparë afati i parashkrimit 3 vite, parashkrimi absolutë do të jetë 6 vite.[288]

---

[285] E drejta penale. Prof.Dr. Ismet Salihu, Prishtinë, 2010, fq. 561-562
[286] E drejta penale. Prof.Dr. Ismet Salihu, Prishtinë, 2010, fq. 568-569
[287] E drejta penale. Prof.Dr. Vllado Kambovski, Shkup, 2006, fq. 1069
[288] Doracaku i Provimit të Jurisprudencës, Prishtinë 2009, fq. 223

6. Veprat penale të cilat nuk mund të parashkruhen

Mos parashkrimi i krimeve ndërkombëtare, ndjekja penale dhe ekzekutimi i dënimit nuk vjetërsohet për veprat penale si: gjenocid, krimet kundër njërzimit dhe krimet e luftës të parapara në KPRK-së, dhe veprat për të cilat janë paraparë me Konventa ndërkombëtare si ajo e Kombeve të Bashkuara për mos parashkrimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njërzimit nga viti 1968 si dhe Konventa Evropiane e vitit 1974.[289]

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës mos zbatueshmëria e parashkrimit për veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare dhe vrases së rëndë neni 111 par.1 dhe 2, asnjë afat i parashkrimit nuk zbatohet për veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, ose për vepra tjera penale të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen si dhe vepra penale e vrasjes së rëndë nuk parashkruhet.

7. Afatet e parashkrimit sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës neni 106

Ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme:

- Tridhjetë (30) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim të përjetshëm neni 106 par.1 pika 1.1 të KPRK-së:
- Njëzetë (20) nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim me më shumë se dhjetë (10) vjet neni 106 par.1 pika 1.2 të KPRK-së:
- Dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim me më shumë se pesë (5) vjet neni 106 par.1 pika 1.3 të KPRK-së:
- pesë (5) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim me më shumë se tre (3) vjetë neni 106 par.1 pika 1.4 të KPRK-së:
- tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim me më shumë se një (1) vjet neni 106 par.1 pika 1.5 të KPRK-së:
- dy (2) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim deri në një (1) vjet neni 106 par.1 pika 1.6 të KPRK-së es.[290]

Formë e Aktvendimit për parashkrimin e ndjekjes penale:

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, me gjyqtarin individual X.X. dhe sekretaren juridike I.I. në lëndën penale kundër të pandehurit N.N. nga Gjakova për shkak të veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.nr.10/2009 dt.10.01.2019, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 107 parag. 8 të KPRK-së, dhe nenit 363 parag.1 pika 13 të KPPK-së, me dt.12.05.2014 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET AKUZA DHE PUSHOHET PROCEDURA PENALE kundër të pandehurit N.N nga Gjakova për shkak të veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 par.1 të KPRK-së.

[289] E drejta penale. Prof.Dr. Vllado Kambovski, Shkup, 2006, fq. 1070
[290] Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.04/L-082, fq. 46

- **Për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale nga neni 107 paragrafi 8 të KPRK-së.**
- Në bazë të nenit 69 të KPRK-së, **i shqiptohet masa e sigurisë-marrja e diplomës së falsifikuar**, e cila është objekt i kryrjes së veprës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë ka parashtruar Aktakuzën PP.nr.10/2009 dt.10.01.2009 pranë kësaj gjykate, kundër të pandehurit N.N. nga Gjakova për shkak të veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke shqyrtuar aktakuzën PP.nr.10/2009 dt.10.01.2009, erdhë në përfundim se ndjekja penale ndaj të pandehurit N.N. nga Gjakova për shkak të veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 par.1 të KPRK-së ka ardh gjerë te parashkrimi absolut.

Vepra penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag.1 i KPRK-së, është e sanksionuar me dënim me gjobë dhe me dënim me burgim deri në 3 (tre) vite.

I pandehuri dyshohet se veprimet i tij për veprën penale që i vihet në barrë i ka ndërmar me datën 17.09.2007 ku e ka prezantuar këtë dokument para organit publik.

Gjykata duke i analizuar veprimet e të pandehurit të ndërmara me datën 17.09.2007 dhe gjerë me datën e marrjes së këtij Aktvendimi 12.05.2014, kanë kaluar mbi 6 (gjashtë) vite, erdhi në përfundim se është arritë parashkrimi absolut i ndjekjes penale ndaj të pandehurit N.N. nga Gjakova për shkak të veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 par.1 të KPRK-së

Siaps nenit 107 parag.8 të KPRK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Vendimi mbi masën e sigurisë – marrja e diplomës së falsifikuar është marrë në bazë të nenit 69 të KPRK- së, e cila është objekt i kryerjes së veprës penale.

Gjykata konform nenit 107 parag. 8 të KPRK-së dhe nenit 363 parag. 1 pika. 13 të KPPK-së, dhe arsyet e caktuara më lart vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

MARRË NË GJYKATËN THEMELORE NË GJAKOVË,

P. nr.23/2009 më datë 12.05.2014.

Gjyqtari

X.X.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej

dite, nga dita e marrjes së tij në dorëzim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.

8. Parashkrimi i sanksioneve penale

Parashkrimi i sanksionit penal konsiston në atë se për shkak të kalimit të afatit i cili është paraparë me ligj nuk mund të ndërmerret ekzekutimi i sanksionit penal dhe personi nuk mund të dërgohet në vuajtje të denimit apo ndonjë obligim në të holla për vepër penale që e ka kryer. Andaj parashkrimi apo vjetërsimi është institut juridik ku shteti pas kalimit të afatit e humb të drejtën e zbatimit të sanksionit penal.

9. Fillimi i parashkrimit të ekzekutimit të sanksionit penal

Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit konsiston në atë se pas kalimit të kohës së paraparë me ligj, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet. Kjo situatë mund të ndodhë nëse dënimi nuk ka filluar të ekzekutohet apo nëse ekzekutimi i tij është ndërprerë.

Afati i parashkrimit të dënimit fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotëfuqishëm, ndërsa nëse është revokuar dënimi alternativ, nga dita kur vendimi mbi revokimin është bërë i plotfuqishëm.

Parashkrimi i ekzekutimit shprehet si për dënimet kryesore, ashtu dhe për dënimet alternative dhe plotësuese. Mirëpo parashkrimi i dënimeve plotësuese nuk shprehet në të njëjtën kohë si për dënimet kryesore dhe alternative.

Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedh prej momentit kur aktgjykimi me të cilin është shqiptuar dënimi është bërë i plotfuqishëm. Përjashtim nga kjo rregull ekziston në rastin e arratisjes së të dënuarit. Përkatësisht, në rastin e revokimit të dënimit me kusht, afati i parashkrimit fillon të ecë prej ditës kur i dënuari është arratisur. [291]

10. Ndalja dhe ndërprerja e ekzekutimit të dënimit

Parashkrimi nuk rrjedh gjatë kohës për të cilën sipas ligjit kryerja e dënimit nuk mund të ndërmerret. Pushimi i parashkrimit mund të jetë i nxitur vetëm me pengesa juridike dhe jo edhe me ato faktike për ekzekutimin e dënimit dhe sanksioneve tjera dhe masave. Pas ndërprerjes së pengesave ligjore parashkrimi vazhdon të rrjedh prej momentit ku është ndërprerë që do të thotë se në afatin e parashkrimit llogaritet edhe koha para paraqitjes së pengesave juridike.

Secili veprim i organeve kompetente i ndërmarr për të kryer dënimin sjell deri te ndërprerja e parashkrimit. Me veprim të ndërmarr për të ekzekutuar dënimim nënkuptojë veprimet e parapara në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, me të cilin sigurohet kryerja vullnetare ose e dhunshme e dënimit si p.sh. thirrja apo urdhëresa për të kryer dënimin me burg apo urdhëresa për sjelljen me dhunë apo fletë rreshtimi vendor dhe ndërkombëtar. Me çdo ndërprerje parashkrimi fillon të rrjedh përsëri, kjo do të thotë se koha para veprimit me të cilën ndërpritet parashkrimi nuk llogaritet në afatin e parashkrimit

[291] E drejta penale. Prof.Dr. Ismet Salihu, Prishtinë, 2010, fq. 563-564

Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit paraqitet në çdo rast kur të kaloj dy herë kohë më shumë që sipas ligjit kërkohet për parashkrim të kryerjes së dënimit.

Rrethanat për shkak të të cilave dënimi nuk mund të ekzekutohet mund të jenë të natyrës juridike dhe faktike. Rrethanat të tilla të cilat shpiejnë ndaljen e afatit të parashkrimit janë p.sh. prolongimi i ekzekutimit të dënimit në bazë të ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, poashtu është e mundur edhe kur i dënuari është i sëmurë, apo i vdes ndonjë antar i familjës së ngushtë dhe kur oraganet e ndjekjës penale nuk mund ta gjejnë përsonin e dënuar. [292]

11. Parashkrimi absolut i sanksioneve penale

Ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit të dënimit prodhojnë të njëjtin efekt si te ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit të ndjekjës penale. Parashkrimi absolut i ekzekutimit të dënimit paraqitet në rast kur të kaloj dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrimin e ekzekutimit, pa marrë parasysh sa ndalja dhe ndërprerja kanë qenë dhe pa marrë parasysh kahëzgjatjen e tyre. Në rast kur shkaktohet (lind) parashkrimi absolut i ekzekutimit të dënimit, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet. Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrushëm janë lloje të sanksioneve penale andaj edhe ndaj tyre vlen instituti i parshkrimit.

12. Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm

Dënimet plotësuese sikundër edhe dënimet kryesore, janë lloje të sanksioneve penale, andaj edhe ndaj tyre vlen instituti i parashkrimit. Instituti i parashkrimit gjithashtu vlen edhe për masat e trajtimit të detyrushëm. Shkaqet e përgjithshme të cilat shpijnë parashkrimin e dënimit plotësues dhe masave të trajtimit të detyrueshëm janë të njëjta si për parashkrimin e ekzekutimit të dënimeve kryesore. Gjithashtu, në të njëjtat kushte vlejnë dispozitat mbi ndaljen dhe ndërprerjen e parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve plotësuese si dhe për parashkrimin absolut. Mirëpo, për shkak të specifikave të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet me to, afatet e parashkrimit të ekzekutimit nuk kanë mundur të caktohen njësoj si për parashkrimin e ekzekutimit të dënimeve kryesore.

13. Veprat penale të cilat nuk mund të parashkruhen

Mos parashkrimi i krimeve ndërkombëtare dhe ekzekutimi i dënimit nuk vjetërsohet. Pra, asnjë afat i parashkrimit nuk zbatohet për veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerzimit, ose për vepra tjera penale të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen.

[292] E drejta penale. Prof.Dr. Vllado Kambovski, Shkup, 2006, fq.1072-1073

14. Afatet e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës neni 108

- Ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillohet nëse kanë kaluar afatët e mëposhtme:
- Tridhjetë (30) vjet nga dënimi me burgim të përjetshëm neni 108 par.1 pika 1.1 të KPRK-së:
- Njëzetë (20) nga dënimi me burgim mbi dhjetë (10) vjetë neni 108 par.1 pika 1.2 të KPRK-së:
- Dhjetë (10) vjetë nga dënimi me burgim mbi pesë (5) vjetë neni 108 par.1 pika 1.3 të KPRK-së:
- Pesë (5) vjetë nga dënimi me burgim mbi tre (3) vjetë neni 108 par.1 pika 1.4 të KPRK-së:
- tre (3) vjetë nga dënimi me burgim me shumë se një (1) vjetë neni 108 par.1 pika 1.5 të KPRK-së:
- dy (2) vjetë nga dënimi me burgim deri në një (1) vjetë neni 108 par.1 pika 1.6 të KPRK-së.

15. Parashkrimit i ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës

- Ndalohet ekzekutimi i dënimeve të tjera plotësuese kur të kenë kaluar pesë (5) vjet nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit me të cilin shqiptohet ky dënim neni 109 par.1 të KPRK-së.

- Ndalohet ekzekutimi i masës së trajtimit të detyrueshëm kur të kenë kaluar tre (3) vjet nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit me të cilin shqiptohet kjo masë nga neni 109 par.2 të KPRK-së.
- Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm ndërpritet kur personi nuk i përmbahet urdhërave të gjykatës lidhur me dënimet plotësuese dhe masat e trajtimit të detyrueshëm neni 108 par.3 të KPRK-së.

Formë e Aktvendimit për parashkrimin e sanksionit penal:

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, me Kryetarin e Gjykatës D.D, lidhur me ekzekutimin e sanksionit penal kundër të dënuarit X.X. nga Gjakova për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 pika 1.1 të KPRK-së, sipas detyrës zyrtare më datë **12.05.2014** mori këtë:

A K T V E N D I M

NDALET ekzekutimi i dënimit për shkak të parashkrimit absolut ndaj të dënuarit X.X. nga Gjakova, për shkuarje në vuajtje të dënimit sipas lëndës ED.nr.20/2009 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, kështu që ndërprehet çdo veprim sa i përket ekzekutimit.

Ankesa nuk e ndalon zbatimin e këtij Aktvendimi.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë, sipas detyrës zyrtare, ka udhëheqë procedurën penale ED.nr.20/09 nga data 20.01.2009, kundër të gjykuarit X.X. me banim në Gjakovë, për dërgim në vuajtje të dënimit, të gjykuar sipas Aktgjykimit P.nr.50/08 të datës 25.07.2008 marrë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vite, i cili Aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datën 15.08.2008.

Gjykata Themelore në Gjakovë të dënuarin e ka ftuar për dërgim në vuajtje të dënimit me datën 20.09.2008 dhe i gjykuari në mënyrë vullnetare nuk është paraqitë në Gjykatë për shkuarjen në vuajtjen e dënimit, kështu që kjo Gjykatë ka lëshuar Urdhëresën për dërgim me dhunë në vuajtje të dënimit ED.nr.20/2009 të dt.01.10.2009 dhe me datën 02.03.2010 kemi lëshuar Fletë rrështimin ED.nr.20/09, mirëpo e njëjta nga Policia e Kosovës -Stacioni Policor në Gjakovë nuk është zbatuar asnjë herë siq rezulton nga shkresat në lëndë.

I dënuari sipas Aktgjykimit të lartcekur ka qenë i gjykuar me dënim burg efektiv në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Duke marrë për bazë se Aktgjykimi P.nr.50/08 të datës 25.07.2008 i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 15.08.2008 dhe është i ekzekutueshem nga dita e marrjes së të njëjtit e gjerë në ditën e marrjes së këtij Aktvendimi kanë kaluar mbi 4 vite, konform nenit 106 par.1 pika 1.6 lidhur me nenin 107, 108 dhe 110 par.1,2 dhe 6 të KPRK-së, Gjykata konsideron se ka ardhur gjerë te parashkrimi i dënimit të sanksionit penal meqenëse kanë kaluar mbi 4 (katër) vite pa u ekzekutuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Nga arsyet e caktuara më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

MARRË NË GJYKATËN TEMELORE NË GJAKOVË,

ED.nr.20 /2009 më datë 12.05.2014.

Kryetari i Gjykatës-gjyqtari,

D. D

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.

16. Përfundimi

Në fund dua të ceki se e gjithë kjo çka është thënë për parashkrimin e ndjekjes penale dhe parashkrimin e sanksioneve penale, ne si shtet i ri nuk i kemi kushtuar shumë rëndësi këtij instituti meqë shumë lëndë parashkruhen nëpër sirtarët e Gjykatave, dhe kjo rrjedh si pasojë e numrit të madhe të lëndëve që kanë gjyqtarët, si dhe mungesa e kuadrove të specializuara në

Policinë e Kosovës për realizimin e urdhëresave si në vendet e perëndimit. Andaj edhe rrjedh parashkrimi. Por duke u nisur nga fakti se një temë e këtillë është një fushë e gjerë, kuptohet se ka edhe shumë për të thënë, megjithatë ajo çka është më me rëndësi është përfshi në këtë punim.

Bibliografia

- E drejta penale. Prof.Dr. Vllado Kambovski, Shkup-2006, Shtëpia Botuese SHB "Furkan ISM" Brigada II Maqedonase lok.22, 1000 Shkup-Maqedoni
- E drejta penale. Prof.Dr. Ismet Salihu, Prishtinë- 2010, Botimi i 4, Universiteti "Fama" - Prishtinë
- Doracaku i Provimit të Jurispodencës, Prishtinë -2009 Implementuar nga UNDP-Kosovë dhe mbështetuar nga Qeveria Japoneze.
- Kodi penal i Republikës së Kosovës, Nr.04/L-082.




Ylber Shurdhiqi* **Violeta Namani*** **Valdet Avdiu*** **Avdulla Abedini***

VEPRAT PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT

1. Hyrje

Kosova pas përfundimit të luftës ka dal me institucione të shkatërruara. Kjo nënkupton, që korrupsioni dhe kriminaliteti në Kosovë sikurse në çdo shoqëri tjetër, ka filluar të ketë shtrirje enorme, gjë që ka vështirësuar funksionimin e përgjithshëm shoqëror. Pas përfundimit të luftës Kosova ishte pa infrastrukturë ligjore, pa institucione dhe pa funksionim të mirëfilltë shtetëror, përkundër asaj që vendosja e administratës së UNMIK-ut, bëri përpjekje që të konsolidoj funksionimin e jetës shoqërore, me të gjitha vështirësitë që ishin evidente.

Tema të cilën e kemi përzgjedhë të punojmë është "Veprat penale kundër korrupsionit". Në këtë punim jemi munduar ta trajtojmë këtë temë me një vështrim kritik, dhe sa më gjithëpërfshirës.

Në fillim të punimit do të flitet për kuptimin dhe nocionin e veprës penale të korrupsionit.

Si fazë tjetër e këtij punimi kërkimor shkencor do të jenë edhe karakteristikat e veprave penale të korrupsionit, korrupsioni zyrtar dhe veprat penale të korrupsionit zyrtar.

2. Kuptimi dhe nocioni i veprës penale kundër korrupsionit

Vepra penale kundër korrupsionit nënkupton çdo shkelje të detyrës së personave zyrtar ose përgjegjës në subjektet juridike dhe çdo veprimtari e iniciatorëve apo përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si përgjigje ndaj një shpërblimi që drejtpërdrejtë ose indirekt është premtuar, ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar apo është pritur për t'u marrë për një person tjetër [293].

Korrupsion – çdo keqpërdorim të pushtetit apo çdo sjellje tjetër të personit zyrtar, personit përgjegjës apo personit tjetër me qëllim të arritjes së një përparësie apo përftimi të kundërligjshëm për veten apo për tjetrin[294].

---

* Ylber Shurdhiqi, kandidatë për gjyqtar
* Violeta Namani, kandidate për prokurore
* Valdet Avdiu, kandidatë për prokuror
* Avdulla Abedini, kandidatë për prokuror

[293] Ligji kundër korrupsionit Nr.2004/34 i datës 22 prill 2005

[294] Ligji për Agjencinë kundër korrupsionit Nr. 03/L-159 i datës 29 dhjetor 2009, është shpallur me dekretin Nr. DL-006-2010, me datën 19.01.2010.

3. Karakteristikat e veprave penale të korrupsionit janë:

1. Shkelja e normave ligjore dhe atyre etike nga personi zyrtar.
2. Qëllimi për përfitime personale.
3. Dobia për vete apo për personin tjetër dhe
4. Shkaktimi i dëmit për individin apo shoqërinë.

Zyrtar i Lartë Publik[295] në Republikën e Kosovës janë:

Presidenti i Republikës së Kosovës, anëtarët e kabinetit të Presidentit, Sekretari si dhe Drejtorët e Departamenteve Profesionale në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës; Deputetët e Kuvendit, të gjithë personat e zgjedhur apo të emëruar nga Kuvendi, Kryesia, Kryetari i Kuvendit si dhe Kabineti i Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës; Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, zëvendës Ministrat, Këshilltarët politik, Shefat e kabineteve si dhe të gjithë te emëruarit nga ta; Sekretarët e Përgjithshëm të Qeverisë, Kryeshefat e Agjencive të themeluara me ligj apo me ndonjë akt tjetër, Drejtori dhe Zëvendës Drejtori, Drejtorët regjional të Administratës Tatimore të Kosovës, Drejtori i përgjithshëm si dhe Drejtorët e Departamenteve të Doganës;

Auditorët në Zyrën e Auditorit Gjeneral dhe të gjithë auditorët e brendshëm te institucioneve;

Anëtarët e Bordeve të Ndërmarrjeve Publike, anëtarët e Bordeve të Rregullatorëve, të Komisioneve apo Agjencive tjera të themeluara me ligj apo me ndonjë akt tjetër; Anëtarët e Bordit, Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i Bankës Qendrore; Kryetarët e Komunave dhe Zëvendës Kryetarët, Kryesuesit;

Zëvendës Kryesuesit, Këshilltarët e Asambleve Komunale si dhe të gjithë Drejtorët e Drejtorive Komunale;

Anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial, Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, Auditori Gjyqësor, Prokurori Disiplinor; Gjyqtarët dhe Prokurorët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Sekretari i Gjykatës Kushtetuese;

Drejtorët e të gjitha Departamenteve, Udhëheqësit e Financave dhe Prokurimit publik në të gjitha institucionet publike; Ambasadorët, Konsujt, Zëvendës Konsujt, Sekretarët e Ambasadave apo Konsullatave të Republikës se Kosovës;

Rektori dhe Prorektorët e Universitetit Publik, Dekanët dhe Prodekanët, si dhe Sekretari i Universitetit Publik dhe Njësive Akademike; Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtoret dhe Drejtoret rajonal të Policisë së Kosovës, Kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës; Komandanti, Zëvendës Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës; Drejtori, Zëvendës Drejtori si dhe Inspektori i Përgjithshëm i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës; Avokati i Popullit dhe Zëvendësit e tij;

Kryeinspektorët e Inspektorive të nivelit qendror dhe lokal.

[295] Ligji për Deklarimin, Prejardhjen, dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik Nr.04/L-050 të datës 31 gusht 2011, shpallur me dekretin Nr.DL-028-2011, i datës 31.08.2011.

Zyrtar i huaj publik apo person i huaj zyrtar [296] nënkupton:

- Cilido person që mban detyrë legjislative, ekzekutive, administrative apo gjyqësore në shtetin e huaj, qoftë i emëruar apo i zgjedhur;
- cilido arbitër që ushtron funksione sipas ligjit kombëtar mbi arbitrimin e shtetit të huaj;
- cilido person që ushtron funksion publik për shtetin e huaj, përfshirë për agjencinë publike ose ndërmarrjen publike;
- cilido zyrtar, punonjës apo përfaqësues i organizatës ndërkombëtare publike dhe organeve të tyre;
- cilido anëtar i asamblesë parlamentare ndërkombëtare; dhe
- cilido gjyqtar, prokuror apo zyrtar i gjykatës apo tribunalit ndërkombëtar që ushtron juridiksion mbi Republikën e Kosovës.

4. Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

Me veprat penale kundër detyrës zyrtare të parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës mbrohet ushtrimi normal, i rregullt dhe i ligjshëm i detyrës zyrtare nga ana e personave të cilëve me ligj u janë besuar autorizime të ndryshme publike dhe shtetërore. Personat e autorizuar detyrën zyrtare duhet ta ushtrojnë në bazë të ligjit si dhe në interesin e efikasitetit të administratës e të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.

Kryerës i këtyre veprave penale më së shpeshti janë personat zyrtarë ose personat përgjegjës [297]. Mirëpo, kryerës i këtyre veprave penale në rastet e caktuara mund të jetë edhe çdo person, siç janë rasti i veprës penale të përdorimit të paautorizuar të pasurisë (neni 427), dhënia e ryshfetit (neni 430) dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtare (neni 433 KPRK-së).

Karakteristikë e përbashkët e këtyre veprave penale është se këto vepra kryhen me dashje. Kjo nga fakti se personat zyrtar apo përgjegjës me kryerjen e këtyre veprave penale me vetëdije dhe me vullnet veprojnë në mënyrë të kundërligjshme. Përjashtim bënë vetëm vepra penale e zbulimit të fshehtësisë zyrtare për të cilën është paraparë përgjegjësi penale edhe në rastet kur kjo kryhet nga pakujdesia [298]

Personi zyrtar [299], i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, neni 422 i KPRK-së.

---

[296] Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr.04/L-82 i datës 20 prill 2012 hyr në fuqi me datën 01 janar 2013, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 4 të Republikës së Kosovës.

[297] Neni 120 paragrafi 1 i Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr.04/L-82 i datës 20 prill 2012 hyr në fuqi me datën 01 janar 2013,shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 4 të Republikës së Kosovës.

[298] Ismet Salihu, E drejta penale (pjesa e posaçme), Prishtinë , 2014 faqe 652.

[299] Personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ shtetëror; personi i autorizuar në një organ shtetëror, organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligj ushtron detyra të posaçme; personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj neni 120 I KPK-së.

Korrupsioni si dukuri negative pengon zhvillimin e vendit sundimin e ligjit, fuqizimin e demokracisë, ndikon në humbjen e besimit të qytetarëve në drejtësi dhe institucionet shtetërore, nxit qytetarët të kryejn vepra penale të korrupsionit, bën rritjen e dallimeve në mes të personave me pozita të larta udhëheqëse të cilët me anë të korrupsionit arrijnë të pasurohen brenda natës, ndikon në zhvillimin ekonomik pasi që investitorët e huaj nuk investojnë në shtetet me korrupsion të theksuar për shkak të pasigurisë.

Kryerës të këtyre veprave penale në radhë të parë janë personat zyrtar dhe personat përgjegjës që ushtrojnë një funksion të caktuar në organet shtetërore, në shërbimet publike, institucionet dhe entet e tjera publike, të cilat vendosin për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve në organe shtetërore. Ata janë përfaqësues të shtresave më të larta shtetërore, ata janë persona në pozita dhe me autoritet, titullarë funksionesh të larta shtetërore dhe ekonomike me autorizime të caktuara, persona në vende përgjegjëse, në afarizmin komercial, ekonomik dhe doganor; në qarkullimin e mallrave - agjentë tregtarë, brigadierë etj. Zakonisht kryerës më të shpeshtë të këtyre veprave penale janë personat zyrtarë.

Mënyra e kryerjes së këtyre veprave penale të korrupsionit është me veprim dhe vetëm me dashje direkte.

Veprat penale kundër detyrës zyrtare, ndahen në vepra penale të cilat mund të kryhen vetëm nga personat zyrtar dhe veprat penale të cilat mund t'i kryejnë edhe personat të cilët nuk e kanë cilësinë e personit zyrtar apo personit përgjegjës.

Në kategorinë e veprave penale të cilat mund të kryhen vetëm nga personi zyrtar hyjnë këto vepra penale:

- Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar
- Keqpërdorimi i informatës zyrtare
- Përvetësimi në detyrë
- Konflikti i interesit
- Zbulimi i fshehtësisë zyrtare
- Mashtrimi në detyrë
- Marrja e ryshfetit
- Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore
- Falsifikimi i dokumentit zyrtar
- Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme
- Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor
- Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare.

Në kategorinë e veprave penale të cilat mund të kryhen edhe nga personat të cilët nuk e kanë cilësinë e personit zyrtar apo personit përgjegjës hyjnë këto vepra penale:

- Përdorimi i paautorizuar i pasurisë
- Dhënia e ryshfetit,
- Ushtrimi i ndikimit penale dhe
- Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj

Një nga elementet themelore të përbashkëta të veprave penale të cilat mund t'i kryej edhe personi i cili nuk e ka cilësinë e personit zyrtar apo personit përgjegjës, është edhe ai që kryerës i saj, në numrin më të madh të rasteve, mund të jetë vetëm personi zyrtar. Mirëpo personi zyrtar, si subjekt kryesor i këtyre veprave, vetvetiu nuk e përcakton karakterin e tyre për t'u radhitur në grupin e veprave penale kundër detyrës zyrtare. U tha se esenca e veprave penale kundër detyrës zyrtare është cenimi i detyrave dhe funksioneve të shërbimeve, gjë që implikon konceptin e gjerë të veprave të këtilla, në të cilat hyjnë, përpos veprave që ndërmerren në ushtrimin e detyrës zyrtare, edhe veprat lidhur me kryerjen e tyre. Bëhet fjalë për vepra penale specifike që nuk janë ekskluzivisht vepra penale zyrtare, por ato, përpos personave zyrtarë, mund t'i kryejnë edhe personat e tjerë në detyrë apo përgjithësisht që punojnë në organet shtetërore apo në ndonjë shërbim publik; kryerës i tyre mund të jetë edhe çdo person (përmes ushtrimit të ndikimit, dhënies së ryshfetit etj.).

Kryerësit e veprave penale të korrupsionit rëndom nuk janë nga radhët e kriminalitetit klasik, por ata janë përfaqësues të shtresave më të larta shtetërore, ata janë persona në pozita dhe me autoritet, titullarë funksionesh të larta shtetërore dhe ekonomike me autorizime të caktuara, persona në vende përgjegjëse, në afarizmin komercial, ekonomik dhe doganor; në qarkullimin e mallrave - agjentë tregtarë.

Këto vepra penale mund të konsumohen vetëm gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe jashtë kësaj, këto vepra penale nuk ekzistojnë. Zakonisht kryerës më të shpeshtë të këtyre veprave penale janë personat zyrtarë që ushtrojnë një funksion të caktuar në organet shtetërore, në shërbimet publike, institucionet dhe entet e tjera publike, të cilat vendosin për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve dhe të personave juridikë, siç janë: dhënia e lejeve a pëlqimeve të caktuara, dhënia e certifikatave, aktvendimeve, diplomave, detyrimet e ndryshme tatimore, doganore dhe detyrimet e tjera financiare ndaj shtetit etj.

5. Veprat penale të korrupsionit sipas Kodi Penal të Republikës së Kosovës

5.1 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar

Kjo vepër penale kryhet me veprim dhe me mos veprim. Me veprim kryhet kur personi zyrtar i ndërmerr veprimet të cilat janë në kuadër të autorizimeve të tij, mirëpo këto autorizime i përdor për ti sjell vetes apo tjetrit dobi pasurore ose për ti shkaktuar dëm tjetrit. Si mënyrë tjetër e kryerjes së kësaj vepre penale është edhe tejkalimi i kompetencave e cila kryhet kur personi zyrtar me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose personin tjetër apo për ti shkaktuar dëm tjetrit tejkalon kompetencat e tij. Me mos veprim kjo vepër penale kryhet atëherë kur personi zyrtar për ti sjell vetes apo tjetrit dobi pasurore ose për ti shkaktuar dëm tjetrit nuk e kryen detyrën e tij zyrtare, nuk e ndërmerr veprimin të cilin në bazë të ligjit është dashur që ta ndërmerr.

Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë.

5.2 Keqpërdorimi i informatës zyrtare

Kjo vepër penale kryhet atëherë kur personi zyrtar me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër e keqpërdor ndonjë informatë zyrtare të cilin e ka mësuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë.

5.3 Konflikti i interesit

Kjo vepër penale konsumohet në rastet kur ka mos pajtim ndërmjet detyrës zyrtare publike dhe interesit privat të një zyrtari, kur gjatë ushtrimit të funksionit të tij zyrtari ose personi i afërt ka interes privat pasuror ose personal jo pasuror, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikon, ose mund të ndikojë në kryerjen në mënyrë të drejtë të funksionit publik, kur gjendet në situata të shkeljes së mundshme të parimeve, të kufizimeve dhe ndalesave apo detyrimeve, sipas dispozitave të ligjit.

5.4 Përvetësimi në detyrë

Kjo vepër penale kryhet kur personi zyrtar me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër gjatë kryerjes së detyrëss zyrtare e përvetëson pasurinë e cila i është besuar për shkak të pozitës së tij. Kryerës i kësaj vepre penale është personi zyrtar të cilit për shkak të pozitës që e ushtron i'u janë besuar para apo sende tjera me vlerë.

Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë.

5.5 Mashtrimi në detyrë

Kjo vepër penale kryhet kur personi zyrtar apo personi përgjegjës gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare e në lidhje me ushtrimin e detyrës zyrtare, me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, duke prezantuar llogari të rreme apo duke sjellë në ndonjë mënyrë tjetër në lajthim personin e autorizuar që të kryejë një pagesë të kundërligjshme.

5.6 Përdorimi i paautorizuar i pasurisë

Kjo vepër penale kryhet kur personi të cilit për shkak të shërbimit apo punës së tij i janë besuar para, letra me vlerë apo pasuri tjetër të luajtshme, ndërsa të njëjtat i përdor për tu sherbyer për vete apo ia jep pa autorizim në shfrytëzim personit tjetër.

Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë.

5.7 Marrja e ryshfetit

Kjo vepër penale kryhet kur personi zyrtat përfiton dobi pasurore për vete apo personin tjetër duke e kryer një punë zyrtare të cilën është dashur që në bazë të ligjit ta kryej, ose të mos e kryej një punë të cilën në bazë të ligjit nuk do të duhej ta kryente.

5.8 Dhënia e ryshfetit

Këtë vepër penale nuk e kryen personi zyrtar por këtë e kryen cilido person i cili jep dhuratë personit zyrtar me qëllim që personi zyrtar në kuadër të autorizimeve të tij ligjore të kryejë detyrën zyrtare të cilën ka qenë i detyruar ta kryejë apo të mos e kryejë detyrën zyrtare të cilën nuk do t'i lejohej ta kryente, apo kur dikush personit zyrtar apo personit përgjegjës i jep ose i premton dhuratë a ndonjë përfitim tjetër që ai, në kufijtë e autorizimeve të tij, të kryejë një veprim zyrtar i cili nuk lejohet të kryhet apo të mos e kryejë veprimin të cilën do të duhej ta kryente.

5.9 Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj

Mënyra e kryerjes së kësaj vepre penale është e ngjashme me mënyrën e kryerjes së veprës penale dhënia e ryshfetit, me dallim që në këtë rast ryshfeti i jepet zyrtarit të huaj publik, i cili për shkak të imunitetit nuk mund të ndiqet penalisht për marrje të ryshfetit.

5.10 Ushtrimi i ndikimit

Këtë vepër penale mund ta kryej çdo person, i cili në mënyrë të paligjshme premton, ofron ose kërkon, pranon dhuratë në mënyrë që të ndikohet te personi tjetër zyrtar që të kryhet apo të mos kryhet ndonjë veprim i ligjshëm apo të paligjshëm.

5.11 Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore

Vepra penale mund të kryhet me veprim dhe me mosveprim. Vepra penale kryhet me veprim duke u marrë një vendim, aktvendim, urdhëresë dhe akt tjetër i kundërligjshëm apo duke u ndërmarrë veprime të tjera me të cilat shkelet ligji, (p.sh., futja me vetëdije në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të fakteve të paqena, të cilat kanë ndikuar esencialisht në mos marrjen e një vendimi të ligjshëm). Ndërkaq, vepra penale kryhet me mosveprim në rastet kur ka ekzistuar obligimi i gjyqtarit për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara, (p.sh., gjyqtari me qëllim nuk i ka futur në procesverbal faktet relevante, nga të cilat varet ekzistimi apo mosekzistimi i përgjegjësisë duke nxjerrë akt të kundërligjshëm.

Për të ekzistuar kjo vepër penale duhet që të ekzistoj qëllimi që gjyqtari vetes apo tjetrit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm.

5.12 Zbulimi i fshehtësisë zyrtare

Kjo vepër penale ekziston kur personi zyrtar apo personi përgjegjës, pa pasur autorizim, ia kumton, ia kalon ose, në ndonjë mënyrë tjetër, ia bën të qasshme tjetrit të dhënat të cilat paraqesin fshehtësi zyrtare ose i siguron të dhëna të tilla me qëllim që ato t'ia bartë personit të paautorizuar, ose kur kryerësi ka për qëllim që të dhënat e tilla t'i publikojë apo t'i shfrytëzojë jashtë territorit të Kosovës.

Veçori e kësaj vepre penale është se mund të kryhet edhe nga pakujdesia si dhe mund ta kryej edhe personi i cili në të kaluarën e tij ka qenë person zyrtar dhe ka pasur për obligim që ta ruaj fshehtësinë zyrtare.

5.13 Falsifikimi i dokumentit zyrtar

Vepra penale ekziston kur personi zyrtar në dokumentin zyrtar apo afarist, në regjistër apo shkresë shënon të dhëna të rreme ose nuk shënon të dhëna të rëndësishme ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar afarist, vërteton regjistrin zyrtar ose shkresën që përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrit ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme.

Ekzistojnë tri modalitete të falsifikimit të dokumentit:

1. Futja e të dhënave të pavërteta apo mos futja e ndonjë të dhëne të rëndësishme;
2. Vërtetimi i dokumentit, regjistrit apo shkresës së rreme dhe
3. Mundësimi i përpilimit të dokumentit, librit apo shkresës së pavërtetë me përmbajtje të rreme.

Forma e parë e veprës penale qëndron në përpilimin e dokumentit, regjistrit apo shkresës zyrtare me përmbajtje të rreme. Vepra është e kryer me shënimin në dokumentin e përmendur të të dhënave të rreme apo mos shënimin e të dhënave të rëndësishme. ***Forma e dytë*** e veprës qëndron në *vërtetimin* e dokumentit, regjistrit ose shënimit zyrtar me përmbajtje të rreme, duke e vënë në të nënshkrimin apo vulën. Vërtetimi duhet të bëhet nga personi zyrtar a personi përgjegjës, ndërsa për ekzistimin e veprës nuk është me rëndësi se cili person e ka përpiluar përmbajtën e rreme. ***Forma e tretë*** e veprës qëndron në ***mundësimin*** e përpilimit të dokumentit, regjistrit ose shkresës me përmbajtje të rreme.

Kjo formë e veprës penale konsumohet kur personi zyrtar, me nënshkrimin vet, përkatësisht me vulë zyrtare i jep mundësi tjetrit të vërë në dorë dokumentin apo regjistrin me përmbajtje të rreme, por me këtë rast kërkohet që personi zyrtar të dijë se personi tjetër në një dokument a regjistër të tillë do të shënoj të dhëna të pavërteta. Kjo vepër penale ekziston edhe kur personi zyrtar a personi përgjegjës shfrytëzon në veprimtarinë e tij afariste dokumentin e rremë zyrtar apo afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën zyrtare si të ishin të vërteta ose asgjëson, fsheh, dëmton apo në çfarëdo mënyre tjetër e bën të papërdorshëm dokumentin zyrtar ose afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën zyrtare.

Kryerës i të gjitha formave të veprës mund të jetë vetëm personi zyrtar ose personi përgjegjës. Veprat penale mund të kryhen vetëm me dashje.

5.14 Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme

Veprën e konsumon personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili nga dikush arkëton diçka që ai nuk është i detyruar të paguajë apo arkëton më tepër sesa që është i detyruar të paguaj ose ai që me rastin e arkëtimit a dorëzimit të ndonjë sendi, arkëton më pak përkatësisht dorëzon më pak. Pra, bëhet fjalë për veprën e drejtë zyrtare.

Sipas veprimit të kryerjes, vepra penale paraqitet në dy forma:

1. Arkëtimi i kundërligjshëm dhe
2. Pagesa e kundërligjshme.

Në rastin e parë, personi zyrtar ose personi përgjegjës arkëton nga dikush diçka që ai nuk është i detyruar të paguajë ose arkëton më tepër sesa që ky kishte borxh, edhe pse është i vetëdijshëm se detyrimi për pagesë nuk ekziston ose që nuk ekziston në shumën e kërkuar. Andaj, vepra nuk do konsumohej, nëse personi zyrtar gabimisht arkëton më tepër. Në rastin e dytë, personi zyrtar ose personi përgjegjës, me rastin e pagesës a dorëzimit të ndonjë sendi, paguan a dorëzon më pak

Kryerës i veprës penale mund të jetë vetëm personi zyrtar a personi përgjegjës, në fushëveprimin e punës së të cilit bëjnë pjesë punët e arkëtimit dhe pagesës.

Vepra penale kryhet me dashje.

5.15 Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor

Veprën e kryen personi zyrtar i cili gjatë bastisjes së lokaleve, kontrollimit të personit ose me rastin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo tjetrin.

Për ekzistimin e veprës penale është e nevojshme që sendi është marr me rastin e kryerjes së veprimeve të ligjshme të theksuara më parë nga personi zyrtar.

Vepra penale mund të kryhet vetëm me ***dashje direkte***, e që përfshinë edhe qëllimin e përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme.
Kryerës i veprës penale mund të jetë vetëm personi zyrtar.

5.16 Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare neni 437

Këtë vepër penale mund ta kryejnë personat zyrtar të cilët janë të obliguar në raportimin e pasurisë në bazë të ligjit për deklarimin, prejardhjen, dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave. Kjo vepër penale mund të kryhet me mos veprim atëherë kur nuk deklarohet brenda afatit ligjor pasuria dhe me veprim kur deklarohet në mënyrë të rreme pasuria.

Në kuadër të KPRK-së ekzistojnë edhe katër vepra penale të cilat konsiderohen si vepra penale me element korruptiv kjo bazuar në udhëzimin e kryeprokurorit të shtetit dhe këto vepra janë :

- Mundësimi i arratisjes së personave të privuar nga liria përcaktuar me nenin 406 të KPRK-së.
- Arratisja e personit nga liria nga neni 405 paragrafi 2 i KPRK-së.
- Dhënia e paarsyeshme e dhuratave nga neni 316 i KPRK-së dhe
- Lidhja e kontratave të dëmshme nga neni 291 paragrafi 2 i KPRK-së.

Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, Parlamenti i Republikës së Kosovës ka nxjerrë Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit i cili ka kompetencat e mëposhtme [300] .

- inicion dhe zhvillon procedurën e zbulimit dhe hetimit paraprak të korrupsionit dhe përcjellë kallëzime penale për rastet e dyshimit për korrupsion në prokurorinë publike kompetente, nëse për të njëjtin rast nuk zhvillohet procedurë penale;
- bashkëpunon me institucionet vendore, të huaja dhe ndërkombëtare që kanë për mision parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
- në bashkëpunim me Komisionin, Qeverinë, institucionet e tjera dhe me organizatat joqeveritare, harton strategjinë kundër korrupsionit dhe planin e veprimit;
- monitoron dhe mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë kundër Korrupsionit dhe planin e veprimit;
- mbikëqyrë dhe parandalon rastet e konfliktit të interesit dhe ndërmerr masat e parapara me ligj të veçantë;
- mbikëqyrë pasuritë e zyrtarëve të lartë publik dhe personave të tjerë, siç parashihet me ligj të veçantë;
- mbikëqyrë pranimin e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmerr masat e parapara me ligj;
- bashkëpunon me autoritetet publike kompetente për hartimin, harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
- përfaqësohet në takime ndërkombëtare që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe merr pjesë në procesin e negociatave për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale apo miratimin e instrumenteve ligjore ndërkombëtare kundër korrupsionit;
- bashkëpunon me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës për realizimin e detyrimeve që dalin nga aktet ndërkombëtare kundër korrupsionit dhe ofron rekomandime për përmbushjen e detyrimeve të tyre;
- merr pjesë dhe ofron këshilla për hartimin e kodit të etikës në sektorin publik dhe privat;
- ofron opinione në lidhje me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare;
- ofron sqarime në lidhje me mënyrën e deklarimit të pasurisë dhe çështje tjera nga fushëveprimi i Agjencisë;
- mbledh, analizon dhe publikon të dhënat statistikore ose të dhëna të tjera në lidhje me gjendjen e korrupsionit në Kosovë;
- bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për ngritjen e vetëdijes së publikut lidhur me korrupsionin;

[300] Neni 5 paragrafi 1 i Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit Ligji Nr.03/L – 159 i datës 29 dhjetor 2009, shpallur me dekretetin Nr. DL-006-2010, i datës 19 janar 2010.

- i raporton Kuvendit një herë në vit dhe Komisionit çdo gjashtë (6) muaj për punën e Agjencisë. Komisioni mund të kërkojë raporte edhe më të shpeshta nga Agjencia.
- përgatit dhe propozon buxhetin vjetor të Agjencisë.

Në kuadër të përpjekjeve për luftimin e korrupsionit, presidentja e Republikës së Kosovës, më datë 15 shkurt 2012, ka themeluar Këshillin Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Qëllimi i këtij këshilli është bashkërendimi i punës dhe aktiviteteve të institucioneve dhe agjencive në kuadër të kompetencave dhe fushëveprimeve të tyre për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Gjithashtu më qëllim të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, ka hartuar Planin Strategjik [301], për bashkëpunim ndër-institucional në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit 2013-2015, e cila është miratuar më datë 16 nëntor 2012.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të tij që burojnë nga Kushtetuta dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, përmes kësaj strategjie demonstron vullnetin dhe përkushtimin e vet në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Gjatë hartimit të kësaj strategjie Këshilli Prokurorial i Kosovës, ka marrë për bazë rekomandimin e Presidencës së këshillit të Bashkimit Evropian të datës 8 qershor 2011, nr.9225/4/11 REV 4. Po ashtu Këshilli Prokurorial i Kosovës, gjatë hartimit të kësaj strategjie, ka konsultuar, ka pranuar komentet dhe rekomandimet nga këto institucione: Policia e Kosovës, Doganat, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Agjencitë dhe institucionet që zbatojnë ligjin në Kosovë. Qëllimi i këtij Plani Strategjik është përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet sistemit prokurorial të Kosovës dhe institucioneve tjera të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, nëpërmjet kësaj strategjie, synon arritjen e këtyre synimeve:

- Përmirësimin e zbulimit, hetimit dhe ndjekjes së suksesshme të krimit të organizuar, posaqerisht në trafikimin e narkotikëvë, armëve dhe qenieve njerëzore,
- Përmirësimi i zbulimit, hetimit dhe ndjekjes se suksesshme te veprave penale të korrupsionit,
- Përmirësimi i zbulimit, hetimit dhe ndjekjes së suksesshme të veprave penale të shpëlarjes së parave,
- Përmirësimi i identifikimit të përfitimeve materiale nga veprat penale dhe ngritjen e nivelit të konfiskimit të përfitimeve materiale nga këto vepra penale,
- Ngritja e parandalimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe shpëlarjes së parave,
- Përmirësimi i kualitetit të informative dhe të dhënave statistikore që kanë të bëjnë me zbulimin, hetimin dhe ndjekjen e krimit të organizuar, shpëlarjes së parave dhe veprave të korrupsionit,
- Ngritja e vetëdijes publike në lidhje me përmirësimin e kualitetit të informatave të siguruara për publikun dhe media dhe përmirësimi i bashkëpunimit me publikun dhe mediat.

Këshilli Prokurorial i Kosovës do të emëroj ekspertët prokuror pas konsultimeve dhe marrëveshjes me Kryeprokurorin e Shtetit dhe Udhëheqësin/en e PSRK-së.

[301] Plan Strategjik për bashkëpunim ndër-institucional në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit 2013-2015, i miratuar me datën 16 nëntor 2012.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, do të krijoj një bazë të të dhënave mbi veprat penale specifike të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Sipas këtij plani strategjik, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit, duhet të bashkëpunojë dhe koordinohen me agjencitë dhe institucionet që zbatojnë ligjin në Kosovë, posaçërisht me: Policinë e Kosovës dhe Agjencinë Kundër Korrupsionit, në raportimin e përbashkët mbi të arriturat në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

6. Monitorimi dhe Vlerësimi i Zbatimit të Strategjisë

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të strategjisë është të përcillet dhe të sigurohet në vazhdimësi zbatimi i synimeve ndërkohë që Plani Strategjik është proces i vazhdueshëm.

Një raport monitorimi duhet t'i prezantohet Këshillit Prokurorial të Kosovës, çdo gjashtë muaj ose në bazë të kërkesave dhe më shpesh ashtu që të mundësohet verifikimi i progresit të kësaj strategjie dhe planit të veprimit.

Raporti duhet të përgatitet nga Njësia e Vlerësimit të Përformancës së Këshillit Prokurorial të Kosovës së bashku më ekspertët prokuror dhe PSRK-në. Vlerësimi i zbatimit të strategjisë, kryhet një herë në vit nga grupi punues i vlerësuesve i përbërë nga përfaqësues të institucioneve dhe agjencive të përfshira në plan, ekspertët përkatës prokuror dhe kreun e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Raporti i vlerësimit duhet të sigurohet dhe raportohet para Këshillit Prokurorial të Kosovës.

7. Përfundimi

Sigurisht që ka shumë për të thënë sa i përket veprave penale të korrupsionit. Mirëpo, ne jemi munduar që arsyeshëm të bëjmë këtë punim kërkimor shkencor dhe si konkludim për veprat penale të korrupsionit dhe për korrupsionin në përgjithësi. Nëse e bëjmë një krahasim lidhur me atë se çfarë është bërë në Kosovë sa i përket fushës së luftimit të veprave penale të korrupsionit, shihet se mbetet shumë për tu bërë.

Edhe përkundër bazës ligjore të mjaftueshme që ekziston por edhe bashkërendimit të institucioneve të ndryshme në Kosovë për luftimin e korrupsionit prap se prap përmasat e korrupsionit janë të mëdha dhe luftimi i këtyre veprave mbetet sfidë e madhe.

Korrupsioni si dukuri negative pengon zhvillimin e vendit sundimin e ligjit, fuqizimin e demokracisë, ndikon ne humbjen e besimit te qytetarëve në drejtësi dhe institucionet shtetërore, nxit qytetaret të kryejn vepra penale të korrupsionit, bën rritjen e dallimeve në mes të personave me pozita të larta udhëheqëse të cilët me anë të korrupsionit arrijnë të pasurohen brenda natës, ndikon në zhvillimin ekonomik pasi që investitorët e huaj nuk investojnë në shtetet me korrupsion të theksuar për shkak të pasigurisë.

Fenomeni i korrupsionit njëkohësisht ka qenë objekt i kritikave të shpeshta nga monitoruesit ndërkombëtar të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Arritja e një standardi më të lartë në këtë drejtim duhet të jetë objektiv kryesor i zbatuesve të ligjit dhe sistemit të drejtësisë në përgjithësi.

Bibliografia

- Ismet Salihu, E drejta penale (pjesa e posaçme), Prishtinë , 2014.
- Ligji kundër korrupsionit Nr.2004/34 i datës 22 prill 2005
- Ligji për Agjencinë kundër korrupsionit Nr. 03/L-159 i datës 29 dhjetor 2009, është shpallur me dekretin Nr. DL-006-2010, me datën 19.01.2010.
- Ligji për Deklarimin, Prejardhjen, dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik Nr.04/L-050 të datës 31 gusht 2011, shpallur me dekretin Nr.DL-028-2011, i datës 31.08.2011.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr.04/L-82 i datës 20 prill 2012 hyr në fuqi me datën 01 janar 2013.
- Plan Strategjik për bashkëpunim ndër-institucional në liftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit 2013-2015, i miratuar me datën 16 nëntir 2012.